



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



ZHVILLIME BASHKËKOHORE NË ESP

Punim për gradën “Doktor”

Specialiteti : Metodikë

Disertanti

Vanina KANINI (Bilimani)

Udhëheqës shkencor

Prof. As. Dr. Fatmir VRAPI

Tiranë, 2015



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



ZHVILLIME BASHKËKOHORE NË ESP

Punim për gradën “Doktor”

(Studim në Inxhinierinë Elektronike)

Specialiteti : Metodikë

KOMISIONI:

Mbrohet më datë __.__.2015

1. Prof. As. Dr. Elida TABAKU (Kryetar, Oponent)
2. Prof. Dr. Viktor RISTANI (Oponent)
3. Prof. Dr. Nikoleta MITA (Anëtar)
4. Prof.As. Dr. Luljeta BUZA (Anëtar)
5. Prof.As. Dr. Silvana VISHKURTI (Anëtar)

Mishel, Anës

...për durimin, mbështetjen, forcën, dashurinë...

FALENDERIME

Ky disertacion është fryt i një pune studimore disa-vjeçare në Universitetin Politeknik të Tiranës. Do të doja të falënderoja me zemër disa persona të cilët kanë dhënë ndihmesën e tyre për realizimin e kësaj teme.

Së pari, dua të shpreh falenderimet e përzemërta për udhëheqësin tim shkencor, Prof. As. Dr. Fatmir Vrapit i cili më është gjendur pranë në çdo moment dhe më ka ndihmuar e këshilluar pa kursim në çdo hap të kërkimit tim. Këshillat e tij, shtysa për të ecur përpara, besimi që pati në aftësitë e mija, ishin një forcë madhe që unë ta mbaroja me sukses punimin tim.

Falenderim të veçantë kam për mikeshat e mia Lindita, Jola, Edita, Merita të cilat më kanë inkurajuar e dhënë zemër që unë të ecja përpara edhe kur kishte raste që besoja se e kisha të vështirë. Mirënjohje e falënderim edhe studentëve të FTI, dega Inxhinieri Elektronike që më përkrahën në këtë nisëm dhe u përballën me të gjitha vështirësitë suksesshëm. Në veçanti iu jam mirënjohëse drejtuesve të Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit, dega Elektronikë, të cilët i janë larguar retorikes mbi reformimin e kurrikulave në kuadrin e Bolonjës dhe i janë vënë punës për një ristrukturim të plotë të mënyrës së përgatitjes së inxhinierëve në fushat respektive.

Njëherazi, do të shprehja mirënjohjen time të thellë për drejtuesit e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, e në veçanti Departamentit të Gjuhës Angleze, të cilët kanë qenë pjesë e formimit tim që kur isha studente e këtij fakulteti e deri kur më dhanë mundësinë dhe mbështetjen e tyre për kryerjen e studimeve të doktoraturës. Faleminderit Prof. Viktor Ristani, Prof.As.Dr. Elida Tabaku, Prof. të ndjerë Hamlet Bezhani, Prof.Shpresa Delija që nuk janë kursyer për të më udhëzuar, orientuar e ndihmuar me materiale të nevojshme për studimet e mija.

Një falenderim që del nga zemra, shkon për familjen time të shtrejtë. Kelin, bashkëshortin dhe shokun tim më të mirë i cili ka besuar tek mua dhe më ka inkurajuar gjithmonë në punën time. Vajzave të mija Mishel dhe Ana, të cilave shpesh ju ka munguar prania ime, i them që “mami ju do pa fund e do buzëqeshi më shumë”. I falenderoj dhe me vjen keq për momentet e munguara por shpresoj t’ia kompensoj shumë shpejt...

Mamit, babit, për ndihmën e pa kursyer në rritjen e fëmijëve dhe u them që nuk ka asgjë në botë që mund t’ua shpërblej ndihmën që më keni dhënë.

Motrës sime të shtrenjtë e të vetme, Andia, për mendimet e saj kritike, për përkrahjen e dashurinë.

Arjanës së dashur një falenderim special. Ajo ka qenë njeriu që ka besuar gjithmonë në aftësitë e mija dhe më ka inkurajuar dhe shtyrë drejt vendimeve më të rëndësishme të jetës sime.

PASQYRA E LËNDËS

FALENDERIME	ii
A. TABELA E SHKURTESAVE	viii
B. SHKURTIME NGA GJUHA ANGLEZE	viii
HYRJE.....	ix
0.1. <i>Përligja e punimit</i>	ix
0.2. Objekti dhe hipotezat e punimit.....	x
0.3. Metodologjia dhe struktura e punimit.....	xii
KREU I.....	1
MËSIMDHËNIA E GJUHËS ANGLEZE TË PROFESIONIT NË UPT DHE ROLI I ESP-së NË KËNDVËSHTRIMIN E LITERATURËS BASHKËKOHORE.....	1
1.1. Kuadër i përgjithshëm historik i Anglishtes për Qëllime të Veçanta	1
1.2. Teoritë e përkufizimit të ESP-së.....	2
1.2.1. Çfarë është ESP-ja?	2
1.2.2. Çfarë NUK është ESP-ja?.....	5
1.3. Klasifikimi i kurseve të ESP-së sipas pemës së Hutchinson dhe Waters	7
1.4. Cilat janë disa nga tiparet që karakterizojnë kurset e ESP-së.....	9
1.5. Ndryshimet ndërmjet EST dhe ESP.....	10
1.6. Mësimdhënia e ESP-së dhe kërkesat e saj në mjediset e UPT-së.....	12
1.6.1. Pse dhe a duhet të ndryshojë sistemi i mësimit të gjuhëve të huaja sot?	12
1.6.2. Ndikimi i përmirësimit të gjuhës së huaj në procesin e reformimit.....	14
1.7. Puna dhe roli i mësuesve të ESP-së.....	17
1.7.1. Mësuesi i ESP-së në rolin e projektuesit të kursit dhe përgatitjes së materialeve mësimore.....	18
1.7.2. Mësuesi i ESP-së si përpilues i materialeve të vëna në përdorim për studentët	18
1.7.3. Mësuesit e ESP-së si bashkëpunëtor.....	18
1.7.4. Mësuesi i ESP-së si një vlerësues.....	19
1.7.5. Trajnimi i mësimdhënësve të ESP-së	19
1.7.6. Mësuesi përcakton situatën në të cilën studenti do e përdori gjuhën.....	22
1.7.7. Një qasje me qendër të mësuarit	23
1.8. Nivelet Gjuhësore në Kurrikulat e UPT.....	24
1.8.1. Mësimi i gjuhëve dhe politikat Evropiane.....	25

GJUHËT E HUAJA SI PRIORITET KOMBËTAR PËRBALLË NDRYSHIMIT DHE
REFORMAVE. INSTRUMENTET BAZË NË REFORMIMIN E KURRIKULAVE NË UPT.32

2.1.	Kontekst i përgjithshëm.....	32
2.2.	Instrumentet në ndihmë të reformimit të kurrikulave të gjuhës së huaj.....	32
2.2.1.	Kuadri Evropian i Kualifikimit (K.E.K.).....	33
2.2.1.1.	Kompetencat bazë.....	33
2.2.1.2.	Angazhimet dhe sfidat në nivel kombëtar dhe sectorial	34
2.2.1.3.	Synimet dhe funksionet e një K.E.K-u	34
2.2.1.4.	Nivelet e referencës së përbashkët të rezultateve të të nxënësve.....	35
2.2.1.5.	Rezultatet e të nxënësve.....	36
2.3.	Kuadri i kualifikimit: mjet për mbështetjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës	36
2.4.	Nevoja për reformë kurrikulare në Arsimin e Lartë	37
2.5.	Parime të përgjithshme të kornizës kurrikulare	40
2.6.	Teknologjia sipas Draftit të Kornizës së re Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar	43
2.7.	Vështrim analitik mbi programet ekzistuese.....	44
2.7.1.	Silabuset ekzistuese	45
2.7.2.	Materialet që vihen në përdorim.....	46
2.7.2.1.	Roli i Pedagogëve	48
2.7.2.2.	Roli i studentëve	48
2.7.2.3.	Burimet	52
2.8.	Qëllimet e veçanta të kurrikulumit dhe silabusit të gjuhës së huaj.....	53
2.8.1.	Plani mësimor	54
2.8.2.	Udhëzuesi i kurrikulave lëndore	54
2.8.3.	Programi lëndor, teksti i nxënësve dhe detyrësve.....	55
2.9.	Qëllimet përfundimtare të lëndës.....	55
2.9.1.	Përmbajtja e lëndës	55
2.9.1.1.	Përzgjedhja e formës së silabusit	59
2.9.1.2.	Formati Linear	59
2.9.1.3.	Formati Modular	59
2.9.1.4.	Formati Ciklik.....	60
2.9.1.5.	Formati Matriks	60
2.9.2.	Përzgjedhja e metodës	61

2.9.3.	Vendi i objektivave në përzgjedhjen e metodave të mësimdhënies së gjuhës së huaj.....	62
2.9.4.	Zhvillimi i Kurrikulës mbi bazën e Metodës	62
2.9.5.	Llojet e silabuseve mbi bazën e KEK dhe Metodës	64
KREU III		66
ANALIZA E NEVOJAVE DHE ZBATIME KONKRETE SI NJË UËDHËZUES PËR NDËRTIMIN E PROGRAMEVE MBI BAZËN E QËLLIMEVE, OBJEKTIVAVE DHE PËRMBAJTJES.....		66
3.1.	Analizë e programeve të gjuhës angleze në UPT në vite.....	66
3.2.	Ndryshimet e silabuseve ndër vite në FTI, UPT	67
3.2.1.	Çfarë pritej nga studentët e nivelit fillestar?	68
3.2.2.	Çfarë pritej nga studentët e Nivelit mesatar të ulët?	69
3.2.3.	Çfarë pritej nga niveli i lartë mesatar i studentëve?.....	70
3.2.4.	Çfarë pritet nga studentët e Nivelit të avancuar?	70
3.3.	Analiza e planeve në vite	71
3.4.	Ndryshimet ndërmjet metodave GE dhe ESP	75
3.5.	Arritjet në komunikim.	81
3.6.	Karakteristikat e stilit tekniko - shkencor	83
3.6.1.	Baza teorike mbi stilin teknik - shkencor	86
3.6.2.	Një ndryshim i veçantë	89
3.7.	Rëndësia që ka analiza e nevojave për ndryshimet në program	93
3.7.1.	Analiza e nevojave.....	93
KREU IV		95
ZBATIME PRAKTIKE TË ANALIZËS SË NEVOJAVE. NDIKIMI I SHKRIMIT TË GJUHËS ANGLEZE TEKNIKE TEK STUDENTËT E INXHINIERISË ELEKTRONIKE. STUDIM RASTI		95
4.1.	Identifikimi i nevojave të studentit	95
4.2.	Informacion rreth kursit të gjuhës angleze për inxhinierët	98
4.2.1.	Përcaktimi i termave	99
4.3.	Ndikimi i shkrimit teknik në kurset e inxhinierive të Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit, dega Inxhinieri Elektronike (Studim rasti)	100
4.3.1.	Parime pedagogjike të gjuhës për një shkrim të suksesshëm.....	101
4.3.2.	Objekti i studimit	105
4.4.	Analizë e rezultatit të sondazhit të kryer me studentët e vitit të tretë, dega Elektronikë	105

4.5. Pasqyrë e funksionimit të metodës Engineering.....	112
4.5.1. Ri-organizimi i orës së mësimit pas sondazhit	116
4.5.2. Çfarë materialesh u përzgjedhën e mbi çfarë bazash?.....	118
4.5.3. Cilat ishin reagimet e studentëve dhe rezultatet e arritura?	126
4.6. Gramatika si pjesë e shkrimit teknik dhe problemet që shfaqën studentët gjatë punës së tyre	126
4.7. Problemet që hasin studentët me klasifikimet sipas kritereve teknike.....	133
4.7.1. Dykuptimësia sintaksore.....	134
4.7.2. Karakteristikat e komunikimit teknologjik efektiv	136
4.7.2.1. Saktësia	137
4.7.2.2. Konciziteti/Ngjeshja	138
4.8. Përfundime.....	138
KREU V	142
ANALIZA E METODËS “ENGINEERING”. PËRVETËSIMI I FJALORIT DHE PROBLEMET ME LEXIMIN E TEKSTEVE TEKNIKE. STUDIM RASTI.....	142
5.1. Probleme me të cilat përballen studentët me metodën e gjuhës angleze “Engineering”	142
5.1.1. Përzgjedhja e teksteve në mësimin e ESP-së.....	142
5.2. Analiza e tekstit “Engineering”	143
5.3. Fjalori teknik dhe ndikimi i tij në mësimin e gjuhës angleze të profesionit	156
5.3.1. Pasqyrë e shkurtër rreth mësimit dhe përvetësimit të fjalorit të ESP-së si dhe zbatimit të tij me studentët e Inxhinierisë Elektronike në UPT	156
5.3.1.1. Kategoritë e fjalorit.....	157
5.3.1.2. Teksti gjuhësor.....	159
5.4. Trajtimi i fjalorit të gjuhës teknike në degën e Inxhinierisë Elektronike.....	160
5.5. Çfarë arrihet nëpërmjet kësaj praktike me studentët?.....	162
5.6. Parashtrimi i studimit. Objekti dhe pyetjet kërkimore	163
5.6.1. Pjesëmarrësit dhe procedurat	163
5.6.2. Procedura e mbledhjes së të dhënave	163
5.6.3. Analiza e të dhënave	163
5.6.4. Rezultatet e studimit	167
5.6.4.1 Sfidat e mësuesve të ESP-së në mësimin e fjalorit	168
5.6.4.2. Aftësimi i pedagogëve në mësimdhënien e fjalorit teknik.....	169
5.6.4.3. Teknika të ndryshme të aplikuara gjatë orës së mësimit dedikuar fjalorit teknik.....	169

5.7.	Ndikimi që ka leximi i materialeve të gjuhës angleze me terma teknik tek studentët e UPT-së	175
5.7.1.	Procedura dhe rezultatet.....	179
5.7.2.	Si të shpjegojmë materialin e përzgjedhur.....	181
5.7.3.	Analiza e përgjigjeve të studentëve	183
5.7.4.	Analiza e përgjigjes së pedagogëve	184
	PËRFUNDIME.....	185
	PERSPEKTIVA PËR KËRKIME TË MËTJESHME.....	194
	BIBLIOGRAFI.....	196
	204
	SHTOJCA	204

A. TABELA E SHKURTESAVE

KPER	KUADRI I PËRBASHKËT EVROPIAN I REFERENCAVE
UPT	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FTI	FAKULTETI I TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT
FGJM	FAKULTETI I GJEOLGJI MINIERAVE
FIMIF	FAKULTETI INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
QGJH	QENDRA E GJUHËVE TË HUAJA
KEK	KUADRI EVROPIAN I KUALIFIKIMEVE

B. SHKURTIME NGA GJUHA ANGLEZE

ESP	ENGLISH FOR SPECIAL PURPOSES
ESS	ENGLISH FOR SOCIAL SCIENCES
EMT	ENGLISH AS A MOTHER TOUNGE
EFL	ENGLISH AS A FOREIGN LANGUAGE
ESL	ENGLISH AS A SECOND LANGUAGE
GE	GENERAL ENGLISH
EST	ENGLISH FOR SCIENCE AND TECHNOLOGY
EBE	ENGLISH FOR BUSINESS AND ECONOMICS
EAP	ENGLISH FOR ACADEMIC PURPOSES
EOP	ENGLISH FOR OCCUPATIONAL PURPOSES

HYRJE

0.1. Përligja e punimit

Përvoja prej 14 vitesh, si pedagoge e gjuhës së huaj në Fakultetet e Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), si përpunuese materialesh teknike, sidomos në fushën e inxhinierisë elektronike, më kanë mundësuar të njihem jo vetëm me terminologjinë e kësaj fushe, me termat, por edhe me anën përmbajtëse, me konceptet. Kjo më ka shtyrë që, mbi bazën e njohurive përkatëse dhe të përvojës së fituar, të ndërmerrija shkrimin e artikujve: ‘Ristrukturimi i Kurrikulës së gjuhës së huaj në UPT’, paraqitur në Konferencën Ndërkombëtare të Katedrës së Gjuhëve të Huaja Sllave dhe Ballkanike me temë “Dialogu midis gjuhëve, kulturave dhe qytetërimeve Ballkanike”; “Për një reformë kurrikulare për anglishten për qëllime specifike”, konference Kombëtare e F.I.M.F, në UPT me temë “Studime të avancuara në inxhinierinë matematike, fizike dhe kimike”; “Përzgjedhja e teksteve në mësimin e ESP”, Konferenca Ndërkombëtare e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, departamenti i Gjuhës Angleze me temë “Scholarly explorations of English Language and Culture”; Konferenca ndërkombëtare e albanologjisë botuar në “Kërkime Gjuhësore”, vëllimi II“ artikulli me temë: Analiza e nevojave të gjuhës së huaj tek studentët të cilët studiojnë në Fakultetin e Gjeologji-Minierave”; Artikullin me temë “Albanian students among changes and challenges in learning ESP courses”, botuar në revistën ruse “Lingua Mobilis”, “Një metodikë për hartimin e kurseve të ESP-së për studentët shqiptarë të cilët studiojnë në fushat e inxhinierisë, teknologjisë dhe informatikës”, artikull i botuar në Buletinin e Shkencave Teknike të UPT-së; “Ndikimi i përmirësimit të gjuhës së huaj në procesin e reformimit në UPT”, artikull botuar në Revistën Pedagogjike.

Rëndësia e arsimit dhe bashkëpunimit arsimor në zhvillimin dhe forcimin e shoqërive të qëndrueshme, paqësore dhe demokratike është pranuar mbarë botërisht si thelbësore. Në kuadrin e efikasitetit në kornizat kohore dhe të angazhimeve të mësipërme shtrohet edhe çështja e mësimin më shpejt e më cilësish të gjuhës së huaj të profesionit. Ajo patjetër që përbën një dimension të kërkuar të të diplomuarit në kuadrin e nevojave për integrim evropian. Duke parë ndryshimet e shumta që po ndodhin në arsimin e lartë atëherë na lind nevoja e përmirësimit të kurrikulës së mësimdhënies së gjuhës së huaj në Universitetin Politeknik, si dhe në të gjithë fakultetet e Shqipërisë, tanimë që kërkesa zyrtare për mbrojtjen e gjuhës angleze në nivele të përparuara përmes provimeve ndërkombëtare (TOEFL, TOEIC, BULLATS etj.) në përfundim të kualifikimeve Bachelor, Master e Doktoraturë i ka vendosur nxënësit, studentët, mësuesit e pedagogët e gjuhëve përpara një përgjegjësie të madhe. Sigurimi i vlerave të shoqërisë në vendet e zhvilluara evropiane në drejtim të reformës kurrikulare synon zhvillimin e temave kros-kurrikulare duke i kushtuar rëndësi dimensionit evropian, duke e konsideruar këtë si një pjesë integrale të kurrikulit universitar.

Në vështrimin kurrikular, lënda e gjuhës së huaj në Universitetin Politeknik të Tiranës bazohej pesë vite më parë në anglishten e formimit të përgjithshëm, ku përfshihej gramatika si dhe situata të jetës së përgjithshme. Në funksion të tij ekziston një program i gjuhës së huaj për të gjithë fakultetet të cilat përfshihen në Politeknik, pra si studentët e inxhinierisë elektronike, si ato mekanike, informatike, gjeodezi, arkitekturë, ndërtim etj., zhvillojnë të njëjtin tekst.

Në kushtet e kërkesave të shoqërisë dhe të tregut të punës, këto fakultete sipas niveleve synojnë të përgatisin inxhinierë me aftësi bazë në fushën profesionale si dhe të përgatisin teknik të lartë me aftësi të domosdoshme profesionale për t'u përshtatur me kërkesat e ekonomisë së tregut. Lënda e gjuhës së huaj për qëllime specifike si në vendet evropiane për këto fakultete, edhe në vendin tonë duhet të zërë një vend të rëndësishëm i cili të jetë në funksion të specialitetit të universitetit.

E nxitur nga rezultatet e arritura, mbi bazën e thellimit të mëtejshëm të njohurive teorike dhe praktike në fushën e ESP-së (Gjuha Angleze për Qëllime të Veçanta), duke analizuar nevojat e studentëve, kërkesat e tyre gjithnjë e në rritje, kërkesat e tregut të punës dhe shoqërisë, vendosëm të ndërmarrim një studim të gjerë e të plotë, duke pasur si objektivi zhvillimet bashkëkohore në fushën e ESP-së të cilat janë të shtrira në një gamë të gjerë dhe të larmishme. Më konkretisht, studimi ynë është përqendruar në degën e Inxhinierisë Elektronike. Nën udhëheqjen shkencore të Prof.As.Dr. Fatmir Vrapit, arritëm të bëjmë përpunimin e materialit të mbledhur, trajtimin sistemor të tij si dhe paraqitjen e temës.

Nga hulumtimet e arritura gjatë këtij punimi, ne mendojmë se meritojnë një vëmendje të veçantë aplikimi i ESP-së në fushën e inxhinierisë elektronike si dhe në të gjitha degët e inxhinierive në fakultetet e UPT-së, materialet e përzgjedhura për përdorim, si dhe konkretizimi i punës së arrirë me studentët të cilët janë edhe inxhinierët e ardhshëm.

Përveç kësaj, në përfundimet e nxjerra në punim janë edhe rekomandime lidhur me domosdoshmërinë e hartimit të kurrikulave dhe silabuseve të reja të ESP-së në fushat e inxhinierive. Po kështu, me interes të veçantë do të ishte hartimi i një fjalori me terma teknike i ndërtuar mbi bazën e nevojave të studentëve Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit (FTI) ku pjesë e saj është edhe dega e inxhinierisë Elektronike në UPT si dhe materialeve të vëna në përdorim nga vetë studentët.

Shpresoj që ky studim, sado që shumë i përgjithshëm, ashtu siç është edhe vetë tema e tij, të ndihmojë për të vijuar rrugën e studimit të ESP-së, e cila është një botë e madhe dhe që ka shumë për tu studiuar e punuar më tej

0.2.Objekti dhe hipotezat e punimit

Në këtë punim metodiko - shkencor vështrohet zhvillimi i ESP-së dhe praktika e saj në FTI dega Inxhinieri Elektronike, sjellja e termave teknike dhe literaturës në gjuhën teknike, ndikimi që ka shkrimi, leximi tek studentët, mënyra e përfutimit të terminologjisë, përshtatja e teksteve teknike në gjuhën shqipe si dhe ndërtimi i një plani të ri të përshtatshëm për studentët të cilët studiojnë në këtë fakultet.

Ky punim është menduar për të krijuar një pasqyrë të realitetit të mënyrës së funksionimit të gjuhës angleze për qëllime të veçanta në fakultetet e UPT-ës duke nxjerrë në pah anët pozitive dhe mangësitë, si dhe duke sjellë një produkt i cili do të ketë vlerë dhe t'ju vijë në ndihmë pedagogëve të ESP-së dhe studentëve të cilët janë të interesuar në studimin e gjuhës angleze për qëllime të veçanta si dhe ti japë përgjigje këtyre pyetjeve disa dhe në formën dhe hipotezave të ngritura nga ne:

Hipoteza 1: A i përmbush programi ekzistues nevojat e studentëve dhe a përkon ai me nevojat e kësaj fushe?

Hipoteza 2: A duhet përfshirë shkrimi teknik në kurrikulën e gjuhës së huaj në mënyrë që të zhvillojmë kompetencën e shkrimit për kurset e inxhinierisë Elektronike?

Hipoteza 3: Cilat janë sfidat kryesore pedagogjike dhe gjuhësore me të cilat përballen pedagogët e ESP-së në QGJH, UPT të cilët u mësojnë gjuhën dhe fjalorin teknik studentëve të fakulteteve të inxhinierive dhe zgjidhjet që ata ofrojnë në përpjekjet për të sjellë në mënyrë sa më efikase për përvetësimin e fjalorit teknik?

- 1) Si mund ta rrisim ndërgjegjësimin e universiteteve në Shqipëri mbi mangësitë që kanë për materiale dhe literaturën mbi gjuhën e specialitetit?*
- 2) Si mund të inkurajojmë një dialog profesional mbi këtë çështje?*
- 3) Si të zhvillojmë mënyra të ndryshme bashkëbisedimi në anglishten e shkruar, të folur, dëgjimin dhe leximin?*
- 4) A mund të përgatisim dhe përpunojmë materiale, si p.sh mësimet udhëzuese si dhe plane mësimore për pedagogët e gjuhës angleze të cilët duan të japin mësim gjuhën angleze për qëllime të veçanta në këto fakultete dhe t'u japim atyre mundësinë për të gjetur burimet e nevojshme për të zhvilluar e përpunuar materialet e tyre didaktike?*
- 5) Si mund të zhvillojmë studime të pavarura mbi materiale apo burime të ndryshme për ata të cilët janë të interesuar të merren me botën e ESP-së?*
- 6) Si të kontrollojmë dhe përshtatim materialet ekzistuese mbi ESP-në dhe për si ti vënë ato në funksion të studentëve?*
- 7) Si të inkurajojmë kërkime të thelluara për metodat më të mira në universitetet në Shqipëri të cilat vënë në funksion gjuhën angleze të specialitetit?*

Prej pyetjeve dhe hipotezave të parashtruara më sipër janë realizuar studime të posaçme e në koherencë të plotë me standardet pedagogjike për vlerësimin e një sërë treguesve të matshëm, rezultatet e të cilëve do të pasqyrojnë me vërtetësi nevojat për ndryshime dhe përmirësime në programet ekzistuese.

Punimi konsiston në një pikëpamje të përgjithshme të disa çështjeve dhe gjuhës së specialitetit të përdorur në FTI, dega inxhinieri Elektronike, mbi eksperiencat e pedagogëve dhe studentëve. Çdo fakultet ka rregullat dhe planet përkatëse mbi mësimin e gjuhës së huaj, të organizuar në mënyra të specifikuar secila, ku jepen synimet dhe se çfarë mendohet të arrihet në fund të çdo kursi.

Janë të ndryshme numri i krediteve, kohështirja, mënyra e organizimit të orëve, materialet, procesi mësimor, plani si dhe testimet e vlerësimit. ESP shihet në këndvështrime të ndryshme në fakultete të ndryshme. Gjuha e inxhinierive, e cila konsiston në një larmi termash e përkufizimesh si dhe elementesh gramatikë në shkrimet shkencore teknike, na siguron një kontekst të pasur për analizat gjuhësore. Dokumentet elektronikë në vetvete janë të shumtë dhe më vlera të veçanta për studim.

Punimi e fokuson vëmendjen në atë se çfarë do të mund të ndihmojë jo-anglisht folësit në punën e tyre të inxhinierisë.

Së pari, ekzaminohet gjuha; komunikimi verbal, me telefon, me grupe të ndryshme diskutimi, në leksione, në lajmërimi, etj.; format e bashkëbisedimit të shkruar të cilat përfshijnë dokumente, shënime, tekste librash, projekte, artikuj kërkimorë, materiale reference, terma inxhinierie, teknike si dhe shënime jo formale dhe mesazhe. Temperamenti që ka secili individ, eksperiencia jetësore, si dhe orientimet filozofike mund të ndikojnë gjithashtu në mënyrën se si komunikojnë njerëzit.

Duke parë shumëllojshmërinë e materialeve që mund të gjenden mbi gjuhën e ESP-së në fushën e inxhinierisë elektronike, fokusi është përqendruar në tre çështje që kanë të bëjnë me termat teknik elektronikë:

- a) elementet e mësimdhënies së ESP-së,*
- b) gjuha e mjediseve të elektronikës teknologjisë dhe informacionit, si dhe*
- c) gjuha e përdorur në jetën e përditshme nga inxhinierët elektronikë në punën e tyre.*

0.3. Metodologjia dhe struktura e punimit

Për të argumentuar idetë në punim jemi mbështetur në literaturën bashkëkohore, si dhe nga tekste bazë mësimore e standarde teknike me të cilat studentët dhe në si pedagogë të gjuhës së huaj të profesionit hasemi çdo ditë. Këtu synohet mësimdhënia e gjuhës së dytë si dhe nevojat që kanë studentët, përfshirë rezultatet dhe arritjet.

Për realizimin e studimit, mbi rrugët për të përmirësuar kurrikulën e gjuhës së huaj në fakultetin e inxhinierisë elektronike në Universitetin Politeknik, me qëllim shndërrimin e saj në një instrument profesional në ndihmë të specialistëve të rinj të përballur me nevojat e integritimit në hapësirën evropiane të punësimit dhe kërkimit, përdoren një sërë teknikash.

Së pari ka qenë studimi i literaturës mbi reformimin e shkollave të larta në kuadrin e Bolonjës. Janë analizuar burime të literaturës si në aspektin e hartimit të reformës (dokumente të ardhura nga Këshilli i Evropës, Komuniteti Evropian, Struktura Universitare Evropiane) ashtu edhe dokumente të implementimit të saj (materiale të përpunuara nga pedagogë e drejtues të universiteteve shqiptare).

Së dyti studiohet specifika e reformimit të kurrikulës së gjuhës së huaj.

Së treti bëhet analiza e nevojave dhe përpjekjeve aktuale në Qendrën e Gjuhëve të Huaja (QGJH) në Universitetin Politeknik dhe në departamentet lëndore të inxhinierisë elektronike.

Së katërti merret në konsideratë shpresa e studentëve të inxhinierisë elektronike në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Së pesti krahasohet dhe përvoja e mësimimit të gjuhës së huaj në universitete të huaja me përvojë të arrirë.

“Të dhëna si nga nxënësit, nga mësuesit dhe nga studentët, konsiderohen thelbësore nëse materiali që duhet marrë, është i saktë dhe që i ndihmon nxënësit që të mësojnë në mënyrë efikase”¹. Ai i adresohet studentëve të cilët mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të dytë të profesionit. Mësuesit e gjuhës familjarizohen me proceset e mësimin të ESP-së, por ndoshta jo me këtë përmbajtje të veçantë. Studentët e ESP-së, si dhe të tjerë që do të lexojnë këtë punim, mund të kenë formime arsimore të ndryshme, si p.sh. gjuhëtarë, punonjës të administratave apo fusha të tjera pune apo studimi. Kjo pjesë përfshin informacion rreth standardeve të përmbajtjes, kornizave kurrikulare, objektivave udhëzuese si dhe modele të planeve mësimore.

Në këtë punim metodik – shkencor trajtohet zhvillimi i gjuhës së huaj për qëllime specifike, se si ka lindur, është zhvilluar, arsytet të cilat çuan në zhvillimin dhe lëvrimin e kësaj gjuhe specifike dhe më pas se si aplikohet ajo në FTI, UPT, si e presin studentët e inxhinierisë elektronike mësimin e termave teknike në gjuhën angleze, sfidat dhe vështirësitë në përvetësimin e saj.

Ky punim përfshin krijimin e një lloji udhëzuesi mbi mësimdhënien e ESP-së për studentët dhe pedagogët si dhe praktikues të tjerë të ESP-së në fakultetet e UPT-së, të cilët nuk e kanë gjuhën angleze si gjuhën e tyre të parë.

Punimi konsiston në pesë kapituj dhe trajton çështje të funksionimit të ESP-së në FTI, UPT, procesin e mësimdhënies së gjuhës së huaj në fushën e specialitetit, problematikat, sfidat, gjuhën, specifikat, kërkesat dhe objektivat që parashtron secila si dhe cilat janë përfundimet dhe qëllimet e fakultetit ku kjo metodë aplikohet.

Punimi metodik – shkencor “Zhvillime bashkëkohore në ESP” (Rast studimi në UPT, inxhinieri Elektronike) është ndërtuar në pesë kapituj si më poshtë:

Hyrja përbën pjesën paraqitëse të punimit, ku parashtrohen rëndësia dhe motivimi i temës së ndërmarrë, si dhe hapësira e shtrirjes së saj. Aty argumentohen gjithashtu karakteristika të zhvillimit të materialeve të ESP, evoluimi dhe përpunimi i materialeve të ESP. Në hyrje paraqiten përlligja, qëllimet, objekti i studimit, metodologjia e ndjekur, baza teorike si dhe struktura e temës.

Kreu parë trajton disa çështje të përgjithshme, ku si fillim kemi një historik të përgjithshëm të lindjes dhe zhvillimit të ESP. Ky kapitull përmban gjithashtu një përshkrim të shkurtër me karakter njohës mbi temën si dhe synimet e objektivat e parashikuara për tu trajtuar në këtë punim. Në këtë kuadër, që në fillim shprehet ideja se kërkimet dhe studimet shkencore janë përherë evolutive e të pafundme, duke dhënë idenë e rizbulimit dhe rivlerësimit pas çdo riciklimi kohor vëzhgues, shqyrtues e shkencor të materialeve studimore rreth gjuhës.

Kreu dytë Në këtë kapitull ne kemi trajtuar gjuhët e huaja si prioritet kombëtar përballë ndryshimeve e reformave duke pasur parasysh edhe nevojat e tregut dhe ndryshimet në reforma. Këtu kemi trajtuar instrumente të ndryshëm që vijnë në ndihmë të reformës duke pasursi qëllim të paraqesim një rrugë të re për përgatitjen e një programi mësimor, ku leximi, shkrimi, mësimi i fjalorit të jenë pjesë thelbësore dhe kyçe e përgatitjes së planit

¹ Jordan, R. R. (1997). *English for academic purposes: A guide and resource book for teachers*. Cambridge: Cambridge University Press.fq.138

mësimor në Fakultetet e Inxhinierive në UPT. Për të realizuar këtë, ne kemi tentuar të përmbledhim kontributet më të nevojshme që kanë lidhje me aspektet teorike të cilat kanë të bëjnë me nevojat e studentëve të cilët mësojnë gjuhën e huaj angleze në degën e inxhinierisë elektronike në UPT-së si dhe analizën e nevojave.

Kreu tretëka për qëllim të përcaktojë dhe përforcojë rëndësinë e nevojave të studentëve dhe analizën e nevojave në një çështje studimi të mësimin të gjuhës Angleze. Gjatë zhvillimit të këtij kapitulli, ne kemi tentuar të përmbledhim kontributet më të nevojshme që kanë lidhje me aspektet teorike dhe praktike të nevojave të studentëve që mësojnë gjuhën e huaj angleze të profesionit në fakultetet e UPT-së. Kapitulli ndahet në dy pjesë: në pjesën e parë të tij trajtohet identifikimi i nevojave të studentëve të cilët studiojnë në fakultetet e UPT si dhe një pasqyrë e trajtimit të gjuhës së huaj të specialitetit në këto fakultetet ndër vite ku kemi bërë një analizë të hollësishme të planeve mësimore që nga vitet 90' e deri në ditët e sotme. Në pjesën e dytë, jemi marrë me zhvillimin profesional të aftësive gjuhësore, ku kemi trajtuar dhe analizuar stilin teknik shkencor.

Kreu katërt përfshin një trajtim edhe me konkret të analizës së nevojave, ku në bazë të pyetësorëve e intervistave është nxjerrë në pah nevoja e përmirësimit të shkrimit shkencor të shoqëruara këto edhe me raste konkrete të përvojës sonë në Fakultetet e Inxhinierive. Këtu përfshihet informacion rreth kursit të gjuhës angleze në fakultetin e inxhinierisë Elektronike dhe të gjitha fakultetet e UPT-së. Do trajtojmë ndikim që ka shkrimi, parime pedagogjike të gjuhës për një shkrim të suksesshëm. Këtu në këtë kapitull kemi paraqitur edhe një pasqyrë të metodës “Engineering” nga ku kemi paraqitur me detaje edhe zbatime praktike të kësaj metode. Me praktikën e shkrimit dolën në pah edhe gabime gramatikore të cilat i kemi analizuar gjatë kapitullit. Trajtimi dha parashtrimi i shembujve konkretë të nxjerrë nga përvoja jonë do të përmirësonte edhe më tepër imazhin cilësor e statistikor të disertacionit.

Kreu pestë Në këtë kapitull ne kemi bërë një analizë të detajuar të metodës “Engineering” të cilën e kanë në përdorim të gjitha fakultetet e UPT-së. Kjo analizë u bë mbi bazën e pyetësorëve drejtuar studentëve të Inxhinierisë Elektronike dhe pedagogëve të QGJH-së me qëllim që të përmirësojmë cilësinë e mësimdhënies dhe ti përshtatemi nevojave të studentit. Në mbyllje do të nxjerrim disa përfundime e vlerësime nga vëzhgimet e rezultatit e arritura përmes këtij studimi. Një vend të rëndësishëm në këtë kapitull zë edhe leximi i teksteve të specialitetit si dhe përvetësimi i fjalorit nga studentët e inxhinierisë elektronike.

Konkluzione

Ky punim do të diskutojë origjinat e ESP-së, çështje kyçe rreth ESP-së dhe do të ekzaminojë çështje të hartimit të kurrikulave të ESP-së. Përmbajtja e këtij punimi u vendos të trajtohej nga nevoja të bazuara në eksperiencën time profesionale si pedagogje e gjuhës së huaj teknike në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Teknologjisë dhe Informacionit, në hulumtime dhe në kërkime konkrete si në procesin mësimor, tekstet e trajtuara në fakultetet e inxhinierive, punime dhe projekte të bëra nga ne; teste e provime të bëra nga ne drejt studentëve si dhe pritshmëria e tyre. Ne shpresojmë që ky punim do të japë pasqyrë në sfidat me të cilat përballet mësuesi ESL duke vepruar si zhvillues ESP i programit mësimor.

KREU I

MËSIMDHËNIA E GJUHËS ANGLEZE TË PROFESIONIT NË UPT DHE ROLI I ESP-së NË KËNDVËSHTRIMIN E LITERATURËS BASHKËKOHORE

1.1. Kuadër i përgjithshëm historik i Anglishtes për Qëllime të Veçanta

Mësimdhënia e gjuhës së huaj për qëllime të veçanta po bëhet gjithnjë e më tepër një domosdoshmëri e kërkesave të kohës dhe tregut të punës. Tashmë çdo i/e diplomuar duhet ti përshtatet këtyre kërkesave duke e vënë në objektivin e tyre edhe mësimin e gjuhës së profesionit të ardhshëm. Studentët të cilët studiojnë në fakultetet e Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), gjithnjë e më shumë po e ndiejnë nevojën e mësimin të kësaj gjuhe, pavarësisht faktit se ata si qëllim kryesor kanë edukimin në inxhinieri. Ndaj edhe ne, pedagogët e gjuhës së huaj në këto fakultete, e ndiejmë përgjegjësinë e madhe që ka lënda jonë dhe jemi të angazhuar që ti përshtatemi nevojave dhe kërkesave të studentëve tanë, duke i dhënë në këtë mënyrë gjuhës së huaj të profesionit një vend të rëndësishëm në studimet e inxhinierëve tanë të ardhshëm. Por, çfarë është ESP?

E njohur si ESP, gjuha Angleze për Qëllime të Veçanta, si në shumicën e zhvillimeve në veprimtarinë e njeriut, nuk ishte planifikuar si lëvizje koherente, por më tepër si një fenomen që u rrit nga një numër i tendencave të shumta. Por historia e ESP-së nuk është edhe aq e re, ashtu si dhe shumë kërkues mendojnë. Shembujt e parë që na shfaqen nga ky fenomen, mund të datojnë që në shekullin e XIV, ku filluan të dalin përmbledhje koleksionesh me dialogë të jetës së përditshme për udhëtarët anglezë që shkonin drejt Francës². Në shekullin e XVI, duke parë interesin dhe nevojat për tregti, filluan të prodhohen libra të rinj me fraza të ndryshme si dhe fjalorë poliglotë të cilët merreshin me nevojat që kishin tregtarët për të komunikuar dhe nevoja për të pasur disa “njohuri për të mbijetuar”, në mënyrë që të blinin e shisnin. Por gjithsesi, mësimi i gjuhëve të huaja është konsideruar më tepër si çështje prestigji dhe kënaqësie për të mësuar një gjuhë të huaj, sesa si nevojë për të gjetur një punë apo si kontribut për të arritur qëllimet e vendosura.

Por në fakt është e vështirë që të thuhet saktë se kur ka lindur ESP-ja. Ishin të shumta ngjarjet që ndodhën në vitet 60’ të cilat çuan drejt shfaqjes dhe zhvillimit të shpejtë të kësaj qasjeje të re të mësimin të gjuhës angleze. Zhvillimet e ESP-së mund ti ndajmë në këto kategori:

Vitet e fillimit (1962-1981), vitet pasardhëse (1981-1990), periudha moderne (1990-2011) si dhe e ardhmja (2011 e në vazhdim). Vitet të cilat pasuan Luftën e Dytë Botërore, e fokusuan kërkimin e tyre tek EST (Gjuha Angleze e Shkencës dhe Teknologjisë), në kontekstin akademik. Përgjatë viteve 1981-1990, një vëmendje e veçantë ju kushtua trajnimit të mësimdhënësve, gjuhës angleze të punësimin si dhe trajnimit të asistentëve

²Howat, A., 1984 “A history of English language teaching”, Oxford university Press., fq.5

ndërkombëtarë të mësimdhënies së gjuhës. Në periudhën moderne, gazeta të reja ndërkombëtare, si dhe studime e zhanre të ndryshme u vunë në qendër të vëmendjes. Fundi i Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945, lajmëroi një epokë të një zgjerimi të paparë në aktivitetin shkencor, teknik dhe ekonomik në një shkallë ndërkombëtare. Ky zgjerim ka krijuar një botë të unifikuar dhe të dominuar nga dy forcat-teknologji dhe tregti të cilat në përparimin e tyre të pamëshirshëm gjeneruan një kërkesë për një gjuhë ndërkombëtare.

Për arsye të ndryshme, veçanërisht fuqisë ekonomike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në botën e pasluftës, ky rol i ra gjuhës angleze. Efekti ishte për të krijuar një masë tërësisht të re të njerëzve që donin të mësonin anglisht, jo për kënaqësi apo prestigjin e të diturit të gjuhës, por sepse anglishtja ishte çelësi ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare të teknologjisë dhe tregtisë.

Më parë, arsyet për të mësuar anglisht (apo ndonjë gjuhë tjetër) nuk ishin të përcaktuara mirë. Një njohuri e një gjuhe të huaj ishte konsideruar përgjithësisht si një shenjë e një arsimimi të mirë e të harmonishëm, por pak kishin pyetur pse ajo ishte e nevojshme. Me pak fjalë, mësimi i një gjuhe të huaj ishte justifikimi. Por, ndërsa anglishtja u bë gjuha ndërkombëtare e pranuar e teknologjisë dhe tregtisë, u rrit ndjeshëm edhe numri i studentëve që dinin konkretisht se përse i duhej të zgjidhnin për të mësuar gjuhën angleze të profesionit. Ky zhvillim u përshpejtua nga kriza e naftës e fillimit të viteve 1970, të cilat rezultuan në një fluks masiv të fondeve dhe ekspertizës perëndimore në vendet e pasura me naftë. Anglishtja papritmas u bë biznes i madh dhe presionet komerciale filluan të ushtrjnë një ndikim. Kufizimet monetare dhe kohore krijuan një nevojë për kurse me kosto efektive me qëllime të përcaktuara qartë. Efekti i përgjithshëm i të gjithë këtij zhvillimi ishte të ushtronte presion mbi profesionin e mësim-dhënies së gjuhës për të shpërndarë mallra të kërkuara.

Ndërsa anglishtja e kishte vendosur më herët fatin e vet, ajo tani u bë subjekt i dëshirave, nevojave dhe kërkesave të njerëzve të thjeshtë, sesa e mësuesve të gjuhës. Anglishtja ishte bërë përgjegjëse për shqyrtimin e mbarë botës dhe shëtitjes tradicionale pa asnjë qëllim, në peizazhin e gjuhës angleze, nuk dukej e përshtatshme në realitetet e ashpra në vendin e tregut.

1.2. Teoritë e përkufizimit të ESP-së

1.2.1. Çfarë është ESP-ja?

ESP është zhvilluar në shpejtësi të ndryshme në vende të ndryshme dhe shembuj të gjithë qasjeve që ne do të përshkruajmë janë marrë nga shkrymtarë të ndryshëm si amerikanë dhe anglezë, por edhe profesorë nga vende të ndryshëm të Evropës. Janë të shumtë artikujt të cilët janë botuar mbi ESP edhe nga profesorë shqiptarë nga të cilët mund të përmendim Profesor Andromaqi Haloçi, Profesor Shpresa Delija, Prof.As Elida Tabaku, Artur Sula, Prof.As. Fatmir Vrapit etj., nga Universiteti i Tiranës, të cilët i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë kësaj fushe të madhe të gjuhës për qëllime të veçanta. Pra, përmbledhja jonë duhet të jetë shumë e përgjithshme në fokusin e saj. ESP përdoret në mbarë botën dhe besoj se shprehemi drejt kur themi që plotëson nevojat e nxënësit. Zhvillimi i saj është

“reflektuar në një numër në rritje të botimeve, konferencave dhe shkrimeve të dedikuara botës së ESP-së³.

Njerëz të ndryshëm e kanë përkufizuar në mënyra të ndryshme ESP-në. Mund të themi se gjendemi përballë një numri të madh përkufizimesh sa dhe vetë numri i gjuhëtarëve të cilët janë marrë me përcaktimin e saj. Të gjitha këto përcaktime duket se mbulojnë karakteristika të ndryshme Sifakis⁴ dhe Rogers⁵; Rogers⁶ dhe Anthony⁷ përmendin “ndryshimin e qartë se si njerëzit interpretojnë kuptimin e ESP-së”. Ai shprehet se “... pjesëmarrësit ishin ndarë në dy grupe. Njëri grup mbronte tezën se ESP kishte të bënte me mësimdhënien e gjuhës angleze për çdo lloj qëllimi që do të mund të specifikohet, ndërsa grupi tjetër i pjesëmarrësve e përkufizonte atë si “mësimdhënia e gjuhës angleze e përdorur në studimet akademike, ose mësimdhënia e gjuhës angleze për qëllime profesionale”⁸. Ky shembull i veçantë i pikëpamjeve të ndryshme në përkufizimin e ESP-së na qartëson mbi të vërtetën në lidhje me këto mospërputhje. Hutchinson dhe Waters⁹ e kanë përkufizuar ESP-në si “një qasje” sesa si “një produkt” – çfarë do të thotë se ESP nuk përfshin domosdoshmërisht ndonjë gjuhë në veçanti, materiale didaktike apo metodikë. Funkcioni themelor që ka ESP është: “Përse ky nxënës ka nevojë të mësojë një gjuhë të huaj?” Milavic,¹⁰ dhe Hutchinson and Waters¹¹.

Hutchinson dhe Waters tregojnë një pamje retrospektive afatgjatë mbi shkaqet që rezultojnë në lindjen e ESP-s, kur ata paraqesin faktorët gati të njëjtë, të cilët, nga ana tjetër, sugjerojnë një marrëdhënie shkak-pasojë¹²:

- Me përhapjen e madhe dhe të pa precedentë të zhvillimeve shkencore, teknike dhe ekonomike në shkallë ndërkombëtare u dalluan dy forca të cilat dominuan botën e re të pas luftës mbi teknologjinë dhe tregtinë, progresi i të cilave shumë shpejt gjeneroi në kërkesën për një gjuhë ndërkombëtare. Falë fuqisë ekonomike të Shteteve të Bashkuara, ky rol iu caktua gjuhës angleze.
- Pati një zhvillim në masë të gjerë të njerëzve që dëshironin të mësonin anglisht – gjuhë angleze u bë çelësi i suksesit për valutat ndërkombëtare të teknologjisë dhe

³Tratnik, A., 2008. "Key issues in testing English for specific purposes", Scripta Manent, 4 (1), fq. 5

⁴ Sifakis, N.C., 2003. "Applying the adult education framework to ESP curriculum development: An integrative model", Science Direct, English for specific Purposes, 22 (2), fq 195-211. Marrë nga <http://sciencedirect.com/science>.

⁵ Rogers, J., 1989. "Adults Learning", Open University Press, Philadelphia.

⁶ Rogers, J., 1996. "Learning and Adult education". Tek "Supporting life long learning (Harrison, R.; Reeve, F.; Hunson, A.; Clarke, J.) eds; (1) Open University Press. Philadelphia. Fq 8-24

⁷Anthony, L., 1997. "ESP: What does it mean?" ON CUE. Marrë nga <http://www.interserver.miyazakimed.ac.jp/~cue/pc/anthony.htm>. fq. 1.

⁸Materiali është marrë nga "The Japan Conference on ESP" e mbajtur në 8 nëntor 1997 në Universitetin Aizu në Aizuwakamatsu Anthony, L., 1997. "ESP: What does it mean?" ON CUE. <http://www.interserver.miyazakimed.ac.jp/~cue/pc/anthony.htm>. fq. 1

⁹Hutchinson, T., and A. Waters, 1987. "English for specific purposes: a Learning-centered Approach", Cambridge University Press. Cambridge

¹⁰Milevica, 2006. "teaching Foreign Language for specific Purposes: teacher Development", 31st annual Association of Teacher Education in Europe (ATEE) Conference, Serbia. Marrë nga <http://www.pef.uni-lj.si/978-961-6637-06-0/487-493.pdf>

¹¹ Hutchinson, T., and A. Waters. 1987. English for specific purposes; "A learning-centered Approach", Cambridge University Press, Cambridge.

¹² Po aty fq.6

tregtisë. Kjo masë njerëzish mblodhi së bashku breza nxënësish, veçanërisht breza të rinjsh të cilët e dinin me saktësi se *çfarë* duhet të mësonin dhe *pse*¹³.

- Kriza e naftës e fillim vitit 1970 përfshiu një sërë shtetesh perëndimore të pasura me naftë. Për këtë arsye, gjuha Angleze u kthye në një “biznes të madh”¹⁴ dhe nga ana tjetër, presionet tregtare filluan të ushtronin influencë tek njerëzit për të përvetësuar gjuhën. Këto kufizime në kohë dhe para, bënë që të lindi nevoja e kurseve me kosto efektive si dhe me qëllime të caktuara të mësimin të gjuhës angleze për qëllime të veçanta.
- Një tjetër arsye ishte edhe nevoja e shumë shteteve për të përditësuar njohuritë e tyre.

Kështu që, ESP-ja filloi të bëhej dhe të zhvillohej gradualisht si gjuha e cila bazohet në nevojat specifike të nxënësit të cilat kërkoheshin dhe bazoheshin në profesionet dhe zanatet e tyre.

Dudley-Evans dhe St. John¹⁵, kanë prezantuar një model përcaktues të ESP-s i cili shtron këto karakteristika dhe shumëllojshmërinë e ESP-së:

a) Karakteristikat Absolute të ESP-së

- përkufizon nevojat e nxënësit;
- vë në përdorim metodën dhe aktivitetet e disiplinës së cilës i shërben;
- përqendrohet tek gjuha (gramatikë, leksik, regjistër) aftësitë, diskursi dhe zhanret e përshtatshme për këto aktivitete.

b) Karakteristikat Variabël të ESP-së

- mund të hartohet ose të ketë lidhje me disiplina të veçanta;
- në situata të ndryshme mësimdhënieje, mund të përdorë një metodologji ndryshe nga ajo e gjuhës angleze të përgjithshme;
- ka më shumë vlera për moshën adulte, sesa për fëmijë;
- hartohet zakonisht për nxënës së nivelit të mesëm ose të lartë të gjuhës;
- që të merresh me ESP besohet nga gjuhëtarë të ndryshëm që duhet të kesh disa baza gjuhësore, por mund të përdoret edhe nga fillestarët.

Hadley¹⁶ ka thënë se “çelësi për të mësuar ESP, është që të përqendrohemi tek “S” e suksesit (nga English for *Special Purposes*). Por fjala *Special* mund ti referohet një gjuhe të veçantë apo qëllime/nevoja të veçanta. Kjo paqartësi për të zgjedhur ndërmjet dy nocioneve vërehet gjatë viteve 1980 (Gatehouse¹⁷ dhe Perren)¹⁸. Mackay dhe Mountford e përkufizuan idenë e gjuhës së veçantë në këtë mënyrë:

¹³ Po aty

¹⁴ Po aty

¹⁵ Dudley-Evans, T., & St John, M. (1998). *Developments in ESP: A multi-disciplinary approach*. Cambridge: Cambridge University Press. Fq. 4-5

¹⁶ Hadley, J., 2006. "Needs analysis in ESP". Tek: *English for Specific Purposes in the Arab World* (Lahlou, M S; Richardson, A), eds; TESOL Arabia. Dubai. fq. 3-6.

¹⁷ Gatehouse, K., 2001. "Key issues in English for Specific Purposes (ESP) Curriculum Development", *The internet TESL Journal* 7 (10), http://iteslj.org/Articles/Gatehouse_ESP.html

“E vetmja mënyrë praktike me të cilën ne mund të kuptojmë nocionin e gjuhës së veçantë, është repertori i fjalëve dhe shprehjeve, i përzgjedhur nga e tërë gjuha, sepse ky lloj repertori mbulon çdo kërkesë, detyrë, brenda një konteksti të mirë përcaktuar¹⁹”.

1.2.2. Çfarë NUK është ESP-ja?

Në fakt, termi ESP ka mbi një çerek shekulli që është në përdorim dhe mund të gjejmë me dhjetëra përkufizime të këtij termi të cilat vijojnë dhe ndjekin botimin e parë të bërë nga T. Hutchinson dhe A. Waters²⁰. Ata u përpoqën që të na jepnin një përkufizim të asaj çfarë NUK është ESP-ja:

“Edhe pse përmbajtja e mësimit mund të ndryshojnë, nuk ka arsye të supozohet se proceset e mësimit duhet të jenë ndryshe për nxënësit e ESP-së se sa për nxënës të cilët mësojnë gjuhën Angleze të Përgjithshme²¹”.

Analogjia e një peme mund të na ndihmojë për t’u afruar me një përkufizim të ESP-së jo aq shumë duke na treguar se çfarë është ESP, por duke treguar se çfarë ESP nuk është.

a) ESP nuk është një çështje e mësimit të “varieteve të specializuara” të gjuhës angleze. Fakti që gjuha përdoret për një qëllim të veçantë nuk do të thotë se ajo është një formë e veçantë dhe ndryshe e gjuhës. Sigurisht, ka disa karakteristika të cilat mund të identifikohen si 'aktuale' në një kontekst të caktuar të përdorimit në të cilën nxënësi ka më shumë gjasa ta takojë në situatën e dhënë. Por këto dallime nuk duhet të na pengojnë në zonën më të madhe të përbashkët që qëndron në themel të përdorimit të gjuhës angleze.

b) ESP nuk është vetëm një çështje e fjalëve të shkencës dhe gramatikës për shkencëtarët. Kur shikojmë pemën, ne shohim degët dhe gjethet, por ka shumë më tepër se kaq. Gjethet nuk rrinë në ajër: ato janë të mbështetura nga një strukturë komplekse. Në të njëjtën mënyrë ka shumë më tepër për komunikimin sesa thjeshtë karakteristikat sipërfaqësore që ne lexojmë dhe dëgjojmë. Duhet të bëjmë dallimin në lidhje me gramatikën, midis performancës dhe kompetencës, që është në mes asaj çfarë njerëzit në fakt bëjnë me gjuhën dhe gama e njohurive dhe aftësive që u mundëson atyre për të bërë atë.²²

c) ESP nuk është e ndryshme në lloj nga çdo formë tjetër e mësimit të gjuhës, në atë që duhet të bazohet në rastin e parë mbi parimet e të mësuarit efektiv dhe efikas. Megjithatë përmbajtja e mësimit mund të ndryshojë, nuk ka asnjë arsye të mendohet se proceset e mësimit të jenë ndryshe për studentë të cilët mësojnë gjuhën e huaj për qëllime të veçanta dhe ndryshe për studentët e gjuhës angleze për qëllime të përgjithshme. Me fjalë të tjera, nuk ka gjë të tillë si metodologjia e ESP, thjesht metodologji që janë aplikuar në klasat e ESP, por edhe mund të jenë përdorur për të mësuar të gjitha llojet e gjuhës angleze.

¹⁸Perren, G., 1974. "Forward in Teaching languages to adults for special purposes", CILT Reports and Papers, (11), CILT. London

¹⁹Mackay, R.; Mountford, A. J. (1978). The teaching of English for Specific Purposes: theory and practice. in: English for Specific Purposes: A case study approach. (Mackey, R.; Mountford A. J.), eds; Longman. London., (fq.13).


²⁰Hutchinson, T., & Waters, A. (1987) English for Specific Purposes: a Learning –centered Approach, Cambridge: CUP

²¹(Po aty: fq. 18).

²²Hutchinson, T. dhe A. Waters, 1981 “Performance and competence in ESP Applied Linguistics. Fq. 56-59.

Pra, duke ju referuar asaj çfarë thamë më sipër, përgjatë historisë së saj, ESP ka pasur ndryshime e zhvillime të mëdha, si në teori dhe praktikë. Megjithatë, pavarësisht dallimeve të tyre, fazat e njëpasnjëshme janë përqendruar të gjitha në aspektin gjuhësor të ESP: Ato janë të gjitha qasje me në qendër gjuhën.

Prezantimi në lidhje me këtë qasje është bërë në formën e një peme, fig.1²³



1.3.Klasifikimi i kurseve të ESP-së sipas pemës së Hutchinson dhe Waters

Për momentin le të kthehemi në pyetjen e shtruar në fillim të këtij seksioni: “Çfarë është ESP”?

²³Fig.1 Prezantimi i ESP në formën e një peme sipas Hutchinson, T. dhe A. Waters, 1981 “Performance and competence in ESP Applied Linguistics”.

Në ESP, theksi vendoset tek *mësimi i gjuhës* dhe jo tek *përdorimi i saj*. Hutchinson dhe Waters, në vëllimin e tyre e përshkruajnë vizionin e tyre mbi ESP-në duke u shprehur se:

“...ESP duhet parë si qasje dhe jo produkt. ESP nuk është një lloj gjuhe apo metodologjie e veçantë dhe as nuk konsiston në një lloj të veçantë materiali. Ajo është një qasje për mësimin e gjuhës me në qendër nevojat e nxënësit...”²⁴

Ata i nisin vëzhgimet e tyre duke na prezantuar me një imazh metaforik në formën e një peme, duke na paraqitur marrëdhënien ndërmjet ESP-së dhe ELT-së. Rrënjët e pemës së ELT-së përfaqësojnë mësimin e komunikimit, ndërsa trunghi, mësimdhënien. Ndarja tjetër përfaqëson mësimdhënien e gjuhës angleze, nga ku dalin tre degë të cilat tregojnë Gjuhën Angleze si gjuha mëmë (English as a Mother Tongue, EMT), Gjuha Angleze si gjuhë e huaj, (English as a Foreign Language, EFL) dhe Gjuha Angleze si gjuhë e dytë, (English as a Second Language, ESL). Trashësia e degëve, EFL, më pas ndahet në Anglishte e Përgjithshme (GE), si dhe Aglishtja për Qëllime të Veçanta (ESP). ESP dallon nga Anglishtja e Shkencës dhe Teknologjisë” English for Science and Technology” (EST), Anglishtja për Biznesin dhe Ekonomikun, “English for Business and Economics”, (EBE) si dhe Anglishtja për Shkencat Sociale, “English for Social Sciences, (ESS). Ashtu siç theksojnë edhe autorët, “degët kryesore të pemës na tregojnë nivelet në të cilat ndodhin kurset individuale të ESP-së”. Vizioni i tyre, nuk është vetëm vetë-shpjegues, por edhe i plotësuar dhe i dobishëm për një sërë qëllimesh për të cilat gjuha Angleze mund të studiohet më në thellësi apo në mënyrë më sipërfaqësore, në varësi të qëllimeve të domosdoshme të secilit nxënës të gjuhës.

Tradicionalisht ESPka qenë e ndarë në dy fusha kryesore:

1. Anglishtja për qëllime akademike (EAP), e cila përfshin eksperiencat lidhur me kurset e mëparshme;
2. Anglishtja për qëllime profesionale (EOP), e cila studion një disiplinë të veçantë (para-studim, në studim, pas studimit) ose një lëndë shkollore (të pavarur apo të integruar).

EAP dhe EOP do të ndahen gjithashtu sipas fushave profesionale apo disiplinore sipas mënyrës së mëposhtme.

1. EAP përfshin: Anglishtja për Teknologjinë dhe Shkencën (EST), Anglishtja për Qëllime Mjekësore (EMP), Anglishtja për Qëllime Ligjore (ELP), Anglishtja për Menaxhim, Financë dhe Ekonomik.
2. EOP përfshin Anglishten për Qëllime Profesionale (Anglishtja për Qëllime Mjekësore, Anglishtja për Qëllime Biznesi (EBP) dhe Anglishtja për Qëllime Rastësore). Në EAP, EST ka qenë fusha kryesore, por EMP dhe ELP kanë pasur gjithmonë vendin e tyre. Kohët e fundit, studimet akademike të biznesit, financave, bankave, janë bërë shumë të rëndësishme, veçanërisht kurset e masterave në Administrim Biznes (MBA). EOP i referohet anglishtes për qëllime profesionale, në administrim, mjekësi, drejtësi dhe biznes, dhe anglishtes për qëllime rastësore për joprofesionistët të cilët thjesht dëshirojnë të gjejnë një punë.

²⁴ Hutchinson, T., & Waters, A. (1987) English for Specific Purposes: a Learning –centered Approach, Cambridge: fq.19.

Ndonjëherë klasifikimi i kurseve të ESP-së krijon probleme të shumta duke dështuar në kapjen e esencës së llojeve të ndryshme të mësimdhënies së ESP-së. Anglishtja e biznesit mund të shihet si ndërmjetësim i gjuhës teknike të biznesit dhe gjuhës së përgjithshme, e cila e vë atë në një pozicion ndërmjet anglishtes për qëllime të përgjithshme (EGP) dhe anglishtes së specializuar. Prandaj, disa autorë si Dudley-Evans dhe St. John²⁵ sugjerojnë që paraqitja e gjithë ELT-së duhet drejtuar në vazhdimësi, nga kurset e përgjithshme të gjuhës angleze, në kurset shume specifike.

Këtu identifikojmë tre kategori të mëdha:

EST (Anglishtja për Shkencë dhe Teknologji),

EBE (Anglishtja për Biznes dhe Ekonomi) dhe

ESS (Anglishtja për Shkencat Sociale).

Ashtu si tek pema (shiko figurën 1), ne mund të shohim se ESP është vetëm një degë e EFL / ESL, të cilat janë vetë degët kryesore të mësimin të gjuhës angleze në përgjithësi. ELT, nga ana tjetër, përfshin disa lloje të mundshme të mësimin të gjuhës. Por, sigurisht, që një pemë mbart shumë më tepër sesa ajo që është e dukshme mbi tokë: Një pemë nuk mund të mbijetojë pa rrënjët. Rrënjët të cilat ushqejnë pemën e ELT janë *komunikimi dhe mësimi*.

ESP nuk është një lloj i veçantë i gjuhës apo metodologjisë, as nuk përbëhet nga një lloj i veçantë i materialeve të mësimin. Kjo është një qasje për mësimin e gjuhës, e cila është e bazuar në nevojat e nxënësit. Për të përkufizuar ESP-në bëjmë pyetje të thjeshtë: *Pse nxënësi duhet të mësojë një gjuhë të huaj?* Nga kjo pyetje rrjedhin një tërësi me pyetje të mëtejshme, disa prej të cilave lidhen me vetë nxënësit, disa me natyrën e gjuhës që përdorin nxënësit, disa me kontekstin e mësimin. Por kjo analizë rrjedh nga një nevojë fillestare të cilën e identifikojmë nëpërmjet nxënësit i cili po e mëson gjuhën. Pra ESP, është një qasje ndaj mësimin të gjuhës në të cilën të gjitha vendimet, si tek përmbajtja dhe metoda janë të bazuara në arsyen që ka nxënësi për të mësuar.

1.4. Cilat janë disa nga tiparet që karakterizojnë kurset e ESP-së

Duke pasur parasysh zhvillimin e kurseve ESP, Carter²⁶ pohon se janë 3 karakteristika të përbashkëta për këto kurse:

- 1) **Materialet autentike:** Kur ne u ofrojmë studentëve materiale autentike për përdorim, atëherë mund të pranojmë që dhe kurset e ESP-së të ofrohen në një nivel mesatar ose të përparuar. Ne në këtë mënyrë i inkurajojmë studentët që të kryejnë hulumtime duke përdorur një shumëllojshmëri të burimeve të ndryshme, ku mund të përmendim kryesisht internetin.
- 2) **Qëllimi i lidhur me drejtimin i referohet stimulimit të detyrave komunikuese që dalin nga situata të ndryshme.** Ne mund ti japim studentëve detyra të ndryshme për

²⁵Dudley-Evans, A. and A.M. St. John, 1998. 'Developments in English for Specific Purposes: A multi-disciplinary approach', Cambridge University Press. Cambridge

²⁶Carver, D. (1983). Some propositions about ESP. The ESP Journal, 2, fq.131-137

të stimuluar përgatitjen e tyre duke përfshirë hartimin e letrave, leximin, marrjen e shënimeve dhe shkrimin. Në FTI, kursi i Anglishtes për studentët e degës së inxhinierisë elektronike i përfshin studentët në prezantimin e detyrave ku ata zgjedhin për të trajtuar një temë të veçantë të teknologjisë apo elektronikës, krijimin e një fjalorthi mbi gjuhën e profesionit, marrëveshjet me klientët (profesionistët dhe blerësit apo klientët), etj.

- 3) Vetëdrejtim, do të thotë që ESP ti kthejë studentët nga *lexues* në *përdorues*. Për vetëdrejtimin është e nevojshme që studentët të inkurajojmë për të pasur një shkallë të caktuar autonomie në mënyrë që të vendosin *kur, çfarë dhe si* duhet të mësojnë. Për të arritur në një rezultat, është e rëndësishme që nxënësit të mësojnë sesi të marrin informacion në një mënyrë të re. Kurset e gjuhës angleze për qëllime të veçanta janë të llojeve të ndryshme, të varura nga fusha apo profesione shkencore (si p.sh kursi me studentët e degës së elektronikës ndryshon nga ai i degës së gjeologji-minierave) dhe duke pasur karakteristika të veçanta për pedagogët të cilët zhvillojnë këto kurse të cilët duhet të luajnë role të ndryshme dhe të kenë njohuri të caktuara.

1.5.Ndryshimet ndërmjet EST dheESP

Në këtë fillim të punimit tonë doja të vija në pah edhe një ndryshim të rëndësishëm ndërmjet EST-s dhe ESP-së për arsye se ka pasur një qëndrim të ndryshëm dhe të pa qartë ndërmjet këtyre dy fushave. Përdorimi i termit EST, në fushën e ESP si fillim u shfaq në këto dy ndarje të hulumtimit të gjuhës, asaj të EAP/EVP (English for Academic Purposes/English for Vocational Purposes), dhe pjesërisht për arsye se përpjekjet e shumta për të arritur tek diçka “e veçantë” rreth gjuhës së shkencës dhe teknologjisë nuk ishin bindëse. Duhet theksuar fakti se EST është dega më e lartë e ESP-së; dega më e madhe në moshë, në numrin e artikujve të botuar si dhe të autorëve të cilët janë marrë me trajtimin e saj.

Trimble thekson se termi EST përkufizohet në mënyrë tepër origjinale nga Selinker si “Ligjërata e shkruar e gjuhës angleze për shkencën dhe teknologjinë”²⁷. Ai më pas, e çon më tej mendimin e tij duke thënë se “EST mbulon zona të gjuhës angleze për qëllime akademike dhe profesionale si dhe gjuha angleze e shkruar për qëllime profesionale, duke përfshirë shpesh ligjëratën e shkruar të cilën e gjejmë në revistat e tregtisë si dhe materialeve të shkruara teknike dhe shkencore”²⁸.

Tradicionalisht, qëllimi i gjuhësisë është marrë me rregullat e përdorimit të gjuhës angleze, siç është gramatika. Megjithatë, studimet e reja e zhvendosën vëmendjen larg nga përcaktimi i tipareve formale të përdorimit të gjuhës në mënyrë që të zbulonin mënyra në të cilat gjuha përdoret në komunikimin e vërtetë²⁹. Një gjetje e këtij hulumtimi ka qenë se, gjuha që ne flasim dhe shkruajmë, ndryshon në mënyrë të konsiderueshme dhe në një

²⁷ Trimble, L. (1985). English for Science and Technology, Cambridge: Cambridge University Press. Fq2.

²⁸ Po aty, fq.6

²⁹Widdowson, H.G (1978); Teaching Language as communication. Oxford universit Press. Oxford

numër mënyrash të ndryshme, nga një kontekst në tjetrin. Në mësimdhënien e gjuhës angleze, u forcua pikëpamja se ka dallime të rëndësishme midis, gjuhës angleze të tregtisë dhe asaj të inxhinierisë. Këto ide u lidhën natyrshëm me zhvillimin e kurseve të gjuhës angleze për grupe të veçanta studentësh. Ideja ishte e thjeshtë: nëse gjuha ndryshon nga një situatë e përdorimit në një tjetër, ajo mund të përcaktojë tiparet e situatave të veçanta dhe pastaj t'i kthejë këto karakteristika në ndihmë të realizimit të kurseve për gjuhën e specialitetit.

Në një artikull mbi natyrën e Anglishtes Shkencore Swales³⁰ trajton zgjerimin e madh të kërkimit mbi natyrën e varieteteve të veçanta të gjuhës angleze - për shembull, përshkrime të gjuhës angleze së shkruar shkencore dhe teknike. Kjo natyrë është trajtuar edhe nga Ewer dhe Latorre³¹, Swales³², Selinker dhe Trimble³³. Shumica e punës së asaj kohe ishte në fushën e Gjuhës Angleze për Shkencën dhe Teknologjinë (EST) dhe për një farë kohe ESP dhe EST u konsideruan pothuajse si sinonime. Por ka pasur studime edhe në fusha të tjera gjithashtu, të tilla si Analiza e Komunikimit mjek-pacient³⁴. Me pak fjalë, u përforcua mendimi se *anglishtja që nevojitet nga një grup i veçantë studentësh mund të identifikohet nga analiza e karakteristikave gjuhësore të fushës së tyre të specialitetit në punë ose studim.*

Swales në fakt përdor zhvillimet në fushën e EST për të ilustruar zhvillimin e ESP-së në përgjithësi: "*Me një ose dy përjashtime, Anglishtja për Shkencën dhe Teknologjinë ka vendosur dhe vazhdon të vendosë trendin në diskutimin teorik, në mënyrat e analizimit të gjuhës dhe në shumëllojshmërinë e përdorimit të materialeve mësimore*³⁵".

Henry Widdowson, i cili njihet për kontributin e tij në Gjuhësinë e Aplikuar si dhe mësimdhënien e gjuhës angleze, ka kontribute të pa diskutueshme edhe në hartimin dhe kërkimin e materialeve mbi EST. Sipas Hewings, ndikimi i Widdowson është ndjerë përgjatë gjithë zhvillimit të ESP-së në përgjithësi, si dhe të EST-së në veçanti. Swales shprehet se Widdowson ka qenë "*...i vetmi zë me influencë në fushën e zhvillimit të EST-së*³⁶. Dudley-Evans dhe St. John mendonin se historia e ESP-së ishte kryesisht historia EST-së. Nga një perspektivë tjetër, Clapham shprehej se "*Janë të shumë kërkuesit e ESP-së të cilët janë përqendruar mbi EST-në, sa që është e lehtë të mendosh se ESP dhe EST janë sinonime*³⁷. Sipas Brought, njihet gjerësisht që pozicioni dominues i EST shihet si rezultat i atillë ku: "*gjysma e letërsisë botërore mbi shkencën është shkruar në gjuhën angleze*³⁸ dhe "*...dy të tretat e literaturës së inxhinierive është në gjuhën angleze, por më*

³⁰Swales, J., ed. 1985. Episodes in ESP. Oxford: Pergamon

³¹Ewer, J.R.& Latorre, G. (1969). A course in basic scientific English. London. Longman

³²Swales, J., Writing Scientific English, Nelson, 1971

³³Selinker, L. and Trimble, L., "Scientific and Technical Writing: the Choice of Tense" in English Teaching Forum, 14, 4, 1976

³⁴Candilin, C.N., Bruton, C.J. and Leather, J.H., "Doctors inCasualty: Specialist course design from a data base" in International Review of Applied Linguistics 3, 1976

³⁵Swales, J.ed. 1985. Episodes in ESP. Oxford: Pergamon.

³⁶Swales, J.ed. 1985. Episodes in ESP. Oxford: Pergamon. fq. 69

³⁷Clapham, C. (1996). A Study of the effect of background knowledge on reading comprehension. Cambridge University Press, New York. Fq.3

³⁸Broughton, G., Brumfit, C., Flavell., R., Hill, P. & Pincas, A. (1978). Teaching English as a foreign language (2nd ed.). Routledge. Fq.3

tepër se dy të tretat e inxhinierëve profesionistë në mbarë botën nuk mund të lexojnë në gjuhën angleze”³⁹.

Zhvillimet e reja në psikologjinë arsimore kanë kontribuar në rritjen e ESP, duke theksuar rëndësinë qendrore të studentëve dhe qëndrimet e tyre në mësim⁴⁰. Studentët kishin nevoja dhe interesa të ndryshme, të cilat ndikuan në mënyrë thelbësore në motivimin e tyre për të mësuar dhe për këtë arsye në efektivitetin e mësimit të tyre. Këto zhvillime i dhanë mbështetje zhvillimit të kurseve për të cilat kishte një “larmi kërkesash” për të përmbushur nevojat dhe interesat e nxënësve.

Kritja e ESP, u soll kombinimi i tre faktorëve të rëndësishëm:

- 1) zgjerimi i kërkesës për gjuhën angleze në përshtatje me nevojave e veçanta;
- 2) zhvillimet në fushën e gjuhësisë;
- 3) zhvillimet në fushën e psikologjisë arsimore.

Të tre faktorët theksuan nevojën për specializimin e mëtejshëm në mësimin e gjuhës për qëllime të veçanta.

1.6.Mësimdhënia e ESP-së dhe kërkesat e saj në mjediset e UPT-së

Në ditët e sotme në Shqipëri, por jo vetëm, i tërë sistemi i arsimit të lartë është vënë nën trysinë e ndryshimeve dhe transformimeve që po pëson e tërë shoqëria njerëzore në kuadrin e “globalizimit”. Sot motoja udhëheqëse e CoE “*learning by doing*” është përmbysur në “*doing by learning*”. Ndryshimet janë ndërvepruese: Arritjet transformojnë jo vetëm realitetin por edhe njeriun. Shumëkush sot përballet me sfidën e arritjes së objektivave pa pasur një model. Shumëkush përballet me detyrimin e të qenit krijues, reflektiv dhe i përshtatshëm në procesin e ndryshimeve.

1.6.1. Pse dhe a duhet të ndryshojë sistemi i mësimit të gjuhëve të huaja sot?

Dihet se universitetet dhe institucionet e arsimit janë përgjithësisht “change-averse” (kundër ndryshimeve), por shumëkush, pa u menduar shumë, do të thoshte “doemos”. Përgjigja është e thjeshtë, por problemi pas saj është mjaft kompleks dhe i ndërlikuar. Në ndihmë të reformimit të arsimit të lartë u gjet një nismë mbarë evropiane që mban emrin e një qyteti, i cili ka traditë të arsimit të lartë në shekuj – Karta apo Procesi i Bolonjës. Karta e Bolonjës, e cila është adoptuar edhe nga shteti shqiptar, është instrument reforme i përshtatur për universitetet. Karta e Bolonjës është vazhdim i “Magna Charta”-s, së vitit 1988⁴¹ dokument i nënshkruar me rastin e kremtimit të shekullit të nëntë të themelimit të

³⁹ Mackay, R., & Mountford, A. (Eds.). (1978). English for Specific Purposes: A case study approach. London: Longman. fq.6

⁴⁰ Rogers, C., Freedom to Learn, Merrill 1969

⁴¹ Më 18 shtator 1988, në praninë e shumë liderave të politikës dhe përfaqësuesve të shoqërisë, 388 rektorë nga Europa e më tej, firmosën Magna Carta. që nga ajo kohë, ky dokument u bë pika e referimit të vlerave dhe principioeve themelore të universitetit. Që nga ajo kohë, Magna Carta është firmosur edhe nga 750 lider nga mbarë bota dhe çdo vit janë të shumta universitetet të cilat i nënshtrohen parimeve të vendosura në Magna Carta. Skena e arsimit të lartë është zhvilluar në mënyrë thelbësore që nga viti 1988, dhe ende Magna carta mbetet parimi i misionëve universitare ngado.

Universitetit të Bolonjës. Karta e Bolonjës është dokument orientues për natyrën e ndryshimit: a do të ndryshonin universitetet globalisht (të gjithë sipas një skeme), apo do të respektojnë veçantitë? Si dhe mbi qëndrimin që duhet të mbahet ndaj traditës së të mësuarit: a do të flakej apo do të mbetej bazë e ndryshimeve? Përballë dilemave të ndryshimit, vetëkuptohet që përgjigja nuk është më aq e “thjeshtë”. Sa më shumë tradita të ketë institucioni i arsimit të lartë aq më i vështirë është ndryshimi. Kontekstin e ndryshimit e komprometon edhe faktori i jashtëm vendas. Komuniteti akademik dhe kërkimor nuk përballet vetëm me sfidën se ç’ të bëjë me përvojën e krijuar, por edhe me sfida të tilla si:

a) Mjedisin kombëtar që ndryshon

Presioni financiar, rritja e konkurrencës, larmia e formave të të mësuarit janë përherë e më të ndjeshëm në mjedisin e brendshëm.

b) Rritja e autonomisë institucionale

Roli, natyra e saj, organizimi, mirëqeverisja janë dilema të shumë institucioneve që kërkojnë të përsosën.

c) Organizimi dhe rinovimi i kurrikulave arsimore

Kurrikula e arsimit parauniversitar është reformuar dhe preson përherë e më shumë në kurrikulën universitare. Arritjet e të mësuarit, kreditet, të mësuarit tradicional, « distance – learning », « life long learning », nuk janë më koncepte evazive, po praktika të gjalla në shumë shkolla të larta.

d) Interneti dhe teknologjitë e reja

Mënyrat e reja të komunikimit dhe të marrjes së dijes janë shumë më të gjalla dhe presojnë të jenë aleatë të mësimdhënies së përditshme në mjediset shkollore. Rritja e nivelit të teknologjive në tregun e punës në Evropë do të vazhdojnë të rrisin presionin e saj edhe në tregun shqiptar të punës, ndaj të cilit duhet të japë kontributin e tij Arsimi i Lartë Shqiptar.

e) Intensifikimi i proceseve evropiane të integritimit

Në një Evropë pa kufij gjeografikë, arsimimi i shoqërisë zë një rol të posaçëm. Domosdoshmërinë e njëjtësimin të sistemit të matjes së informacionit integrimi e bën imperativ. Me të lidhen respekti për ndryshimet dhe shansi i integritimit.

f) Ndërkombëtarizimi i tregut të punës

Përputhshmëria dhe krahasimi i sistemeve të arsimit dhe kërkimit shkencor dikton njëjtësinë e sistemit të referimit, krijimin e një hapësire evropiane të Arsimit të Lartë.

g) Angazhimi i hapur për të siguruar cilësi në arsim

Parimet e Bolonjës, para se gjithash kanë parasysh rritjen e cilësisë së arsimit jo vetëm në nivel vertikal (universitetet brenda tyre), por edhe në nivel horizontal (universitetet mes tyre). Rritja e cilësisë së formimit profesional kërkon ballafaqim me tregun e punës.

h) Është koha e pragmatizmit

Së fundi, problemi shtrohet edhe nga pikëpamja pragmatike. A duhet të vazhdojë shoqëria të shpenzojë burime financiare dhe njerëzore për të përgatitur specialistë që ndoshta nuk do të punojnë kurrë si kërkues shkencorë, por vetëm si drejtues punimesh apo drejtpërdrejt në prodhim? Detyra e institucioneve të arsimit të lartë që t’i përgjigjen kërkesave të tregut të

punës, për nivelet e ndryshme të kualifikimi është imperativ. Në kuadrin e efikasitetit në kornizat kohore dhe të angazhimeve të mësipërme shtrohet edhe çështja e mësimit më shpejt e më cilësisht i gjuhës së huaj të profesionit. Ajo patjetër që përbën një dimension të kërkuar të diplomuarit në kuadrin e nevojave për integrim evropian. A duhet përmirësuar kurrikula e mësimdhënies së gjuhës së huaj në Universitetin Politeknik, për t'iu përshtatur nevojave të studentëve dhe kërkesave të kohës? A duhen unifikuar kreditet në të gjitha fakultetet e UPT-së?

1.6.2. Ndikimi i përmirësimit të gjuhës së huaj në procesin e reformimit

Universiteti ka një strukturë solide që është e vështirë të përshtatet në përputhje me ndryshimet ekonomike e teknologjike të kohës. Problemet aktuale që shqetësojnë sot Universitetet shqiptare në fushë, pa pretenduar që ato të jenë të vetmet dhe të përhershmet, rendisim:

- Infrastrukturë institucionale e fragmentuar
- Staf kërkimor i vjetër
- Politikë kërkimore jo-koherente
- Mungesë fondesh
- Mungesë e strategjisë afatmesme dhe mentalitetit ndërmarrës.

Përmirësimi i mësimdhënies së gjuhës së huaj do t'i bëjë më të dukshme rezultatet e reformimit në shumë drejtime. Studentët dhe pedagogët do të jenë më shumë të integruar në fushën e kërkimeve universitare. Kërkimi shkencor kërkon dimensione të reja të të kuptuarit të idesë së ndërtimit të një hapësire Evropiane të kërkimit. Sot studentët dhe pedagogët janë të sfiduar nga idetë e një tregu global kërkimi dhe nevojës për krijimin e njohurive dhe ideve të reja. Strukturat e ndryshme kombëtare të kërkimit shkencor duhet të gjejnë rrugët e tyre optimale për t'u përfshirë në Hapësirën Evropiane të Kërkimit. Zotërimi i gjuhës së huaj në aspektin akademik aplikativ nuk është më një çështje që shtrohet për diskutim. Duke vlerësuar se intensiteti i kërkimit shkencor në vend është shumë i vogël krahasuar me vendet e tjera të BE, është imperativ riorientimi i programeve të këtij kërkimi dhe zotërimi i shprehive të komunikimit. Fakti që Shqipëria ka kushte makro-ekonomike të stabilizuara, zhvillimi pozitiv i sektorit bankar dhe funksionimi i ekonomisë së tregut, kërkojnë një partner të dëshiruar për rritjen e rezultateve pozitive në programet ndërkombëtare.⁴²

⁴²(Universitetet-Qendra të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor dhe teknologjik Referat mbajtur më 7 Mars në UPT nga Prof. Përparim Hoxha dhe Prof. Aleksandër Xhuvani.




Fig. 2 Detyrat të cilat duhet të gjejnë zgjidhje me anë të instrumenteve të politikës kërkimore janë:

- Promovimi i një rrjeti institucional kërkimor brenda dhe jashtë vendit;
- Mbështetja e pjesëmarrjes së suksesshme në programet kërkimore të BE dhe në iniciativat e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Rinovimi i bashkëpunimit kërkimor rajonal;
- Ristrukturimin emergjent të mësimdhënies së gjuhës së huaj në shkollat e larta.




Fig. 3 Detyrat të cilat duhet të gjejnë zgjidhje me anë të instrumenteve të politikës kërkimore

Strukturat dhe politikat evropiane e shikojnë bashkëpunimin në fushat e kërkimit dhe të edukimit si “një bazament i qëndrueshëm për ndërtimin e një bashkëpunimi ekonomik të qëndrueshëm”, si “një ambient të favorshëm dhe parakusht për zhvillimin të mëtejshëm me interes të ndërsjellë” (P. Hoxha)⁴³.




Fig. 4 Kriteret kryesore për ndërveprimin aktiv mes faktorëve Evropianë

Bashkëpunimi rajonal forcon zhvillimin e qëndrueshëm dhe luan një rol të rëndësishëm për prosperitet.

Intensiteti i ndërveprimit evropian të së sotmes dhe të ardhmes dikton përmirësime të shprehive të komunikimit të përditshëm e shkencor.

Kriteret kryesore për ndërveprimin aktiv mes faktorëve evropianë janë:

- *Kërkimi cilësor;*
- *Ndikimi i gjerë;*
- *Shkëmbimi informacionit;*

⁴³BURIMI (Universitetet-Qendra te mësimdhënies dhe te kërkimit shkencor dhe teknologjik Referat mbajtur më 7 Mars ne UPT nga Prof. Përparim Hoxha dhe Prof. Aleksandër Xhuvani.

Dimensionet rajonale

Cilat janë përfitimet kryesore nga përmirësimi i shprehive të komunikimit në gjuhë të huaj të studentëve dhe specialistëve të sapodiplomuar?

- Përgatitja për një pjesëmarrje efikase në programet e mëdha të EU;
- Zgjidhja e problemeve të ndjeshme të rajonit (ambient, shëndet, infrastrukturë);
- Importimi i traditës evropiane për zhvillimin e kërkimit shkencor;
- Përhapja e shpejtë e njohurive dhe e informacionit
- Krijimi i një bazamenti të mirë për aktivitete të edukimit modern nëpërmjet kërkimit shkencor.

Këto janë disa nga nevojat për më shumë kooperim në rajon dhe Evropë që diktojnë zotërimin e instrumentit gjuhë e huaj.

Faktori më i rëndësishëm, për ta vlerësuar cilësinë e produkteve të universiteteve sot është *indeksi i punësimit* për një të diplomuar, të formuar nga një program i veçantë, institucion apo universitet kudo në Evropë.

1.7. Puna dhe roli i mësuesve të ESP-së

Ashtu si kursi ESP-së, i cili është i shumëllojshëm, autorët si Dudley-Evans dhe St.John⁴⁴ përdorin termin doktor dhe jo mësues, për të theksuar se puna e ESP-së përfshin shumë më shumë se mësimdhënien. Profesionistët e ESP-së mund të kenë role të ndryshme. (Shiko Fig. 4)

Mësuesi ka një objektiv shumë të rëndësishëm; të ndihmojë studentët se si të mësojnë. Gjithsesi, ne si pedagogë nuk jemi njohës kryesor të përmbajtjes së materialit. Kursi është i orientuar në mënyrë specifike kundrejt përmbajtjes së lëndës ose punës në të cilën studentët janë të angazhuar dhe ndonjëherë këto të fundit dinë më tepër për lëndën, sesa vetë ne mësuesit. Ne kemi mundësi që të fitojmë nga studentët njohuri për përmbajtjen e lëndës gjatë komunikimit në klasë. Shpeshherë ka ndodhur që ti jem drejtuar studentëve me shprehjen “Unë nuk jam inxhinierë...” Kur në orën e gjuhës angleze, studentët trajtojnë tema, si për shembull se si të shkruajnë një raport inxhinierie, është e rëndësishme që të marrim pozicionin e atij që ka njohuri në praktikat komunikuese, por është gjithashtu e nevojshme të negociojmë me studentët në mënyrën se si ti shqyrtojmë këto praktika me qëllim që të arrijmë të përmbushin sa më mirë objektivat që kemi. Kjo marrëdhënie ngjan më shumë si një partneritet. Pra, në këtë rast, kemi nevojë për një klimë të ngrohtë dhe bashkëpunuese. Në disa situata, ne si pedagog të ESP-së na del për detyrë që ti këshillojmë studentët mbi përdorimin e gjuhës (për shembull si të publikojnë në revista ndërkombëtare). Si pedagogë të ESP-së duhet të kemi durim të mjaftueshëm, të jemi të gatshëm për të dëgjuar studentët dhe të tregojmë interes për aktivitetet ku ata përfshihen.

⁴⁴Dudley-Evans, T., & St John, M. (1998). *Developments in ESP: A multi-disciplinary approach*. Cambridge: Cambridge University Press

1.7.1. Mësuesi i ESP-së në rolin e projektuesit të kursit dhe përgatitjes së materialeve mësimore

Prej kohësh është pothuajse e pamundur të punosh vetëm me një tekst libri, pa pasur nevojë për materiale shtesë. Ndonjëherë materialet nuk gjenden dhe ne na duhet ti sigurojmë nëpërmjet burimeve të ndryshme. Kjo përfshin përzgjedhjen, përshtatjen dhe shkrimin e materialeve. Ne gjithashtu duhet të vlerësojmë efektin që kanë këto materiale kur vihen në përdorim. Ndodh që materialet e përzgjedhura nuk i pëlqejnë studentëve, apo ju duken tepër të vështira për tu përshtatur në gjuhë shqipe, edhe kur ato janë të përshtatshme për të zgjidhur një situatë të dhënë. Shpeshherë konsultohemi me pedagogë (inxhinierë), të cilët na sugjerojnë tekste apo materiale të cilat mund ti vijnë në ndihmë studentëve. Këto materiale janë të bazuara më së shumti në literatura të huaja mbi lëndët e profesionit. Ndaj, kur i caktojmë studentëve detyrat e kursit, i sugjerojmë të konsultohen me pedagogët e lëndëve të tjera mbi literaturën që do t'ju duhet në vijim të studimeve të tyre, me qëllim që dhe detyra e kursit të gjuhës së huaj të vlejë për diçka konkrete në punën e tyre.

1.7.2. Mësuesi i ESP-së si përpilues i materialeve të vëna në përdorim për studentët

Lidhur me studimet në gjuhën angleze për qëllime të inxhinierisë, është rritur interesi për gjuhën dhe aftësitë e përdorura në fushën e inxhinierisë. Ne na duhet të jemi në kontakt me atë që po studiohet, ndaj gjithmonë pyesim studentët dhe pedagogët e lëndëve të specialitetit mbi ecurinë apo materialet e studimit të vëna në përdorim nga studentët. Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi i pedagogëve të gjuhës së huaj me pedagogët e lëndëve të profesionit. Ashtu si përmenda edhe më lart, ajo çfarë studentët mësojnë në fillimet e tyre akademike në gjuhën e huaj teknike, duhet të jetë pjesë e studimeve të tyre të mëtejshme gjatë viteve të studimit. Vlera dhe rëndësia e gjuhës së profesionit, e merr formën dhe kuptimin e saj në vitin e dytë dhe të tretë kur studentët njihen me termat teknik në gjuhën shqipe dhe tashmë të mësuara edhe në gjuhën e huaj. Për këtë arsye, një bashkëpunim i frytshëm me profesorë të lëndëve të inxhinierive mbi përzgjedhjen e materialeve që do u vihen në dispozicion studentëve, do të ishte dhe çelësi i suksesit për studentët të cilët studiojnë në fakultetet tona të inxhinierive.

1.7.3. Mësuesit e ESP-së si bashkëpunëtor

Puna me subjekte të caktuara është arritur mjaft mirë nëpërmjet bashkëpunimit me specialistët e subjektit. Kjo përfshin bashkëpunimin sipas të cilit ne gjejmë programin mësimor të lëndëve në një kontekst akademik, përfshijmë detyrat që studentët duhet të realizojnë në një situatë pune apo mjedisi inxhinierie, ose mund të përfshijë bashkëpunimin e veçantë, ku mbizotëron integrimi i studimeve të specializuara, aktiviteteve dhe gjuhës. Një specialist mund të kontrollojë dhe të komentojë në përmbajtjen e materialeve mësimore që mësuesi ESP-së ka përgatitur. Bashkëpunimi i plotë arrihet kur një ekspert i lëndës dhe një mësues i gjuhës i nënshtrohen punës në grup.

Në EAP, ky bashkëpunim mund të ndihmojë në mësimin e ligjëratave apo në përgjigjet e provimeve, eseve apo tezave të provimeve, ndërsa në EOP mund të ndihmojë në një bashkëpunim ndërmjet mësuesit të gjuhës dhe një inxhinieri në mënyrë që të punojnë së bashku për të përmirësuar aftësitë mbi gjuhën e komunikimit inxhinierik.

1.7.4. Mësuesi i ESP-së si një vlerësues

Gjatë projektimit të kursit të gjuhës së huaj të specialitetit, shpesh e kam gjetur veten të përfshirë në testimin e nxënësve, vlerësimin e kurseve dhe materialeve mësimore. Testet janë kryer:

- 1) për të vlerësuar nëse studentët kanë gjuhën dhe aftësitë e nevojshme për të ndërmarrë një kurs akademik apo një karrierë e cila është e rëndësishme në për vijimësinë e studimeve të tyre dhe metodave që do të kenë në përdorim;
- 2) për të përcaktuar nivelin e tyre gjuhësor
- 3) për të vlerësuar nivelin e arritjeve të tyre, domethënë se sa njohuri kanë fituar studentët nga kursi.

Ndërsa kursit i vjen fundi, edhe materialet mësimore të vëna në dispozicion duhet të kenë përfunduar. Pasi kanë përfunduar, bëhet vlerësimi nëse studentët janë të aftë të zotërojnë dhe të përdorin atë që kanë mësuar dhe të gjejnë atë për çfarë ata nuk janë përgatitur. Një vlerësim i tillë përmes diskutimeve, mund të përdoret për ta bërë programin më të përshtatshëm. Vlerësimi bëhet mbi bazën e pjesëmarrjes dhe aktivizimit në seminare, si dhe dorëzimit të detyrave të caktuara gjatë vitit. Në mes të semestrit, studentët kanë për detyrë të bëjnë një ese, e cila është pjesë e programit mësimor dhe gjithashtu testi përfundimtar së bashku me detyrën e kursit, janë pjesë e vlerësimit përfundimtar të studentëve.

Figura në Shtojcën 1 na informon me një pasqyrë të pasur rreth rolit dhe punës së mësuesit të ESP-së, me ato çfarë thamë më sipër si dhe me disa aftësi të tjera shumë të rëndësishme që luan një mësues.⁴⁵

1.7.5. Trajnimi i mësimdhënësve të ESP-së

Shumica e kurseve të trajnimit të mësuesve përmbajnë 4 elemente themelore:

1) Përzgjedhja

Është e nevojshme përzgjedhja fillestare dhe përfundimtare sepse jo çdokush mund të bëhet mësues i gjuhës adekuate. Çdo mësues ka përgjegjësi përgjatë një karriere që mund të zgjasë për 30 vjet ose më gjatë. Kjo përgjegjësi e bën të qartë faktin se personat jo-efektivë nuk mund të jenë pjesë e këtij profesioni.

2) Vazhdimi i arsimit personal

Mësuesit duhet të jenë njerëz të mirë-arsimuar. Standardet e pranuar për mësuesit ndryshojnë nga një vend në një vend tjetër. Është e qartë se arsimimi personal

⁴⁵ Vrapj, F, 1995. Punim I tezës së doktoraturës mbi ESP dhe rolin e mësuesit të ESP-së

përmirësohet edhe nga trajtimi profesional ku 2 apo 3 vitet e para të studimit nuk përmbajnë elemente të trajnimit si një mësues, por vazhdojnë në vitin e 4 i cili ka më shumë metoda për mësimin e gjuhës së huaj. Sidoqoftë, shpesh hamendësohet se niveli i arsimimit të atyre që sapo janë diplomuar, konsiderohet si i pamjaftueshëm.

3) Trajnimi i përgjithshëm profesional si një mësues dhe edukator

Këtu përfshihen të gjithë faktorët që mësuesit duhet të dinë lidhur me lëndën që trajtojnë, ku mund të rendisim:

- a) të jenë të informuar rreth psikologjisë arsimore, studimit dhe zhvillimit të fëmijës, psikologjisë sociale si dhe parimeve të mënyrës së të menduarit;
- b) të dinë të organizojnë orën e mësimit si dhe të jenë të ndërgjegjshëm për llojet e ndryshme të arsimimit, për rrugët normale dhe të pazakonta drejt tij.
- c) të ndërgjegjësohet për të pasur një edukim moral dhe retorik të karakterit, entuziazmit etj.
- d) të ketë njohuri dhe aftësi për menaxhimin e klasës, disiplinës dhe trajtimin e grupeve të ndryshme të nxënësve;
- e) të ketë njohuri dhe aftësi mbi teknikat themelore mësimore dhe mbi marrëdhënien mësues-nxënës.
- f) të kuptojë programin dhe materialin mësimor.
- g) të jetë gjithnjë i angazhuar për të qenë në kontakt me profesionin e mësimdhënies.

4) Trajtimi i veçantë si një mësues i një gjuhe të huaj apo një gjuhe të dytë

Kompleksi i këtij trajnimi, i cili përbën thelbin e kurseve të trajnimit të mësuesve mund të bëhet më i thjeshtë përmes 3 aspekteve të cilat janë:

1) **Faktori i aftësive** i cili po ashtu përfshin 3 aftësi të ndryshme të kërkuara nga mësuesi:

- a) komanda e gjuhës që mësuesi mundohet t'ua mësojë studentëve; ky komponent duhet të sigurojë që komanda që ka mësuesi mbi gjuhën e huaj të jetë sa më e përshtatshme për arritjen e qëllimeve në klasë;
- b) teknika mësimore dhe aktivitetet në klasë; Pjesa më e madhe e mësuesve trajnues është për të asimiluar teknikat efektive;
- c) menaxhimi i të mësuarit, është një pjesë kryesore e aftësive të mësuesit në klasë për të vlerësuar në çdo moment ecurinë e çdo individi dhe për të menaxhuar aktivitetet në klasë. Komponenti i aftësive kërkon trajnim praktik në kryerjen e detyrave që e realizojnë plotësisht një mësues.

Është një gamë e gjerë e aktivitetesh që përmblihen si më poshtë:

- mbikëqyrja e teknikave specifike dhe plotësimit të detyrave mësimore,
- mbikëqyrja e klasave aktuale,
- praktika në përgatitjen e planit mësimor,
- teknika me përdorimin e mundshëm të regjistrimeve nëpërmjet kamerës,

- roli si asistent i një mësuesi në klasë,
- mësimdhënia në klasë, nën mbikëqyrje,
- diskutimi mbi mësimdhënien e atij që po trajnohet,

2) Përbërësit e informacionit:

- a) informacioni mbi arsimin
- b) informacioni mbi materialet dhe programin mësimor
- c) informacioni mbi gjuhën

Përmbajta e informacionit mund të mësohet edhe nga leximi i leksioneve.

3) Përbërësit e teorisë

Profesioni i mësimit të gjuhës bën lidhjen me studimet teorike në disiplina të ndryshme si, gjuhësore, psikologji, psikolinguistikë, sociolinguistikë, teori sociale etj. Komponenti i teorisë mund të asimilohet nga diskutimet praktike për zgjidhjen e problemeve, shpjegimet dhe koha që duhet për të gjetur mënyra të tjera të të menduarit. Ajo që duhet theksuar dhe nuk duhet harruar është fakti se, ne pedagogët e ESP-së, nuk jemi të specializuar në një fushë të caktuar, por në mësimin e anglishtes si gjuhë e huaj. Subjekti ynë është anglishtja për profesionin dhe jo profesioni i anglishtes. Ne i vijmë në ndihmë studentëve që të njohin lëndën edhe më mirë se sa vetë ne, pedagogët e tyre. Ne duhet të zhvillojmë aftësitë sociale të kuptimit, të përdorim si dhe të prezantojmë informacione të mirëfillta për profesionin tonë. Një mësues profesionist i ESP-së duhet të jetë i aftë të kalojë nga një fushë profesionale në një tjetër pa qenë nevoja për të shpenzuar shumë kohë e për t'ia nisur nga e para, por thjeshtë duke gjetur materialet e nevojshme për të punuar.

Ndonjëherë, për fat të keq, ka raste ku ndihemi të izoluar si nga profesionistët që merren me specializimet e studentëve të tyre, ashtu edhe nga kolegët tanë që mund të punojnë në institucione të tjera, duke u përballur kështu me vështirësi në marrjen apo shkëmbimin e informacioneve në këtë fushë. Gjithashtu, ne mendojmë që rrjeti ESP është shumë i rëndësishëm, prandaj është i nevojshëm edhe sigurimi i tij.

Në Shqipëri më saktë në UPT, puna me tekstet e ESP-së ka ndodhur shumë vite më vonë, në krahasim me vende të tjera të Evropës Perëndimore, deri diku dhe të Evropës Lindore. Kjo punë është përqendruar kryesisht në analizën e një teksti teknik, nga ana e fjalorit më tepër, sesa nga ana e strukturës së fjalive apo materialeve gramatikore të përdorura. Studentët nuk kanë pasur në përdorim tekste të mirëfillta të gjuhës teknike, por materiale të gjetura në literatura të huaja, apo të marra nga interneti, ku ato sillleshin “bruto” nga studentët, tekste të gjata, me terma teknike të komplikuar, shpeshherë me skema të analizuara në gjuhë të komplikuar teknike ku studentët kanë pasur vështirësi për analizimin e tyre. Më pas, rreth viteve 2007, u krijua një kurrikul e re, e cila i përshtatej më tepër nevojave të studentëve të cilët studionin në fakultetet e UPT-ës, e cila bëri që të viheshin në përdorim tekste të mirëfillta të inxhinierisë. Por sërish hasen probleme. Teksti i zgjedhur “Technology”, kishte një sërë temash të cilat trajnonin në mënyrë të përciptë tema nga fusha të ndryshme të teknologjisë dhe ishte gjithëpërfshirës, që do të thotë se: një student i cili studion për inxhinieri gjeologji-miniera, mund të hasej vetëm me një temë të

gjuhës së profesionit të tij, gjatë gjithës tekstit të përzgjedhur. Temat e tjera, preknin fusha të ndryshme të teknologjisë. Atëherë u mendua që do të ishte më e udhës që të përzgjidhej një tekst i cili t'u përshtatej më tepër nevojave të studentëve të cilët ta gjenin veten e tyre përgjatë gjithë tekstit. Më pas, Qendra e Gjuhëve të Huaja (QGJH), duke parë edhe nevojat dhe interesimin në rritje të studentëve për të mësuar gjuhën e profesionit, bëri përzgjedhjen e tekstit “Engineering”, i cili është ende në përdorim në të gjitha fakultetet e UPT-ës. Teksti “Engineering”, një botim i Express Publishing, është analizuar në vijim të punimit tonë, ku kemi nxjerrë në pah anët pozitive dhe negative të tij.

1.7.6. Mësuesi përcakton situatën në të cilën studenti do e përdori gjuhën

Ne e përmendëm më sipër se, qëllimi i kursit të ESP-së është që t'i mundësojë studentëve të funksionojnë në mënyrë adekuate në një situatë të caktuar, që do të thotë, situata të cilën studentët do të përdorin gjuhën që janë duke mësuar. Në këtë mënyrë procesi i krijimit të tekstit të ESP-së duhet të identifikojë më parë objektivin dhe pastaj duke të kryej një analizë rigorozë të tipareve gjuhësore të situatës. Karakteristikat e identifikuar formojnë planin mësimor të kursit të ESP-së. Ky proces është i njohur zakonisht si *analiza e nevojave*. Megjithatë, ne preferojmë të marrim termin “Analiza e situatës Tagër”⁴⁶, pasi ai është përshkrimi më i saktë i procesit. Shpjegimi më i plotë i kësaj analize është sistemi i vendosur nga John Munby në *Communicative Syllabus Design*⁴⁷. Modeli i Munby prodhon një profil të detajuar të nevojave të nxënësve në aspektin e komunikimit, aftësive gjuhësore, funksioneve, strukturave etj.

Faza e analizës shënoi një moshë të caktuar për ESP-ën. Kjo fazë ka bërë një përpjekje për të marrë në konsideratë jo vetëm gjuhën, por proceset e të menduarit që shtrihen tek përdorimi i gjuhës. Nuk ka asnjë figurë dominuese në këtë lëvizje, edhe pse ne mund të përmendim punën e Françoise Grellet⁴⁸, Christine Nuttall⁴⁹ dhe Charles Alderson dhe Sandy Urquhart⁵⁰, pasi kanë dhënë kontribute të rëndësishme për të punuar me aftësinë e leximit. Pra, projektet i kanë përqendruar përpjekjet e tyre në strategjitë e leximit. Ideja kryesore pas qasjes me në qendër aftësitë është që në themel të përdorimit të gjuhës ka procese arsyetimi dhe interpretimi të zakonshme, të cilat, pavarësisht nga format sipërfaqësore, na mundësojnë të nxjerrim kuptimin e shkëputur nga diskursi. Pra, nuk ka nevojë të fokusohet ngushtësisht në format sipërfaqësore të gjuhës. Fokusi duhet të jetë më tepër në strategjitë themelore interpretuese, të cilat mundësojnë nxënësin të përballojë format sipërfaqësore, si p.sh. hamendësimin e kuptimit të fjalëve nga konteksti, duke

⁴⁶Chambers, F. (1980). A re-evaluation of needs analysis. *ESP Journal*, 1/1, fq. 25-33

⁴⁷Munby, J., *Communicative Syllabus Design*, Cambridge University Press, 1978

⁴⁸Grellet, F., *Developing Reading Skills*, Cambridge University Press, 1981

⁴⁹Nuttall, C., *Teaching Reading Skills I a Foreign Language*, Heinemann, 1982

⁵⁰Alderson, J.C. and Urquhart, A.H (eds.), *Reading in a Foreign Language*, Longman, 1984

Shumica e punës në fushën e aftësive dhe strategjive, megjithatë, është bërë në skemat e Projektit Kombëtar ESP në Brazil dhe Universiteti i Malaya, Projekti ESP. Të dy këto projekte ishin ngritur që të bashkëpunonin me studimin ku e mesmja e udhëzimeve është gjuha amtare, por studentët kanë nevojë të lexojnë një numër të teksteve të specializuara të cilat janë të vlefshme vetëm në anglisht.

përdorur paraqitjen vizuale për të përcaktuar llojin e tekstit, duke shfrytëzuar fjalët e përafërta të cilat janë të ngjashme në gjuhën amtare dhe gjuhën target etj..

"Është argumentuar se aftësitë e leximit nuk janë të veçanta, por universale dhe se ka një bërthamë të gjuhës (për shembull, struktura të caktuara të argumentit dhe format e prezantimit), të cilat mund të identifikohen si" akademike "dhe nuk janë subjekt specifik"⁵¹.

Siç është vënë re, në drejtim të materialeve kjo qasje përgjithësisht e vë theksin në lexim apo dëgjim. Ushtrimet karakteristike i bëjnë nxënësit të reflektojnë dhe analizojnë se si është prezantuar një detyrë me shkrim apo si prezantohet ajo në gjuhën e folur. Duke marrë sugjerimin e tyre nga teoritë konjitive rreth mësimit, nxënësit e gjuhës trajtohen si qenie të të menduarit që mund t'u kërkohet për të vëzhguar proceset interpretuese që ata shfrytëzojnë në përdorimin e gjuhës.

1.7.7. Një qasje me qendër të mësuarit

Në përvijimin të origjinës së ESP, kemi identifikuar tre forca, të cilat ne mund ti karakterizojmë siç është

- a) nevojat e studentëve,
- b) ide të reja për gjuhën dhe
- c) ide të reja rreth të mënyrës së mësuarit.

Megjithatë, duhet të bëhet e qartë se në zhvillimet e mëvonshme, pak vëmendje i është kushtuar pjesës së fundit të këtyre forcave të mësuarit. Shqetësimi në çdo rast ka qenë në lidhje me përshkrimin se çfarë bëjnë njerëzit me gjuhën. Por ky shqetësim në ESP nuk ka të bëjë me përdorimin e gjuhës edhe pse kjo do të na ndihmonte për përcaktimin e objektivave të kursit. Shqetësimi lidhet me mësimin e gjuhës. Ne nuk mund të supozojmë që përshkrimi dhe demonstrimi se çfarë bëjnë njerëzit me gjuhën do të ndihmonte dikë për ta mësuar atë. Nëse kjo do të ishte kështu, ne nuk do të duhej të bënim më shumë sesa të lexonim një libër gramatike dhe një fjalor në mënyrë që të mësonim një gjuhë. Një qasje vërtetë e vlefshme për ESP-ën duhet të bazohet në kuptimin e proceseve të mësimit të gjuhës. Të mësosh gjuhën e huaj për qëllime të veçanta, duhet angazhim, përkushtim, ambient i krijuar enkas mbi këtë çështje për ta përcjellë sa më qartë dhe saktë tek studenti atë që nesër për këta studentë do të jetë dhe gjuha me të cilën do të komunikojnë dhe veprojnë në ambientet e punës së tyre. Nevojat e tyre janë prioritet për ne dhe na bëjnë që të jemi gjithmonë në kontakt me zhvillimet dhe të rejat e kësaj fushe të gjuhës, ku informacioni i mbledhur nga ana jonë të përcillet tek studentët, duke marrë vlerat për të cilat ato vërtetë janë krijuar. Që në fillim, objektivat e vendosura në hartimin e plan programeve për studentët të cilët mësojnë gjuhën e huaj të profesionit, duhen bërë të qarta. Çdo vit, këto programe duhen përmirësuar duke sjellë ide të reja rreth mënyrës së mësimit dhe përvetësimit të kësaj gjuhe.

⁵¹Chitavelu, N., "English for Special Purposes" in ELT Documents 107, British Council, 1980

1.8. Nivelet gjuhësore në kurrikulat e UPT

Përpyekjet e mëdha për të përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet shteteve Evropiane duke lehtësuar mënyrat me të cilat njerëzit takohen e komunikojnë janë rritur shumë këto vitet e fundit. Të rinjtë dhe në veçanti studentët, konsideroheshin si kategoria më e gjallë e shoqërisë të cilët mobilizoheshin me mësimin e gjuhëve të huaja për arsye edhe të zgjedhjes së tyre për të mësuar në një vend të huaj (jo atë të origjinës) dhe kjo ishte mënyra më e mirë për të përhapur kulturën, njohuritë dhe gjuhën e tyre në vende të tjera të Evropës. Nga fillimi i viteve 1976, u krijua Programi Aksion në Fushën e Edukimit⁵² dhe në të njëjtin vit u krijua edhe programi⁵³. Komisioni Evropian themeloi Programin Erasmurs në vitin 1987. Që nga ajo kohë, mbi një milion studentë Evropianë kanë përfutur nga grandet e këtij programi i cili është bërë shumë i famshëm jo vetëm për studentët të cilët studiojnë në universitete, por edhe për një sektor më të gjerë të shoqërisë⁵⁴. Ky popullaritet çoi në zgjerimin e programit ku përfshiu mësues dhe staf administrativ e duke e zgjeruar në këtë mënyrë ndërkombëtarizimin e universiteteve. Por deri në vitin 1990 nuk ishin diskutuar ende çështje të shkollimit universitar. Studimi i kryer nga raporti i Trends⁵⁵ zbuloi se vendet më të fuqishme kishin vënë në zbatim strukturat me 2 cikle në procesin e tyre. Kishte shumë çështje të cilat i bënë qeveritë që ta shihnin me shqetësim procesin Evropian. Një nga këto shqetësime ishte fakti se një treg i hapur Evropian, i cili nuk kishte rregulla mbi lëvizjen e studentëve në shtete të ndryshme, do të çonte në një mosbalancim ndërmjet numrit të studentëve që hynin dhe atyre që dilnin nëpër shtete të ndryshme në Evropë dhe si rrjedhojë do të ndikonte jo vetëm në statusin e sistemit akademik të një vendi, por do të çonte edhe në atë që quhet “largimi i trurit”.

Disa shtete, të tilla si Britania, Holanda, Norvegjia dhe Austria, e mirëpritën konkursin ndërkombëtar dhe filluan të mirëpresin studentë nga përtej kufijve⁵⁶. Gjithsesi, ky treg i universiteteve nuk u mirëprit dhe nuk u pa si pozitiv nga shumë vende të tjera. Në Greqi, procesi ndërkombëtarizues i cili rridhte nga Deklarata e Bolonjës, mendohej se do çonte në degradimin e universiteteve publike dhe kjo solli polemika të forta nga shoqata e bashkuar e akademikëve.

1.8.1. Mësimi i gjuhëve dhe politikat Evropiane

I vetmi dokument i cili ka përmendur në mënyrë eksplicite rëndësinë e mësimin të gjuhëve për procesin e Deklaratës së Bolonjës, ishte Komunikata e Berlinit (Berlin Communique), megjithëse njohuria për gjuhët ishte një domosdoshmëri për reformën. Në 1982, Komiteti i Këshillit të Ministrave për Evropën, kishte themeluar parimet bazë që kishin të bënin me mësimin e gjuhëve moderne që:

⁵² Wit, J. de & Verhoeven, J. C. 2001. The higher education policy of the European Union. In Higher Education and the Nation State. The international dimension of Higher Education, J. Huisman, P. Maasen & G. Neave (eds), Oxford: Pergamon

⁵³ Huisman, J. & van der Wende, M. 2004. The EU and Bologna: Are supra and International initiatives threatening domestic agendas? *European Journal of Education* 39(3). Fq. 349.

⁵⁴ http://europa.eu.int/comm/education/archive/million/milloin_en.html Acc.

⁵⁵ Reichert, S. & Tauch, C. 2003. Trends 2003. *Progress towards the European Higher Education Area*. Brussels: EUA. Fq. 45-6

⁵⁶ (Po aty. Fq 353)

“...vetëm nëpërmjet njohurive të mira të marra nga gjuhët moderne Evropiane do të jetë e mundur të komunikohet lehtësisht dhe të ketë një bashkëveprim ndërmjet Evropianëve me gjuhë amtare të ndryshme të cilët promovojnë bashkëpunim, lëvizshmëri dhe lënë mënjanë paragjykimet dhe diskriminimet...”⁵⁷;

Shtetet anëtare mund të arrijnë në konvergjenca të mëdha teksa adaptojnë apo zhvillojnë politika kombëtare në fushën e mësimnxënies/mësimdhënies së gjuhëve moderne në nivel Evropian duke vënë në praktikë politika dhe bashkëpunime të duhura. Që nga ajo kohë, kanë qenë të shumta takimet e dokumentet të cilat kanë trajtuar çështjen e mësimin të gjuhëve të huaja në Evropë. Në fillim të vitit 1989, Këshilli i Evropës krijoi projektin “The Common European Framework of Reference for Languages-Learning, Teaching, Assessment”, “Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencave për Mësimin e Gjuhës, Mësimdhënien dhe Vlerësimin”, si një nga proceset më të mira të mësimin të Gjuhëve për qytetarët Evropianë (1989-1996). Si rezultat, Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencave për Mësimin e Gjuhës, Mësimdhënien dhe Vlerësimin, është krijuar si “një bazë e përbashkët për bashkëpunimin e silabusit gjuhësor, udhëzimeve të kurrikulës, testeve, teksteve si dhe materialeve të tjera nëpër Evropë”⁵⁸

Arritje kryesore të Kornizës së Përbashkët Evropiane kanë qenë:

1. Krijimi i tre përbërësve përcaktues të kompetencave komunikuese gjuhësore: kompetenca gjuhësore, sociolinguistike dhe pragmatike
2. Katër aktivitetet gjuhësore: thithja, prodhimi, ndërveprimi dhe meditim
3. Tre fusha: personale, punësimi dhe edukimi

Megjithatë, më tepër e rëndësishme për mësuesit e gjuhës dhe nxënësit në Evropë ishte krijimi dhe përshkrimi i detajuar i Niveleve të Përbashkëta të Referencës (Common Reference Levels) për të gjitha gjuhët në Evropë. Ato i inkurajojnë dhe ndihmojnë mësuesit që të përcaktojnë nivelet e studentëve dhe për rrjedhojë krijojnë lehtësira në vendosjen e objektivave për kurset e mësimin të gjuhëve.

Thënë këto, kthejmë vështrimin në atë që ne sot e kemi realitet, në atë që ne bëjmë çdo ditë, mësimdhënia në ambientet e UPT-ës, aty ku edukohen breza të tërë studentësh, të cilët janë inxhinierët e ardhshëm. Aplikimi i Sistemit të Bolonjës në këtë universitet na jep këtë paraqitje për sa i përket nivelit të gjuhës angleze dhe aplikimit të tij në të gjitha fakultetet e UPT-së:

Qendra e Gjuhëve të Huaja duke pasur parasysh zhvillimet Evropiane, zhvillimet në Arsimin e lartë Shqiptar (orientimet e MASH), kërkesat e nevojat në rritje të studentëve për Nivele më të larta cilësore e sasiore në Gjuhët e Huaja është përpjekur që t’u përgjigjet këtyre zhvillimeve, tendencave e kërkesave konkrete që paraqiten për Nivelet e Gjuhës, sidomos angleze, në Ciklet e Parë, të Dytë e të Tretë të Studimit Universitar e Pasuniversitar⁵⁹.

Në këtë drejtim, synohet të unifikohen e standardizohen programet e mësimdhënies në Fakultete e Degë të ndryshme Inxhinierie për të synuar një unifikim të krediteve, shtrirje

⁵⁷ Rekomandim, R(82)18 <http://www.coe.int/acc>

⁵⁸ <http://culture2.coe.int/portfolio/documents/0521803136txt.pdf>Acc(fq.1)

⁵⁹ Vrapit, Fatmir 2013botim mbi Nivelet gjuhësore në Kurrikullat e UPT-së.

kohore e kohëzgjatje të programit për të realizuar objektivat e duhur në fushën e gjuhës (Teaching and Learning Outcomes).

Në këtë kuadër marrin rëndësi jo vetëm Metodatat Komunikuese, efikase dhe bashkëkohore në fushën e mësimdhënies, por edhe ngritja e një baze laboratorike të kompjuterizuar, krijimi i një mjedisi të dobishëm në favor të mësimdhënies, metodologjia e kërkimit dhe shfletimit të fjalorëve terminologjikë etj. në nxitje të edukimit profesional, shumë-gjuhësor të studentëve duke stimuluar interesin e studimit të tyre për lëndën e gjuhës së huaj.

Qendra e Gjuhëve të Huaja në pajtim dhe me Kurikulat e reja sipas Protokollit të Bolonjës si dhe me synimin për arritjen e standardeve gjuhësore sipas Kornizës Evropiane të Gjuhëve, është përpjekur të rrisë nivelin në mësimdhënie e mësim-nxënie përmes metodave të reja komunikuese dhe sa më cilësore duke u mbështetur në tekste dhe literaturë bashkëkohore, shoqëruar dhe me literaturën përkatëse të cilën e sigurojmë nëpërmjet artikujve të ndryshëm në rrjet si dhe mundësi të tjera të ofruara qoftë nga literatura e rekomanduar nga vetë Fakultetet apo laboratorit i gjuhëve të huaja⁶⁰.

Me futjen e teksteve të reja e literaturës së fundit, pedagogët janë përpjekur të vënë në zbatim sipas gjuhëve, metoda sa më efektive dhe funksionale duke nxitur përvetësimin e gjuhëve përmes aftësive e shprehive të integruara për studentët, duke pasur parasysh dhe kryesisht aspektet profesionale e teknike në formimin e tyre gjuhësor. Në këtë drejtim, kanë shërbyer dhe format e larmishme të kontrollit dhe sesionet praktike laboratorike. Por mbetet shumë për të bërë për një ndryshim e rinovim të mëtejshëm të laboratorit për të sjellë standarde sa më cilësore, për shërbime sa më integrale, bashkëkohore dhe dobiprurëse për studentët dhe pedagogët⁶¹. Duhet vënë në dukje vlera e standardizimit të krediteve në Fakultete (iniciativë e marrë dhe nga Senati por e papërfunduar) sidomos në hartimin e plan – programeve të reja mbështetur në tekste autentike e përvoja pozitive të hasura në shumicën e fakulteteve (me 5 – 6 kredite). Gjithashtu synohet dhe rritja e nivelit cilësor në mësimdhënie e mësim-nxënie sipas Standardeve të Kornizës Evropiane të Gjuhëve (në Nivelet B1-B2-C1-C2) mbështetur në përvojat e metodat bashkëkohore si dhe tekste e literaturë të pasur, autentike në gjuhë të huaj⁶².

Nxitja e rritja e bashkëpunimit, shkëmbimi i përvojës e kooperimi i frytshëm si dhe efektiviteti si në institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, synojnë barazinë, ekuivalentimin dhe standardizimin e vlerave e produkteve përkatëse. Në kuadër të zhvillimeve e perspektivës së vendit tonë që synon të integrohet në BE, gjuha si mjeti kryesor e më i larmishëm i komunikimit, nuk mund të lihej mënjanë. Nën këtë vështrim, filluan dhe hapat e përpjekjet e para për krijimin e konturimit e Kornizës Evropiane të Gjuhëve të shteteve përbërëse të këtij Unioni. Përkufizimi kryesor i Kornizës së Niveleve gjuhësore do të shprehej më së miri e qartazi në gjuhën Angleze: “The Common European Framework of Reference for Languages-Learning, Teaching, Assessment”. Korniza e Përbashkët Evropiane e Gjuhëve pati si synim kryesor unifikimin e termave të referencës,

⁶⁰Prospekt i UPT 2011

⁶¹Vrapi, F. 2013, Nivelelet gjuhësore në Kurrikullat e UPT-së

⁶²Kuadri European për Gjuhët Buletini i UPT, 2005

në fushën e përvetësimit e kualifikimit sipas niveleve gjuhësore burimore të ndryshme dhe objektivave përkatës⁶³.

Ne do të veçonim e dallonim sipas kësaj Kornize Gjuhësore 6 nivelet kryesore shoqëruar me kompetenca specifike dhe veçoritë e karakteristikat përshkruese përmes të cilave mund të kalibrohen këto nivele. Nivelet paraqiten si vijon:

A1-Beginner Level	B1- Pre-intermediate Level	C1-Advanced Level
A2-Elementary Level	B2-Intermediate Level	C2-Proficient Level
(Basic User)	(Independent User)	(Proficient User)

Duke pasur parasysh përgatitjen e kualifikimin sa më të mirë të Inxhinierëve të rinj sipas kërkesave të kohës e të tregut, ndërtohen dhe kurrikulat e planet mësimore të cilat synojnë të reflektojnë situatën reale dhe zhvillimet objektive brenda veçorive specifike në Departamentet e UPT mbështetur në kohëzgjatjen e procesit mësimor dhe kreditet përkatëse. Mbështetur në përshkrimin, veçoritë, dhe programin sasior e cilësor të këtyre niveleve ndërtohet dhe puna e përgatitja për të kryer me sukses provimet ESOL nga Universiteti i Kembrixhit ku dhe QGJH synon të japë kontributin e saj në kryerjen me sukses të këtyre provimeve për Nivelin e Ciklit të Dytë (B2=Master Profesional) dhe Nivelin e Ciklit të Dytë e të Tretë (C1-C2=Master Shkencor dhe Doktoraturë).

Një relacion shpjegues e i qartë paraqitet dhe në tabelën e mëposhtme nga Piers Wall, gjuhëtar e lektor anglez nga Universiteti i Glouchesterit, Angli, ku krahasohen nivelet e Këshillit të Evropës, me kurset e Gjuhës Angleze të Përgjithshme (General English) dhe provimeve të tjera.

CILC Level	Council of Europe Level	Cambridge Examination
Elementary	A1	
Pre-Intermediate	A2	KET
Intermediate	B1	PET
Upper Intermediate	B2	FCE
Lower Advanced	C1	CAE

Në vijim, po paraqesim dhe nje tabelë përmbledhëse ku përshkruhen në përgjithësi nivelet gjuhësore sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët. Aty tregohen njohuritë e shprehite që e karakterizojnë një përdorues të gjuhës sipas niveleve përkatëse:

- Studenti (përdorues) i niveleve A1-A2 përshkruhet si një Basic User, përdorues me shprehi bazë gjuhësore.
- Studenti (përdorues) i niveleve B1-B2 përshkruhet si një Independent User, përdorues i pavarur i shprehive gjuhësore.
- Studenti (përdorues) i niveleve C1-C2 përshkruhet si një Proficient User, përdorues i Avancuar i shprehive gjuhësore.

⁶³Keith M. 2001, Insights from the Common European Framework Council of Europe.

**NIVELET GJUHËSORE SIPAS KUADRIT TË PËRBASHKËT
EVROPIAN TË REFERENCAVE PËR GJUHËT**

Niveli	Përshkrimi i përgjithshëm i niveleve gjuhësore
A1	Studenti mund të kuptojë dhe të përdorë shprehje të përditshme dhe shprehje bazë që synojnë plotësimin e nevojave konkrete. Mund të prezantojë veten dhe të tjerët dhe të pyesë e të përgjigjet për detaje vetjake si: ku jeton, banon, njerëzit që njeh, sendet që ka etj. Mund të komunikojë në një mënyrë të thjeshtë nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë, qartë dhe është i gatshëm ta ndihmojë.
A2	Studenti mund të kuptojë fjali dhe shprehje të përditshme që lidhen me fusha të nevojës më të domosdoshme si p.sh: informacion bazë rreth tij dhe familjes, gjeografi lokale, punëve që bën. Mund të komunikojë për detyra të thjeshta dhe rutinë që kërkojnë shkëmbim informacioni të drejtpërdrejtë për çështje të njohura dhe të përditshme. Mund të përshkruajë me terma të thjeshta aspekte të formimit të tij/saj, mjedisit rrethues dhe çështje të fushave me interes të drejtpërdrejtë.
B1	Studenti mund të kuptojë çështjet kryesore të njohura që hasen rregullisht në shkollë, punë, argëtim etj. Mund të merret vesh (është i aftë të orientohet) në situata gjatë një udhëtimi në vende ku flitet gjuha në fjalë. Mund të hartojë materiale të thjeshta për tema të njohura ose të një fushe të interesit personal. Mund të përshkruajë përvoja dhe ngjarje, ëndrra, shpresat dhe ambicje si dhe arsye të shpjegojë në mënyrë të përmbledhur mbi opinione dhe plane të ndryshme.
B2	Studenti mund të kuptojë idetë kryesore të një teksti kompleks mbi çështje konkrete e abstrakte duke përfshirë diskutime në fushën e tij të specializimit. Mund të bashkëveprojë rrjedhshëm dhe spontanisht, me folës vendas pa vështirësi për të dy palët. Mund të hartojë tekst të qartë, të detajuar rreth një sërë temash si dhe shpjegojë pikëpamjet e tij/saj për një çështje të ditës, duke parashtruar avantazhet dhe disavantazhet për opsione të ndryshme.
C1	Studenti mund të kuptojë tekste më të gjata me një shkallë më të gjerë kërkesash dhe thënie të tërthorta. Mund të shprehet rrjedhshëm dhe spontanisht. Mund ta përdorë gjuhën në mënyrë elastike dhe efektive për qëllime akademike, sociale dhe profesionale. Mund të hartojë tekst të qartë, të mirë-strukturuar, të detajuar për tematika komplekse, duke mundësuar përdorim të qartë të organizimit të të menduarit dhe të të shprehurit.
C2	Studenti mund të kuptojë lehtësisht çdo gjë që dëgjon apo lexon. Mund të përmbledhë informacionin e marrë nga burime të shkruara ose të dëgjuara, duke riformuluar argumentet dhe rezultatet në një prezantim koherent. Mund të shprehet spontanisht, shumë rrjedhshëm dhe saktë, duke dalluar nuancat kuptimore edhe në situatat më komplekse.

Figure 5 Nivelet gjuhësore sipas KPER

Në vijim, po paraqesim disa tregues sasiore për vitin 2011-2012 të Qendrës së Gjuhëve të Huaja të UPT, reflektuar këto të dhëna dhe në hartimin e kurrikulave të reja.




Fig.6. Raporti i Gjuhëve sipas numrit të studentëve i shprehur në përqindje⁶⁴.




Fig.7. Ngarkesa mësimore e mbuluar me pedagogë te brendshëm e të jashtëm⁶⁵

Studentët e UPT-së kanë nevojë të jenë të aftë për të komunikuar në mënyrë të suksesshme në gjuhën e tyre të profesionit. Detyra jonë si pedagogë është që ti motivojmë studentët në mënyrën e të mësuarit dhe gjetjen e rrugëve më efikase dhe të dobishme të mësimit të gjuhës edhe kur ata janë larg auditoreve apo mësuesve të tyre.

⁶⁴ Arkiva e kurrikula nga QGJH e UPT

⁶⁵ (Po aty)

Organizimi dhe vetëdija janë të përfshira në objektivat e silabusit të ESP-së në mënyrë që studentëve t'u jepet ndihma e duhur dhe njohuritë e duhura për të arritur nivelin B2 si standard që duhet për marrjen e Diplomës Bachelor, një nivel i njohur nga Evropa dhe që rrjedh nga Korniza e Përbashkët e Referencave për Gjuhët. Aftësitë e të mësuarit janë të përfshira në objektivat e mësim-nxënies në kurrikulën e ESP-së për një zhvillim sa më profesional të kompetencave gjuhësore të studentit. Me qëllim që studentët të punojnë në mënyrë efikase dhe të dobishme edhe pasi të jenë diplomuar nga universiteti, ata kanë nevojë të zhvillojnë aftësitë e tyre studiuese që të jenë të aftë të mësojnë në mënyrë të pavarur.

"Language skills will be important in achieving European policy goals, particularly against a background of increasing global competition"⁶⁶

KREU II

GJUHËT E HUAJA SI PRIORITET KOMBËTAR PËRBALLË NDRYSHIMIT DHE REFORMAVE. INSTRUMENTET BAZË NË REFORMIMIN E KURRIKULAVE NË UPT.

2.1.Kontekst i përgjithshëm

Një vëmendje e konsiderueshme i është dhënë për vite me radhë zhvillimit të teknikave të mësimdhënies. Në mënyrë të ngjashme, ka pasur një rritje të dukshme të interesit për sa i përket materialeve mësimore të gjuhës angleze. Megjithatë është e rëndësishme që të dyja së bashku, gjuha e përgjithshme dhe ajo specifike ti kushtohet një vëmendje e veçantë dhe e baraspeshuar për të pasur një proces trajnimi sa më të mirë dhe frytdhënës. Duke marrë në shqyrtim një shembull që konkretizon rastin, një inxhinier mund ta ketë të nevojshme të shprehë disa koncepte matematikore apo koncepte kimike në situata të caktuara. Pastaj mund të pretendohet që studentët e inxhinierisë mund ta kenë të nevojshëm përfitimin e terminologjisë sociale, matematikore apo edhe shkencore gjatë periudhës së trajnimit të tyre në universitet. Ky kapitull synon të nxjerrë në pah nevojat e studentëve në fakultetet e UPT-së si dhe të ristrukturojë programin aktual në mënyrë bashkëkohore. Ky program duhet të jetë në shërbim të pedagogëve të gjuhës angleze, qëllimi i të cilëve është të zhvillojnë aftësitë e leximit, shkrimit dhe mësimin të termave teknik të studentëve të cilët ndjekin nivelin B1/B2/C1 të gjuhës angleze në fakultetet e inxhinierisë në UPT.

2.2.Instrumentet në ndihmë të reformimit të kurrikulave të gjuhës së huaj

Procesi i integritimit Evropian është kthyer në një realitet. Perspektiva e zgjerimit së bashku me thellimin e marrëdhënieve mes vendeve jo anëtarë, nuk është më një ëndërr, por sfidë. Ndërgjegjësimi në rritje i shumicës politike, i botës akademike dhe opinionit publik për t'u përfshirë në proceset e ngritjes së një Evrope më të plotë institucionale, mbështetur në dimensionet e saj intelektuale, kulturore, sociale, shkencore dhe teknologjike shtron para arsimin detyra madhore. Evropa e dijes⁶⁷ është tashmë e pranuar gjerësisht si objektiv pan

⁶⁶A new framework strategy for multilingualism European Commission, 2005

⁶⁷Commission of the European Communities; Brussels 2003, COM (2003)58 final; The role of the universities in the europe of knowledge; Krijimi i një Evropë së dijes ka qenë një objektiv kryesor për Bashkimin

evropian, si faktor i pazëvendësueshëm për rritjen e kapaciteteve humane, për pasurimin dhe konsolidimin e qytetarisë evropiane. Rëndësia e arsimit dhe bashkëpunimit arsimor në zhvillimin dhe forcimin e shoqërive të qëndrueshme, paqësore dhe demokratike është pranuar universalisht si thelbësore. Në vijim janë shënuar nisma si Deklarata e Bolonjës, Kuadri Evropian i Kualifikimit i cili sillet në dy funksione: e para për të bërë të unifikueshme të tëra programet dhe e dyta si një instrument që duhet vënë në funksion.

2.2.1. Kuadri Evropian i Kualifikimit (K.E.K.)

Nisur nga këndvështrimi teorik i mësipërm, për realizimin praktik të këtij kurrikuli, duhet të përdoren instrumente të unifikuar. I tillë vjen Kuadri Evropian i Kualifikimit (KEK), i cili rekomandon parimet dhe procedurat e përbashkëta të hartimit të kurikulave për shumë fusha. Dhe jo vetëm kaq: rëndësi të veçantë ai u jep sigurimit të cilësisë, vlerësimit të të nxënies jozyrtar, drejtimit dhe këshillimit të studentit, si dhe provimit të kompetencave bazë. Konkretisht, ai mund të përdoret si instrument përcaktues për⁶⁸:

2.2.1.1.Kompetencat bazë

Përcaktimi i kompetencave bazë realizohet me ndihmën e strukturës orientuese të Kuadrit Evropian të Kualifikimeve. Ai identifikon 8 kompetenca bazë:

- a) Komunikimi në gjuhën amtare;
- b) Komunikimi në gjuhë të huaja;
- c) Kompetencat bazë në matematikë, shkencë dhe teknologji;
- d) Kompetencat numerike;
- e) Të mësuarit për të nxënë;
- f) Kompetenca ndër-personale, ndërkulturore dhe sociale;
- g) Shprehjet kulturore;
- h) Sipërmarrja.

Këto kompetenca arrihen në fund të arsimit dhe përmes trajnimit mbahen efektive gjatë gjithë jetës. Këto kompetenca bazë janë integruar pjesërisht në “të mësuarit se si të nxësh”, “kompetencës ndër-personale dhe qytetare”, “sipërmarrjes dhe shprehjes kulturore”, si dhe “kompetencat profesionale dhe personale”⁶⁹. Hartimi i KEK dhe në veçanti i niveleve të referencës së përbashkët dhe të tregueseve të suksesit në nivel evropian, orientojnë të gjitha programet mësimore në fushën e kompetencave bazë.

Evropian që nga Këshilli Evropian i Lisbonës së marsit 2000. Këshillat Evropian pasues, veçanërisht ai i Stokholmit në Mars 2001 dhe Barcelonës në mars 2002, i kanë çuar përpara objektivat Lisbonës.

⁶⁸Referenca Europena Commission The European Qualification s Framework for Life Long Learning (KEK); Luxembourg:Office for Official Publications of the European Communities 2008

⁶⁹(Po aty)

2.2.1.2. Angazhimet dhe sfidat në nivel kombëtar dhe sektorial

Zhvillimi dhe zbatimi i KEK kërkon një rishikim të sistemeve të gjera të të mësuarit në universitet dhe të institucioneve të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe duhet të rezultojnë me lidhje të ngushta dhe bashkëpunim midis tyre. KEK-u dhe në veçanti përshkruesit e niveleve të reja të referencës, imponojnë ndryshime të rëndësishme. Paragrafët e mëposhtëm u drejtohen marrëdhënieve midis KEK dhe Kuadrit të Kualifikimeve respektivisht në nivel kombëtar dhe sektorial. Proceset kryesore të mëposhtme janë propozuar për bashkëveprim midis sistemeve kombëtare dhe sektoriale dhe kuadrit të KEK-ut:

“Është përgjegjësi kombëtare përcaktimi si i strukturave të kualifikimit kombëtar, që duhet të lidhen me nivelet e KEK-ut ashtu edhe i udhëzuesit që duhet të lehtësojnë këtë proces”⁷⁰ theksojnë autoritetet evropiane.

Një KEK i universiteteve shqiptare mund të shërbejë si një pikë e përbashkët reference që mund të drejtojë, informojë dhe frymëzojë zhvillimet e edukimit, trajnimit, dhe të nxënit në nivel sektorial.

2.2.1.3. Synimet dhe funksionet e një K.E.K-u

KEK-u është një meta-kuadër që mundëson sistemet dhe kuadrot sektoriale, kombëtare dhe ndërkombëtare të lidhen dhe komunikojnë me njëri-tjetrin, për të lehtësuar transferimin, transparencën dhe njohjen e kualifikimeve të nënkuptuara si rezultate të të nxënit, të vlerësuara dhe certifikuara nga një organ kompetent kombëtar ose sektorial. Një funksion bazë i këtij kuadri duhet të jetë forcimi i besimit reciprok midis mbështetësve të reformës. Ky konsiderohet si parakushti i domosdoshëm për të nxënit dhe për përdorimin më të mirë të njohurive, aftësive dhe kompetencave më të gjera ekzistuese. Funksionet e mëposhtme specifike do të plotësohen nga instrumenti KEK në reformimin e kurikulave universitare⁷¹:

- KEK vendos një pikë të përbashkët referimi për rezultatet e të nxënit dhe të niveleve të kompetencave, duke thjeshtëzuar komunikimin midis pedagogëve dhe studentëve në edukim. Kjo kërkon përshkrues dhe nivele reference të cilët janë *mjaftueshëm të përgjithshëm* për të përfshirë shumëllojshmërinë e kualifikimeve ekzistuese në nivel kombëtar dhe sektorial. Në të njëjtën kohë ato duhet të kenë mundësi të *bëjnë dallimin* ndërmjet niveleve të ndryshme të shprehura në terma të kompetencës në rritje dhe të ekspertizës.
- KEK funksionon si një *mjet përkthimi* – një konvertues ose tabelë duke bërë të mundur për të pozicionuar dhe krahasuar rezultatet e të nxënit. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për nivelin evropian, por gjithnjë e më shumë edhe në nivelet sektoriale, rajonale dhe kombëtare.

⁷⁰ (Po aty)

⁷¹ (Po aty)

- KEK funksionon si *një referencë e përbashkët për sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e edukimit dhe të trajnimit.*
- KEK siguron një referencë për zhvillimet e kualifikimet sektoriale.

Prezantimi i niveleve të referencës së përbashkët dhe përshkruesve do t'u mundësojë mbështetësve të identifikojnë ndërlidhjen e sinergjive dhe mbivendosjen e mundshme.

- KEK është një shtysë për ndryshime në nivel evropian, kombëtar dhe sektorial.

Brenda perspektivës të të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke mbështetur vazhdimësinë dhe zbatimin e objektivave të përbashkëta për sistemet evropiane të edukimit dhe trajnimit, siç është rënë dakord në 2002.

- KEK lidhet drejtpërdrejtë në nivel kombëtar dhe sektorial me politikë-bërësit dhe organet eksperte që janë përgjegjës për arsimimin e trajnimit dhe me sistemet e politikave të mësuarit.

Lidhja e KEK-ut me qytetarët do të sigurohet nga zhvillimi dhe implementimi i mjeteve dhe instrumenteve të përbashkëta si, transferim kredish dhe sisteme mbledhës, instrumentit EUROPASS dhe të dhënat PLOTEUS bazuar në mundësitë për të mësuar. Duke ndjekur miratimin e KEK-ut, kualifikimet personale, të dhënat në nivel kombëtar ose sektorial, duhet të kenë një referencë të qartë të KEK-ut.

2.2.1.4.Nivelet e referencës së përbashkët të rezultateve të të nxënit

Vlera e përdorimit të KEK-ut ndikon në krijimin e një sistemi reference të rezultate të të nxënit. Këto pika reference vendosen në një nivel shkallëzimi që përfshin një sasi të plotë kualifikimesh nga shkollat e arsimit të detyrueshëm drejt kualifikimeve më të përparuara për profesionistët me përvojë duke përfshirë kualifikimet e arritura përmes të nxënit jo formale dhe mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Kjo merr formën e një kuadri kualifikimi kombëtar me një numër nivelesh. Studimet e bëra për të mbështetur hartimin e sistemit të transferimit të krediteve për arsimin profesional dhe trajnimit arritën në përfundimin se 8 nivelet do të jenë numri i duhur për një kuadër evropian që mbulon arsimin e lartë dhe Arsimin Profesional dhe Trajnimit.⁷² Struktura prej 8 nivelesh siguron përputhjen optimale me strukturat e kualifikimit kombëtar në shumë vende. Secili prej niveleve të referencës në një KEK kërkon një përshkrues arritjesh. Shkrimi i përshkruesve të niveleve është një proces kompleks. Përdorimi i konceptit të kompetencës si gur themeli për përshkruesit e niveleve u ka ofruar qetësi përdoruesve të shumtë të kuadrit të kualifikimeve. Ato sigurojnë korrespondimin me instrumente të arsimit të lartë, siç janë transferimi i krediteve evropiane dhe sistemi i akumulimit.

⁷² Ky kërkim i bërë nga CEDEFOP me kërkesë të Komisionit (Coles dhe Qates2 005) I referohet përvojave të shteteve që janë duke hartuar kuadrin e kualifikimeve për të mësuarin gjatë gjithë jetës si dhe kërkimeve akademike që studiojnë nivele të ndryshme të zhvillimit të kompetencës(për shembull, punimet e kryera nga Dreyfus, Jacques, etj.)

Kualifikimet e arsimit të lartë në këtë nivel shoqërohen me një “cikël të shkurtër” (brenda ciklit të parë) kualifikimesh në kuadrin e hapur brenda procesit të Bolonjës dhe shpesh mbështeten nga tekste të avancuara duke përfshirë në mënyre tipike aspekte që janë në ballë të studimeve në këtë fushë. Kualifikimet e nivelit të gjashtë, shoqërohen me kualifikimet e ciklit të parë në arsimin e lartë, zhvilluar sipas kuadrit të procesit të Bolonjës⁷³.

2.2.1.5.Rezultatet e të nxënit

Në secilin nivel në KEK përshkruhen arritjet në termat e tri tipave:

- njohuritë
- aftësitë
- kompetenca më të gjera, të dhëna si rezultate personale dhe profesionale

Çdo nivel i një KEK-u mund të përshkruhet me terma tipike për rezultatet e të nxënit, të cilat mund të priten dhe nuk duhet të përfshijë detaje të kualifikimeve specifike ose sistemeve që operojnë në shtete dhe sektorë. Duke iu afruar në këtë mënyrë hartimit të një KEK-u, çdo nivel ose kualifikim kombëtar ose sektorial mund të lidhet nga ekspertët kombëtarë dhe sektorialë dhe organet kompetente të një niveli të veçantë në një KEK.

2.3.Kuadri i kualifikimit: mjet për mbështetjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës

Kuadri i kualifikimit është vendosur në shumë vende në sektorë në Evropë dhe më gjerë (OECD 2003-2004). Parimi i tij kryesor është të qartësojë (për studentët, prindërit, siguresit e të nxënit), si mund të sigurohet progresi, deri në cilën masë lejohet transferimi dhe mbi cilat baza merren vendimet për njohjen. Kuadri i kualifikimit përdoret gjithashtu për sigurimin e cilësisë dhe qëllimet e zhvillimit, si dhe për sigurimin e referencave për zhvillimet në nivel lokal, rajonal, sektorial dhe kombëtar. Kështu gjuha angleze në universitet duhet të zhvillohet për të përmbushur njëkohësisht qëllimet profesionale të studentëve si dhe nevojat e tyre për komunikim në rajon.

Qëllimi kryesor i KEK-ut është të mbështesë të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të sigurojë rezultatet e të nxënit të vlerësohen dhe të përdoren ashtu siç duhet. Cedepof jep këtë përkufizim të të nxënit⁷⁴:

Të nxënit është një proces grumbullues ku individët gradualisht asimilojnë gjithnjë e më shumë entitete komplekse dhe abstrakte (koncepte, kategori, mënyra të të sjellurit) dhe/ose përvetësojnë aftësi dhe kompetenca më të gjera. Një tërësi njohurish, aftësish dhe/ose kompetencash që një individ i ka fituar dhe/ose është i aftë t'i demonstrojë pasi ka përmbushur procesin e të nxënit. Rezultatet e të nxënit janë provat se çfarë një nxënës

⁷³ (Po aty)

⁷⁴ (Po aty)

pritet të dijë dhe të kuptojë dhe/ose të jetë i aftë të bëjë pas mbarimit të një periudhe mësimi.

Termi “*rezultat i të nxënit*” është një pjesë thelbësore e përpjekjeve të vazhdueshme në nivel kombëtar, rajonal dhe sektorial për të reformuar mësimin e gjuhës së huaj.

Me hapjen drejt botës dhe me aspiratën për t’u integruar në Bashkimin Evropian, edhe në Shqipëri duhet të synohet për krijimin e një *“hapësirë shqiptare të të nxënit gjatë gjithë jetës”*, A. Haloçi,⁷⁵ si pjesë e hapësirës evropiane të të nxënit gjatë gjithë jetës. Shkujdesjet, hezitimet apo indiferentizmi në këtë drejtim do të ndikonin negativisht në zhvillimin ekonomik, shoqëror, kulturor e teknologjik të vendit dhe të aftësive të tij konkurruese.

Aktualisht në Shqipëri, në kuadrin e reformimit të sistemit arsimor dhe të ngritjes e zhvillimit të sistemit të formimit, si dhe të veprimtarisë së aktorëve të ndryshëm në fushën e të nxënit, përgjithësisht janë rritur mundësitë dhe në mjaft raste janë përmirësuar edhe kushtet për zhvillimin e të nxënit në mënyrë formale, dhe jo formale.

Mënyra me të cilën ne marrim informacion dhe shërbime vazhdon të ndryshojë. Ne na nevojiten kompetenca të reja në mënyrë që të përballojmë një botë të re të dixhitalizuar, jo vetëm duke kërkuar teknika të reja aftësimi, por gjithashtu duke kuptuar më gjerë mundësitë, sfidat dhe madje pyetjet të cilat ngrihen nga teknologjitë e reja.

Në këto kushte ndryshimesh, ka dhe një ndërgjegjësim dhe shqetësim në rritje rreth kohezionit social. Një pjesë e madhe e evropianëve ndihen si të lënë mënjanë nga globalizimi dhe revolucioni dixhital. Kjo kërkon që njerëzit të informohen dhe shqetësohen rreth shoqërisë së tyre si dhe të jenë më aktivë me ndryshimet që ndodhin. Kështu që si rezultat, edhe aftësitë që çdokush i ka të nevojshme duhet të ndryshojnë që ti përshtaten ndryshimeve dhe zhvillimeve të kohës⁷⁶.

2.4. Nevoja për reformë kurrikulare në Arsimin e Lartë

Ndryshimet që kanë ndodhur në vendin tonë, të para dhe në kontekstin shkollor, kushtëzojnë dhe drejtimet kryesore të zhvillimeve arsimore, në përgjithësi dhe të ndryshimeve kurrikulare, në mënyrë të veçantë. Në njëzet vitet e fundit Shqipëria ka njohur ndryshime të mëdha në fushën ekonomike, politike, shoqërore dhe kulturore. Sot po bëhet gjithnjë e më e vështirë të vlerësosh prirjet e zhvillimeve në kërkesat dhe perspektivat e tregut të punës.

Dukuria e pakësimit të burimeve ekonomike dhe njerëzore është bërë tipar dallues edhe i arsimit, gjë që shtrton detyrën e rritjes në shkallë më të lartë të frytshmërisë së përdorimit të burimeve ekzistuese. Arsimin në vendin tonë i duhet të zhvillojë aftësitë e domosdoshme për të ndihmuar përballjen me sfidat e ndryshimeve dhe zgjidhjen e problemeve.

Ndryshimet në fushën ekonomike dhe dukuria gjithnjë e më e shpeshtë e ndryshimit të vendeve të punës dhe të profesioneve, shtrton sidomos përpara shkollave të formimit profesional detyrën e zhvillimit të

⁷⁵Haloçi, A. (2005) Vlerësimi i aftësisë së komunikimit në mjedisin shkollor, Buletini Kurrikula dhe Shkolla nr.7, botim i ISP

⁷⁶(Recommendation of the European Parliament and of the Council of 18 December 2006 on key competences for lifelong learning. Official journal of the European Union L 394).

aftësive dhe të shprehive të shumanshme praktike si dhe të qëndrimeve pozitive për të nxënëit gjatë gjithë jetës. Parashikimet për të ardhmen kërkojnë që politikat arsimore të vënë theksin dhe rëndësinë që ka rritja e cilësisë në fushën e arsimit dhe cilësia e hulumtimeve shkencorë që lidhen me të. Njohuritë, shprehitë dhe aftësitë për t'i përdorur dhe menaxhuar përfundimet e hulumtimeve në një mënyrë krijuese, vlerësohen si pasuritë më të mëdha në këtë fushë. Prandaj kërkohet që arsimi të marrë përsipër përgjegjësi të mëdha për krijimin e një të ardhmeje më pozitive për të gjithë.

Prirje themelore e zhvillimeve të kohëve të fundit janë proceset e decentralizimit dhe autonomisë së shkollës, gjë që shoqërohet me rritjen gjithnjë e më të madhe të besimit që po i jepet shkollës për zgjidhjen e problemeve që lidhen me të. Vetë sistemi shkollor po bëhet më i përgjegjshëm, por edhe më fleksibël. Rritja e pushtetit të shkollës për të siguruar vetë burime materiale dhe financiare, për të rritur cilësinë e shërbimit të saj në shoqëri, lëndët e mundshme me zgjedhje etj., do të rritin mundësitë për të zhvilluar aftësi dhe shprehi në fusha të ndryshme të jetës dhe për t'u dhënë studentëve mundësi më të mira studimi, duke i aftësuar ata se si të nxënë gjatë gjithë jetës.

Vendet e punës në të ardhmen shihen më shumë pranë biznesit të vogël se në firmat e mëdha prodhuese të cilat gjithnjë e më shumë investojnë në pajisje e mjete moderne prodhimi. Kjo kërkon nga shkollat profesionale krijimin e qëndrimeve pozitive ndaj mundësisë së vetëpunësimit dhe të ndërmarrjeve private edhe gjatë procesit të shkollimit, që do të thotë se shkolla jonë duhet të punojë shumë për të edukuar shpirtin e iniciativës, të punës së pavarur dhe të përgjegjësisë për të gjithë individët që hyjnë në radhët e saj.

Globalizmit gjithnjë e më rritje është prirje e zhvillimit të sotëm. Ndërveprimi ekonomik dhe kulturor po përfshin një numër gjithnjë e më të madh vendesh. Sukseset në tregun botëror kërkojnë zgjedhje ekonomike dhe përdorim të teknologjive gjithnjë e më të përparuara. Shqiptarët gjithnjë e më shumë po i drejtohen shoqërive të zhvilluara, duke studiuar dhe punuar jashtë vendit, ndërkohë që në Shqipëri nuk mungojnë shoqëri dhe organizma të huaja që për arsye të ndryshme, ekonomike, turistike dhe fushat të tjera shoqërore dhe më gjerë, sjellin zhvillime të reja të qytetërimit botëror. Sistemi ynë arsimor i Aftësimit dhe Formimit Profesional duhet më shpejtësi ti përgjigjet këtyre ndryshimeve. Ai duhet të jetë sa më i përshtatshëm dhe i ndjeshëm ndaj shoqërisë globale, që kërkon njerëz që të nxënë gjatë gjithë jetës.

Rritja me hapa të mëdha e informacionit dhe e shpërndarjes së tij dhe lehtësitë në rritje për të udhëtuar në vende të ndryshme të botës, i kanë rritur dhe po i rritin njohuritë për vende dhe kultura të ndryshme, duke i bërë kulturat dhe vlerat që qarkullojnë në vendin tonë dhe në vendet e tjera, më të ndryshme.

Strukturat ekonomike, politike dhe shoqërore kanë pësuar ndryshime të rëndësishme sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit. Këto ndryshime kanë kushtëzuar edhe arsimin dhe janë pasqyruar edhe në fushën e tij. Globalizmi duke qenë një sfidë pothuajse për të gjitha vendet e botës, qëndron si i tillë edhe përballë shoqërisë shqiptare. Në këtë kuadër arsimi ndodhet përballë kërkesave të zhvillimeve cilësore dhe të ngritjes në nivele më të larta.

Për këtë arsye edhe në fushën e kurrikulit duhet të ndërmerren ndërhyrje të shpejta, të sakta dhe që t'u përgjigjen zhvillimeve të sotme të shoqërisë botërore. Këmbimet e shumëllojta, të njohura dhe të miratuara në nivel ndërkombëtar, merren parasysh edhe në fushën e arsimit. Sot më tepër se kurrë arsimi shqiptar kërkon dhe gjen fusha të reja veprimi.

Kurrikula, si fusha bazë e arsimit, kërkohet të jetë e hapur dhe të pasqyrojë në përmbajtjen e vet zhvillimet e reja në të gjitha fushat dhe veprimtaritë bazë të shoqërisë njerëzore të gjitha vendimet që merren në shoqëri, në një mënyrë ose në një tjetër, lidhen me vlerat. Problemet bëhen më të vështira, veçanërisht në periudha ndryshimesh rrënjësore, të cilat, përveç të tjerave, kërkojnë dhe rishikimin dhe vlerësimin e problemeve nga këndvështrime të ndryshme.

Në këtë drejtim, shkolla duhet të transmetojë dhe të mbështesë ato vlera që ndihmojnë në mbijetesën dhe zhvillimin e shoqërisë, në zhvillimin e plotë të personalitetit të individit dhe të ideve të tij për të ardhmen. Zhvillimet dhe ndryshimet shumëplanëshe të dhjetëvjeçarit të fundit kanë rritur heterogjencën në radhët e të rinjve lidhur me çështje të ndryshme. Këndvështrimet e tyre për shkollën, studimet, jetën, veprimtaritë e kohën e lirë etj. kanë ndryshuar ndjeshëm. Dëshira nga më të larmishmet po zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në jetën e të rinjve përkrah interesit për shkollim, madje në shumë raste ato arrijnë ta shmangin atë. Përveç shkollës, të rinjtë përdorin burime të tjera gjithnjë e më të shumta për marrjen e informacionit dhe fitimin e njohurive.

Mënyrat si të rinjtë veprojnë, vëzhgojnë dhe analizojnë botën përreth tyre kanë ndryshuar dhe po pasurohen vazhdimisht. Papunësia hedh një hije të errët në përfytyrimet e të rinjve për një të ardhme të sigurt dhe të pavarur.

Nga ana tjetër, prirja e të rinjve për t'u larguar nga Shqipëria do të rrisë raportin e popullsisë së plakur ndaj asaj të re, veçanërisht në zonat rurale, ku barra e punëve të bujqësisë ka rënë në kurriz të të miturve e sidomos të grave. Mënjanimi i një dukurie të tillë kërkon nga sistemi ynë arsimor aftësinë për të bërë një rishikim tërësor, të mbështetur në njohjen e thellë të realitetit dhe të orientuar nga e ardhmja e mundshme, madje edhe e dëshiruar nga shumica e shqiptarëve.

Kurrikula bashkëkohore në fushën e të nxënësve theksojnë rolin aktiv të nxënësve në ndërtimin e strukturës së njohurive të tyre. Qëndrimet e nxënësve dhe perceptimet e tyre shkojnë drejt pikave ku përqendrohet vëmendja e tyre. Në një farë mase, kjo varet nga informacioni që ata marrin dhe nga interpretimi që i bëjnë atij. Drejtimi i procesit të të nxënësve varet shumë edhe nga përvojat e tyre vetjake.

Që procesi i të nxënësve të shërbejë strukturimit dhe plotësimin të njohurive paraprake të studentëve dhe të modeleve të tyre të veprimit të sjelljes, vetë ata duhet të vlerësohen si pjesëmarrës aktivë në procesin e fitimit, të përpunimit dhe të vlerësimit të njohurive. Vetëm kështu dhe nëpërmjet punës së mëtejshme njohurisë dhe aftësitë e tyre do të organizohen dhe do të përqendrohen në struktura që mundësojnë përdorimin e tyre. Kjo kërkon edhe ndryshimin e rolit të pedagogëve që shfaqen gjithnjë e më shumë si drejtues dhe hartues të situatave mësimore.

Shkolla është e prirur të transmetojë vetëm një pjesë shumë të vogël nga sasia e informacionit që rritet me shpejtësi marramendëse. Për këtë arsye shkolla dhe arsimi, në përgjithësi, duhet të bëjnë zgjedhje tepër të kujdesshme për të siguruar frytshmërinë e kërkuar në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Për shkollën ka shumë rëndësi të përcaktojë se:

- mbi çfarë bazë do të zgjidhet përmbajtja e asaj që duhet të mësohet,

-
- si do të përzgjidhet ajo që është e rëndësishme nga sasia e madhe e informacionit, por dhe
 - si do të realizohet strukturimi i njohurive, shprehive dhe vlerave për një qëllim të vetëm.

Informacionet e vjetruara dhe të parëndësishme të përfshira në përmbajtjet e disiplinave të ndryshme shkollore, duhet të mënjanohen duke u zëvendësuar shkallë - shkallë dhe në mënyrë tepër të kujdesshme nga informacionet e reja.

Shkolla duhet t'i drejtojë studentët drejt qëndrimeve gjithnjë e më kritike ndaj njohurive të fituara dhe fitimit të aftësive për të zgjidhur problemet dhe situatat praktike. Rritja e frytshmërisë së të nxëniet kërkon lidhjen ndërmjet lëndëve të ndryshme.

2.5.Parime të përgjithshme të kornizës kurrikulare

Vijimësia në kurrikul lidhet me strukturën e paraqitjes së programeve e të lëndëve dhe me përmbajtjet e tyre. Ajo respekton kriteret e *linearitetit, të koncentrizmit dhe të integritetit* si parime bazë të paraqitjes së dijeve në një kurrikul dhe mënyrën e organizimit të tyre që krijojnë baraspeshë dhe koherence të përshtatshme brenda një kurrikule dhe ndërmjet fushave kurrikulare. Përmes vijimësisë i jepet kurrikulës lëndore pamja e vet sipas zgjedhjes që është bërë, e organizuar përmes fushave të studimit, linjave dhe nën-linjave.

Vijimësia si parim kurrikular ndihmon në respektimin e parimit të decentralizimit dhe fleksibilitetit. Në këtë vështrim, ajo është e pranishme në çdo nivel shkollimi.

Zbatimi i vijimësisë së kurrikulit varet nga burimet materiale dhe njerëzore, nga interesat dhe motivimi i studentëve dhe nga hallkat e veçanta që lidhin shkollën me komunitetin lokal. Kjo kërkon dhe krijon mundësi për të dalluar aspektin individual të arsimimit, në përputhje me interesat dhe motivimet e studentëve, që të orientohen më mirë në vitet e shkollimit dhe për të ndërtuar profesionin e tyre të ardhshëm.

Pra e njëjta gjë duhet zbatuar edhe për gjuhën e huaj. Sugjeroj që duke parë interesat e studentëve dhe prirjet që ata kanë për gjuhën e huaj, do të jetë në të mirë të tyre që lënda e specialitetit të ketë një shtrije më të gjerë në kohë, përkatësisht në çdo fakultet, duke i dhënë asaj hapësirën e duhur për t'u përvetësuar nga studentët.

Parimet e mësipërme janë përfshirë përmes paketave opsionale në çdo fushë kurrikulare edhe për çdo grup studentësh.

Plani javor i zberthyer në orë javore, është një veprimtari konkrete e shkollës, që përmban me hollësi veprimtaritë e javës, të mbështetura në kurrikulin bazë. Plani javor në përgjithësi ruan vijimësinë e zbatimit të kurrikulit.

Por në fakultetet e UPT-ës, shtrirjes së gjuhës nuk i jepet shumë prioritet. Nuk ka ndarje të njëtrajtshme të krediteve, çfarë do të thotë që megjithëse nën një “çati”, atë të UPT-së, fakultete të ndryshme, zbatojnë numër të ndryshëm kreditesh.

Në shkollë ka rregulla të përcaktuara për fillimin e punës dhe vazhdimësinë e saj, të tilla si sasia e orëve për lëndë të ndryshme të kurrikulit bazë. Kurrikuli bërthamë përfshin lëndët e detyruara, të cilat e kanë të përcaktuar në planin mësimor numrin e përgjithshëm të orëve që do të zhvillohen. Shkolla bën shpërndarjen e tyre në tërë ngarkesën javore për çdo klasë dhe lëndë. Përveç kësaj, në shkollë duhet të gjendet hapësira e mundshme që t'u japë kohë studentëve për të ndjekur dhe zgjedhur alternativa të tjera për studimvetjak ose për ndjekjen e lëndëve me zgjedhje. Në këtë kuptim, plani i shkollës duhet të përmbledhë orët dhe shtrirjen e tyre sipas lëndëve dhe viteve të shkollimit, si dhe planifikimin e plotë për veprimtaritë kros dhe ekstra-kurrikulare.

Korniza kurrikulare siguron *përdorim të plotë të burimeve njerëzore dhe materiale*, që pedagogët dhe aktorët e tjerë në shkollë të japin ndihmesë të rëndësishme në procesin e të nxënimit⁷⁷.

Për këtë qëllim dhe në përputhje me zhvillimet më të fundit në nivel kombëtar dhe botëror, korniza kurrikulare:

- Krijon mundësinë dhe lejon që në planin mësimor të ketë lëndë me zgjedhje.
- Mundëson vëzhgimin e mësimdhënies prej grupeve të mësuesve dhe të punës së tyre në bazë të grup-lëndëve për probleme që lidhen me mësimdhënien dhe kurrikulat e veçanta e ndryshimet e mundshme në to.
- Lejon dhe mbështet orientimin e studentëve në shkollë për të ndjekur vitet pasardhëse të shkollimit të tyre.

Hierarkia dhe zgjedhja kulturore duhen parë dhe vlerësuar si parime që lidhen me zgjedhjen, ndarjen dhe përzgjedhjen e njohurive që lidhen me kulturën njerëzore dhe veprimin e shoqërisë në një kuptim të gjerë në përmbajtjen e fushave kurrikulare. Thelbësore në këtë kuptim është vendosja në lëndë dhe grupimi i njohurive në fusha të përshtatshme kurrikulare. Ky lloj organizimi ka një numër të gjerë përparësish:

- Mundësi për lidhje dhe ndërthurje ndër-lëndore;
- Raport më të drejtë të fushave dhe lëndëve shkollore;
- Lidhje me teorinë bashkëkohore;
- Njohje të stileve dhe rrymave të ndryshme të të nxënimit etj.

Parimi i përzgjedhjes kulturore synon:

- Zhvillimin e shumanshëm të personalitetit të çdo studenti;
- Shpërndarjen më të gjerë dhe të larmishme në fushat e njohjes;

⁷⁷Drafti i kornizës së re Kurrikulare të arsimit parauniversitar, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Departamenti i Kurrikulave, Tiranë 2004.

-
- Vendosi e shprehive bazë dhe përfaqësimin e vlerave që kanë të bëjnë me formimin e pamjes së shoqërisë demokratike.

Hierarkia dhe zgjedhja kulturore kërkon grupimin e lëndëve shkollore brenda fushave kurrikulare (të cilat mund të jenë 6,7 etj.) gjë që varet nga zgjedhjet dhe grupimet që bëjnë specialistët në hartimin e planit mësimor.

Zbatueshmëria synon të përshtatë përmbajtjen e lëndëve të ndryshme brenda fushës kurrikulare me nivelet e zhvillimit psikologjik të individit kjo përshtatje synon :

- Njohjen e zhvillimit psikologjik të moshave të ndryshme shkollore ;
- Vendosi e objektivitetit, të gjerësisë dhe të ndryshueshmërisë të fushave të njohjes dhe të veprimit njerëzor.

Parimi i koherencës lidhet me baraspeshën, karakterin homogjen të edukimit, qëllimet vertikale dhe horizontale të tij, të cilat ndryshe interpretohen si ndërveprim i fushave kurrikulare të shprehura përmes raporteve ndërmjet tyre dhe lëndëve që studiohen në shkollë. Në përshtatje me këtë parim, kurrikula bërthamë pasqyron në përmbajtjen e vet zhvillimet më të reja të fushave që e përbëjnë atë, lidhjet ndërmjet tyre, respektimin e objektivitetit të çdo njërës fushë si dhe bashkëveprimin dhe rimarrjen ndërmjet tyre. Zbatimi i këtij parimi lehtëson mbingarkesën shkollore dhe i jep kurrikulit të çdo fushe apo lënde frymëmarrje dhe bashkëveprim.

Mbështetur në konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, çdo student ka të drejtë të shkollohet në një sistem të caktuar arsimor. Në zbatim të këtij parimi çdo sistem arsimor është i detyruar të krijojë mundësi për përzgjedhje brenda lëndëve që e përbëjnë këtë nivel shkollimi. Ky parim synon t'u krijojë studentëve mundësi nga pikëpamja e shfrytëzimit të rrugëve dhe hapësirave të reja për të mësuarin e diferencuar.

I shoqëruar me kritere dhe akte ligjore, ky parim përqendrohet në temat më të përgjithshme bazë. Në këtë mënyrë, korniza kurrikulare krijon mundësi për një lidhje logjike ndërmjet bërthamës së kurrikulës dhe kurrikulës në bazë shkolle, duke lejuar mbështetje të specializuar për çdo hapësirë të nxëni dhe lirie profesionale të mësuesve, që u përgjigjet të gjitha shtresave të komunitetit, pa përjashtuar ndonjë individ.

Kurrikuli duhet të sigurojë një lidhje të ngushtë *ndërmjet shkollës dhe komunitetit*, ndërmjet shkollës dhe nevojave të saj shoqërore. Kështu, roli i fushave të këshillimit dhe i udhëzimeve duhet të jetë i një niveli të lartë. Me ndihmën e tyre studentët do të jenë të informuar rregullisht për gjetjen dhe rrugët e larmishme për të përdorur sistemin teorik të orientimit të tyre profesional.

Përfshirja e familjes në jetën e shkollës, rrit në mënyrë të ndjeshme rolin e familjes në marrjen e vendimeve dhe në monitorimin e tyre dhe të të dyjave së bashku, në vijueshmërinë e studentëve në shkollë dhe në cilësinë e shkollimit të tyre. Ky parim luan rol me rëndësi për të përcaktuar aftësitë kryesore specifike, për të siguruar njëherësh nevojat e domosdoshme për trajnim, për pjesëmarrje në arsimin e lartë dhe kërkesat për specializim të mëtejshëm, për t'iu përgjigjur tregut të punës.

Parimi i lidhjes së kurrikulit me jetën shoqërore synon të sigurojë kërkesat e domosdoshme për certifikim dhe gjetje për :

- Vazhdimin e shkollimit pas arsimit të mesëm ;
- Ndjekja e arsimit të lartë;
- Gjetjen e tregut të punës.

Korniza kurrikulare duhet të mbështetet në bashkëveprimin e katër karakteristikave: përsosmëria, drejtësia, partneriteti dhe përgjegjësia

Në çdo ndryshim kurrikular, parësore është përmirësimi dhe përsosja e përmbajtjes shkollore. Synimi drejt përsosmërisë bën të kërkohet dhe të gjendet më e mira, gjë që nuk mund të arrihet jashtë përgjegjësive, bashkëveprimit e punës në grup dhe mbështetjes ligjore.

Parimet e mësipërme mund të kuptohen në një kontekst bashkëveprimi me njëri-tjetrin dhe hapin hapësira për një kurrikul gjithnjë e më cilësor. Këtu domosdoshmërisht na lind nevoja për një ndryshim rrënjësor dhe sigurisht cilësor të kurrikulave të *gjuhës së huaj* duke i përshtatur ato me kërkesat bazë të procesit të Bolonjës dhe të një ndryshimi të ri në arsim.

Kurrikuli kombëtar, si një dokument i rëndësishëm i sistemit arsimor të një vendi, synon të përcaktojë njërën prej çështjeve më kryesore të arsimit, atë të metodave më frytdhënëse për rregullimin dhe drejtimin e të gjitha veprimtarive shkollore në nivel kombëtar e deri në nivel klase.

2.6. Teknologjia sipas draftit të kornizës së re kurrikulare të arsimit parauniversitar

Teknologjia është përdorimi krijues dhe i qëllimtë i njohurive njerëzore, aftësive dhe burimeve fizike për zgjidhjen e problemeve praktike. Teknologjia përshkon jetën tonë të përditshme në familje, punë e kudo gjetkë. Ajo përfshin zhvillimin e objekteve, të sistemeve ose mjediseve.

Të gjithë nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë aftësitë teknologjike dhe kuptimet që i përkasin botës në të cilën ata jetojnë. Edukimi teknologjik ndihmon të zhvillohen tek ata kërkesa për t'u përshtatur në një botë të ndryshimeve të shpejta.

Nxënësit do të zhvillojnë një kuptim të rrugëve në të cilat teknologjia është formuar dhe vazhdon të formohet nga shoqëria. Ata do të mësojnë se teknologjia ka ndikuar në mënyrën e jetesës së njerëzve dhe se njerëzit kanë zhvilluar dhe përdorur teknologjitë për të plotësuar nevojat e tyre. Ata do të zhvillojnë njohuri për ndikimet e teknologjisë në mjedis.

Nxënësit do të ndihmohen të marrin vendime të menduara rreth përdorimit të teknologjisë në lidhje me shoqërinë, mjedisin dhe ekonominë. Ata do të mësojnë të vlerësojnë kostot potenciale dhe përfitimet prej llojeve të teknologjive të përdorura. Nxënësit, gjithashtu, do të zhvillojnë njohuritë rreth llojeve të teknologjive të realizuara, rrugët në të cilat ato

operojnë dhe përdorimet që gjejnë. Ata do të zhvillojnë kompetencën në një radhë teknologjish, si dhe aftësinë e të përshtaturit ndaj përdorimit të teknologjive të reja.

Edukimi teknologjik zhvillon një numër të madh aftësish, duke përfshirë ato të zgjidhjes së problemeve, projektimin, ndërtimin, komunikimin, të menduarit kritik, analizën, sintezën dhe vlerësimin. Kjo fushë e të mësuarit ka lidhje me të gjitha lëndët shkollore, si për shembull, me shkencat e natyrës, matematikën, shkencat shoqërore, vizatimin, artet etj. Brenda kësaj fushe jepen mundësi të shumta për formimin e nxënësve edhe në drejtim të realizimit të edukimit për karrierën.

Zhvillimi i aftësive për punët e dorës është objektiv fillestar i teknologjisë në moshat e vogla. Në varësi të veprimtarive, duhet punuar për të zhvilluar te nxënësit ndjenjën e arritjes së qëllimit, të rritjes së saktësisë, shpejtësisë dhe të integritit në botën e punës në nivel shkollë⁷⁸.

2.7. Vështrim analitik mbi programet ekzistuese

Të studiosh anglisht për qëllime të veçanta (ESP) do të thotë që të përmbushësh nevojat e një pjese të veçantë nxënësish⁷⁹. Por gjithsesi, e parë në një pikëpamje më të gjerë mund të themi se, nëse një student është shumë i mirë në Anglishten e përgjithshme, ai/ajo do të jetë në gjendje të komunikojë në mënyrë perfekte në sferën profesionale të tijin/sajën.

Pasi të jetë analizuar situata ku jemi përqendruar si dhe nevojat e situatave të të nxënësve gjithashtu edhe objektivat e kursit atëherë na mbetet gjëja më e rëndësishme që është hartimi i silabusit. Pas një analize që kam bërë si të nevojave të targetit si dhe të nevojave të situatave të mësimin, çështja e silabusit u vendos si tipari princip organizativ i silabusit të gjuhës angleze për studentët të cilët studiojnë në të gjitha fakultetet e UPT-së. Janë të shumta arsyet që vërtetojnë këtë:

Së pari, për sa i përket terminologjisë, një çështje silabusi i ESP-së është në gjendje të mbulojë të gjitha zonat e rëndësishme ku studiojnë studentët tanë, dhe për rrjedhojë, të gjithë terminologjinë e rëndësishme të shoqëruar me këto fusha temash. Ashtu siç përmenda dhe më lartë, në punën e tyre të ardhshme, studentët tanë do të kenë nevojë për aftësi të shkëlqyera leximi në fushën e tyre. Ata mund (dhe duhet) të dinë të lexojnë dhe përdorin fjalorët; pavarësisht se janë të pakët fjalorët për anglishten elektronike, dhe ato nuk përmbajnë terminologji të mjaftueshme që ti përshtaten nevojave të tyre si dhe nevojës për një praktikë të inxhinierisë elektronike. Për rrjedhojë, kursi i gjuhës angleze për elektronikën duhet të përmbajë sa më shumë terminologji bazë të elektronikës të mundet.

Së dyti, një çështje silabusi sistematike ka një efekt motivimi mbi studentët tanë të cilët janë edhe inxhinierët e ardhshëm. Eksperiencia ime ka provuar se edhe në qoftë se një silabus është sistematik nga ana gjuhësore, por jo nga pikëpamja e çështjeve të temave,

⁷⁸Teknologjia sipas Draftit të kornizës së re Kurrikulare të arsimit parauniversitar, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Departamenti i Kurrikulave, Tiranë 2004, fq 46-47.

⁷⁹ Dudley-Evans and A. M. St. John, 1998, "Developments in English for specific Purposes: A multi-disciplinary approach", Cambridge University Press. Cambridge fq.4-5.

atëherë, studentët tanë tentojnë ta konsiderojnë të shpërndarë njohurinë që marrin dhe kjo gjë i ç'motivon ata. Për rrjedhojë, *një silabus me çështje sistematike* duket të jetë zgjidhja më e mirë e problemit meqenëse i jep studenteve tanë një pamje të qartë jo vetëm të objektivave të trajnimit të ESP-së së tyre, por gjithashtu mënyrës se si ata do ti arrijnë këta objektiva.

Nga ana tjetër, duhet pasur kujdes që orët e ESP-së të mos kalojnë temat në çështje speciale, meqenëse vetë pedagogu i gjuhës së huaj nuk është një specialist dhe kjo gjë mund të çojë më tej në keqkuptime. Duke ndjekur temat e një silabusi sistematik, do të jemi më të orientuar dhe do të shmangim problemet me termat speciale të lëndëve të ndryshme.

Për më tepër, nëse një temë është diskutuar, kjo i motivon studentët tanë teksa lexojnë një tekst të ri, sepse ata e konsiderojnë të kuptuarit e tekstit të ri si një sfidë e cila i aktivizon njohuritë e tyre profesionale.

Problemi bazë kur ndërtojmë një temë të silabusit është se, ne nuk jemi specialist të një fushe të caktuar të inxhinierisë (p.sh radioelektronik) dhe për rrjedhojë nuk jemi të aftë të vendosim vetë se cilat tema të përfshijmë në silabus në mënyrë që të përfshijmë terminologjinë e duhur. Këto probleme mund të zgjidhen nëse bëhen konsultime me specialistë të lëndëve përkatëse. Bashkëpunimi ndërmjet një hartuesi silabusi ESP dhe një specialisti të një fushe të caktuar mund të rezultojë në hartimin e një silabusi të efektshëm.

Shumë nga programet e reja ndërtohen ose me qëllim që të kurojnë mangësitë e programeve ekzistuese, ose për t'i zgjeruar dhe përmirësuar ato.

Për përshkrimin e një programi që është në zbatim, duhen ekzaminuar pesë komponentë bazë:

- a) kurrikula ekzistuese dhe silabuset,
- b) materialet në përdorim,
- c) mësuesit,
- d) studentët,
- e) si dhe burimet e programit.

Një studim i tillë, shoqërohet gjatë gjithë kohës nga një pyetje themelore: “Në çfarë mënyre ka përparuar ose dështuar programi? Vetëm duke kuptuar pikat e forta dhe dobësitë e programeve ekzistuese, mund të zhvillojmë një program të ri më të mirë.

2.7.1. Silabuset ekzistuese

Silabusi, përbërësi i parë që duhet analizuar, është mjeti me anë të të cilit hartuesit marrin informacion nga pedagogët, autorët e teksteve, komiteteve të ekzaminimeve si dhe studentëve që kanë të bëjnë me programin. Nuk ka rëndësi cili është titulli, sigurisht që është përmbajtja e dokumentit i cili ka hartime programesh, jo në atë që mund të quhet në një shtrirje specifike “silabus” mund të quhet edhe “kurrikulum”, “plan” “skica e një kursi”

ose një sërë emrash të tjerë. Sido që të quhet, ai është një dokument i cili përshkruan në mënyrë ideale⁸⁰:

1. çfarë pritet të kenë mësuar studentët në fund të kursit, ose objektivat e kursit në terma operative;
2. çfarë duhet shpjeguar ose mësuar gjatë kursit, në formën e çështjeve të inventarizuara;
3. kur duhet shpjeguar dhe në çfarë shkalle zhvillimi duke lidhur çështjet inventarizuara me nivelet e ndryshme dhe stadet si dhe me zbatimin dhe kohëzgjatjen e kursit;
4. si duhet shpjeguar, duke pasur parasysh procedurat, teknikat dhe materialet;
5. si duhet vlerësuar, sugjerime për testimin dhe mekanizmat e vlerësimit.

Kur një silabus është i vlefshëm, ne bëjmë një pikë-fillim të rëndësishëm në situatën ekzistuese. Sidoqoftë, shpesh një inspektim paraprak i silabusit na ka rezultuar që dokumentet të cilat i referohemi si “silabus” kanë dështuar së na dhëni informacionin e nevojshëm. Mund të ketë qenë shumë i përgjithshëm duke pasur mungesa detajesh të cilat janë të nevojshme për planifikimin e kursit në nivel lokal dhe duke na lënë në këtë mënyrë ne si pedagogë dhe hartuesit e kursit pa drejtim.

Në të njëjtën mënyrë, një situatë e këtillë mund të jetë tipike për qëllimet e një kursi semestral për të huajt ku planifikuesit presin një aftësi të plotë komunikuese.

Disa nga seksionet e kurrikulumit ose silabuseve duhet të reflektojnë qasje filozofike dhe edukative të cilat udhëzojnë politikë-bërësit. Por një qasje e këtillë mund të jetë e vjetruar për studentët ose që nuk i përshtatet nevojave aktuale të studentëve.

Sigurisht, shumë thjesht mund të imagjinohet një situatë në të cilën nuk ka një silabus ekzistues. Në shumë mënyra, një situatë e tillë është e preferuar nga pikëpamja që kanë hartuesit e kursit dhe që atëherë, specifikimi i silabuseve bëhet një pjesë integruese e punës së madhe që kërkon kursi i hartimit.

Në bazë të informacionit të mbledhur në fazën e gjetjes së fakteve, ndërtuesit e planeve do të prodhonin një dokument i cili i jep përgjigje pyetjeve të specifikuar në këtë seksion.

2.7.2. Materialet që vihen në përdorim

Teksa shohim materialet ekzistuese, është e nevojshme të zhvillojmë pyetje si një ndihmë për të vlerësuar ato. Pyetjet që vijnë sugjerohen si një set minimal:

1. Kush i krijoi materialet dhe ku u zhvilluan ato? Nga një skuadër që merret me krijimin e materialeve të cilët janë të familjarizuar me këtë sistem të veçantë

⁸⁰Dubin, Fraida, Olshtain, Elite,(1986), Course Design, "Developing programme and materials for language learning", Cambridge University Press fq.27

edukativ dhe me popullaritetin e studentëve, apo u prodhuan për tregun ndërkombëtar?

2. A janë materialet konkurruese me silabusin?

Konkurrenca duhet të duket qartë për të gjitha pikat e specifikuar në silabus. Në të njëjtën mënyrë, procedurat dhe teknikat, si dhe prezantimi i çështjeve duhet të jetë në harmoni me specifikimet e dhëna në silabus. Në momentin që një konkurrencë e tillë ekziston, e kemi relativisht më të lehtë të shohim situatën ekzistuese meqenëse përfundimet e nxjerra nga ekzaminimi i silabuseve ekzistuese do të aplikohen edhe për materialet. Gjithsesi, nëse materialet nuk janë konkurruese, atëherë ato do të vlerësohen veças.

Shembuj jo konkurrence mund të gjenden shpesh në materiale të cilat nxjerrin në pah njohuri të reja dhe pasqyrojnë nevojat e studentëve më tepër sesa silabusi në të cilin ata janë mbështetur. Kjo ndodh kur planifikuesit nuk pranojnë të përfshijnë ide dhe rryma të reja para sesa ata ti kenë eksperimentuar ato me kujdes dhe të kenë gjetur më të përshtatshmet. Në këto rrethana, materialet, shumë shpesh përmbushin funksionin e eksperimentimit me mënyra të reja, por mund të ndodhë edhe e kundërta; një silabus i ri i cili shërben si bazë e materialeve të reja, shumë shpesh mund të bashkëpunojë me zhvillimet e fundit në fushën e mësimin të gjuhës, ndërsa materialet ekzistuese ende reflektojnë versione të hershme të silabusit.

3. A i sigurojnë alternativa shumica e materialeve pedagogëve dhe studentëve?

Alternativat mund të ofrohen në formë detyre për studentin, stile të të nxënës, teknika prezantimi, rezultatet e pritshme etj. Ky është një tipar i rëndësishëm i materialeve efektive, meqenëse jo të gjitha mënyrat e të nxënës janë të përshtatshme për të gjithë studentët. Kur nuk ka alternativë të cilat i lejojnë pedagogët dhe studentët të zgjedhin atë që i përshtatet atyre në situata të veçanta, atëherë materialet mund të jenë rënduese, kufizuese dhe aspak nuk të lejojnë për shtrirje apo pasurim. Materialet ideale duhet të prezantojnë pedagogët dhe studentët me një stimul për procesin e mësimdhënies në çdo pikë. Materialet e efektshme duhet ti shtojnë pedagogët me eksperiencë dhe studentët autonom që të zhvillojnë alternativat e tyre duke u bazuar tek nevojat e tyre personale dhe preferencat.

4. Cilat nga aftësitë gjuhësore mbulojnë materialet? A prezantohet veças apo janë të mirë integruara?

Materialet shpesh reflektojnë preferencat e zhvilluesit për disa aftësi gjuhësore për llogari të të tjerëve. Në rast se kjo është konkurruese me të gjithë qëllimet e tjera të vendosura, si p.sh qëllime të këtilla të përgjithshme mund të theksojnë faktin që studentët nuk kanë nevojë për të aftësuar shkrimin, atëherë ky do të ishte një realizim i përshtatshëm për silabusin. Por gjithsesi, nëse kemi mangësi integrimi i cili është i pavarur nga qëllimet e specifikuar, atëherë kjo mund të jetë një e metë serioze e materialeve. Një shembull i mirë i një situatë të tillë është mospërputhja ndërmjet qëllimeve të cilat mund të specifikojnë nevojën e materialeve për dëgjim si dhe materiale të cilat e injorojnë tërësisht këtë pikë.

5. Sa autentik janë tekstet e përfshira tek materialet?

Kjo mund të jetë një pyetje shumë kritike, veçanërisht në rastet kur tekstet janë adaptuar për shumë qëllime të ndryshme. Kështu, një dialog i cili lexohet nga studentët vetëm në formë të shkruar, pa një version për t'u dëgjuar, mund të jetë me shumë të meta. Në të njëjtën mënyrë, nëse një tekst përmban histori për t'u rishkruar të cilat janë adaptuar për tekste të veçanta, studentëve të cilët i përdorin këto tekste nuk mund t'ju jepet mundësia të ndeshen me tekstet autentike. Për më tepër, llojet e ndryshme të teksteve mund të jenë

shumë domethënës duke i treguar studentëve llojin e teksteve të cilat do të jenë tepër të rëndësishëm për ta përgjatë kursit si dhe pas tij.

6. Si ndihen pedagogët dhe studentët të cilët i kanë përdorur këto materiale?

Ndryshe nga pyetjet objektive të bëra më sipër, është e rëndësishme që të mblidhet informacion subjektiv në mënyrë që përfitojmë më tepër informacione rreth materialeve. Ky lloj informacioni është mbledhur nëpërmjet intervistave jo formale.

2.7.2.1.Roli i Pedagogëve⁸¹

Kur flasim për pedagogët, është e rëndësishme të dallojmë ndërmjet shtrirjes së gjuhës natyrale dhe asaj të huaj. Në gjuhën natyrale, pedagogët janë zakonisht folës vendas të gjuhës dhe ata mund të merren me ndryshime vendimmarrëse të cilat kanë të bëjnë me përdorimet gjuhësore; nga ana tjetër, përsa i përket shtrirjes së gjuhës së huaj, pedagogët në pjesën më të madhe të rasteve nuk e kanë gjuhën angleze gjuhën e tyre dhe ata nuk mund të kenë qenë kurrë në një vend anglisht-folës dhe për këtë arsye mund ta kenë shumë më të vështirë që të marrin vendime të natyrës së gjuhës amtare.

Faktori *pedagog* është shumë domethënës në përmbushjen me sukses të materialeve dhe silabuseve të reja. Sjelljet e pedagogëve edhe aftësia e tyre për tu përshtatur me një mënyrë të re të të menduarit apo atë çfarë përfshihet në praktikë, vihet re edhe si vijon: drejtimi që i jep pedagogu targetit të gjuhës (kur nuk është gjuha amtare), trajnimi që kanë pedagogët, arsimimi e trajnimi i tyre, niveli i lartë i shkollimit, idetë që japin ata në lidhje me natyrën e gjuhës si dhe mësimdhënia gjuhësore, eksperiencia në mësimdhënie, dhe aftësia e pedagogut për të punuar me ndryshimet në një program të dhënë.

Për sa i përket aftësisë së pedagogut në përshtatje me programet e reja, këtu duhet punuar më tepër nëse trajnimi i pedagogëve është përfshirë si një përbërës i rëndësishëm i materialeve të reja.

Nga ana tjetër, planifikuesit kanë shumë pak kontroll në fushën e komandimit të targetit gjuhësor. Shpesh ky është një faktor i dhënë i cili duhet marrë në konsideratë teksa planifikojmë programet e reja. (Shiko shtojcën)

2.7.2.2.Roli i studentëve

Numri i studentëve është faktori tjetër i rëndësishëm në klasë. Në shumë programe të reja bashkëbiseduese, pritet që studentët të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata vendosen në situata ku i duhet të ndajnë së bashku përgjegjësi, të marrin vendime, të vlerësojnë progresin e tyre, të shfaqin preferencat individuale. Këto kërkesa mund të jenë të reja dhe të panjohura për studentët. Studentëve mund ti duhet të mësojnë se si të punojnë

⁸¹Mbi rolin e pedagogëve të ESP-së kemi folur më gjerësisht në Kreun 1, pika 1.8. Puna dhe roli i mësuesve të ESP-së

në grup, të bëhen iniciatorë të aktiviteteve etj. Në shtrirjen e gjuhës së huaj, studentët mund të jenë nga prejardhje social-ekonomike homogjene dhe për këtë arsye procesi i sintetizimit të tyre për sa i përket mënyrave të reja të të mësuarit, është i lehtë për tu kryer. Por në gjuhën natyrale, është më e zakonshme që studentët të vijnë nga shtresa të ndryshme me kultura të ndryshme. Për këtë arsye, ata bëhen pjesë e një klase ku mësohet gjuha e huaj duke pasur shumë supozime rreth të mësuarit dhe mësimdhënies, një faktor ky i cili mund të ketë një efekt serioz në suksesin e programit të ri.

Megjithatë, jo çdo student është krijuar në mënyrë të barabartë dhe kjo është një gjë e mirë. Nëse çdo nxënës do ishte njësoj, mësimdhënia do të ishte një punë e mërzitshme. Disa studentë janë thjesht më të vështirë se disa të tjerë për një sërë faktorësh të jashtëm. Shumica e pedagogëve shprehen se nuk kanë një student të preferuar, por e vërteta është se ka studentë të cilët kanë disa karakteristika që i bëjnë ata të jenë të përsosur. Është e vështirë të mos përkrahësh këta studentë për shkak se ata e bëjnë punën tonë më të lehtë. (Shiko figurën).

Një student i mirë bën pyetje

Shumica e mësuesve duan që nxënësit të bëjnë pyetje kur ata nuk e kuptojnë një koncept që është ka shpjeguar mësuesi. Kjo është me të vërtetë e vetmja mënyrë që një mësues të kuptojë nëse studenti ka kuptuar diçka. Nëse nuk bëhen pyetje, atëherë mësuesi duhet të supozojë që koncepti është kuptuar. Studentët e mirë nuk janë të frikësuar për të bërë pyetje për shkak se ata e dinë se në qoftë se nuk e kuptojnë diçka që në fillim, mund ta kenë më të vështirë më vonë kur kjo aftësi të zgjerohet. Të bësh pyetje është shpesh e dobishme për klasën si tërësi për shkak se shanset janë që në qoftë se ju keni atë pyetje, ka studentë të tjerë cilët kanë të njëjtën pyetje.

Një student i mirë, punon shumë

Studenti i përkryer nuk është domosdoshmërisht student i mirë i zgjuar. Kjo është e rëndësishme të kuptohet në këtë diskutim. Ka shumë studentë që janë të bekuar me inteligjencën natyrore, por u mungon vetë disiplina për të vënë në pah këtë inteligjencë. Mësuesit duan studentët që zgjedhin të punojnë shumë, pa marrë parasysh se cili është niveli i tyre i inteligjencës. Studentët të cilët punojnë më tepër, në fund të fundit do të jenë më të suksesshëm në jetë. Të qenit një nxënës që mëson shumë në shkollë thjesht do të thotë që të plotësosh detyrat që të caktohen në kohë, duke bërë përpjekjet maksimale në çdo detyrë, duke kërkuar ndihmë shtesë kur ke nevojë për të, duke studiuar shumë për testimet, si dhe duke njohur dobësitë dhe në kërkim të mënyrave për të përmirësuar mbi këto dobësi.

Një student mirë angazhohet gjithmonë

Duke qenë të përfshirë në aktivitete ekstra - kurrikulare mund ta ndihmojë një student të fitojë besimin dhe mund të përmirësojë suksesin akademik. Shumica e shkollave

sigurojnë aktivitete jashtëshkollore ku studentët mund të marrin pjesë. Këto aktivitete mund të ofrojnë aq shumë mundësi të mësuarit, se sa mund të ofrojë një klasë tradicionale e thjeshtë. Të tilla aktivitete mund të përmendim ato që organizohen nga Fakulteti i Gjeodezisë, Gjeologji-minierave, etj., ku studentët çohen në terren dhe njihen e përballen me atë çfarë kanë mësuar, apo studentët e gjuhë - letërsisë të cilët shkojnë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, nga jugu në veri, për t'u përballur me dialektizmat. Këto aktivitete gjithashtu ofrojnë mundësi për të qenë në rolin e liderit dhe kështu ata mësojnë njerëzit të punojnë së bashku si një ekip për të arritur një qëllim të përbashkët.

Një student i mirë është lider

Mësuesit i duan studentët e mirë të cilët janë lider brenda klasës së tyre. Klasat kanë personalitetet e tyre unike dhe shpesh herë këto klasa të cilat kanë udhëheqës të mirë, janë klasa të mira. Këtu mund të përmendim rastin kur vendosen kriteret për të hyrë në atë Fakultetin e Teknologjisë dhe Informacionit, kërkohet një mesatare më e lartë, sesa kur aplikon për në fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, apo Gjeologji-Minierave. Kështu, kur nis viti akademik, vihet re menjëherë ndryshimi kur japim mësim në këto dy fakultete paralelisht. Nëse në një grup studentësh të degës së Inxhinierisë Elektronike, me një numër prej 30 studentësh, pesë prej tyre nuk ecin me të njëjtin ritëm me pjesën tjetër të klasës, pas një muaji duket ndryshimi, ata motivohen dhe tërhiqen pozitivisht nga pjesa më e madhe e klasës. Mes tyre ka një konkurrencë të jashtëzakonshme dhe të gjithë studentët janë të motivuar për të mësuar. Por e kundërta ndodh me studentët e degës së Inxhinierisë Mekanike, apo Gjeo-Mjedis. Nëse në një klasë me 30 studentë, 20 nuk janë studentë që punojnë shumë, ndërsa pjesa tjetër janë kërkues, pas një muaji shkollë, do shohim se edhe ata të dhjetë janë ç'motivuar nga pjesa më e madhe e klasës. Kjo është një pjesë e cila kërkon një studim më vete.

Aftësitë e udhëheqjes janë shpesh të lindura. Ka nga ata që e kanë këtë virtyt por që nuk e shfrytëzojnë. Ajo është gjithashtu një aftësi që zhvillohet me kalimin e kohës. Besimi është një element kyç për të qenë një lider. Nëse shokët e klasës nuk e besojnë dikë, atëherë ai kurrë nuk do të jetë udhëheqës.

Një student i mirë është i motivuar

Motivimi vjen nga shumë faktorë. Studentët më të mirë janë ata studentë të cilët motivohen për të qenë të suksesshëm. E kundërta ndodh me studentët të cilët nuk janë të motivuar. Ata shpeshherë e kanë të vështirë që të ecin me të njëjtin ritëm me shokët e tyre, kalojnë peripeci dhe janë më të predispozuar që të lejnë shkollën. Studentët të cilët janë të motivuar për të mësuar, e kanë edhe më të lehtë për të nxënë. Ata e duan shkollën, duan ta frekuentojnë atë, dëshirojnë të mësojnë dhe duan të përfundojnë me rezultate të shkëlqyera.

Megjithatë, motivimi merr kuptime të ndryshme, në njerëz të ndryshëm. Ka nga ata njerëz të cilët nuk motivohen nga asgjë, por ata janë të pakët në numër. Nëse do i drejtojmë një pyetje të karakterit social, emocional apo kulturor, një student të Inxhinierisë Elektronike, do jetë e vështirë të marrësh një përgjigje entuziaste. Por në rast se u drejton atyre një

pyetje e cila ka të bëjë me shkencën, teknologjinë, aparatura elektronike, apo gjithçka tjetër që ka të bëjë me

shkencat ekzakte, reagimet e studentëve janë të menjëhershme, me informacione të larmishme, të sakta e plot motivim. Kjo ka të bëjë me natyrën e degës të cilën ata studiojnë, ku janë më të tërhequr nga shkenca, teknologjia si dhe me gjithçka që përfshin bota e inxhinierëve. Kështu që një mësues i mirë duhet të dijë të ngacmojë imagjinatën e një studenti dhe ti motivojë ata që të shprehen në gjuhën e huaj në mënyrën më të mirë të mundur.

Një student i mirë mundohet që të zgjidhë çdo problem

Një nga aftësitë që i mungojnë më shumë këtij brezi studentësh, është aftësia për të zgjidhur një problem. Studentëve u kërkohet që të jenë të aftë në zgjidhjen e problemeve. Studentët të cilët zotërojnë aftësitë e zgjidhjes së problemit të vërtetë janë të pakët në këtë brez, kryesisht për shkak të mënyrës së marrjes së informacionit. Vetëm me një klikim të thjeshtë, studentët sot mund të hyjnë në botën e internetit dhe të gjejnë më shumë informacion se kurrë më parë, duke e bërë kështu çështjen e zgjidhjes së problemeve një aftësi praktikisht të vjetruar. Ata studentë të cilët zotërojnë aftësinë e zgjidhjes së problemeve janë ata që ne si mësues duam. Ato mund të përdoren si një burim për të ndihmuar në zhvillimin e studentëve të tjerë në mënyrë që të bëhen zgjidhës të problemeve të tyre.

Një student i mirë i ndjek mundësitë që i jepen

Një nga mundësitë më të mëdha që ofron ky vend është, se çdo fëmijë ka një arsim falas dhe publik. Për fat të keq jo çdo njeri merr përparësi të plotë të asaj mundësie. Është e

vërtetë që çdo student duhet të shkojë në shkollë për një kohë të caktuar, por kjo nuk do të thotë që secili prej tyre të kapë këtë mundësi dhe maksimizon potencialin e tij të të mësuarit.

Një student i mirë është edhe një përkrahës i mirë

Për fat të keq, kjo cilësi është nga ato cilësi ku studentët e kanë të vështirë ta kontrollojnë plotësisht. Gjithashtu është e rëndësishme të theksojmë se shumë studentë nuk kanë pasur një sistem përkrahjeje gjatë rritjes së tyre. Në fakt kjo edhe mund të kapërcehet, por bëhet edhe më e lehtë nëse ke një përkrahje. Ka njerëz që na përkrahin shumë gjatë jetës sonë, që na shtojnë dhe udhëheqin drejt sukseseve, na këshillojnë që kanë interesa pozitive karshi nesh. Në shkollë, ata synojnë të ndjekin takimet me prindër e mësues, sigurohen që i kanë bërë detyrat e tyre, janë kërkues të notave të mira dhe zakonisht të motivojnë që të arrijnë qëllimet akademike. Të jesh i motivuar e të nxitesh nga dikush, pa dyshim që është një përkrahje e madhe.

Një student i mirë është i besuar

Besnikëria, është një cilësi të cilën jo vetëm ne si mësues, por edhe shokët e klasës e vlerësojnë. Askush nuk ka dëshirë që të jetë i rrethuar nga njerëz mosbesues.

Shtojca 2 ilustron rolin e studentit në mësimin e ESP-së⁸²

2.7.2.3. Burimet

Vendimmarrja mund të jetë e vërtetë dhe frytdhënëse vetëm nëse merr parasysh kufizimin e burimeve të vlefshme për implementim, si nga sasia ashtu dhe cilësia. Limite të tilla në burime mund të interpretohen në një sërë faktorësh kyç të cilët duhen konsideruar me kujdes, si pjesë e procesit të vendimmarrjes:

1. Koha që duhet në dispozicion për përfitimin e targetit gjuhësor është një faktor kyç dhe mund të përcaktohet si i këtuillë shumë lehtë meqenëse çdo planifikim merr parasysh orët që janë në dispozicion në javë, javët që janë në dispozicion për një vit shkollor, madje dhe vitet e kursit. Objektivat dhe mënyrat me të cilat ato duhen arritur, si gjithnjë varen nga sasia kohore që ke në dispozicion dhe në çfarë mënyre shpërndahet ajo.
2. Vendosja e klasës është gjithashtu një faktor i rëndësishëm, i cili pasqyron një numër tiparësh relevante të situatave të mësimdhënie/studentë. Faktorë të tillë si numri i studentëve dhe pedagogëve në klasë dhe mënyra e vendosjes së bankave, mund të jenë faktorë që duhen konsideruar kur planifikojmë aktivitete individuale apo në grup (round table). Mjedisi aktual fizik i klasës (drita, forma e dhomës, etj.) është gjithashtu për tu marrë parasysh dhe mund të kenë efekt pozitiv ose negativ në procesin e të mësuarit. Disa nga këta faktorë mund të alternohen, nëse pedagogu i gjuhës së huaj ka në dispozicion ambientet e tij ku studiohet gjuha dhe do të ishte nën disavantazh serioz nëse atij do ti duhej të lëvizë klasë më klasë.

Gjithashtu për tu marrë në konsideratë është disponueshmëria me pajisje të tilla si manjetofoni, slajdet, filmat, posterat, si dhe tipare të tjera të tilla audio-vizuale të cilat mund të kenë një efekt të madh dhe pozitiv tek aktivitetet e zhvilluara gjatë orës së mësimin, por kufizimet buxhetore zakonisht nënkuptojnë që një planifikim ideal duhet rregulluar sipas rrethanave reale.

Kur planifikojmë programe të reja, është e rëndësishme që të vlerësojmë me kujdes si burimet ekzistuese ashtu edhe kufizimet e tyre meqenëse ato mund të na paraqesin ide të reja të cilat mund të jenë të realizueshme ose të destinuara për të dështuar⁸³.

Si hartues të programeve duhet të kemi parasysh këto pika që vijojnë:

⁸²Vrapi, F, 1995. Punim i tezës së doktoraturës mbi ESP dhe rolin e studentit të ESP-së

⁸³Dubin, Fraida, Olshtain, Elite, Course Design, "Developing programme and materials for language learning", Cambridge University Press (1986).

-
1. A përmbajnë tekstet komerciale në përdorim deklarata rreth pikëpamjeve edukative dhe gjuhësore? Shpesh këto shfaqen në një parathënie, hyrje, ose në një udhëzues që kanë pedagogët. A përkojnë këto politika formuluese me pikëpamjet që ka pedagogu i cili i përdor këto metoda? Apo, a jemi vetë ne pedagogët në dijeni të këtyre orientimeve edukative dhe gjuhësore?
 2. Sa kemi mundur ne si pedagogë të cilët përdorim këto tekste ti kemi adaptuar ato me kornizat e kohës si dhe me detyrime të tjera të kursit?
 3. A bëjmë ne pedagogët ndonjë adaptim kulturor me tekstet?
 - duke i ndryshuar emrat?
 - duke i ndryshuar vendndodhjen emrave?
 - duke alternuar tema që kanë të bëjnë me kulturën, si për shembull, të vënit në përdorim të pushimeve lokale apo jashtë vendit, ushqimet, sportet, etj., në vend të tyre apo së bashku me ato në tekste?
 4. Çfarë adaptimesh bëjmë ne, pedagogët, në mënyrë që të përshtatim sjelljet lokale kundrejt të nxënit të gjuhës? Për shembull, a përdoren seksionet e dialogëve në mësim si ushtrime diktimi apo përkthimi?

2.8. Qëllimet e veçanta të kurrikulumit dhe silabusit të gjuhës së huaj

Përgjegjësia si hartues të kurseve të gjuhës së huaj është që jo vetëm të vendosim qëllime të gjera dhe të përgjithshme, por gjithashtu të specifikojmë objektivat për të gjithë ata që përfshihen në program. Detyra, zbatohet nëpërmjet dokumenteve të shkruara të cilat emërtohen me emra të ndryshëm: udhëzues, plane, skica etj. Në punim janë dy koncepte me të cilat operohet: kurrikulumi dhe silabuset⁸⁴.

1. Kurrikulumi përmban një përshkrim të gjerë të një sërë qëllimesh duke vënë në pah një filozofi të përgjithshme edukativo-kulturore e cila aplikohet nëpërmjet temave së bashku më një orientim teorik kundrejt gjuhës dhe të nxënit e gjuhës. Një kurrikulum është zakonisht edhe reflektim i drejtimeve politike apo kombëtare.
2. Silabusi (plani mësimor), është një formulim më i detajuar dhe operacional i mësimdhënies dhe elementeve të të mësuarit e cila e udhëheq filozofinë e kurrikulumit e një seri hapash të planifikuara që të çojnë drejt objektivave më të ngushta dhe më të detajuara në çdo nivel.

Përkufizimi i kurrikulumit dhe silabusit veçazi si entitete të veçanta duket më i dobishëm në mënyrë që të tërheq vëmendjen funksioneve të veçanta të tyre, edhe megjithëse një dokument mund të përmbajë seksione të cilat shprehin qëllime të ndryshme. Një arsye e rëndësishme për të bërë dallimin ndërmjet të dyjave është për të theksuar faktin se një kurrikulum i vetëm mund të jetë baza e zhvillimit të një varieteje të veçantë silabusesh të cilat kanë të bëjnë me audiencë lokale të përcaktuar, me nevoja të veçanta, dhe me objektiva të ndërmjetme.

⁸⁴Po aty, fq.34.

2.8.1. Plani mësimor

Ai përbën një dokument shtetëror bazë që i orienton dhe i detyron të gjitha shkollat e një tipi të realizojnë një vëllim të caktuar njohurish, shkathtësish dhe shprehish. Plani mësimor mishëron politika shtetërore në lidhje me objektivat arsimore dhe edukative që synon të arrijë shkolla, si dhe qëllimet që burojnë nga destinacioni i saj.

Në planin mësimor përcaktohen:

- Lëndët ose disiplinat mësimore, shpërndarja dhe radhitja e tyre sipas klasave.
- Orët mësimore për çdo lëndë dhe ngarkesat me orë mësimore për çdo javë.
- Struktura e vitit shkollor, kohëzgjatja e mësimëve, detyrimet apo provimet në fund të tij, koha e pushimeve.

Plani mësimor karakterizohet nga :

- Gjerësia, e cila lejon përvojat e përshtatshme për të siguruar mbulim të mjaftueshëm të fushave të të mësuarit.
- Baraspesha, e cila siguron një shpërndarje të përshtatshme të kohës për çdo fushë të veprimtarisë kurrikulare.
- Koherenca, e cila vendos lidhjen ndërmjet fushave të të mësuarit, duke ndihmuar në këtë mënyrë nxënësit të kenë një formim të mirë shkencor e kulturor.
- Vazhdimësia, e cila siguron lidhje organike e të përshkallëzuar të dijeve nga një nivel apo cikël shkollor më i ulët në një tjetër më të lartë.
- Përshkallëzimi, i cili u siguron nxënësve një seri nivelesh të dijeve, ndërkohë që gjatë secilit nivel janë vendosur qëllime të arritshme për ta.
- Fleksibiliteti, që siguron zbatimin e kurrikulit bazë të kushteve të çdo shkolle.

Modelet e kurrikulave kombëtare lëndore dhe të integruara shërbejnë si bazë për hartimin e programeve të veçanta. Në to parashtrohen objektivat e përgjithshëm dhe specifike të lëndës për cikle dhe klasa të caktuara mbështetur në standardet lëndore përkatëse.

2.8.2. Udhëzuesi i kurrikulave lëndore

Ai përbën një element të rëndësishëm të kurrikulës zyrtare. Ato lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimin e politikave shkollore për kurrikulat lëndore dhe zbatimin e tyre në klasë. Udhëzuesit e kurrikulave lëndore ndërtohen mbi një sërë parimesh të përbashkëta dhe kanë për qëllim:

-
- Të sqarojnë përmbajtjen e kurrikulit;
 - Të sigurojnë gjerësinë, baraspeshën, koherencën, vazhdimësinë dhe përshkallëzimin në kurrikul;
 - Të japin udhëzime për zhvillimin vetjak dhe shoqëror të nxënësve;
 - Të japin udhëzime për metodologjitë dhe teknologjitë e reja të të mësuarit;
 - Të japin udhëzime për vlerësimin e studentëve në koherencë me testet

kombëtare.

2.8.3. Programi lëndor, teksti i nxënësit dhe mësuesit

Janë një dokument i rëndësishëm, i cili rrjedh nga dokumentet kurrikulare zyrtare që kanë lidhje me lëndën duke filluar nga politika arsimore, korniza kurrikulare e fushës e deri të standardet lëndore .

Në përbërje të tij mund të jenë edhe elementë të kornizës kurrikulare të ciklit apo të fushës, por në këtë rast ato përqendrohen të veçoritë e klasës përkatëse, pra janë më të detajuar dhe ndikojnë drejtpërdrejt në zbatimin e lëndës në shkollë.

2.9. Qëllimet përfundimtare të lëndës

Ato klasifikohen në qëllime ose objektiva të përgjithshëm, të cilat pasqyrojnë drejtimit themelore të formimit të përgjithshëm qytetar e intelektual që parashikohen të arrihen nga nxënësit në fund të vitit shkollor dhe në objektivat e të mësuarit që janë, gjithashtu, objektiva të përgjithshëm dhe përfundimtarë.

Të parët lidhen drejtpërdrejt me punën gjithëvjetore të mësuesit, ndërsa objektivat e të mësuarit pasqyrojnë karakteristikat dhe thelbin formues të një disipline të caktuar shkollore duke shërbyer në këtë mënyrë si parime udhëheqëse për veprimtaritë didaktike që zhvillohen në klasë.

2.9.1. Përmbajtja e lëndës

Është pjesa themelore e programit kurrikular të disiplinave shkollore. Në përmbajtjen lëndore parashtrohet vëllimi i njohurive, shprehive dhe vlerave, të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën që përfaqësojnë sistemin e plotë dhe të njësuar të dijeve potencialisht të parashikuara për t'u përvetësuar nga nxënësit gjatë një viti shkollor.

Për të përcaktuar në parametra sa më optimalë gjerësinë dhe thellësinë e elementeve të ndryshëm të përmbajtjes, përveç mbajtjes parasysht të përshtatjes së brendisë lëndore me pjekurinë psikologjike të nxënësve, duhet të zbatohen disa kritere të tilla, si :

- Vazhdimësia që siguron mbartjen e përvojave dhe arritjeve të mëparshme;
- Përshkallëzimi, që siguron renditjen e nivelit të dijeve sipas një taksonomie të caktuar;
- Koherenca që siguron lidhjet e brendshme dhe lidhjet ndër-lëndore.

Ndërkaq, organizimi i përmbajtjes duhet me domosdo të mbështetet në një ose më shumë prej parimeve të njohura didaktike, si: parimi konceptual, problemor, global, por ka edhe parime didaktike, që janë specifike për disiplina të caktuara. Në programin sintetik, shënohet sasia e orëve për çdo javë dhe vjetore, njohuritë, shprehitë dhe vlerat, veprimtaritë praktike (ushtrime, detyra, hartime, etj), ekskursionet, vizitat mësimore etj., përsëritjet përgjithësuese, si dhe orët në dispozicion të mësuesve. Ndërsa në programin analitik përshkruhen shkurtimisht elementët kryesorë të përmbajtjes sipas kapitujve dhe temave mësimore, siç janë:

a) Arritjet e pritshme të studentëve

Shprehin cilësinë e mundshme të përvetësimit të dijeve nga studentët për çdo linjë, nën-linjë e klasë.

b) Teknologjitë e reja

Në këtë pjesë pasqyrohen përmbledhtazi dhe në formë rekomandimesh mënyrat e përdorimit, vlerat dhe temat ose grup-temat ku do të përdoren teknologjitë e reja, të cilat janë vënë në dispozicion të pedagogëve.

Në teknologjitë mësimore mund të përfshihen aparaturat, instrumentet, pajisjet kompjuterët, videot didaktike etj.

c) Metodologjia e të mësuarit

Shpreh tërësinë e metodave, të ecurive metodike, të formave të organizimit të mësimit në klasë e jashtë saj, të mjeteve mësimore që përdoren në orën e mësimit, të cilat janë të ndryshme për çdo lëndë të veçantë.

Metodat e mësipërme përdoren të ndërthurura me njëra tjetrën në përputhje me karakteristikat e dijeve që jepen.

d) Metodologjia e vlerësimit

Vlerësimi i nivelit të përvetësimit të njohurive, shprehive dhe sjelljeve të nxënësve, përfshihet në liritë dhe kompetencat profesionale të çdo pedagogu. Megjithatë, për të ndihmuar pedagogët mund të rekomandohen udhëzime lidhur me mënyrat, tipat dhe etapat e vlerësimit, si dhe me kërkesat më të domosdoshme që duhen mbajtur parasysht për arritjen e një vlerësimi të suksesshëm.

Format dhe teknikat e vlerësimit mund të jenë të larmishme, si për shembull, vlerësimi sistematik, periodik ose semestral, vlerësimi me gojë, me shkrim etj.

Përcaktimi i përmbajtjes lëndore që do të kontrollohet, sasia dhe niveli taksonomik i pyetjeve, sistemi pikëzimit dhe mënyra e konvertimit në notë për çdo test vendosen nga pedagogët.

e) Udhëzimet për zbatimin e programit

Ato mund të jenë të përgjithshme dhe orientuese për pedagogët, por në shumicën e rasteve janë zyrtare dhe rrjedhimisht të detyrueshme për t'u zbatuar. Këtu mund të përfshihen: e drejta e pedagogëve për shpërndarjen e orëve të një kapitulli, fusha a moduli në funksion të nevojave mësimore, të gjendjes së bazës materiale, të kushteve të shkollës etj., e drejta e pedagogëve për shpërndarjen e orëve të lëna në dispozicion, si dhe mënyra e të vepruarit për vendosjen e raporteve të drejta kohore ndërmjet temave teorike dhe veprimtarive praktike, sidomos për ato raste kur për arsye objektive pedagogët e kanë të pamundur ti realizojnë ekskursionet, vëzhgimet dhe eksperimentimet në terren etj.

f) Teksti i studentit

Përmbush disa funksione tradicionale që lidhen me procesin mësimor.

Ato janë:

- *Transmetimi i njohurive*

Ky funksion realizohet kur studenti asimilon koncepte të veçanta. Në këtë rast studenti duhet të jetë i aftë jo vetëm që t'i përsërisë këto dije, por të përfshijë në to edhe shprehitë konjitive që kërkohen në mësim.

- *Zhvillimi i shkathtësive dhe i shprehive*

Në këtë rast, krahas asimilimit të njohurive synohet që të përvetësohen edhe metoda e qëndrime, madje edhe zakone të punës e të jetesës. Në këtë proces theksi vihet të veprimtaria që duhet kryer. Studenti duhet të mësohet që ta ushtrojë këtë veprimtari për një numër të madh objektesh të mësimin.

- *Përforcimi i dijeve*

Pas përvetësimit të një dijeje apo shprehie është e domosdoshme që ato të ushtrohen disa herë në situata të ndryshme për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre të nevojshme. Ky rol plotësohet nga ushtrimet, zbatimet etj.

- *Vlerësimi i dijeve*

Në këtë rast teksti i vetëm mund të përcaktojë drejtimit e vetëvlerësimit, por vetë ai nuk mund t'i realizojë funksionet e vlerësimit vërtetues. Vlerësimi i realizuar nëpërmjet tekstit shkollor është i tipit formues.

- *Roli ndihmës në integrimin e njohurive të përfuara*

Ky funksion nënkupton një proces të dyfishtë: lidhjen e njohurive dhe të shprehive me nivele të ndryshme të së njëjtës disiplinë, pra integrimin vertikal dhe bashkërendimin e aftësive dhe kompetencave, të fituara në procesin e studimit të disiplinave të ndryshme, pra integrimin horizontal.

- *Edukimi shoqëror e kulturor*

Ky funksion ka të bëjë me synimin e tekstit jo vetëm në transmetimin e njohurive dhe të shprehive, por edhe në ndihmesën e këtij të fundit për edukimin e atyre qëndrimeve, që e ndihmojnë studentin për të gjetur gjithnjë e më mirë vendin e tij në strukturat shoqërore, familjare, kulturore e kombëtare.

- *Referenca*

Teksti shkollor mund të trajtohet si një doracak praktik, tek i cili çdo lexues mund të gjejë informacion të saktë e të shkurtër për tema të ndryshme. Në rastet kur kemi informacion të mjaftueshëm, teksti mund të luajë rolin e një kornize referencash, e cila në bashkëveprim me burime të tjera e ndihmon studentin për të ndërtuar orientime të qëndrueshme dhe të lidhura me mësimin.

Të gjithë mësimdhënësit e gjuhës së huaj japin mësim sipas librave (teksteve) të hartuara posaçërisht për ta. Tekstet e tyre janë drejtuesit kryesorë të veprimtarisë mësimdhënëse, sepse në to përfshihen qëllimet, përmbajtja e shkurtuar e materialit dhe mjetet e metodat e mësimdhënies. Ato përmbushin kryesisht funksione formuese, si: funksionin e informimit shkencor, funksionin e formimit pedagogjik, i lidhur ky me disiplinën, funksionin e ndihmës në procesin mësimor dhe në administrimin e mësimeve, si dhe funksionin e ndihmës në vlerësimin e dijeve.

Në varësi të ndërtimit të tyre, tekstet për mësuesin mund të jenë të mbyllura ose të hapura;

Teksti i mbyllur përmban në mënyrë të plotë e të mjaftueshme gjithçka që i nevojitet mësuesit. Në këtë rast ai është si një botim ndihmës, që plotëson librin e nxënësit.

Teksti i hapur shërben si mjet reference për të ushqyer mendimin e mësuesit. Ai plotëson informacionin shkencor e pedagogjik, duke propozuar variante të ndryshme të zhvillimit të mësimin, por pa e kufizuar mësuesin në një kornizë këshillash të detyrueshme.

Pavarësisht nga lloji, libri i mësuesit gjithmonë duhet të përmbajë informacion të shumëllojshëm e të mjaftueshëm, përfshirë:

- Informacionin e domosdoshëm që mungon në librin e nxënësit, që ta nxisë këtë të fundit për të bërë kërkime;
- Informacionin plotësues që është i panjohur apo pak i njohur për mësuesin dhe që mund të shërbejë për ta bërë mësimin më tërheqës;
- Informacionin pedagogjik që mësimdhënësi nuk njeh.

Krahas tekstit të mësuesit për të janë mjaft të rëndësishëm edhe tekstet ndihmës sepse ndihmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e frytshmërisë së punës së mësuesit në klasë.

Të hartuar në formën e broshurave, ata përmbajnë udhëzime konkrete për zbatimin e lëndëve të veçanta mbi bazën e çështjeve, të ushtrimeve, temave e kapitujve duke i orientuar mësuesit sipas specifikimeve të lëndëve të tyre.

2.9.1.1.Përzgjedhja e formës së silabusit

Dilema bazë me të cilën duhet të pajtohen mësime të ndryshme të gjuhës së huaj është fakti që gjuha është e pafund, por një silabus duhet ta ketë një fund. Për më tepër, ky fund apo kjo përmbajtje e zgjedhur kërkon një lloj organizimi, apo formati në formën me të cilën mund të përshtatet më mirë me objektivat e veçanta të projektit.

2.9.1.2.Formati Linear

Formati i cili adaptohet tradicionalisht për përmbajtje me elementë diskretë, në mënyrë të veçantë gramatikore ose struktura, është forma lineare. Parimet gjuhësore dhe pedagogjike përcaktojnë rendin me të cilin do të prezantohen njësitet. Kur kjo renditje është përcaktuar, renditja e brendshme e çdo njësie rezultojnë në një organizim i cili duhet mbajtur në formatin e tij origjinal. Me fjalë të tjera, ne nuk mund ta ndryshojmë rendin e njësive apo ta anashkalojmë atë pa respektuar rendin e përcaktuar.

Gjithsesi, një formë strikte lineare nuk funksionon mirë nëse kategoritë e përmbajtjes gjuhësore janë funksionale dhe vepruese përderisa nuk ka sekuenca të trashëguara apo renditje e cila duket më e mirë⁸⁵. Shumë tekste shkollore përdorin format lineare edhe megjithëse nuk përfshijnë principet e renditjes.

Ilustrimi tregon pjesërisht një tabelë përmbajtjeje të tekstit shkollor në nivel A2/B1/B2, "Engineering", në të cilin renditja lineare e elementëve ndjek një skicë familjare (të njohur). 'Praktika e bashkëbisedimit' në secilën njësi në të cilën janë prezantuar funksione të ndryshme gjuhësore, na shfaqet që ka lidhje në një farë mënyre me termat bazë. Gjithsesi, asnjë shpjegim i arsyeshem nuk i është dhënë përzgjedhjes së kategorive të veçanta funksionale, as gramatikës, si në librin e mësuesit, ashtu edhe në atë të studentit.

2.9.1.3.Formati Modular

Një format modular është i përshtatshëm më së miri për kurse të cilat integrojnë një gjuhë rrethore apo tematike dhe përdoret shpesh për një silabus i cili është i hartuar për një program në të cilin objektivi është tek fleksibiliteti i materialeve që janë në përdorim është

⁸⁵Johnson, K. (1982). *Communicative Syllabus Design and Methodology*. London: Pergamon Press

në maksimum. Ilustrimi ndjek një plan modular ku janë integruar aftësitë me drejtim akademik dhe njësitë tematike. Çdo modul konsiston në një sekuençë detyrash së ndërtimit të aftësive, e cila zgjat 2-3 javë, dhe që përmban të njëjtën temë;

1. të lexuarit; studentët bëjnë formimin kulturor si përgatitje para leksionit
2. të lexuarit dhe mbajtja e shënimeve; studentët dëgjojnë një mini-leksion (25 minuta) i cili prezantohet nga mësuesi tyre, dhe mbajnë shënime;
3. leximi/shkrimi; studentët përdorin shënimet e tyre për t'u përgatitur për një kuiz.
4. leximi; studentët lexojnë rreth temës së tyre nga një variete burimesh të ndryshme.
5. gjuha e folur; studentët përfshihen në biseda, zgjedhin probleme në grupe të vogla si dhe diskutojnë për ato që kanë përgatitur.
6. shkrimi; studentët shkruajnë një ese prej 150-200 fjalësh me temën që ka lidhje me çështjen. Të shkruarit procedohet nga mbledhja e ideve, shtrirja e tyre, si dhe nëpërmjet drafteve të para dhe të dyta.

Ilustrimi na shfaq një plan semestral i cili liston njësitë tematike nga të cilat mund të përzgjedhim unë dhe studentët. Më pas, gjatë javëve 6-14, një klasë tipike duhet të punojë në tre çështje, por çdo herë përsëritet i njëjti cikël të dhënash. Integrimi i ciklimit të të dhënave dhe njësia tematike përbëjnë modulin.

2.9.1.4.Formati Ciklik

Ky është një princip organizativ i cili detyron mësuesin dhe studentët të punojmë me të njëjtën temë më tepër së një herë, por çdo herë rishfaqet një e veçantë që është në një nivel më të vështirë dhe më kompleks. Gjithsesi, kriteri i cili vendos se cilat janë fushat më të vështira të strukturave gramatikore mund të varet nga eksperiencia që ka pedagogu. Në formën ciklike, koncepti është se temat e reja nuk duhen prezantuar njëherë në silabus dhe më pas të hiqen; preferohet që të ri-prezantohet në manifestime të ndryshme dhe në kohë të ndryshme përgjatë kursit.

2.9.1.5.Formati Matriks

Si një formë e cila e jep përdoruesve një fleksibilitet në maksimum për të përzgjedhur çështje nga një tabelë përmbajtjeje në një rend të rastësishëm, matriks është e mirë përshtatur për një përmbajtje rrethore. Në, *Koha për të folur*⁸⁶ jepen gjashtë kategori detyrash të cilat matricohen me gjashtë katro rrethore. Katrorët rezultues të matriksit përfshijnë secila tre apo katër aktivitete bashkëbisedimi të cilat përfshijnë detyrat e dhëna me situatën e veçantë apo me mjedisin.

⁸⁶Dubin, F. and Margol (1997). It's time to talk: Communication activities for learning English as a new Language. Englewood Cliffs, New Jersey:Prentice-Hall.

Formati në linjën e një historie. Çështja e mbajtjes së koherencës në një silabus ndërtuar mbi nocionet dhe funksionet u soll nga Wilkins⁸⁷. Sugjerimi i tij se futja në një linjë e historive mund të ketë efektin e sigurimit të vazhdimësisë tematike dhe të ndihmojë në zgjidhjen e çështjeve e urdhërimin e kategorive në lidhje me njëri-tjetrin. Shembujt janë marrë nga shkrimtarë të ndryshëm të teksteve: Griffin në *Follow me to San Francisco*⁸⁸ dhe Abbs, Ayton and Freebairn⁸⁹. Ky format, pasi ka në thelb tregimin e një historie, është i një lloji ndryshe nga formatet e ilustruara më sipër.

2.9.2. Përzgjedhja e metodës

A duhet që një metodë e veçantë të jetë elementi fokusues mbi të cilin zhvillohet silabusi?

Në kurrikulumin profesional dhe në hartimin e silabusit, nevoja për bashkëpunim e ashtuquajtur metodë, thjesht zhduket sepse funksioni i tyre është nxjerrë në pah nëpërmjet specifikimit në planeve udhëzuese dhe materialeve. Metoda, sidoqoftë e përkufizuar, ndodhet në kurrikulum, silabus dhe tek materialet. Kjo nuk do të thotë, sigurisht, që metodologjia për pedagogët, ose vëmendja që i kushtohet praktikave të ndryshme në klasë është duke u lënë mënjanë; por kjo nuk është në qendër të interesave në këtë diskutim.

Përcaktimi më i saktë që iu bë metodës dhe që u përhap shpejt dhe me shumë sukses, ishte ajo që u ofrua nga Anthony⁹⁰. Ai e përkufizoi metodën në lidhje me dy terma të tjerë, qasja dhe teknikat. Qasjet u panë edhe nga ana e pikëpamjeve teorike të gjuhës dhe nga ajo psikologjike të cilat kanë të bëjnë me studentin. Në një model, i cili funksionoi edhe si tabelë, përfshiheshin 'përzgjedhja e materialeve që duhej shpjeguar, klasifikimi i këtyre materialeve, prezantimi dhe implementimi i tyre pedagogjik në mënyrë që të nxiste të mësuarit'. Teknikat ishin praktika të përditshme klase dhe procedura, ndërsa ky përkufizim i metodës nxori në pah disa nga funksionet e silabuseve ashtu edhe të metodave dhe përcaktimi nuk përfshinte rolin e silabusit për të qartësuar se çfarë përmbajtje gjuhësore duhej përfshirë. Sidoqoftë, modeli i Anthony funksionoi me efikasitet.

Kohët e fundit, metodat duket sikur kanë shpërthyer në të gjitha drejtimet. Çdo gjëje tashmë mund ti referohesh me termin metodë, edhe nëse nuk i përshtatet përkufizimit të bërë nga Anthony. Një element që kanë të përbashkët këto metoda është se ato synojnë të merren me segmente të njëanshëm të të gjithë spektrit. Disa janë të fokusuar në aspektin e një baze të fortë për një kurrikulum, që do të thotë nga natyra e të mësuarit të gjuhës, dhe të tjerë janë nxjerrë nga plotë filozofi të veçanta edukative. Të influencuara nga psiko-linguistët, ato metoda të cilat kanë orientim të mësuarit e gjuhës, ngrenë këtë pyetje; Cila është natyra e të mësuarit të një gjuhe të dytë dhe natyra e një studenti që mëson një gjuhë të dytë?

⁸⁷ Wilkins, D. A. 1976. *Notional Syllabuses*. Oxford: Oxford University Press. fq.66

⁸⁸ Griffin, S. 1981. *Follow me to San Francisco*. New York: Longman Inc. and London: B.B.C. English by Television

⁸⁹ Abbs, B., A. Ayton, and I. Freebairn. 1975. *Strategies*. London: Longman.

⁹⁰ Anthony, Edward. 1963. 'Approach, method and technique.' *English Language Teaching Journal* fq. 17: 63-7 riprintuar në Allen, H. and R. Campbell (eds.): *Teaching English as a Second Language*. (2nd ed.)1972. New York: McGraw-Hill.

Është e rëndësishme për t'u theksuar se këto metoda me bazë psikologjike synojnë të mos e adresojnë veten në një rrugë serioze pyetjesh rreth përmbajtjes gjuhësore apo drejt aspektit *jetësor të* silabusit.

2.9.3. Vendi i objektivave në përzgjedhjen e metodave të mësimdhënies së gjuhës së huaj.

Studenti i kursit fiton njohuri e shprehi specifike mbi gjuhën e huaj duke thelluar më tej njohuritë e marra. Njëherazi me konsolidimin e tyre, synohet drejt një formimi sa më të thellë e të specializuar për gjuhën në drejtim të leximit, të folurit, shkrimit e dëgjimit apo shprehive të tjera të integruara të cilat janë tejet vitale e efektive për gjuhën e huaj.

Përmes një tematike të larmishme dhe specifike synohet familjarizimi, interpretimi e përdorimi kontekstual i ideve apo aktiviteteve si dhe formave të rregullta gramatikore.

Gjithashtu, synohet edhe paraqitja e mendimeve në formën e shkrimit të goditur e koherent përmes eseve, përkthimeve apo punimeve, pa neglizhuar përdorimin e një fjalori të bollshëm terminologjik mbështetur mbi nevojat e kërkesat që dalin nga fushat inxhinierike.

2.9.4. Zhvillimi i kurrikulës mbi bazën e metodës

Meqenëse kurrikulumi merret me një përshkrim të përgjithshëm për të formuluar vendime të matura vendimarrëse, kombinon qëllimet kulturore-edukative me qëllimet gjuhësore. Për shembull, një trajtim i përgjithshëm edukativ mund të fokusohet në një nga këto pikëpamje madhore:

- (a) një orientim bihejviorist i konsideron speciet njerëzore si një organizëm pasiv, të cilët reagojnë nga një stimul i jashtëm mjedisor:
- (b) një orientim konjitiv-racional i konsideron speciet humane si burimin dhe iniciatorin e të gjithë veprimeve;
- (c) një orientim humanist merret me rritjen dhe zhvillimin e çdo individi, ndërsa vë në pah gjithashtu edhe faktorët emocionalë. Nga ana kulturore, çdo njëra nga këto filozofi mund ti përshtatet më mirë një komuniteti të caktuar.

Në vija më të gjera, një orientim edukativ është i konkureshem me një apo më shumë teori gjuhësore dhe të mësuarit të një gjuhe. Kështu, pikëpamja bihejvioriste është një filozofi edukativo-psikologjike e cila është e pajtueshme me një pikëpamje strukturaliste gjuhësore dhe me një pikëpamje të reagimit të një stimuli rreth të mësuarit të gjuhës humane. Diagrami na paraqet këta tre përbërës të një kurrikulumi audio-gjuhësor, një pikëpamje e cila triumfoi në vitet 1950 dhe 1960, duke ardhur si një shembull se si pikëpamjet e mëdha influencojnë në kurrikulum.




Fig. 1 Zhvillimi i kurrikulës mbi bazën e metodës

Meqenëse influencat teorike që bazoheshin në kurrikulumin e një gjuhe u zhvendosën, orientimi racional konjitiv u reflektua ndjeshëm në pikëpamjet e gjuhës njerëzore që u propozuan transformimet gjenerative gjuhësore u shoqëruan me afrimin kodit konjitiv me të mësuarit e gjuhës. Orientimi humanist është shoqëruar së bashku me pikëpamjet komunikuese gjuhësore. Është fjala ajo që ka spikatur më shumë që nga mesi i viteve 1970.

Është interesante të ndjekësh prejardhjen e pikëpamjeve të ndryshme të spikatura në mësimdhënien e gjuhës. Për shembull, si qasja e gramatikës-përkthimit, e cila ishte e përdorur në mënyre tipike në mësimdhënien e gjuhës greke dhe asaj latine dhe me pas u përgjithësuan në mësimdhënien moderne të gjuhës, dhe qasja më bashkëkohore e *Silent Way*⁹¹ kanë prirje të qarta me një orientim racional-konjitiv në mënyrën se si ato të dyja theksojnë format e të mësuarit të gjuhës. Ndërkohë, si shembull mund të themi se një pedagog i gramatikës-përkthimit do t'i japi studentëve pika sqaruese gramatikore, pedagogu i *Silent Way* do t'i sigurojë atyre një model shqiptimi të shoqëruar nga heshtja, e cila, sipas trajtimit nxit studentët që të marrin iniciativën për aktivitete konjitive.

Një tjetër trajtim bashkëkohor i cili lidh një pikëpamje racionale-konjitive me një orientim komunikues kundrejt përdorimit të gjuhës quhet Përqasja Natyrale⁹². Kjo përqasje ka shumë

⁹¹Gattegno, C. An approach that Humanizes Teaching, 1992

⁹²Krashen, Stephen D. and Tracy D. Terrell (1983). The Natural Approach. Language Acquisition in the Classroom Oxford: Pergamon Press

të përbashkëta me pikëpamje të tjera bashkëkohore të cilat theksojnë rëndësinë e dëgjimit dhe të kuptuarit në mësimin e të mësuarit-ndërmjet tyre Silent Way⁹³.

Ashtu siç është parashtruar edhe në diagram, tre orientimet bazë, njëra që kanë të bëjë me gjuhën, njëra me të mësuarit e gjuhës, si dhe një që ka të bëjë me pedagogjinë, mund të reflektohen pjesërisht ose në mënyrë të plotë në një varietete të gjerë të qasjeve të të mësuarit të gjuhës.

2.9.5. Llojet e silabuseve mbi bazën e KEK dhe metodës

Në dekadën e kaluar, iu kushtua një vëmendje e madhe elementeve të veçantë gjuhësorë të cilat janë përfshirë në një silabus si dhe në sistemin organizativ sipas të cilit ato prezantohen. Diskutimet kanë marrë gjithnjë në konsideratë avantazhet dhe disavantazhet e tre apo katër tipeve kryesore të silabuseve, silabuset funksionale, dhe silabuset situacional.

Silabuset më të njohur strukturorë, gramatikorë apo gjuhësorë përqendrohen rreth çështjeve të tilla si kohët, nyje, njëjës/shumës, format ndajfoljore etj. silabusi kuptimor (ose semantiko-kuptimor) erdhi në fokus në mesin e viteve 70, dhe e radhiti njësinë semantike në qendër të organizimit të silabusit. Një silabus i këtillë është i organizuar rreth temave që kanë lidhje me hapësira më të gjera kuptimi të tilla si hapësira, koha, detyrimi, etj. silabusi funksional, fokusohet në funksionet sociale të gjuhës, si njësia qendrore e organizimit. Kështu, një silabus funksional ka lidhje me elemente të tillë si ftesat, sugjerimet, të kërkuarit ndjesë, refuzimet, etj. lloji i katërt i përmendur këtu, ai situacional, megjithëse nuk është shumë i përhapur nga të tjerat, është njohur në të mësuarit e gjuhës për më tepër se qindra vjet me anë të librave frazale për turistët.

Të katër shembujt e cituar (strukturor, nocion, funksionet dhe situatat) ilustrojnë realizime të ndryshme të një trajtimi organizativ bazuar në njësi diskrete. Kohët e fundit, përbrenda qasjes komunikuese të kurrikulumit dhe hartimit të silabusit, ideja e prezantimit të një koncepti organizativ i cili nuk është i bazuar në njësi të ndara por në një proces të vazhdueshëm komunikimi dhe negocimi në targetin e gjuhës ka fituar popullaritet. Në këtë mënyrë, nevojat komunikuese të studentëve janë bazat mbi të cilat zgjidhen gjuhëtar të ndryshëm, si dhe elemente tematikë ose funksionalë. Roli i pedagogut është që të lehtësojë pjesëmarrjen e studentit në këto shkëmbime komunikative. Teorikisht, duhet të ketë gjithashtu edhe një shtytje për studentin që të marrin nën përgjegjësi analizimin e nevojave të tyre dhe për rrjedhojë të kërkojnë ndihmë nga pedagogu apo materialet. Ne si pedagogë, teksa kemi hartuar kurset të cilat i konsiderojmë me kujdes qasjet e ndryshe për ndërtimin e silabuseve, mund të arrijmë në përfundimin se një sasi e silabuseve të ndryshëm nevojiten dhe kombinohen më së miri në mënyrë eklektike në mënyrë që të sjellë rezultate pozitive.

⁹³Krashen, Stephen D. and Tracy D. Terrell (1983). The Natural Approach. Language Acquisition in the Classroom Oxford: Pergamon Press

PËRFUNDIME

Në këtë kapitull trajtuam disa instrumente bazë të cilat vijnë në ndihmë për reformimin e kurrikulave ku përmendim KEK, Nivelin e përbashkët të kuadrit të referenca për gjuhët, Kuadrin e kualifikimit si mjet për mbështetjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës, reforma e arsimit të lartë. Ndryshimet në fushën ekonomike dhe dukuria gjithnjë e më e shpeshtë e ndryshimit të vendeve të punës dhe të profesioneve, shtron sidomos përpara shkollave të formimit profesional detyrën e zhvillimit të aftësive dhe të shprehive të shumanshme praktike si dhe të qëndrimeve pozitive për të nxënëit gjatë gjithë jetës. Parashikimet për të ardhmen kërkojnë që politikat arsimore të vënë theksin dhe rëndësinë që ka rritja e cilësisë në fushën e arsimit dhe cilësia e hulumtimeve shkencorë që lidhen me të. Njohuritë, shprehitë dhe aftësitë për t’i përdorur dhe menaxhuar përfundimet e hulumtimeve në një mënyrë krijuese, vlerësohen si pasuritë më të mëdha në këtë fushë. Prandaj kërkohet që arsimit të marrë përsipër përgjegjësi të mëdha për krijimin e një të ardhmeje më pozitive për të gjithë.

Shohim se kemi një ndryshim të madh në vite që vjen që nga përzgjedhja e metodave të cilat janë tashmë të dedikuara tërësisht gjuhës angleze për qëllime të veçanta si dhe i përputhen në mënyrë dinjitoze kërkesave të kohës.

Në këtë studim, duket se është dalë në konkluzionin se mund të jetë e nevojshme të përdoret një silabus strukturor/situacional vitet e para të studimit të kursit, duke lëvizur më pas në një plan funksional të organizimit, e shoqëruar nga kombinimi nocional, dhe duke përfunduar me një krijim të plotë komunikimi për fazat finale të kursit. Një zgjidhje e tillë do të ishte e përshtatshme për një gjuhë të huaj, ndërsa një përshtatje e pastër komunikative mund të jetë më e përshtatshme për t’u aplikuar në kuadrin natyral. Tipari më i rëndësishëm për çdo silabus modern gjuhësor, është respektimi i trashëgimisë potenciale kulturore e gjuhësore, rregullimi dhe shtimi gradual i saj, duke u bazuar në vendimet e marra me kujdes gjatë çdo niveli kursi.

It seems fairly obvious that if teachers are to be the ones responsible for developing the curriculum, they need the time, the skills and the support to do so. Support may include curriculum models and guidelines and may include support from individuals acting in a curriculum advisory position. The provision of such support cannot be removed and must not be seen in isolation, from the curriculum⁹⁴

KREU III

ANALIZA E NEVOJAVE DHE ZBATIME KONKRETE SI NJË UËDHËZUES PËR NDËRTIMIN E PROGRAMEVE MBI BAZËN E QËLLIMEVE, OBJEKTIVAVE DHE PËRMBAJTJES

3.1. Analizë e programeve të gjuhës angleze në UPT në vite

Në këtë pjesë të punimit tonë, jemi përpjekur për të nxjerrë në pah disa ndryshime ndërmjet planeve të cilat kanë qenë në funksion në vitet 80'-2007, ku mbizotëronte gjuha angleze përgjithshme (GE) dhe plan-programet e vëna në dispozicion e funksion të fakulteteve të UPT-së që nga viti 2007 e në vazhdim të cilat janë tërësisht ESP. Më pas e përfundojmë me vlerësimin e nevojave për materiale “të specializuara” si dhe “qasje” të “specializuar” të mësimdhënies së gjuhës për studentë të veçantë (siç janë studentët të cilët studiojnë në fakultetet e UPT-ës, Inxhinierisë Elektronike). Kemi përfshirë edhe skica për vlerësimin e materialeve, mënyrat e premisit për shkrimin e përpunimin e materialeve, ndërthurur me fazat përgatitore e veçoritë specifike.

Termi ESP na është shfaqur shumë shpesh në literaturën e mësimdhënies së gjuhës angleze në këto dekada të fundit. Ky term përdoret për t'iu referuar mësimdhënies së gjuhës angleze për qëllime të veçanta:

- 1) kërkesa për punësim
- 2) kërkesa për trajnime profesionale
- 3) kërkesa për studime akademike profesionale.⁹⁵

⁹⁴Nunan, D. (1987). The teacher as curriculum developer: An investigation of curriculum processes within the Adult Migrant Education Program. South Australia: National Curriculum Resource Centre. Fq.75

⁹⁵Bates, M. (1978) “Writing, ‘Nucleus’” in Mackay, R. & Mountford, A. (eds): English for specific Purposes, London: Longman. fq.2

“Kategoritë ku përmbliidhen qëllimet e punësimit dhe ato të trajnimit profesional nuk janë diskrete dhe shpesh përputhen gjerësisht”⁹⁶; për shembull, një kurs i mirëfilltë trajnimi për një stuardeshë përfshin gjithashtu aftësi studimi për qëllime akademike në mënyrë që ta ndihmojë atë të kalojë një provim profesional në shërbimin e ushqimit pasagjerëve që udhëtojnë me linjat ajrore. Por edhe në vendin tonë është rritur interesi i mësimit të gjuhës së huaj EFL dhe tregu ka filluar të furnizohet edhe me tekste të ESP-së për inxhinierët, doktorët, juristët, etj. Kjo fushë e mësimit të gjuhës angleze, ESP, duket se ka dy karakteristika të rëndësishme të cilat nuk i ka GE:

- 1) Është më tepër e përdorur nga një moshë adulte, sesa nga fëmijët;
- 2) Roli i rëndësishëm ndihmës që luan gjuha angleze në këtë rast për një edukim më të specializuar, si inxhinierë, shkencëtarë, teknolog etj., në një mënyrë më efikase⁹⁷.

Tipari që i karakterizon më tepër studentët e degëve të inxhinierisë (në përgjithësi) në mësimin e ESP-së është se ata janë tepër të motivuar për të mësuar gjuhën angleze. Për ata, mësimi i ESP-së është tepër i rëndësishëm; pa gjuhën angleze të profesionit, studentët nuk mund të ecin me sukses në karrierën e tyre. Në fakt, ndodh që kur bëjmë prezantimin me studentët në javën e parë të fillimit të vitit akademik, ata e marrin lehtë lëndën e gjuhës angleze, duke menduar se kanë njohuri të mjaftueshme nga shkolla e mesme për t’u zotëruar gjuhësi dhe një tjetër faktor, është fakti se ata kanë ardhur për t’u bërë inxhinierë dhe kështu që nuk i japin rëndësinë e duhur lëndës së gjuhës së huaj. Por me kalimin e javëve ata përfshihen gjithnjë e më tepër në mësimin e termave teknik, në përvetësimin e fjalorit, analizën e tekstit, etj. Studentët fillojnë e përballen edhe me vështirësi të cilat nuk i kishin meduar dhe kjo gjë i bën ata që t’u pëlqejnë e të tërhiqen më tepër nga mësimi i gjuhës angleze të profesionit. Dua të theksoj këtu faktin se studentët tanë të inxhinierive janë studentë të cilëve ju pëlqejnë sfidat, të ecin me hapin e kohës, të kërkojnë shumë nga vetja dhe nga pedagogu i lëndës dhe kjo gjë na vë edhe neve si pedagogë përpara përgjegjësi të mëdha.

3.2.Ndryshimet e silabuseve ndër vite në FTI, UPT

Tani le të shtjellojmë disa arsye se si një silabus i cili mbulon nevojat e kësaj kategorie, ndyshon me qëllimet që ka silabusi i gjuhës angleze të përgjithshme. Krahasimet bëhen mbi bazën e silabuseve të vjetra që kanë qenë në përdorim nga vitet 90’ e deri në vitin 2007 ku më pas u zëvendësuan nga silabuse të ESP-së.

Para viteve 90’, përkatësisht vitet 80’- 90’, planet mësimore të cilat aplikoheshin në Fakultetet e UPT-ës, bazoheshin mbi metodat tradicionale, si p.sh., (translation methods), metodat e leximit dhe të përkthimit të teksteve letrare, (grammar in focus), fokusi gramatikor, ku çdo mësim kishte gramatikën përkatëse e cila vështirësohej hap pas hapi në bazë të niveleve të caktuara, metoda strukturaliste, si (verb-patterns), word-building,

⁹⁶Falvey, P. (1979) “Current Trends in English for Special Purposes (A Survey)” IDELTI Journal No. 13. A Publication of IDELTI in Iraq, fq.19

⁹⁷Bates, M. (1978) “Writing, ‘Nucleus’” in Mackay, R. & Mountford, A. (eds): English for specific Purposes, London: Longman.fq.

format foljore, (idioms), shprehjet idiomatike, etj., sipas Horby-t apo teksteve të asaj kohe në përdorim që ishin metodat “Essential English1, 2, 3”, etj⁹⁸..

Në shtojcën 3 paraqitet një program mësimor i cili i përket viteve 80’-90’ të aplikuar në fakultetet e UPT-së:

Ai ishte një plan mësimor autentik i cili vihej në zbatim në të gjitha fakultetet e UPT-së para viteve 90’. Nëse i bëjmë një analizë këtij plani, do të shohim se tekstet të cilat aplikoheshin në atë kohë ishin metodat “Essential English”, të cilat ishin shumë popullore gjatë asaj periudhe. Fokusi ishte më tepër në tekste të cilat përbëheshin nga një gjuhë e komunikimit të përditshëm, bashkëbisedime, tregime ngjarjesh apo shprehish të gjuhës letrare. Në atë plan mësimor një vëmendje e mirë i kushtohej gramatikës, e cila zinte një vend të konsiderueshëm të orës së mësimimit, ku më pas shoqërohej edhe me ushtrime rreth saj. Klasa ndahej me nivele ku studentët testoheshin në fillim të vitit akademik dhe më poshtë po rendisim rezultatet që priteshin nga çdo nivel:

3.2.1. Çfarë pritej nga studentët e nivelit fillestar?

Në këtë nivel mendohej se studentët kishin mundësi të pakta të të kuptuarit, apo nuk kishin fare mundësi; ata mund të shprehnin fjalë, të lexonin apo të shkruanin fjalë apo fjali të shkurtra duke dhënë informacion mbi veten apo persona të familjes. Edhe pritshmëritë nga ana gramatikore ishin të një niveli të dobët. Në mënyrë që të shmangej motivimi i studentëve në përpjekje për të komunikuar, sugjerohej që korrigjimi i gramatikës të mos bëhej në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të hapur në momentin që ata e shpreheshin në gjuhën e folur. Tekstet për lexim duhet të ishin shumë të thjeshta.

Gjuha e folur: fokusi ishte në komunikimin autentik dhe të vërtetë. Nëpërmjet një varieteti aktivitetesh në gjuhën e folur, studenti duhej të merrte pjesë dhe të kuptonte bashkëbisedimet bazë rreth temave të përditshme, të tilla si: Informacion personal dhe rreth familjes; Preferencat; Qëllimet që kishin për të ardhmen; si dhe të shprehte mendimet e tija; të merrte pjesë në biseda që bëheshin rreth një teksti të lexuar më parë; të pyeste dhe tu përgjigjej pyetjeve të thjeshta; të jepte dhe të kuptonte informacionin e marrë; të merrte pjesë në biseda të thjeshta; të zgjidhte probleme dhe të plotësonte detyrat që i jepeshin duke punuar në grup apo në palë.

Leximi dhe shkrimi

Studentët duhet të lexonin pasazhe të shkurtra dhe të thjeshta të cilat i çonin edhe në diskutime të hapura. Ata duhet shkruanin fjali në nivel paragrafi rreth pasazheve që lexonin. Kjo përfshinte reagimin që ata kishin pasi kishin lexuar një pasazh si dhe përmbajtjen dhe përmbledhjen e asaj që kishin lexuar.

Format gramatikore të sugjeruara ishin: Pjesët e ligjëratës, Emrat dhe përemrat vetorë; Mbiemrat; posesivë dhe përshkrues; Foljet; prezantimi me foljet e rregullta dhe të çrregullta, veçanërisht *be* dhe *have*; Parafjalët e vendndodhjes: *in, on, over, under* etj.

⁹⁸Planet dhe dokumentat janë siguruar nga arkivi i DGJH në QGJH në UPT

Ndajfoljet e vendit në fjali, ndajfoljet e kohës: p.sh. *never, sometimes, always*; Present Participle; Lidhëzat: *and, but*; Kohët e foljeve; dëftore, mohore, pyetëse, urdhërore; Koha e tashme: foljet e rregullta dhe foljet e çrregullta; Koha e tashme në vazhdim; ndryshimi ndërmjet kohës së tashme të thjeshtë dhe të tashmes në vazhdim; Koha e shkuar e thjeshtë; Koha e ardhme: *will* dhe *going to*; Foljet modale, foljet ndihmëse; Të shprehësh aftësi: *can, could*; Të shprehësh nevojë: *have to/had to, must, need to*; Të kërkosh leje: *can, could, may*.

3.2.2. Çfarë pritej nga studentët e nivelit mesatar të ulët?

Në këtë nivel, aftësia e studentëve ishte që të përfitonin një fjalor të kufizuar por që vinte duke u rritur. Shkrimi dhe gjuha e folur kishin tendencë për të qenë në një nivel të ulët, duke i bërë studentët që të ndalonin herë pas here dhe të mendoheshin për tu shprehur. Studentët e kishin më të lehtë të kuptonin, diskutonin dhe të shkruanin rreth temave familjare. Ata mund të përshkruanin njerëz, vende dhe objekte si dhe të bënin një referim në kohën e tashme, por shpesh herë kishin mangësi të fjalorit të duhur. Leximi gjithashtu përmbante shumë fjalë të reja. Studentët në këtë nivel kishin aftësinë të shkruanin fjali të shkurtra deri në nivel paragrafi.

Gramatika në atë nivel fokusohej në:

Pjesët e Ligjëratës; Emrat: të numërueshëm, të pa numërueshëm; Mbiemrat; krahasorë dhe sipërorë; Ndajfoljet; *yet, still*, vendndodhja e tyre në fjali; Foljet: vijueshmëria e kohëve të dhëna dhe përsëritja e foljeve të çrregullta; Lidhëzat : *because, so, or, when*; Format foljore: dëftorë, mohore, pyetëse; Koha e shkuar dhe koha e ardhme duke përdorur *for* dhe *since*; ndryshimi ndërmjet kohës së tashme të thjeshtë dhe kohës së kryer; Koha e shkuar: *used to+ infinitive*; Foljet ndihmëse: dëftore dhe mohore; Të shprehurit mbi mundësi: *can, could, might, may, should, must*; Si të jepje këshilla: *should, ought to, had beter, must, have got to*

Fokusi në gjuhë e folur është në komunikimin e vërtetë, autentik.

Nëpërmjet një sërë temash të hapura, studenti duhej të kuptonte dhe të merrte pjesë në dialogë dhe biseda rreth çështjeve me tema familjare, apo të bënte dhe të tu përgjigjej pyetjeve që kishin për bazë informacion personal, mendime, sjellje, preferenca si dhe plane për të ardhmen, si dhe të zgjidhte probleme dhe të plotësonte detyrat e dhëna në grup apo në palë.

Leximi dhe shkrimi

Studentët duhej të lexonin dhe më pas diskutonin mbi pasazhe në gjuhën angleze të thjeshtë. Ata jepnin përgjigje me shkrim për paragrafët e lexuara në nivel eseje të shkurtër. Kjo përfshinte edhe një përmbledhje të asaj që ata kishin lexuar. Studentët praktikonin shkrimin përshkrues dhe tregues.

3.2.3. Çfarë pritej nga niveli i lartë mesatar i studentëve?

Studentët në këtë nivel kishin më lehtësi në të shprehur dhe në të shkruar kur tema që po trajtohej ishte e njohur për ta, por shpesh kishin mangësi fjalori në momentin që haseshin me një temë të re. Gramatika e përdorur saktë vinte në mënyrë automatike, megjithëse përsëri konstatoheshin gabime të përsëritura. Studentit i duhej dhënë kohë për tu menduar dhe ata mund të diskutonin rreth ideve abstrakte si dhe të jepnin argumente në mënyrë që të mbronin atë që ishin duke shprehur. Edhe megjithëse ata nuk kishin praktikuar pjesën më të madhe të shprehjeve idiomatike, ata kishin aftësinë për të lexuar tekste më të gjatë, më të vështirë, duke përfshirë edhe disa versione origjinale të gjuhës angleze, si dhe mund të shkruanin deri në një faqe.

Format gramatikore të sugjeruara në këtë nivel ishin:

Pjesët e ligjëratës; Foljet: që tregonin shkak. P.sh: *He made/had/let them do it*; Foljet me-*ing* të përdorura si kryefjala e një fjalie, p.sh. *Walking is good exercise*; Foljet e shoqëruara nga infinitivi, p.sh. *I intend to go*; Pjesorja e tashme: e përdorur si mbiemër, p.sh. *a confusing problem*; Përcjellorja: e përdorur si emër, p.sh. *he enjoys watching TV*; Përdorimi i *go*, p.sh. *go swimming*; Përdorimi i *who, whom, which, that, where, when, whose*; Format foljore; Koha mëse e kryer (past – in – the – past); Koha e kryer në vazhdim, p.sh *He has been studying English*; Koha mëse e kryer në vazhdim, p.sh *He had been studying English*; Forma jo veprare dhe përdorimi i saj; Foljet ndihmëse dhe Shprehje të njëjta; si të shprehnin shkallën e sigurisë, p.sh. *He is sick/he may be sick/He must be sick*; si të bënin sugjerime, p.sh *Let's/Why don't we/we could used to (habitual past) vs be used to*; përdorimin e shprehjeve idiomatike dhe foljet e shoqëruara nga parafjalët; p.sh *by word of morth, keyed up, wait for, wait up, wait around*.

Fokusi në gjuhën e folur ishte në bashkëbisedimin autentik

Gjuha e folur, leximi dhe shkrimi përfshiheshin më tepër në këtë nivel, ku secila përkrahte dhe pasuronte tjetrën nëpërmjet një larmie temash të hapura që organizoheshin në grupe dhe në palë mes studentëve. Ata duhet të zgjidhnin probleme, të plotësonin detyrat e ngarkuara dhe të paraqisnin rezultatet. Duhej të analizonin dhe të përmbledhnin informacionin; të organizonin hapat në një proces; të aktivizoheshin në biseda që kishin të bënin me tema komplekse dhe ide abstrakte; të merrnin pjesë në bisedat që bëheshin rreth një teksti të lexuar; të intervistonin dhe të intervistoheshin; të bënin relacione të shkurtra përmbledhëse.

Leximi dhe shkrimi kërkonte që studentët të lexonin, diskutonin dhe shkruanin ngjarje në variant autentik. Në këtë fazë prezantoheshin edhe materialet me tema teknike. Studentët duhej të ishin të aftë të shkruanin deri në një faqe si dhe të merrnin shënime dhe të nënvizonin temat e trajtuara.

3.2.4. Çfarë pritet nga studentët e nivelit të avancuar?

Studentët e këtij niveli mund të konsideroheshin më një gjuhë të folur të rrjedhshme në gjuhën Angleze dhe të ishin aftësinë e të kuptuarit, të dëgjimit, dhe të shkrimit në nivelin e një anglisht folësi. Duke marrë këtë parasysh, mënyra e të shprehurit dhe e organizimit të ideve, opinionet dhe informacionet duhet të ishin koherente. Shkrimi konsiderohej si sfida më e fortë për studentët e këtij niveli dhe në këtë mënyrë i duhej dhënë më tepër hapësirë. Edhe megjithëse studentët e këtij niveli kishin një fjalor të pasur dhe të gjerë, prezantimi me tema të reja të çonte në nevojën për të mësuar fjalë të reja. Ata vazhdonin të perfeksiononin shprehjet idiomatike në gjuhën angleze si dhe përsosin përdorimin gramatikor. Studentët e avancuar ishin të aftë të lexonin tekste në gjuhën Angleze origjinale.

Pjesët e Ligjëratës të përfshira në planet e këtij niveli ishin: klauzolat mbiemërore: ku studentët kthenin pjesë të nënrenditura të fjalisë në fraza të tilla si, p.sh. *The boy who is sitting next to me - The boy sitting next to me*; emrat: emrat e çrregullt, p.sh: *herres, calves, sheep*; shprehjet emërore që përdorin *whether* ose *if*, p.sh: *I wonder whether/if he needs help*; kohët e foljeve- Future Progressive, p.sh.: *I will be studying*; Future Perfect Progressive, p.sh.: *I will have been studying*; Future Perfect, p.sh.: *I will have studied*; foljet ndihmëse si dhe shprehje të njëjta; si të kërkosh leje, p.sh.: *Would you mind if I smoke? Can I smoke?*; pritet: *be suppose to vs should*; si të shprehje që shprehin përsëritje të veprimeve në kohën e shkuar: *used to, would*; shprehjet idiomatike të shoqëruara nga parafjalë; duke treguar marrëdhënien midis ideve; Strukturat paralele; Çifte kushtesh: *both...and, not only...but also, either...or, neither...nor*; Marrëdhëniet shkak pasojë; *because, due to, therefore, consequently, such...that, so...that*; Si të shprehnin një kusht; *only if, provided that, in the event that, even if, whether or not*.

Gjuha e folur, leximi dhe shkrimi

Në nivelin e avancuar, bisedimi me gojë, gjuha e shkruar dhe ajo e folur integroheshin së bashku. Leximi: teksti në përgjithësi është origjinal. Mund të lexohen edhe disa materiale teknike, të tilla si revista me terma teknikë. Në mënyrën e të shkruarit studentët duhej të përqendroheshin në aftësitë organizative si: organizimi dhe informacioni rreth ideve; identifikimi dhe shkrimi rreth një audience specifike dhe me qëllime të sakta; të shprehnin deklaratatë të qarta; të ndërtonin dhe shkruanin ese me paragraf. Në këtë fazë studentët ishin të aftë të shkruanin për një temë dhe audiencë të caktuar tregime, ese, relacione, abstrakte, artikuj teknikë, letra, përmbledhje dhe analiza tekstesh të lexuara.

Megjithëse fokusi i udhëzimeve mbetet ai i gjuhës Angleze të përgjithshme, studentët në këtë nivel fillonin të zhvillonin aftësitë e tyre mbi fjalorin teknik.

Nëse do të shohim me kujdes këtë plan, vejmë re se përmendet edhe puna e bërë me tekste të specialitetit, që normalisht janë termat inxhinierikë, por mënyra se si punohej me këto terma është e pa qartë. Në rast se studentët kishin si metodë bazë “Essential English”, atëherë ata do e kishin të vështirë kalimin në trajtimin dhe analizimin e teksteve të specialitetit për arsye se në planin mësimor (të cituar më lart), ato nuk shtriheshin gjatë vitit akademik, por merreshin, apo gjendeshin nga vetë studentët si materiale plotësuese.

3.3. Analiza e planeve në vite

Po ti referohemi viteve 80-90, duhet të marrim parasysh faktin se, sa e vështirë ka qenë për një student të gjente informacion mbi gjuhën e huaj të specialitetit, duke menduar se në atë kohë, Shqipëria ka qenë një vend i izoluar nga bota dhe gjetja e këtyre materialeve ka qenë tepër e vështirë. Për rrjedhojë, edhe marrja dhe përpunimi i teksteve nga ana e studentëve ka qenë e një niveli tepër të ulët, ku dhe rezultatet nuk kanë qenë të kënaqshme.

Po të vejmë re, edhe ndarja e orëve në planin mësimor është fokusuar më tepër në orë leximi dhe njohurish gramatikore, sesa në diçka që ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me nevojat e studentit, që janë termat e gjuhës së specialitetit.

Ndërsa plani mësimor që i përket viteve 90', kur Shqipëria filloi të hapej me botën dhe gjuha e huaj u fut në mënyrë masive që në shkollat 8-vjeçare, pati një zhvillim të gjerë dhe u përfaqëua nga popullsia shqip-folëse. Gjuha e huaj shtrihej dy vitet e para të një viti 5-vjeçar akademik dhe studentët i nënshtroheshim një "Placement test", test i cili bënte ndarjen në nivele të studentëve, duke nisur me nivelin "Beginner", "Fillestar", dhe përfundonte me nivelin "Advanced", "I avancuar". Planet e hartuara në atë kohë (shiko Shtojcën 4).

Po ti bëjmë një analizë planit mësimor pas viteve 90', do të shohim se ka një ndarje të planeve sipas nivelit të studentëve. Studentët testoheshin javën e parë të semestrit të parë dhe vijonin mësimin në nivelet përkatëse. Kjo gjë nuk ndodh më në planet që ne do paraqesim më vonë gjatë punimit, për arsye se në vitet 2000 nuk pati më ndarje në nivele të studentëve që hynin në fakultetet e UPT-së për faktin se gjuha e huaj hyri fuqishëm në gjimnazet e vendit tonë dhe ajo tashmë është vënë me detyrim dhe testohet në provimet e maturës. Për rrjedhojë, supozohet që studentët të hyjnë në shkollë të lartë me një bagazh të konsiderueshëm në gjuhën e huaj dhe të jenë mbi nivelin mesatar, (B2).

Tjetër aspekt që vihet re është fakti që materialet e gjuhës së specialitetit, zinin një hapësirë tepër të vogël në planet mësimore të atyre viteve, për të mos thënë që deri në nivelin mesatar ato nuk përfshiheshin fare në plane. Kjo për arsye se studentët me një nivel tepër të ulët në gjuhë të huaj, e kishin shumë të vështirë të përballeshin me tekste të këtij zhanri, pasi ata nuk kishin njohuritë bazë të gjuhës së huaj dhe jo të mendohej që ata të merreshin me gjuhën e specialitetit. Thënë kjo, këto materiale prezantoheshin në nivelet mesatare të larta dhe niveli i avancuar, ku studentët të mund të trajtonin një tekst të gjuhës së profesionit.

Pas viteve 2000, me ndryshimet që ndodhën në sistemin arsimor, ku gjuha e huaj filloi të mësohej që në klasat e para fillore dhe kur Ministria e Arsimit, Kulturës dhe Shkencës e zyrtarizoi gjuhën angleze, si gjuhën e dytë në vendin tonë, atëherë pati edhe një revolucion në hartimin e planeve të reja në qenderën e Gjuhëve të Huaja në UPT, ku tashmë thelbi i këtyre planeve ishte gjuha e huaj e specialitetit. Për këtë arsye u përzgjedh teksti "Technology1,2", i cili kishte në fokusin e tij materiale në gjuhën e shkencës dhe teknologjisë, gramatikë (e cila ishte e limituar), kjo për arsye se mendohej që studentët ta kishin mbaruar anën gramatikore që në shkollë të mesme dhe fjalor me bazë terma teknik. Planet mësimore pas viteve 2000 deri në vitin 2013 gjenden në Shtojcën 5.

Në hartimin e planeve mësimore në këto vite shohim ndryshime rrënjësore që përfshijnë këto programe që nga shtrirja në kohë e lëndës së gjuhës së huaj e cila u përqendrua semestrin e parë të vitit të parë akademik dhe për disa degë siç është edhe dega e Inxhinierisë Elektronike pati shtrirje me dy kredite edhe semestrin e parë të vitit të dytë. Pati një ndarje jo të drejtë dhe të njëtrajtshme të orëve e krediteve në fakultete të ndryshme të UPT-së gjë e cila çoi në një çorientim të shpërndarjes së orëve mësimore dhe zbatimit të plan programeve nëpër fakultete. Duhet të theksoj këtu faktin që planet mësimore të cilat janë në përdorim dhe aplikohen në fakultetet e UPT-së janë të njëjta për të gjitha fakultetet. Ndryshime shohim edhe në përbërjen e planeve, objektivave, pritshmërive, njohurive dhe aftësive që përftohen nga përvetësimi i lëndës, ndarja e krediteve në orë seminari dhe laborator, tipologjia e lëndës e cila i dedikohet tërësisht gjuhës së specialitetit. Lënda është e tipit të formimit bazë me tema të cilat përfshijnë komunikimin në të gjitha fushat e inxhinierive dhe se çfarë nevojitet të dish për një karrierë në teknologji. Ajo përfshin situata të ndryshme ku nevojitet përdorimi i termave të caktuara teknike, tekste të specialitetit, gramatikë që vjen në ndihmë për një të shprehur më korrekte, ushtrime të cilat zhvillohen me anë të dëgjimit dhe më pas bëhet riprodhimi, si dhe me projekte të cilat vihen në zbatim dhe praktikë nga vete studentët.

Njohuritë paraprake

Studenti duhet të ketë fituar njohuritë bazë në: kuptimin e përpunimin e informacionit në fushën e tyre përkatëse përmes gjuhës angleze duke bërë dëgjime e video, duke lexuar tekste e materiale, duke shkruar raporte e dokumente shkencore, duke marrë pjesë në diskutime e debate që lidhen me fushën e tyre; duke u mundësuar studentëve dhe diplomantëve studim e formim në universitetet e huaja si dhe pjesëmarrja aktive e dinjitoze në konferenca, seminare, etj, duke paraqitur edhe punimet e tyre në gjuhën angleze. Ti krijojnë mundësi reale për të marrë pjesë aktivisht në situata e aktivitete komunikimi. Qëllimi i lëndës është që të përforcojë dhe thellojë njohuritë në gjuhën e përgjithshme nëpërmjet përdorimit të tyre në fushën profesionale përmes kontrollit të njohurive me formate pyetëse si provime, teste apo shlyerje detyrash sipas fushave përkatëse inxhinierike në gjuhën angleze. Studentët duhet të njihen e prezantohen me terma e fjalorë të specialitetit gjatë zhvillimit të seancave mësimore. Ata duhet të aftësohen në komunikimin profesional në gjuhën angleze me gojë dhe me shkrim duke praktikuar situata pune reale, projekte, përkthime, kumtesa shkencore, interpretime etj. Studentët duhet ta ushtrojnë përdorimin e gjuhës si burim informacioni në fushën profesionale si dhe të japin gjithashtu edhe disa elemente kulturorë të përgjithshëm që ndikojnë në formimin e tyre të përgjithshëm kulturor.

Me fitimin e krediteve në semestrin e parë në vitin e parë, në 14 javë mësimore studenti duhet të jetë i aftë të komunikojë pa vështirësi në gjuhë të huaj, dhe në gjuhën teknike; të jetë i aftë të lexojë dhe përkthejë një tekst në gjuhën e specialitetit; të jetë i aftë të riprodhojë një pjesë që e ka dëgjuar apo lexuar; të jetë i aftë të shkruajë një ese, raport, letër formale/joformale; të dijë rregullat bazë dhe përdorimin e kohëve në gramatikë; të zbatojë saktë rregullat drejtshkrimorë dhe shqiptimin e fjalëve.

Kjo që paraqitëm më sipër, ishte plani mësimor për vitet e para të cilat studionin në Fakultetin e Teknologjisë dhe Informacionit në UPT. Lënda kishte 5 kredite, nga ku tre ishin orë seminare dhe dy orë punë laborator. Ajo shtrihej në 14 javë mësimore në vitin e

parë, semestrin e parë. Lënda e gjuhës angleze në këtë fakultet shtrihej edhe në semestrin e parë të vitit të dytë. Lënda ishte e tipit të formimit bazë së gjuhës së teknologjisë dhe informacionit, me tema të cilat përfshinin komunikimin në të gjitha fushat e inxhinierive dhe se çfarë u nevojitej studentëve të dinin për një karrierë në teknologji. Ajo përfshinte situata të ndryshme ku nevojitej përdorimi i termave të caktuara teknike, teksteve të specialitetit, gramatikë që vinte në ndihmë për një të shprehur më korrekte, ushtrime të cilat zhvilloheshin me anë të dëgjimit dhe më pas bëhej riprodhimi, si dhe me projekte të cilat viheshin në zbatim dhe praktikë nga vetë studentët.

Lënda kishte për qëllim të përforconte dhe thellonte njohuritë në gjuhën e përgjithshme nëpërmjet përdorimit të tyre në fushën profesionale përmes kontrollit të njohurive me formate pyetëse si provime, teste apo shlyerje detyrash sipas fushave përkatëse inxhinierike në gjuhën angleze. Studentët njiheshin e prezantoheshin me terma e fjalorë të specialitetit gjatë zhvillimit të seancave mësimore. Kjo i aftësonte studentët në komunikimin profesional në gjuhën angleze me gojë dhe me shkrim duke praktikuar situata pune reale, projekte, përkthime, kumtesa shkencore, interpretime etj. Ata ushtronin përdorimin e gjuhës si burim informacioni në fushën profesionale duke dhënë gjithashtu edhe disa elemente kulturorë të përgjithshëm që ndikonin në formimin e tyre të përgjithshëm kulturor.

Vlerësimi i studentëve bëhej në bazë të frekuentimit, i cili duhej të ishte në masën 75%, pjesëmarrjes, aktivizimit përgjigjes në seminare dhe laboratorë, plotësimin të detyrave të ngarkuara në klasë dhe në shtëpi, krijimin e një eseje të cilën studentët e bënin në javën e gjashtë të semestrit si dhe testit final e dorëzimit të detyrës së kursit. Në fund të semestrit ata testohen në një provim me shkrim dhe një detyrë kursi të cilën e prezantojnë dhe me gojë.

Në vitin akademik 2013-2014, QGjH, hartoi plane të reja të gjuhës angleze, sepse ndryshoi edhe metodën e vënë në përdorim. Gjuha e huaj, në vitin akademik 2014-2015, u hoq nga vitet e dyta të Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit ku shtrihej gjatë semestrit të parë dhe kishte dy kredite. Duke filluar nga viti akademik 2013-2014 e në vazhdim studentët kanë punuar me metodën “Engineering”, e cila është një metodë bashkëkohore nga Express Publishing e autorëve Charles Lloyd dhe James A. Fraizer dhe solli një mënyrë ndryshe të trajtimit të gjuhës së huaj.

Kjo metodë është e hartuar në tre faza, përkatësisht të niveleve A2, B1, B2, me nga 15 mësimet secila dhe të gjitha mësimet i referohen vetëm gjuhës së inxhinierisë. Ajo ka në qendër studentin dhe nevojat e tij në gjuhën e profesionit. Përqendrimi është tek tekstet e leximit me tema inxhinierike, trajtimi me pyetje dhe analizimi i tekstit, fjalori teknik i dhënë në variante të ndryshme me ushtrime plotësuese, si edhe ushtrimet me dëgjim të cilat janë shumë të rëndësishme për studentët të cilët mësojnë një gjuhë të huaj. Objektivat që kërkohen të realizohen nga kjo metodë janë: Të përforcojë dhe thellojë njohuritë në gjuhën e përgjithshme nëpërmjet përdorimit të tyre në fushën profesionale përmes kontrollit të njohurive sipas fushave përkatëse inxhinierike në gjuhën angleze; të njihet terminologjia me fjalorë të specialitetit; të aftësojë studentët në komunikimin profesional në gjuhën angleze me gojë dhe me shkrim duke praktikuar situata pune reale, projekte, përkthime, kumtesa shkencore, interpretime, etj., si dhe të ushtrojë studentët për përdorimin e gjuhës si burim informacioni në fushën profesionale duke dhënë edhe elemente kulturorë të përgjithshëm. Lënda zhvillohet në semestrin e parë, në vitin e parë, në

14 javë. Me fitimin e krediteve të saj studenti duhet të jetë i aftë: të komunikojë pa vështirësi në gjuhë të huaj (anglisht), si dhe në gjuhën teknike; të jetë i aftë të lexojë dhe përkthejë një tekst në gjuhën e specialitetit; të jetë i aftë të riprodhojë një pjesë që e ka dëgjuar apo lexuar.

Engineering është një burim i ri edukativ për inxhinierët e ardhshëm të cilët duan të përmirësojnë aftësitë e tyre në gjuhën e folur dhe atë të shkruar në gjuhën e huaj (angleze) të profesionit. Kjo metodë ka një ndërthurje të fjalorit të gjuhës teknike dhe atë të profesionit, si dhe kontekste të cilat janë parë me kujdes nga lider në industrinë e inxhinierisë, ku çdo unit ofron hap pas hapi udhëzime të cilat i aftësojnë studentët në të katër faktorët kyç të gjuhës të cilat janë: leximi, dëgjimi, e folura dhe shkrimi. Career Paths: Engineering, adreson tema të cilat përfshijnë veglat, materialet, shifrat, konceptet inxhinierike, konvertimet e matjeve si dhe opsione të karrierës.

Kjo metodë është e organizuar në tre nivele vështirësie dhe ofron një fjalor të pasur me 400 terma fjalori dhe fraza. Çdo mësim përfshin një testim mbi leximin e teksteve, fjalor, si dhe aftësitë e të dëgjuarit çka i çon studentët drejt një riprodhimi në gjuhën e folur dhe atë të shkruar.

Libri është i shoqëruar nga libri i mësuesit edhe CD.

Librat 1-3 të Career Paths: Engineering, janë cilësuar sipas Kornizës Evropiane të Referencave për Gjuhët në nivelet A2, B1 dhe B2.

Ajo se çfarë gjejmë ndryshe në këto plane dhe metoda të rinovuar është fakti se ato janë më bashkëkohore, plotësojnë nevojat e studentit dhe janë më të pasura me fjalorin teknik të gjuhës inxhinierike. Planet mësimore janë hartuar në mënyrë bashkëkohore dhe sipas standardeve të caktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Këtu gjejmë ndryshime në përpilimin e programit mësimor i cili konsiston që në nivelet mësimore të ofruara, ashtu edhe në mënyrën e vlerësimit të studentëve. Studenti vlerësohet me 60% të notës mbi njohuritë e marra dhe të testuar në testin përfundimtar, 20% e pikëve i jepet detyrës së kursit dhe 20% e pikëve i jepet nga pjesëmarrja, aktivizimi në seminare dhe frekuentimi.

Pra, po të krahasohet me planin e mëparshëm, mënyra e përqindjes në vlerësim është menduar të ndryshohet. Në vitin akademik 2014-2015, i është dhënë më prioritet në përqindje aktivizimit në seminare duke marrë parasysh faktin se pjesa më e madhe e orëve në orën e gjuhës angleze janë seminare dhe studentët kanë mundësi të vlerësohen shumë shpesh. Këto pikë, më pas, i bashkëngjiten vlerësimit përfundimtar, nga ku 60 pikë i ka testi përfundimtar, 20 pikë gjatë përgatitjes vjetore, seminare, detyra, frekuentim e aktivizim si dhe 20 pikët e detyrës së kursit.

Sigurisht që duke bërë krahasimin me planet e viteve 80', 90' e 00', shohim një zhvillim të larmishëm të planeve mësimore, të cilat gjithmonë e më shumë i përshtaten zhvillimeve në kohë, teknologji dhe i përputhen nevojave të studentit.

3.4.Ndryshimet ndërmjet metodave GE dhe ESP

Qëllimi kryesor dhe i rëndësishëm i një kursi ESP është që studentët të pajisen me teknikat gjuhësore të cilat i nevojiten për të përmbushur studimet shkencore, apo të familjarizohen më termat teknik të sferës së tyre të profesionit. Thënë kjo, Widdowson⁹⁹ thotë: “ESPMund të jetë tepër e përqendruar tek aftësia për të zhvilluar komunikim shkencor dhe teknik”. Nga ana tjetër, një kurs GE ka objektiva më të zgjeruara dhe të përgjithshme; i referohet gjuhës angleze si “një gjë e mirë për t’u mësuar si pjesë e një edukimi të gjerë¹⁰⁰. Në një kurs ESP-je objektivat përqendrohen në shërbim të nevojave të menjëhershme dhe dobishme të studentëve.

Qëllimet e domosdoshme të kursit të GE, përcaktohen nga brenda, duke iu referuar kërkesave të pranimit, pavarësisht nga fakti nëse ekzaminime të tilla reflektojnë ose jo përdorimet e gjuhës angleze që studentët vërtetë kërkojnë në karrierën e tyre; ndërsa në një kurs ESP, qëllimet janë të përcaktuara nga jashtë nga referencat për qëllime të veçanta¹⁰¹.

Për këtë qëllim, plani mësimor i gjuhës angleze për qëllime të veçanta duhet të sigurojë studentët me gjuhën të cilën ata mund ta vënë për përdorime praktikë të menjëhershme. Meqenëse studentët kanë nevojë që ta shfrytëzojnë gjuhën angleze në komunikim e në situata të vërteta të jetës, atëherë nevoja që t’u mësohet gjuha e përdorur dhe jo përdorimi i gjuhës, është i domosdoshëm. Pra, një shqetësim me ESP përfshin një shqetësim me aftësinë komunikuese dhe përdorimin e jo kompetencës gjuhësore. Në këtë pikë, është e rëndësishme të theksojmë se materiali gjuhësor mësimor që përdor konceptin e kompetencës komunikuese, “përqendrohet në qëllimin për të cilën gjuha është vënë në përdorim”¹⁰².

Ndryshimet që qëndrojnë në qëllimet e përcaktuara ndërmjet një kursi ESP dhe GE, pa dyshim që rezultojnë me ndryshime të theksuara në lidhje me aftësitë mbi leximin, shkrimin, gjuhën e folur dhe dëgjimin. Meqenëse ESP përfshin krijimin e një programi për studentë të veçantë dhe me nevoja të veçanta komunikuese atëherë ato mund të kryhen jo vetëm përmes aftësive të dëgjimit dhe gjuhës së folur por edhe në të gjitha aftësitë e përmendura më sipër. Kursi i ESP bën të mundur që këto aftësi të mësohen në nivel komunikimi dhe jo “në një (fjali) segmentale apo niveli sintaktik “si në rastin e kursit GE¹⁰³. Kursi ESP-së duhet të jetë i fokusuar në mësimdhënien e mikro-aftësive ose nën-aftësive dhe jo me mësimin e makro-aftësive si në rastin e kursit GE. Këto mikro-aftësi janë nxjerrë nga makro-aftësitë dhe specifikohen nga një analizë e nevojave komunikuese të studentëve¹⁰⁴; për shembull, një inxhinieri nuk do i duhet të shkruajë një hartim, por ai mund të ketë nevojë që të mësojë mënyrën se si të shkruajë një përmbledhje të mirë të projektit të tij në gjuhën angleze; një polic mund të ketë nevojë që të shkruajë një raport

⁹⁹Widdowson, H. G. (1979) *Exploration in Applied Linguistics*. Oxford: OUP.fq.40

¹⁰⁰ Bates, M. (1978) “Writing, ‘Nucleus’” in Mackay, R. & Mountford, A. (eds): *English for specific Purposes*, London: Longman.fq.2

¹⁰¹ (Po aty, fq.37)

¹⁰² (National Extension College Trust Ltd., 1994).

¹⁰³ Falvey, P. (1979) “Current Trends in English for Special Purposes (A Survey)” *IDELTI Journal* No. 13. A Publication of IDELTI in Iraq. Fq.37

¹⁰⁴ (Po aty, fq.39)

mbi trafikun dhe kështu me rradhë¹⁰⁵. Gjithësesi, edhe pse shumë nën-aftësi mbivendosen dhe të gjithë janë pjesë e aftësive makro, 'ato janë aftësi të dallueshme dhe duhet të shihen si të tilla'¹⁰⁶.

Por, ashtu siç gjetëm ndryshime tek aftësitë, mund të themi se ndryshime gjejmë edhe tek gramatika dhe fjalori. Kursi ESP-së duhet të përfshijë në silabusin e tij në gjuhën angleze shkencore dhe përdorimin e ndërtimit të disa strukturave të caktuara të gjuhës (të tilla si forma jo veprorë, koha e shkuar e thjeshtë, koha e tashme, kushtore, urdhëroret, pjesorja e tashme (-ing), si dhe pjesorja e shkuar). Kjo duhet paraqitur në silabus i cili dhe të përqendrohet në këto zona. Por kjo nuk do të thotë që pjesë të tjera të gramatikës duhen neglizhuar. Në fakt puna e Ewer & Latorre¹⁰⁷ na tregon se anglishtja shkencore përdor të gjitha strukturat kryesore, por duke theksuar më tepër ato struktura të cilat janë më të dobishme për studentët të cilët studiojnë profile shkencore duke bërë që studentët të jenë më të vëmendshëm dhe të përqendruar në to.

Gjithashtu, kur ri-ndërtuam planet e reja patëm si synim që në fushën e fjalorit të vinim në pah natyrën shkencore të materialit me të cilin do të merreshin studentët, ndryshe nga çfarë bënim më parë në një kurs të GE ku pjesën kryesore në hartimin e plan/programave e zinim situata të jetës së përditshme, gramatika dhe ushtrime. Me fjalë të tjera, kur u hartuan planet e reja, një pjesë të madhe zuri përqendrimi fjalori teknik, p.sh, për studentët e degës së inxhinierisë së Teknologjisë dhe Informacionit, rëndësi zuri fjalori përkatës për degët, Elektronikë, Informatikë dhe Telekomunikacion.

Një silabus ESP duhet që në qëllimet e tij të ketë parësore plotësimin e nevojave të studentit. Kështu që, bazuar në kërkesat e menjëhershme, konkrete të natyrës praktike dhe instrumentale të studentëve, një silabus ESP përfshin një qasje komunikuese. Për ta vërtetuar këtë pikëpamje le të citojmë Widdowson¹⁰⁸:

Për sa kohë që shqetësimin ynë është në mësimin e "përgjithshëm" të gjuhës angleze pa ndonjë qëllim të menjëhershëm, pa e ditur në ndonjë mënyrë shumë të caktuar çfarë lloj kërkesash komunikuese do të bëhen nga ajo, atëherë nevoja për ta mësuar gjuhën si mënyrë komunikimi nuk është veçanërisht e dukshme. Pasi ne jemi ballafaquar me problemin e mësimdhënies së gjuhës angleze për qëllime të veçanta atëherë ne jemi menjëherë kundër problemit të komunikimit.

Një kurs GE, deri sa nuk fokusohet në përdorime të veçanta në të cilën do përdorur gjuha, bazohet në mënyrë më strukturore tek përdorimi se sa tek mënyra e përdorur; ndërsa një kurs ESP-je, i cili ka si qëllim ti pajisë studentët me mënyra se si të përdorin gjuhën në situata të veçanta, përqendrohet tek përdorimi; "mësimdhënien se si shkencëtarët dhe teknikët e përdorin sistemin e gjuhës për të komunikuar dhe jo se cilat elemente gjuhësore janë përdorur më tepër"¹⁰⁹. Ashtu si mendon dhe Widdowson, kompetencat komunikuese

¹⁰⁵ (Po aty)

¹⁰⁶ (Po aty)

¹⁰⁷ Ewer, J. R. & (1967) "Preparing an English Course for Students of Latorre, G. Science" ELT 21 /3.fq.224

¹⁰⁸ Widdowson, H. G. (1979) Exploration in Applied Linguistics. Oxford: OUP, fq.12

¹⁰⁹ (Po aty: fq. 12-13)

nuk ndjekin detyrimisht perfeksionimin e përdorimit dhe sistemit të gjuhës. Kështu që “rregullat e përdorimit duhet t’u mësohen studentëve po me aq kujdes si dhe rregullat e gramatikës”¹¹⁰.

Një silabus GE ishte pa shumë përfitim për studentët e degëve të inxhinierisë për deri sa nuk mund të zhvillonte kompetencat komunikuese pa i lidhur ato me situatat komunikuese në të cilat studentët të gjenin veten e tyre.

Studentëve shpesh u kërkohet që të plotësojnë detyra që kanë të bëjnë me përshkrime, klasifikime, ose dhënie marrje udhëzimesh. Kështu që, në mënyrë që të plotësojnë këto kërkesa të studentëve që mësojnë gjuhë teknike, një silabus duhet që të jetë funksional. Në këtë mënyrë, studentëve të inxhinierisë u duhet mësuar gramatika, por jo për vete, por si një mjet i cili do përdoret për të punuar; për të shprehur nocionet dhe funksionet të cilat studentët i marrin si të përshtashme dhe të dobishme të tilla si identifikimi, klasifikimi, krahasimi, vëzhgimi e kështu me rradhë¹¹¹. Kjo qasje shkencore funksionale e gramatikës mund të rrisë motivimin dhe interesin e studentëve për deri sa u tregon atyre se si mund të përdorin njohuritë që kanë mbi gjuhën dhe për ti shërbyer nevojave të tyre shkencore komunikuese; p.sh, forma kushtore mund të përdoret si një mënyrë për të shprehur një hipotezë shkencore;

If the temperature rises more than two degrees the ice will melt.

Nëse temperatura rritet më tepër se dy gradë, akulli do të shkrihet.

Edhe koha e tashme e thjeshtë mund të përdoret si koha e cila shpreh vërtetësinë e një eksperimenti shkencor, p.sh:

Water boils at 100° C,¹¹²

Uji zjen në temperaturën 100 gradë celsius.

Një program mësimor ESP, i cili merret me mësimin e përdorimit komunikues të gjuhës, duhet të adoptojë një qasje mjaft më tolerante ndaj gabimeve të studentëve, se sa një silabus GE. Mendojmë se është thelbësore për mësuesin i cili është i përfshirë në mësimdhënien e gjuhës angleze për qëllime të veçanta që të bëjë kujdes me dallimin ndërmjet gabimeve 'të pranueshme'; p.sh. ata që nuk e dëmtojnë komunikimin, mes shkencëtar dhe shkencëtar, dhe ata që e bëjnë. Në rastin e llojeve të gabimeve të fundit, lind nevoja për një punë riparuese¹¹³.

¹¹⁰ (po aty: fq. 13).

¹¹¹ Garwood, C. H. (1970) “The Teaching, of English to the Non-English Speaking Technical Students. 2. Relating the Structures to the Contexts of Situation” ELT 24/3, fq.246

¹¹² (Po aty: fq. 248)

¹¹³ Ewer, J. R. & (1971) “Further Notes on. Developing an English Programme. Hughes-Davies, G. for Students of Science and Technology” (1). ELT 26/1, fq.68.

Dy karakteristikat më të rëndësishme të cilat karakterizojnë programet e gjuhës angleze për qëllime të veçanta janë përmendur dhe më lart gjatë punimit: të qenit në moshë madhore, si dhe roli i rëndësishëm që i është dhënë gjuhës angleze për të luajtur si një mjet për të çuar më tej arsimin e tyre të specializuar. Por tani le të shikojmë se si një silabus i cili përmbledh nevojat e këtyre studentëve mund të ndikojë në teknikat dhe materialet e mësimdhënies.

Së pari, ngrihet pyetja se cilat tekste duhen përdorur? Por me sa thamë më lart, duket qartë se studentët kërkojnë një tekst i cili përdor fjalorin teknik shkencor dhe që përfshin përbërësit gramatikorë që atyre u nevojiten. Meqenëse kurset e mëparshme të GE " kishin në pjesën më të madhe dërmuese "përmbajtje letrare"¹¹⁴, atëherë, ky lloj i materialit patjetër që ishte i mangët për të përmbushur kërkesat e studentëve të tillë.

Pra, duket e arsyeshme të përdorim materiale shkencore si bazë për mësimin e fjalorit, gramatikës funksionale dhe nuk ka nevojë për të ngarkuar studentët me fjalë në gjuhën e GE. Gjithashtu, është e rëndësishme që përzgjedhja e materialit të jetë ajo e duhura, pra studentët të cilët studiojnë për elektronikë, ti kenë tekstet dhe materialet në përdorim në këtë fushë. Kështu, Niederhauser¹¹⁵ vëren se "duke ndihmuar nxënësit për të lidhur mësimin e gjuhës për qëllimet e tyre personale është një mënyrë e madhe për mësuesit për të filluar adresimin e çështjes që është motivimi i klasës së tyre".

Një tjetër mangësi e materialeve të gjuhës angleze të përgjithshme është se ato përbëhen më së shumti nga lloje materialesh leximi të thjeshtuara dhe shkurtuara. Këtë e kemi vënë re kur bëjmë shpjegimin e një mësimi të ri dhe studentëve i kërkojmë që të krijojnë një ide rreth tekstit që do të lexojnë, duke u nisur nga titulli i materialit. Më pas, ata duhet të bëjnë një skanim të tekstit dhe më pas, pa e lexuar atë, ti drejtohen pyetjeve për të gjetur përgjigjet. Por studentët, e lexojnë një herë tekstin, më pas lexojnë pyetjet e sërish i kthehen pyetjeve për ta lexuar sërish e për të gjetur përgjigjen. Por në këtë rast ne kemi të bëjmë me mangësi që kanë studentët mbi strategjitë e leximit të një teksti.

Do të theksoja këtu se, edhe përzgjedhja e teksteve origjinale do të ishte me shumë vlera për mësimdhënien/mësimnxënien e gjuhës së specialitetit, Pra, rezultati i kësaj mbi mbështetje në gjuhën angleze 'artificiale' është se kur nxënësit ndeshen me artikuj të vërtetë, atëherë përballen vështirësi në kuptimin e materialit¹¹⁶. Prandaj, materiale të cilat janë të destinuara për të përmirësuar nevojat reale komunikuese të nxënësve të tillë duhet të shfrytëzohen për të lexuar tekste origjinale të pandryshuara.

Edhe pse studentët që vijnë të studiojnë në UPT në vitet e para, e kanë bërë gjuhën angleze në shkollë të mesme dhe në universitet vijnë studimet e tyre, por tashmë në një natyrë të profilizuar të gjuhës, sërish nuk ka asnjë garanci që ata ta zotërojnë atë në mënyrë të përsosur, edhe pse "...ata kanë zotëruar "bërthamën e përbashkët" të gjuhës angleze"¹¹⁷. Kështu që është shumë e vështirë për ata që të përfitojnë nga materialet e propozuara të cilat bazohen në gjuhë teknike. Ajo që nevojitet është që materiali ESP i

¹¹⁴ Ewer, J. R. & Latorre (1967) "Preparing an English Course for Students of Latorre, G. Science" ELT 21 /3.fq.228

¹¹⁵ Niederhauser, Janet, S. (1997) "Motivating; Learners at South. Korean Universities". English Teaching Forum, 35/1.fq.9

¹¹⁶ Ewer, J. R. & (1967) "Preparing an English Course for Students of Latorre, G. Science" ELT 21 /3.fq.228


¹¹⁷ Streven, P. (1973) "Technical, Technological and Scientific English" ELT 27/3. fq. 230

këtyre studentëve duhet të paraprihet nga materiali GE në mënyrë që t'u sigurojë atyre "bërthamën e përbashkët-thelbësore"¹¹⁸ të gjuhës angleze si mjet për të punuar me të.

Studentët kanë nevojë për materiale origjinale të cilat janë pa fund, por ata duhet të dinë ti përzgjedhin si në gjuhë të folur edhe në gjuhë të shkruar. Prandaj, ne duhet të kemi parasysh se kur përcaktojmë kriteret mbi përzgjedhjen e materialeve që do vihen në përdorim si dhe më pas me hartimin e plan programeve mësimore, përzgjedhja të jetë me materiale origjinale. Në këtë drejtim, materialet e gjuhës angleze të përgjithshme të cilat zakonisht ndjekin një qasje strukturore, ishin padyshim të pamjaftueshme meqenëse vuanin nga mungesa e teknikave e cila fokusohej në trajnimin e studentit mbi strategjitë e leximit në mënyrë që t'i mësonte ata se si të punonin, apo si ta kuptonin një tekst. Në mbështetje të kësaj pikëpamjeje, Lessard-Clouston¹¹⁹ thekson se strategjitë e të mësuarit të gjuhës janë të rëndësishme për mësimin e saj sepse 'ato janë mjete për përfshirje aktive, vetë-drejtuese ', të cilat janë thelbësore për zhvillimin e kompetencës komunikuese'.

Përveç dallimeve që kanë materialet, për studentët e interesuar, ndryshojnë edhe teknikat gjithashtu. Mësimdhënësit e përfshirë në mësimin e studentëve në fjalë miratojnë shumë mënyra efektive të cilat nuk janë të kuptueshme për mësuesit që japin gjuhën angleze të përgjithshme; ata duhet të vënë në përdorim teknikën e njohur si 'transferimin e informacionit', 'me të cilën nxënësi interpreton diagramet, tabelat etj., gojarisht ose transferon informacion nga teksti verbal në atë jo-verbal në tilla si diagram, tabelë etj.¹²⁰.

Kështu, Bruton¹²¹ rekomandon që "të përdoren më tepër diagramet" dhe ai shton se "një pjesë shumë e madhe e materialit do të mund të lihet jashtë duke e zëvendësuar atë me ilustrime të qarta dhe të shumta, të cilat kanë përparësi shtesë në mësimin e gjuhës angleze". Kështu, mësuesi i gjuhës angleze për qëllime të veçanta është i aftë që të vejë theksin tek materialet jo-verbale me të cilat studentët janë të njohur nga shkenca dhe për ta përdorur atë si bazë në funksion të gjuhës. Gjuha mund të përfaqësohet nga grafikët, tabelat, diagramet dhe simbolet. Widdowson¹²² jep një shembull:



Kjo formulë mund të përdoret, si Widdowson¹²³ vë në dukje, për të siguruar një bazë për deklaratën e përgjithshëm të faktit se si:

Zinc combines with sulphuric acid to form zinc sulphate and hydrogen is given off.

Zinku kombinon me acid sulfurik për të formuar sulfat zinku dhe hidrogjeni është hequr.

When zinc combines with sulphuric acid, zinc sulphate is formed and hydrogen is given off.

¹¹⁸ Po aty

¹¹⁹ Lessard-Clouston, Michael (1997) "Language Learning Strategies: An Overview for L2 Teachers" The Internet TESL Journal, Vol. 3, No. 12 .

¹²⁰ Bates, M. (1978) "Writing, 'Nucleus'" in Mackay, R. & Mountford, A. (eds): English for specific Purposes, London: Longman. Fq 91

¹²¹ Bruton, J. g. (1961) "The Simplification of Technical Literature" ELT, Vol. 16.fq.26

¹²² Widdowson, H. G. (1979) Exploration in Applied Linguistics. Oxford: OUP. Fq.33

¹²³ (Po aty)

Kur zink kombinon me acid sulfurik, sulfat zinku formohet dhe hidrogjeni hiqet.

Pra, teknikat e mësimdhënies së gjuhës angleze për qëllime të veçanta duhet të përfshijnë në përgjithësi mësimin e gjuhës së shkencës, metodologjisë dhe këtu pajtohem me Widdowson¹²⁴ kur ai këshillon mësuesit e gjuhës angleze për qëllime të veçanta që të kërkojnë udhëzime metodologjike jo nga gjuhëtarët apo filozofët e shkencës, por nga vetë pedagogët e shkencave. Kjo ndodhte shpesh në fillimet e mija akademike si pedagog e gjuhës angleze të profesionit, kur më duhej shumë shpesh të kontaktoja me pedagogë të inxhinierisë për t'u konsultuar me përkufizimin e termave teknikë, përdorimin e tyre si dhe një përshtatje më profesionale të termit në gjuhën shqipe. Pastaj në dritën e dallimeve të konsiderueshme në mes gjuhës angleze për qëllime të veçanta dhe gjuhës angleze për qëllime të përgjithshme të përshkruara dhe të diskutuara gjatë gjithë këtij punimi, mund të përfundohet se ekziston nevoja akute për një tekst të specializuar përmbajtja dhe teknikat e të cilit i shërbejnë kërkesave specifike komunikuese të studentëve të shkencës dhe të pasqyrojnë interesat e tyre profesionale.

Një tjetër pikë që duhet shtuar është se kurse të tilla si kursi i ESP duhet të njihet, si një komponent plotësues i GE dhe nuk duhet të trajtohet si një zëvendësues i saj.

3.5. Arritjet në komunikim.

A. Kontributet e Lëvizjes komunikuese.

- 1- Qëllimi i mëimit të gjuhës: aftësia komunikuese mund t'i shërbejë më mirë nevojave të studentit.

Kompetenca gramatikore	Kompetenca socio-kulturore	Kompetenca strategjike
Njohja e temave leksikore dhe rregullave morfologjike, sintaksore, njohjes së anës kuptimore të fjali \ve dhe fonologjia.	Kompetenca socio-kulturore Njohja e lidhjes së përdorimit të gjuhës në kontekstin jo-gjuhësor.	Kompetenca te diskursit Njohja e rregullave të kohezionit dhe kohere-ncës.
		Strategjitë e komunikimit verbal dhe joverbal mund të quhen një veprim për të kompensuar dështimet në komunikim për shkak të variablave të performancës ose të kompetencave të pamjaftueshme.

Kompetencat komunikuese

¹²⁴(Po aty, fq.47)

B. Gjuha angleze për qëllime specifike (ose gjuha angleze për qëllime speciale).

Kur gjuha anglze mësohet si një gjuhë e dytë në shkollat fillore apo të mesme, ajo mësohet në mënyrë të përgjithshme, me një qëllim të përgjithshëm: qëllim edukativ. Anglishtja, së bashku me lëndët e tjera, konsiderohet si diçka e mirë për nxënësit, ose për atë që ata mund të kenë nevojë në të ardhmen. Zakonisht nuk ka ndonjë kërkesë të menjëhershme për nxënësit për të përdorur gjuhën angleze për ndonjë qëllim të vërtetë komunikues. Ndryshe nga mësimi i anglishtes si pjesë e programit mësimor të shkollës, ka rrethana ku një nxënës mëson anglisht me një qëllim specifik dhe të menjëhershëm dhe për nevojat reale. Gjuha angleze e mësuar në të tilla rrethana quhet “gjuha angleze për qëllime specifike”.

Ekzistojnë shumë terma të ndryshëm për të përshkruar programet e të mësuarit anglisht të cilat synojnë subjekte të ndryshme, të tilla si: Gjuha Angleze për Shkencën dhe Teknologjinë, Gjuha Angleze për kopshtet, Gjuha Angleze për Biznesin Ndërkombëtar, Gjuha Angleze për Financat.

Një dallim është bërë përgjithësisht midis Gjuhës Angleze për Qëllime Akademike (EAP) dhe Gjuhës Angleze për Qëllime Profesionale (EOP). EAP merret me të mësuarit e anglishtes në fusha të tilla si, mësimi i anglishtes për ndjekjen e një diplome kolegji. EOP merret me të mësuarit e anglishtes për qëllime profesionale ose në vendet e punës.

Ajo që duhet të theksohet është se dallimi nuk është gjithmonë i qartë. Janë 2 karakteristika kritike që janë shpërndarë nga të gjitha programet ESP dhe tre karakteristika të tjera që mund të aplikohen vetëm në disa programe ESP¹²⁵.

1) Karakteristikat kritike:

- qëllim i drejtuar, që do të thotë më tepër se sa një qëllim në vetvete. Gjuha konsiderohet si shërbim se sa një lëndë e studiuar më vete.
- bazuar në një analizë të nevojave të nxënësve. (Jan: duke përfshirë analizën e regjistrit/zhanër të gjuhës së përdorur për situata të caktuara).

2) Karakteristika të veçanta:

- nxënësit janë shpesh të rritur;
- periudha kohore në dispozicion për të mësuar, shpesh është e limituar;
- homogjeniteti (nga përkatësia e subjektit apo profesionit) mund të ekzistojë.

Përveç përputhjes me gjuhën, studenti mëson dhe nevojat e të mësuarit, përzgjedhja dhe paraqitja e materialeve mësimore janë gjithashtu të bazuara në një analizë të regjistrit dhe/ose zhanrin e gjuhës së përdorur në situata të caktuara.

¹²⁵Robinson, P. (1991) ESP Today: A Practitioner's Guide. Hemel Hempsted: *Phoenix ELT* . fq. 24

Lind pyetja se çfarë e bën këtë gjuhë të ndryshme nga çdo gjuhë tjetër që përdoret në ndonjë disiplinë tjetër?

Çdo disiplinë duhet të ketë një sasi të caktuar të fjalorit të specializuar, por a është gjuha e shkencës më shumë se sa kaq? A është e vërtetë të thuhet se shkenca është më gjerësisht e lirë në kulturë?

Kjo pyetje është e rëndësishme për mësimin e gjuhës. Nëse ka pjesë të caktuara të gjuhës që përdoren më shpesh në shkencë se në kurset e gjuhës së orientuar jo-shkencërisht, atëherë këto janë pjesë të përqendruara në mësimet e ESP.

3.6.Karakteristikat e stilit tekniko - shkencor

Çfarë karakteristikash ka gjuha e shkencës? Çfarë ka ajo të përbashkët me gjuhën e zakonshme? Cila pjesë është më e madhe? (e përbashkët apo e specializuar?)

Stili tekniko-shkencor është gjuha e veprave, e artikujve dhe e studimeve shkencore, si edhe gjuha e veprimtarisë shkencore e teknike, e prodhimit etj. *Një karakteristikë e përgjithshme e leksikut të prozës shkencore është pasuria me terma nga fusha të ndryshme të dijeve*¹²⁶.

Gjithsesi kur lexojmë një studim shkencor për inxhinieri, mjekësi, për industri, për gjuhësi, për art etj., na bien në sy në radhë të parë termat. Kjo pjesë e terminologjisë sa vjen e rritet, ngulitet dhe mbizotëron në çdo fushë të shkencës. Funkzioni stilistik i këtij ligjërimi është kumtues, domethënë gjuha u nënshtrohet kërkesave që të jepet një përmbajtje e caktuar sipas natyrës së kësaj sfere¹²⁷.

Fjalët e përgjithshme të shkencës jo vetëm janë të pranishme në shkencat e ndryshme, por edhe ndeshen në përdorimin e zakonshëm intelektual e kulturor dhe siç e kemi përmendur dhe më lart ka terma të shumtë që kalojnë në gjuhën e folur dhe depërtojnë në jetën e zakonshme dhe fare pak ndodh ky fenomen në të kundërt¹²⁸.

Sfondi i pamjaftueshëm profesional i mësuesve ESP në fushat inxhinierike është shpesh një arsye kryesore për ngurrimin e ekspertëve të mësimdhënies. Në këtë kapitull kemi menduar të trajtojmë aspekte të cilat duhen marrë në konsideratë, veçanërisht kur strukturojmë dhe organizojmë një plan mësimor në ESP. Këto përfshijnë aspektet leksikore të gjuhës profesionale, aktivitetet në klasë dhe aftësitë e komunikimit që i lehtësojnë mësimin e ekspertëve të ESP-së nga njëra anë dhe nga ana tjetër ju sigurojnë qasje në anglishten universale profesionistëve. Këtu kemi përfshirë fusha që vazhdimisht paraqesin sfida për mësuesit e ESP-së, veçanërisht ato të angazhuar në mësimdhënien e gjuhës teknike dhe teknologjisë informacionit në anglisht dhe prekim zgjidhje të reja në drejtim zgjidhjes së problemeve në mësimin ESP .

¹²⁶Thomai, J. (2006), “Leksikologjia e gjuhës shqipe”Tiranë, f.300

¹²⁷ Lloshi, Xh. (1999) “ Stilistika dhe Pragmatika” Tiranë, f. 188

¹²⁸Lloshi, Xh. (1999) “ Stilistika dhe Pragmatika” Tiranë, f. 193

Duke qenë se ne, si mësues të gjuhës angleze, na duhet të përballemi çdo ditë me studentë të inxhinierisë, shpeshherë e gjejmë veten ngushtë teksa na drejtohen pyetje të cilat janë shumë specifike në llojin e tyre dhe ne kemi njohuri të pamjaftueshme ekstra - gjuhësore të cilat janë tepër të rëndësishme për procesin e të mësuarit ESP. Si mund të ndihet një mësues përballë një auditori ku njohuritë e tij janë më pak profesionale dhe pa përvojë? A mundet një mësues të ndihmojë nxënësit të shprehin idetë që ata nuk kuptojnë ?

Është e qartë se gjuha angleze për qëllime specifike ndryshon nga gjuha angleze e përgjithshme në specifika të përcaktuara nga profesioni ose dega e shkencës. Por një mësues ESP nuk duhet të vërë në dyshim faktin se çdo degë e gjuhës, përfshirë ESP-në, buron nga gjuha angleze e përgjithshme – “ajo ka trashëguar modelet e formimit të fjalës, sintaksës dhe diskursit ¹²⁹”.

Le të marrim në konsideratë një paragraf të shkëputur nga një tekst i cili përmban gjuhë të inxhinierisë së telekomunikacionit mbi fibrat optike:

Optical telecommunication is usually conducted with infrared light in the wavelength ranges of 0.8–0.9 μm or 1.3–1.6 μm —wavelengths that are efficiently generated by light-emitting diodes or semiconductor lasers and that suffer least attenuation in glass fibres. Fibrescope inspection in endoscopy or industry is conducted in the visible wavelengths, one bundle of fibres being used to illuminate the examined area with light and another bundle serving as an elongated lens for transmitting the image to the human eye or a video camera.¹³⁰

Telekomunikacioni optik kryhet zakonisht me dritë infra të kuqe me gjatësi vale 0,8-0,9 mM ose 1,3-1,6 mM-gjatësi valore që janë të krijuara në mënyrë efikase nga dioda ose lazer gjysëm përçuesdhe që pësojnë dëmtin të fibrave të xhamit. Inspektimi Fibrescope në endiskopi ose industri është kryer në gjatësi vale të dukshme, një pako e fibrave duke u përdorur për të ndriçuar zonën e shqyrtuar me dritë dhe një tjetër pako që shërben si një lente e zgjatur për transmetimin e imazheve të syrit të njeriut ose të një video-kamere.

Konteksti mund të duket i frikshëm. Një mësues është i frikësuar në fillim kur përballlet me një tekst që përmban një tekst të këtij lloji, por a është paragrafi i mësipërm tipik i gjuhës që përdorin studentët e inxhinierisë të cilët studiojnë ESP?

Përgjigja është Jo, pasi ajo lidhet me fushën specifike brenda inxhinierisë së telekomunikacionit, jo një zone të përgjithshme inxhinierike të cilën shumica e inxhinierëve ose studentëve të inxhinierisë përdorin. Ne si pedagogë të ESP-së i dimë limitet tona se deri ku duhet të shkojmë në shpjegimin e specifikave, pra duhet të prekim vetëm sipërfaqen, atë të cilën ne dhe studentët dimë, pa hyrë në detaje profesionale. Gjithashtu, “tekstet nuk duhet të jenë të vështira për arsye se as ne si pedagogë, as studentët nuk kanë nivel të lartë të njohurive profesionale, por duhet të përmbajnë sfida të cilat të aktivizojnë sfidat e njohurive profesionale tek studentët¹³¹”.

¹²⁹Choroleeva K. (2012). Some Issues in Teaching English for Specific Purposes (ESP).

¹³⁰<http://www.britannica.com/EBchecked/topic/205837/fibre-optics>

¹³¹Helsvig, J. (2010). ESP – Challenges for learners and teachers in regard to subject-specific approach.

Si mësues të ESP-së, ne nuk duhet të shpenzojmë shumë nga koha jonë duke u përqendruar tek leksiku, sepse është një pjesë shumë e vogël krahasuar me gjithë atë punë të madhe që ne si mësues bëjmë në një kontekst më të përgjithshëm. Prandaj, ne duhet të kuptojmë, analizojmë dhe ripërpunojmë kuptimin e një fjalie apo teksti dhe më pas ta përcjellim atë tek studentët.

Edhe kur hartojmë silabuset dhe programet mësimore, duhet të shmangim përfshirjen e teksteve me gjuhë të komplikuar teknike apo shumë specifike, sepse mund të përfundojmë në situata të cilat kthehen në të sikletshme për ne. P.sh, nëse nuk do kemi njohuritë e duhura shkencore, një pedagog i ESP-së do ta shmangte shpjegimin e fjalisë jo veprare duke e ilustruar me një shembull të këtillë:

*Nearly 400 million acres of farmland worldwide are now used to grow GE crops such as cotton, corn, soybeans and rice. The majority of genetically engineered crops are resistant to pesticides and/or herbicides so that they can withstand being sprayed with weed killer while the rest of the plants in the field die. Some GE crops are actually classified as pesticides. For instance, the New Leaf potato, which has been taken off grocery shelves, was genetically engineered to produce the Bt (*Bacillus thuringiensis*) toxin in order to kill any pests that attempted to eat it. The actual potato was designated as a pesticide and was therefore regulated by the Environmental Protection Agency (EPA), instead of the Food & Drug Administration (FDA)¹³².*

*Gati 400 milionë hektarë tokë bujqësore në mbarë botën tani janë përdorur për të rritur bimë GE të tilla si pambuku, soje dhe oriz. Pjesa më e madhe e tyre janë të transformuara gjenetikisht që të jetë rezistente ndaj pesticideve dhe / ose herbicideve në mënyrë që ata mund të përballojnë spërkatjen me kimikate vrasëse, ndërsa pjesa tjetër e bimëve në terren vdesin. Disa bimë të transformuara gjenetikisht, aktualisht janë klasifikuar si pesticide. Për shembull, patate të reja, e cila është marrë ngaftet ushqimore, ishte e gjenetikisht e transformuar për të prodhuar BT (*Bacillus thuringiensis*) toksina në mënyrë që të vriste çdo kafshë që përpiquej për ta ngrënë atë. Patate aktuale ishte caktuar si një pesticid dhe për këtë arsye është rregulluar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA), në vend të Administratës Food Drug (FDA).*

Mësimdhënia e gjuhës së huaj të profesionit, shpesh herë konceptohet nga studentët si diçka e vështirë dhe ata shprehen se në pothuaj 90% të rasteve e kanë për herë të parë mësimin e kësaj gjuhe dhe termave teknikë. Flas në këtë përqindje për arsye se një pjesë e studentëve të cilët vijnë nga shkollat e mesme profesionale, kanë pasur mundësi të merren me terma teknik në gjuhën angleze. Duke marrë parasysh faktin se këta studentë kanë lëndët e vitit të parë, lëndë të formimit të përgjithshëm dhe jo lëndë të specialitetit, atëherë ata përballen me mësimin e ESP-së për herë të parë.

Shpesh, e veçanërisht në rastet e gjuhës teknike për inxhinierët e teknikët, ESP-ja pritet të jetë e vështirë dhe serioze për arsye se dhe dega të cilën studentët kanë zgjedhur të studiojnë është e vështirë dhe kërkon përkushtim dhe seriozitet. Por mendoj se çdo gjë varet nga ana e mësuesit/pedagogut të lëndës, mënyra se si ia ofron studentëve lëndën dhe

¹³²<http://www.sustainabletable.org/264/genetic-engineering>

në kundërshtim me lëndët të cilat ata studiojnë dhe janë tepër të vështira dhe tensionuse, ora e gjuhës së huaj mund të quhet për ta dhe si një orë çlodhjeje dhe argëtimi, për më tepër kur studentëve u ofrohen ushtrime me plotësime, apo përzgjedhje fjalësh në plotësim fjalie etj. Ushtrimet me dialogë mund të zhvillohen në formën e një loje, si p.sh. studentët mund të analizojnë funksionin dhe qëllimin e një pajisjeje duke e imagjinuar se si mund të ishte jeta nëse ajo pajisje (p.sh kompjuteri), nuk do të ekzistonte.

Implementimi i metodave të këtylla i bën studentët që të çlirohen nga tensioni i lëndëve ekzakte dhe të përfshihen në mësimin e gjuhës me shumë kreshëri dhe kënaqësi. Por ka edhe raste, sidomos kur punohet me materiale të përzgjedhura nga ana e studentit, apo nga burime të tjera, si p.sh internet apo literaturë e huaj, që ne si pedagogë jemi ndodhur përballë vështirësish për arsye se teksti i përzgjedhur nga studentit mund të ketë qenë me karakter tepër teknik. Atëherë ka ndodhur që ky “disavantazh”, të jetë kthyer në një “avantazh” për ne si pedagogë, pasi kanë qenë studentët, të cilët me njohuritë e tyre më specifike mbi degën që studiojnë na kanë shpjeguar materialin e përzgjedhur. Çuditërisht, studentët janë tepër të hapur për këtë formë komunikimi dhe u pëlqen supozimi i të qenit në rolin e mësuesit. Kjo gjë i bën ata të ndihen të vlefshëm dhe i inkurajon që ta përcjellin informacionin që gjejnë apo mësojnë në mënyrën më korrekte të mundshme. Kjo i bën studentët që të motivohen dhe të angazhohen seriozisht në kursin e gjuhës angleze, pse jo, me krenari e them që studentët shprehen se: “We look forward to having English classes”.

3.6.1. Baza teorike mbi stilin teknik - shkencor

Në këtë seksion kemi shqyrtuar disa baza teorike nga shkrimtarë të ndryshëm të cilët janë marrë me shkrimin teknik-shkencor. Ne duhet të studiojmë bazat e teorive të studiuara më parë mbi këtë pjesë të ESP-së, para se të vendosim për përzgjedhjen, trajtimin dhe zhvillimin e teksteve mësimore.

Stevens¹³³ në një artikull studimi pyet se cila është natyra e diskursit shkencor dhe çfarë ka ajo ndryshe krahasuar me pjesën tjetër të gjuhës “normale”. Ai thotë se diskursi shkencor përdor shumë fjalë, rrënjë dhe para/prapashtesa me origjinë greke dhe latine dhe përdor, ose është e përafërt në simbole, numra, emra kimikatesh etj, të cilat janë me karakter ndërkombëtar. Në shumë aspekte, gjuha shkencore është normale në funksionet shkencore si një gjuhë mike, duke përdorur të njëjtin sistem shqiptimi, të njëjtin theks, të njëjtën gramatikë të përbashkët, rregullat të shqiptimit dhe ortografisë dhe shumë fjalorë të përbashkët jo të specializuar, si çdokush tjetër.

Sipas Stevens “diskursi shkencor është një stil ndryshe, prandaj ndryshimet mund të shpjegohen jo në aspektin e përbërësve bazë të gjuhës, por në aspektin e pjesëve statistikore të një përzierjeje ku ato ndodhin si dhe qëllimit, arsyes sipas përzgjedhjes dhe përdorimit të tyre”¹³⁴.

¹³³Stevens (1977) Stevens P. (1976) Problems of learning and teaching science through a foreign language. *Studies in Science Education*. 3, fq.153-154.

¹³⁴(Po aty, fq. 153)

-
- Tiparet e prozës shkencore për Strevens janë:

1. fjali tepër të gjata që përmbajnë shumë pjesë, shpesh në një shkallë të ndërlikuar të varësisë me shumë hyrje.

2. grupe të gjata nominale që përmbajnë vargje të mbiemrave ose emrave që luajnë rolin e mbiemrave, duke siguruar secili specifikim më të madh që nga modifikimi mbi modifikimin.

3. forma të shpeshta të formës jo veprare, të cilat kanë efektin e vendosjes së ideve kryesore në pozicion fillestar, ku në gjuhën angleze mbajnë peshën e gjithë kuptimit¹³⁵.

“Anglishtja Shkencore” është thjesht ‘anglishtja e përdorur nga shkencëtarët ose për qëllime të personave të angazhuar në shkencë’. Ajo ka të njëjtën gramatikë, shqiptim dhe drejtshkrim si janë gjetur në të gjitha llojet e anglishtes. Ajo përfshin më shumë fjalor të përgjithshëm të gjuhës angleze, me një numër të madh artikujsh të specializuar ose të fjalëve të zakonshme të përdorura në një mënyrë të specializuar; ajo gjithashtu mbart një rrjet të simboleve lidhëse dhe simboleve vizuale të cilat mund të jenë verbale për ata të cilët i njohin rregullat e të vepruarit kështu.

Atëherë çfarë është ndryshe ose e veçantë lidhur me “anglishten shkencore”? Një përgjigje e shkurtër dhe e thjeshtëzuar është se përzierja e veçantë e gramatikës dhe fjalorit të gjendura veçanërisht në “anglishten shkencore” mund të shfaqin disa ose të gjitha karakteristikat, duke përfshirë p.sh:

- fraza emërore të gjata dhe të komplikuar
- një sasi (përqindje) e madhe e formave të formës jo veprare
- përdorimi i shpeshtë i mjeteve logjike-gramatikore.
- një përqindje e lartë e fjalorit të specializuar.

Po kaq i rëndësishëm është fakti se argumentet retorike, funksioni komunikues i “anglishtes shkencore” janë zgjedhur në mënyrë që t’iu shërbejnë qëllimeve të veçanta të shkruarit ose lexuesit. Kështu që, logjika, lidhëzat dhe fjalori i specializuar është një problem për folësit vendas të painformuar po ashtu edhe për folësit jo vendas. Kjo jep disa pika kyçe se çfarë duhet të theksohet në mësimdhënie.

Ewer¹³⁶ krahasonte anglishten shkencore me atë që kurset e anglishtes së “përgjithshme” japin në shkolla. Ai vuri re ndryshimin e gjerë për shkak të leksikut, por gjithashtu gjeti ndryshime në nivelin gramatikor. Ai vuri re ndryshimet si më poshtë dhe dha përfundimet. “Prandaj është e qartë se çdo material i mësimi të gjuhës angleze, për studentët e shkencës duhet t’ju vendoset një theks i veçantë këtyre mjeteve gjuhësore”¹³⁷.

¹³⁵Strevens (1977) Problems of learning and teaching science through a foreign language. *Studies in Science Education*. 3, fq.154.

¹³⁶Ewer JR. (1971) Further notes on developing an English programme for students of science and technology (1). *English Language Teaching Journal*. 26:1, p65-70.

¹³⁷Ewer JR. (1971) Further notes on developing an English programme for students of science and technology (1). *English Language Teaching Journal*. fq. 67

- **Lista e Ewer¹³⁸ (1971) e mjeteve gramatikore që duhen theksuar në ESP:**

Grupi 1: Gjërat thelbësore të anglishtes shkencore bazë, por të pa paraqitura dhe të pa punuara në çdo kurs:

- format “ing” zëvendësojnë një krahasim (pjesë krahasuese);
- mënyra paskajore si zëvendësim për frazat e gjata;
- fjalë të ngjashme në formë, por me kuptim të ndryshëm në të njëjtin funksion;
- shumica e parashtesave dhe prapashtesave;
- shumica e fjalëve dhe shprehjeve strukturore dhe kualifikuese.

Grupi 2: Gjërat thelbësore të anglishtes shkencore bazë, por të pa paraqitura dhe të pa punuara në 2 nga 3 kurse ose të pa trajtuara mirë:

- emrat e përbërë, format joveprore, kushtoret, format paskajore.
- strukturat shkak-pasojë.
- fjalët e ngjashme në formë, por me funksion të ndryshëm.
- përdorimet e pjesores.
- folje me 2 pjesë, të zakonshme në anglishten shkencore.

- **Robinson (1980)¹³⁹**

Robinson thotë se të dhënat ekzistuese janë të pamjaftueshme për të krijuar dhe dalluar qartë një “regjistër” shkencor. Në “surprizën” e Ewer dhe Latorre tek “Great varieties of writing in Scientific English” u raportua dhe fakti se nën-regjistra të ndryshëm “tentonin të përdorin struktura të dallueshme¹⁴⁰”.

Ai na kujton faktin se vetëm një minoritet i shkencëtarëve lexojnë gazetatat kërkimore dhe akoma gazetatat kërkimore si zhanër kanë qenë më të studiuara nga kërkuesit e ESP. Ekziston një marrëveshje se, anglishtja shkencore është anglishtja e përgjithshme plus komponentët ekstra të shkencës¹⁴¹. Ajo thotë se ekziston një nevojë e madhe për më pak përgjithësim dhe saktësi të madh që mund të numërohen për të ndryshuar opinion. Swales¹⁴² për shembull ka theksuar se foljet kryesore në tekstet shkencore janë përgjithësisht në kohën e tashme (unë shkoj), ndërsa thekson formën e vazhduar të foljes (unë jam duke shkuar)¹⁴³.

Një marrëveshje e gjerë se shenjat e ligjëratave dhe fjalët lidhëse janë të rëndësishme, duket se ekziston¹⁴⁴ edhe pse për ironi Robinson vëren se fjalët lidhëse janë ndoshta të rëndësishme: “jo sepse janë të veçanta për ESP, por sepse përgjithësisht ELT deri tani i ka

¹³⁸ (Po aty)

¹³⁹ Robinson, P. (1980). *ESP: the current position*. Oxford: Pergamon Press. Në kapitullin 2, “Anketa e pozicioneve retorike” Robinson jep një hulumtim historik të shkurtër të ESP, materiale të “Analizës së regjistrave”, “Analizë diskursi” dhe “Përafrime komunikuese”.

¹⁴⁰ Ewer JR, Latorre G. (1967) Preparing an English course for students of science. *English Language Teaching Journal*. 21:3, fq.221-229.

¹⁴¹ (Po aty. Fq. 17)

¹⁴² Swales, J., M. (1971). *Writing Scientific English*. London: Thomas Nelson.

¹⁴³ Robinson, P. (1980). *ESP: the current position*. Oxford: Pergamon Press, fq.19

¹⁴⁴ (Po aty fq.21)

injuar ato”¹⁴⁵. Shenjat e ligjëratave nuk janë domosdoshmërisht unike për shkencën, por janë shumë të rëndësishme¹⁴⁶. Në kërkimet e tij ai gjeti se ndryshimi i vetëm i rëndësishëm midis fëmijëve emigrantë dhe homologëve të tyre vendas, ishte se emigrantët, të aftë në të gjitha fushat e tjera, ishin të dobët në fjalët lidhëse.

Gjuha shkencore shmang vetën I dhe vetën e II, duke shkëputur një mesazh nga dërguesit dhe marrësit e saj. Përdoret forma jo veprorë. “Ne” është gjithashtu e përdorur, por në një mënyrë të veçantë për t’iu referuar të dyve: personi që po komunikon (flet) dhe personi i adresuar (ai që dëgjon/lexon)¹⁴⁷. Është e rëndësishme të dimë se një fjalim “jo i personalizuar” i shkencëtarit prezanton një mënyrë referimi të dukurive (fenomeneve) në një mënyrë “jo të zakonshme”, e cila është një pjesë po aq e rëndësishme sa edhe “subjekti i lëndës”¹⁴⁸.

Termet e rinj në literaturë janë komplekse, në shkencë ato janë të përbërë siç është “elektrode bakri”¹⁴⁹.

Kjo për Widdowson nuk është një pikë e gramatikës. Shembulli i dhënë i një emri të përbërë, “elektrode bakri”, ndërkohë gramatikisht ekuivalent me: ”elektroda e cila është e bërë nga bakri”¹⁵⁰, nuk kanë të njëjtën vlerë. Termi i përbërë është emri i diçkaje që shihet se ka një identitet të veçantë, të ndarë dhe qëllimi është ky emër, jo të përshkruash elektrodën.

Për ta përmbledhur, anglishtja shkencore sipas Widdowson është karakteristike në termat e komunikimit si për shembull format jo veprorë të papërcaktuara, përdorimi i “ne” për t’iu referuar shkrintarit dhe lexuesit dhe emrave të përbërë në vend të emrave kompleks.

“Përfundimi i përgjithshëm është se ‘shkenca’ nuk është një shembull homogjen gjuhësor, ku qëllimi i shkrintarit dhe audiencës, më tepër se sa tema, janë përcaktimet e formave gjuhësore”¹⁵¹. Është e dukshme që anglishtja shkencore është disi e ndryshme nga anglishtja e përgjithshme, por përpjekjet për të deklaruar saktësisht se ku janë këto ndryshime, kanë dështuar. Përgjithësimet e Streven janë udhëzime të përdorshme, por nuk janë të zbatuara në të gjitha shkrimet shkencore. Listat e Ewer janë një hap në drejtimin e duhur, por janë aq të bazuara në qëllime edukative sa edhe të dhënat e një eksperimenti të vështirë që janë gjerësisht të zbatueshme. Argumenti i Widdowson se gjuha shkencore përdor format përgjithësuese është një përgjithësim, disa stile i përdorin, por jo të gjitha gazetat kërkojnë përdorimin e formës joveprorë, sepse ajo ndonjëherë është e rëndësishme për të theksuar se kush po e bën veprimin, sepse personi mund të ndikojë te rezultati.

¹⁴⁵ (Po aty. Fq. 21)

¹⁴⁶Dawe L. (1983) Bilingualism and mathematics reasoning in English as a second language. Educational Studies in Mathematics. 14, fq. 325-353. argumenton

¹⁴⁷Widdowson HG. (1974) Literary and scientific uses of English. English Language Teaching Journal. 28:3, fq. 282-292.

¹⁴⁸ (Po aty, fq. 289)

¹⁴⁹ (Po aty. Fq. 290)

¹⁵⁰ (Po aty, fq. 290)

¹⁵¹Robinson PC. (1991). ESP today: a practitioner's guide. Prentice Hall, UK. Fq. 24.

3.6.2. Një ndryshim i veçantë

Dokumentimi i ndryshimeve duhet gjithashtu t'i paraprijë një vlerësimi të rëndësisë së tyre. Ewer¹⁵² listoi disa karakteristika të anglishtes shkencore dhe thekson se duke pasur parasysh dallimet dhe vështirësitë që ato shkaktojnë te studentët. Gjëja më e rëndësishme është që të përcaktojnë saktësisht cila prej vështirësive që studentët duket se përballin janë të rëndësishme.

- Çfarë është një ndryshim i "veçantë"?

Kjo ngre pyetjen se çfarë është një ndryshim i rëndësishëm. Ewer¹⁵³ e sheh një ndryshim të rëndësishëm si një vështirësi të rëndësishme të dhënë studentëve. Kjo thekson opinionin e studentëve për ndryshimet, por ngre pyetjen se çfarë është një vështirësi e rëndësishme. Ewer e përshkruan një vështirësi të rëndësishme si diçka e cila rrit gabimet e "papranueshme" p.sh ndërhyr materialisht me komunikimin midis shkencëtarëve. Rëndësia varet nga çfarë ti do të bësh.

Shpeshherë, ne flasim ose referojmë në termat "gjuhë angleze shkencore" dhe "gjuhë angleze letrare" sikur ato të ishin dy forma të ndryshme të gjuhës dhe jo përdorime (stile) që kumtojnë aspekte të ndryshme të realitetit rreth nesh. Madje, viktimë e një gjykimi të tillë fiktiv, bien padashur edhe gjuhëtarë të shquar si Halliday, HC Intch¹⁵⁴ dhe Strevens duke u shprehur se:

"Gjuha ndryshon siç ndryshon funksioni i saj: Ajo ndryshon në situata të ndryshme. Emri që i jepet një varietetit të gjuhës për të dalluar atë sipas përdorimit, quhet regjistër. Dhe në sajë të treguesve formal-gjuhësorë përcaktohen regjistrat".

Sipas këtij përkufizimi, regjistrat paraqiten si varietete formalisht të dallueshme të një gjuhe të caktuar. Natyrshëm krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me një stil të veçantë për komunikim në gjuhën mjekësore, për tekstet e inxhinierisë, së bujqësisë, të turizmit e menaxhimit, e kështu me radhë. Në realitet, si shkrimtari i letrave të letërsisë apo shkrimtari i fenomeneve shkencore (shkencëtari) paraqesin nëpërmjet gjuhës aspekte apo fenomene të realitetit që nuk kapen a vërehen nga syri i zakonshëm, por që në fund të fundit, piktura apo tabloja e dhënë (apo fenomeni i paraqitur) projektohen nëpërmjet gjuhës që ne përdorim (në rastin tonë gjuhës angleze) për të komunikuar diçka që fshihet nën sipërfaqen e këtij realiteti të dukshëm, për të dhënë një mesazh të caktuar.

Por le të ilustrujmë më saktë mendimin e shprehur me 2 shembuj e mëposhtëm, që i referohen:

Shembulli i Parë, Stilit letrar të gjuhës angleze dhe Shembulli i Dytë, Stilit tekniko-shkencor¹⁵⁵:

¹⁵²Ewer JR. (1971) Further notes on developing an English programme for students of science and technology (1). English Language Teaching Journal. 26:1, fq. 68.

¹⁵³(Po aty)

¹⁵⁴Halliday, M.A.K (1985a) An introduction to functional grammar. London: Edward Arnold

¹⁵⁵Vrapi, F. 1995, Punimi shkencor për titullin Doktor.

-“I bring fresh showers, for the thirsty flowers,

From the seas and the streams.

-“I bear lightshade for the leaves when laid,

In their moonday dreams”

“Unë sjell rrebesh të madh, kur lulet eten n’hall,

Nga përrenj dhe detra

Dhe hije-dritën sjell, kur gjethet janë pështjellë,

Nga të vapës ëndrra”.

(Nga “The cloud” P.B Shalley)¹⁵⁶

-Anglisht-

- In effect, we have redefined, the task of science to be the discovery of laës that will enable us to predict events up to limits set by the uncertainty principe. The question remains however: How or why we’re the laws and the initial stage of the universe chosen?

-Përkthim-

- Në fakt, ne e kemi ripërkufizuar detyrën e shkencës si zbulim i ligjeve që mundësojnë parashikimin e ngjarjeve, deri në kufijtë e vendosur nga parimi i papërcaktueshmërisë. Megjithatë, një pyetje mbetet: Si dhe Përse u zgjodhën këto ligje në fazën e parë të krijimit të universit?

S. Hawking

From “A Brief History of Time” nga S Hawking¹⁵⁷

Siç vërehet nga shembulli i parë (Shelly) ka një përdorim emrash, përemrash dhe mbiemrash që mbartin një ngarkesë emocionale të theksuar e pështjellin një figuracion të caktuar; p.sh përdorimi i vetës së I-rë (I=Unë) i referohet Resë (The Cloud) dhe jo poetit (Shellit) në ujitësen e luleve, figuracioni simbol që rrethon renë (The Cloud) ndryshon mjaft nga përdorimet që ne do të hasim në komunikimin e zakonshëm.

Në anën tjetër, në shembullin e dytë, vërejmë përdorimin e përemrit “we” (Veta e parë shumë=Ne) që i referohet shkencëtarit (S. Hawking) dhe është karakteristik për stilin tekniko-shkencor, krahas përemrave “It” (Ai, Ajo) dhe “This” (Ky, Kjo). Gjithashtu vihet

¹⁵⁶ Percy Bysshe Shelley published in the 1820 collection Prometheus Unbound, *A Lyrical Drama, in Four Acts, With Other Poems* by Charles and James Ollier in London in August 1820.

¹⁵⁷ “A Brief History of Time” by S. Hawking 1988 (Bantam Dell Publishing Group).

re edhe përdorimi i emrave terma që tregojnë dukuri apo lidhje shkak-pasojë, i foljeve që shprehin përkufizime, parashikime, pasoja, etj., si dhe i fjalëve pyetëse që dëshmojnë e debatojnë vërtetësinë e faktit apo fenomenit shkencor. Krahas veçorive të mësipërme që përmendëm në lidhje me regjistrin (stilin) tekniko-shkencor ne hasim disa module universale të komunikimit në kumtesat shkencore, raportet teknike, tekstet, etj., të cilat mund t'i përcaktojnë si veçori bazë të retorikës për çdo gjuhë, të tilla akte shkencore shprehin koncepte të caktuara në disiplinat përkatëse shkencore; midis tyre do të dallonim:

Përkufizimet, përgjithësimet, klasifikimet, përshkrimet, udhëzimet e ndryshme, raportimet, formulat, simbolet, ekuacionet, tabelat, skicat, diagramet, treguesit etj. Të gjitha këto, e të tjera do të përbënin në vetvete akte të komunikimit shkencor por në asnjë mënyrë “gjuhë” ose “varietet shkencor” të saj.

Veçoritë e mësipërme karakteristike për stilin shkencor që i përkasin kryesisht morfologjisë, por edhe sintaksës, nuk do të legjitimonin në asnjë kontekst ekzistencën e “gjuhës shkencore” sepse edhe po të përmbledheshin të gjitha bashkë ato do të arrinin shifrën 10-15 % të gjuhës normale që ne përdorim zakonisht.

Rrjedhimisht, kur trajtojmë problemin e përvetësimit dhe njohjes së stilit shkencor të gjuhës angleze nga studentët në fakultetet inxhinierike ne do të shquanim 3 drejtime:

- a) Së pari, ndërveprimin objekt-subjekt, domethënë, student-mësues (çfarë niveli kanë, përgatitjet, aktivitetet, motivimi, etj.),
- b) Së dyti, përvetësimin e njohjes e veçorive të stilit shkencor nga të dy palët (treguesit e jashtëm e të brendshëm të tij)
- c) Së treti, zbulimin apo vënien në funksion të atyre metodave e rrugëve që e bëjnë efektiv përvetësimin e këtij stili nëpërmjet veprimtarive komunikuese përkatëse.

Vetëm pasi kemi përcaktuar e vlerësuar drejt këto tre drejtime me të dhëna cilësore e sasiore, mund të flasim për një qëllim të paracaktuar të një kursi me studentë të specialiteteve teknike e inxhinierike. Pas kryerjes me sukses të një kursi të tillë do t'u mundësohej studentëve kuptimi a vlerësimi i një teksti a raporti (kumtese) shkencore dhe më vonë do të kalohej në demonstrimin racional e të thellë të njohurive gjuhësore nëpërmjet të folurit e referimit, të përgatitjes e shkrimit të një kumtese a raporti shkencor, të përkthimit apo interpretimeve të ndryshme me shkrim e me gojë.

Normalisht, kur fillon studimet në shkollën e lartë, çdo student sipas programit shkollor e vlerësimeve me notë në shkollë, duhet të krijojë një bagazh të caktuar gjuhësor në kuadër të gjuhës.

Ky bagazh gjuhësor, po qe se do të ishte real e funksional (jo fiktiv), do të mundësonte një kalim gradual e të natyrshëm të studentit në fazën e re, pra, nuk do të krijonte probleme të koklavitura e të pazgjdhura për të me kusht që nëse shprehemi në mënyrë të figurshme, po të kish ngritur një godinë me mure të forta e bazamente prej disa mijëra gurësh (fjalësh) (=gjuha e përgjithshme e përvetësuar në shkollën e mesme!) do të mjaftonin edhe 3000-4000 fjalë të tjera për të ndërtuar një shtëpi të bukur e me arkitekturë tërheqëse. 3000-4000

mijë fjalët e tjera (të stilit tekniko-shkencor) do të mjaftonin për t'i vendosur çatinë kësaj godine të ndërtuar vite më parë.¹⁵⁸

Logjikisht, kuptohet se studentët me një bagazh prej dhjetëra e qindra fjalësh në anglisht si dhe në një shkallë të ulët përvetësimi të gjuhës do të ndesheshin në vështirësi të panumërta gjuhësore gjatë procesit mësimor. Në lidhje me këto situata gjuhësore mund të shprehemi se studentët e ESP-së do të përballeshin të paktën në tre probleme akute dhe mjaft të rëndësishme që kërkojnë zgjidhje e përgjegjësi profesionale:

1. Përcaktimi i nivelit të studentëve nëpërmjet “Placement Test”, teste të cilët janë nga më të ndryshmet dhe plot variacione. Kemi parë e vëzhguar “Oxford Placement Test”, “Canadian Placement Test” “Fred’s Placement Test” (amerikan), “CESC placement Test” etj. Dhe kemi operuar në disa prej tyre jo pa sukses me studentët tanë në inxhinieri.
2. Përcaktimi apo ndarja e degës a fushës së studimit të studentit sipas pemës së përgjithshme të ELT dhe në vijim të trungut mësimor të ESP (Anglishtja për Qëllime Specifike).

3.7. Rëndësia që ka analiza e nevojave për ndryshimet në program

Detyra e parë që na del për të bërë analizën e nevojave, është që të vendosim se çfarë të dhënash të mbledhim, mbi çfarë bazash, kur ti mbledhim, kush ti mbledhë, me çfarë qëllimi. Një pjesë e informacionit ne e mbledhim përpara se të fillojë mësimi. Këto të dhëna padyshim që përfshijnë informacion biografik, si p.sh., niveli i gjuhës angleze, mosha, të dhëna mbi arsimimin dhe mbi vlerësimin që kanë pasur në një mesatare të përgjithshme në shkollë të mesme. Ato i mbledhim gjithmonë në orën e parë të javës së parë të vitit akademik me anën e intervistave ose kur u kërkojmë studentëve të shkruajnë të dhëna rreth vetes së tyre. Në këtë mënyrë ne krijojmë një tablo të audiencës me të cilën do të punojmë duke e marrë edhe si bazë mbi të cilën do të përzgjedhim materialet të cilat do ti vemi në përdorim përgjatë mësimdhënies.

3.7.1. Analiza e nevojave

Gjatë viteve 1970 filluan të shfaqen procedurat për ndryshimet e planeve mbi bazën e nevojave. Sipas Këshillit të Evropës mbi gjuhët moderne, i cili u konsiderua si një bashkëpunim për të përkrahur të mësuarit gjatë gjithë jetës si dhe për një komunikim më frytdhënës, në 4-6 Nëntor 1959 u mbajt një konferencë në Paris, nën drejtimin e Qeverisë Franceze dhe më pjesëmarrjen e Këshillit të Evropës¹⁵⁹. Ata propozuan një program bashkëpunimi në fushën e edukimit teknik. Një nga katër pikat shqetësuese të diskutuara në konferencë ishte dhe “koordinimi i kurrikulës dhe zgjerimi i studimeve të gjuhës së

¹⁵⁸Shkëputur nga punimi shkencor i Prof.Asoc. Fatmir Vrapi për titullin “Doktor i shkencave”.

¹⁵⁹Trim, L.M. John, Modern Languages in the Council of Europe 1954-1997, Language Policy Division, Strasbourg, www.coe.int/lang, fq. 6.

huaj”. Nga dokumentet e Këshilli të Evropës, analiza e nevojave përdoret si procesi fillestar për përcaktimin e objektivave të sjelljes. Po nga këto objektiva rrjedhin edhe aspekte më të detajuara të silabusit të tilla si funksioni, nocioni, temat, leksiku dhe eksponentët strukturorë.

Sipas Richards, analiza e nevojave na shërben për tre qëllime kryesore¹⁶⁰:

- Na shërben si mjet për të pasur mundësi më të madhe ndërhyrje tek përmbajtja, hartimi dhe implementimi i programeve gjuhësore;
- Mund të përdoret me qëllim që të zhvillojë qëllimet, objektivat dhe përmbajtjen;
- Mund të përmbajë të dhëna për të rivlerësuar dhe vlerësuar një program ekzistues.

Ndërkohë që, sipas Brindely, ai e shikon hartimin e silabusit mbi bazën e nevojave nga një perspektivë tjetër, duke bërë një dallim ndërmjet “nevojave objektive” dhe “nevojave subjektive”:

“...Nevojat “objektive”, janë ato nevoja të përcaktuara nga mësuesi bazuar mbi të dhënat personale rreth nxënësve, bashkë me informacionin mbi aftësitë gjuhësore si dhe modeleve të përdorimit gjuhësor (duke përdorur si udhëzues njohuritë dhe eksperiencën e tyre personale). Ndërsa nevojat “subjektive” (të cilat janë më së shumti “dëshira”, “pritshmëri” ose mungesë e manifestimeve të tjera psikologjike) nuk mund të diagnostikohen (përcaktohen) po aq lehtësisht dhe në të shumtën e rasteve as nga vetë nxënësit...”¹⁶¹

Sipas Nunan, ajo çfarë ka vërtetë rëndësi në zhvillimin e aftësive të gjuhës së dytë është përfshirja nxënësve në eksperiencë mësimore interesante dhe kuptim plote¹⁶². Ai vijon duke thënë se analiza e nevojave është një tërësi procedurash për të përcaktuar parametrat e një kursi studimi. Parametra të këtillë përfshijnë kritere për ndarjen në grupe të nxënësve, përzgjedhjen dhe vijimësinë e përmbajtjes së kursit, metodologjinë, kohëzgjatjen e kursit, dhe intensitetin. Teknikat për analizën e nevojave subjektive do të kenë të njëjtin ndikim si dhe nevojat objektive në sisteme të tilla¹⁶³.

Në një sistem mësimi me në qendër nxënësin, idealja është që përmbajtja e programit të jetë rrjedhojë e procesit të konsultimit dhe negociatave me nxënësit, ku qëllimi kryesor është përqendrimi tek nevojat e nxënësit¹⁶⁴. Rowntree na sugjeron disa qasje intuitive të cilat mund të merren në konsideratë kur hartojmë një program¹⁶⁵:

- Të bëjmë pyetje dhe të dëgjojmë edhe të tjerë të cilët janë të përfshirë në këtë proces
- Të pyesim mësues të tjerë si dhe ekspertë të kësaj fushe
- Të analizojmë kurse të tjera të këtij lloji

¹⁶⁰Richards, J. (1984), “Language Curriculum Development”, RELC journal, 15, fq.5

¹⁶¹Brindley, G. (1984)Need analysis and Objective Setting in the Adult Migration Program, Sydney:NSW, Adult Migrant Education Service, fq. 31.

¹⁶² Nunan, D. 1992, The learner-centered curriculum, Cambridge University Press, fq. 44.

¹⁶³ Po aty, fq. 45

¹⁶⁴ Po aty, fq 55.

¹⁶⁵ Rowntree, D. (1981), Developing courses for students, London: MCGraw Hill (UK), fq.54.

-
- Të shfletojmë tekste dhe metoda të cilat trajtojnë të njëjtat tema dhe janë në të njëjtin nivel me atë që kemi ne
 - Të shqyrtojmë gazeta revista, të lexojmë gazeta apo shohim filma, etj., të cilat kanë lidhje me temën tonë
 - Të diskutojmë me studentët rreth temës dhe të marrim në konsideratë mendimet e tyre
 - Të mendojmë për aktivitete të cilat të jenë interesante dhe tërheqëse për studentët
 - Të zgjedhim librat (apo materialet e tjera të cilat do të na vijnë në përdorim), rreth temës me të cilën do të organizohet mësimi.

“...If you talk to a man in a language he understands, that goes to his head. If you talk to him in his language, that goes to his heart...” - Nelson Mandela

KREU IV

ZBATIME PRAKTIKE TË ANALIZËS SË NEVOJAVE. NDIKIMI I SHKRIMIT TË GJUHËS ANGLEZE TEKNIKE TEK STUDENTËT E INXHINIERISË ELEKTRONIKE. STUDIM RASTI

4.1. Identifikimi i nevojave të studentit

Po e nisim këtë kapitull me një pasqyrë përmbledhëse të zhvillimit të gjuhës së huaj në vite në fakultetet e Universitetit Politeknik të Tiranës. Nisur nga kjo, unë kam botuar edhe një artikull me temë “Studentët shqiptarë mes sfidave dhe ndryshimeve në mësimin e kurseve të ESP-së.”

Shqipëria, ka qenë e izoluar nga bota për pothuajse 50 vite për shkak të regjimit komunist. Pas viteve 90’, u rrit numri i studentëve shqiptarë të cilët filluan të mësonin gjuhët e huaja dhe ishin shumë të aftë në mësimin dhe përvetësimin e gjuhëve të huaja. Shqiptarëve u pëlqen të mësojnë gjuhë të huaja, dhe gjuha angleze është një ndër gjuhët e preferuara. Gjuha e huaj ka filluar të mësohet në shkollat publike 9-vjeçare, që në klasën e tretë dhe vazhdon e mësohet deri në nivel universitar.

Deri pak vite më parë, gjuha angleze mësohej si gjuhë e huaj e dytë, e cila bazohej në metodat tradicionale si metoda e përkthimit, mësimi i gramatikës, format foljore, shprehjet frazeologjike etj. Kur Shqipëria filloi të hapej me botën, industria e tregtisë, ndërtimit, bujqësisë, biznesit, etj., panë nevojën në rritje të mësimdhënies së gjuhës së huaj për qëllime të veçanta në Shqipëri. Mësimi i ESP nisi të aplikohet në të gjitha universitetet e vendit dhe u vu re një interesim i madh si nga ana e pedagogëve ashtu edhe nga ana e studentëve për të mësuar gjuhën e huaj të specialitetit. Kjo ishte për arsye se studentët e panë si me leverdi mësimin e gjuhës teknike për karrierën e tyre të ardhshme. Por edhe në ditët e sotme, kurset e gjuhëve të huaja të cilat ofrojnë mësimin e ESP-së janë ende të kufizuara. Por me zgjerimin dhe pjesëmarrjen gjithnjë e në rritje të kërkesës për përdorimin e gjuhës në arenën ndërkombëtare, i duhet kushtuar më tepër vëmendje hartimit të kurseve të ESP-së të cilat i vijnë në ndihmë studentëve për të komunikuar në gjuhë të huaj të profesionit. Në përgjigje të këtyre nevojave, duhet bërë një provë për të siguruar një qasje udhëzuese për hartimin e kurseve të ESP-së për studentët shqiptarë të cilët studiojnë në fakultetet e inxhinierive të UPT-së.

Me globalizimin e tregtisë dhe ekonomisë dhe rritjen e vazhdueshme të komunikimit ndërkombëtar në fusha të ndryshme, kërkesa për gjuhën angleze për qëllime specifike është zgjeruar, veçanërisht në vendet ku Anglishtja mësohet si gjuhë e huaj. Edhe pse kurset ESP janë bërë popullore kohët e fundit në Shqipëri dhe shumë institucione dhe universitete ofrojnë kurse për studentët e tyre, për vite të tëra këto kurse nuk kanë qenë në funksion të studentëve, çfarë do të thotë që nuk plotësoheshin nevojat bazë të studentëve,

madje as që merrej në konsideratë dëshira e tyre. Kjo shpesh çon në motivim të ulët në studimet e studentëve në gjuhën angleze dhe nga ana tjetër, reagim të varfër kur ata e përdorin anglishten në profesionin e tyre të ardhshëm.

Pikëpamjet e tyre në lidhje me shkollën, studimet, jetën, aktivitetet e kohës së lirë etj., kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Dëshira për të mësuar gjuhë të huaja zë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në jetën e interesat e të rinjve. Përveç shkollës, të rinjtë përdorin burime të tjera më të shumta për marrjen e informacionit dhe për të përfutur njohuri. Ka ndryshuar shumë mënyra se si të rinjtë sillen, vëzhgojnë dhe analizojnë botën që i rrethon dhe ajo ka filluar të pasurohet gjithnjë e më shumë. Tregu i varfër i punës si dhe numri i lartë i papunësisë shihet si një e ardhme e frikshme dhe e pa sigurt nga studentët.

Për rrjedhojë, shohim një tendencë në rritje në numër të studentëve të cilët tentojnë të largohen nga vendi pasi kanë mbaruar studimet e tyre në mënyrë që të punësohen në vende të tjera nëpër botë. Për të shmangur fenomene të tilla, është e nevojshme që sistemi ynë arsimor të bëjë një shqyrtim të hollësishëm, të bazuar në njohuri të thella të realitetit dhe të së ardhmes.

Procesi i mësim-nxënies i shërben strukturave të plotësimit të njohurive të marra më parë në kohë nga studentët dhe mënyrat e sjelljes së tyre duhen vlerësuar si pjesëmarrje aktive në procesin e kërkimit, përpunimit dhe vlerësimit të njohurive.

Kështu që nëpërmjet punës së vazhdueshme si dhe aftësive e njohurive të cilat bazohen në struktura të ndërtuara në mënyrë harmonike, si dhe me përshtatjen tonë si pedagogë dhe mësimdhënës të ESP-së, mund të arrihen rezultatet e kërkuara. Shkolla ka mundësinë të transmetojë vetëm një pjesë të informacionit dhe është e rëndësishme të caktojë që mbi ç' baza do të përzgjedhë përmbajtjen e asaj që duhet mësuar dhe se si do të realizohet strukturimi i njohurive, aftësive dhe vlerave për një qëllim të vetëm.

Shkollat duhet të udhëzojnë studentët drejt një qëndrimi gjithnjë e më kritik për fitimin e njohurive dhe aftësive të fituara për të zgjidhur problemet praktike dhe situatat. Rritja e efikasitetit të mësuarit kërkon lidhje midis subjekteve të ndryshme. Në përgjigje të këtyre problemeve, është e rëndësishme ti ndihmojmë studentët që të përshtaten me konkurrencat e shoqërisë së sotme duke i theksuar faktin që fakultetet në universitet e kanë të nevojshme hartimin e kurseve të ESP-së, kurse të cilat do ti përgatisin studentët për të komunikuar në të ardhmen në gjuhën e profesionit. Por që të hartosh një kurs të ri ESP-je, të duhet ti përgjigjesh disa pyetjeve të tilla si: çfarë të shpjegoj, si ta shpjegoj, nga ta nis. Bazuar në një qasje të integruar, është e rëndësishme të theksojmë faktin se ne, si pedagogë të ESP-së, duhet të punojmë shumë dhe me përkushtim, në mënyrë që të krijojmë një kornizë shembull mbi kursin e ESP-së duke analizuar në mënyrë kritike elementet bazë të cilat përbëjnë një kurs ESP-je; analizën e nevojave; qëllimet e kursit dhe objektivat; detajet e kursit; hartimin e materialeve dhe në fund vlerësimin, në mënyrë që të kemi rezultate të mira në mësimdhënien dhe mësim-nxënien e kurseve të ESP-së.

Rritja e lëvizjes ESP është rezultat i zhvillimit të shpejtë të ekonomisë botërore dhe është ndikuar në masë të madhe nga metodologjia e ELT dhe zhvillimin e Gjuhësisë së Aplikuar.

Në fillimin e viteve 80' u vu re një nevojë e caktuar e cila theksonte përdorimin e një gjuhe të caktuar dhe për më tepër, duheshin marrë në konsideratë procesi i të mësuarit dhe aftësitë e mësimdhënies.

Analiza e nevojave të grupeve të veçanta nxënësish shërbejnë si preludë në hartimin e një kursi të ESP-së. Chen¹⁶⁶ arriti gjithashtu në përfundimin se hartuesit e kurseve si gjë të parë duhet të eksplorojnë dhe të identifikojnë nevojat potenciale të studentit. Ky koncept, i cili ka të bëjë me analizimin e nevojave në ESP, sipas Duddely-Evans dhe St John¹⁶⁷. përfshin dhe merr në konsideratë aspektet që vijojnë:

- a) Informacion profesional rreth studentit; detyrat dhe aktivitetet që studentët do të vënë në përdorim për të mësuar gjuhën angleze
- b) Informacion personal rreth studentit; fakte të cilat mund të ndikojnë në mënyrën se si ata mësojnë, eksperiencat të mëparshme lidhur me mënyrën e të mësuarit, informacionin kulturor, arsyet se përse po e ndjekin atë kurs dhe cilat janë pritshmëritë e tyre.
- c) Informacion mbi njohuritë e gjuhës angleze që ka studentit; cilat janë aftësitë aktuale, analiza e situatës aktuale - gjë e cila na jep ne mundësinë për të vlerësuar (d)
- d) Mangësitë që ka studentit; mangësitë ndërmjet (c) dhe (a)
- e) Informacion mbi mësimin e gjuhës; mënyra efikase për të mësuar aftësitë dhe gjuhën në (d); nevojat e të mësuarit.
- f) Informacion mbi komunikimin profesional rreth (d): njohuri se si gjuha dhe aftësitë përdoren në situata të caktuara: analiza gjuhësore, analiza e diskursit, analiza e zhanrit.
- g) Çfarë pritet nga kursi
- h) Informacion rreth vendit se ku do të zhvillohet kursi

Në hartimin e kurrikulës së ESP-së, një tjetër çështje që duhet marrë në konsideratë, është funksioni gramatikor, aftësitë e përfitimit të informacionit, terminologjia, funksione specifike të përmbajtjes së disiplinës, të cilat janë pjesë shumë të rëndësishme të kursit të ESP-së. në të njëjtën kohë, duhet parë edhe përfshirja e gjuhës angleze të përgjithshme në hartimin e kursit, meqenëse nuk mund të funksionojë pa përfshirjen e gjuhës angleze të përgjithshme.¹⁶⁸

Bazuar në eksperiencën profesionale mbi zhvillimin e kurrikulës Gatehouse¹⁶⁹ vuri në pah se “kur zhvillojmë një kurrikul ESP-je, duhet të përfshijmë tre aftësitë në të me qëllim që të arrijmë një komunikim të suksesshëm. Këto tre aftësi përfshijnë:

- aftësinë për të përdorur një gjuhë zhargon në një situatë të caktuar;
- për të vënë në përdorim aftësi të përgjithshme akademike; dhe si përfundim,

¹⁶⁶Yong, C. (2006). From common core to specific. Asian ESP Journal Online, 1(3), fq.24-47. Marrë nga http://www.asian-esp-journal.com/June_2006_yc.php

¹⁶⁷ Duddely-Evans, T& St John, M. .J.1998, Developments in English for Specific Purposes: A *multi-disciplinary approach*. Cambridge:Cambridge Universitu Press, fq.125.

¹⁶⁸ (Po aty, fq.125)

¹⁶⁹Gatehouse, K. (2001). Key Issues in English for Specific Purposes (ESP) Curriculum Development. The Internet TESL Journal, Vol. VII, No. 10. Marrë nga: November 29th, 2006 nga [http:// iteslj.org/](http://iteslj.org/)

-
- aftësinë e përdorimit të gjuhës së përditshme jo formale në mënyrë që të komunikojnë në mënyrë më efektive”.

Për këtë arsye, teksa hartojmë një kurs ESP-je, duhet të marrin parasysh përfshirjen e tre aftësive.

Edhe vlerësimi është një fazë e rëndësishme e cila duhet përfshirë në procesin e hartimit të një kursi. “...Vlerësimi është një proces matjeje për të parë atë se çfarë njerëzit dinë dhe se çfarë mund të bëjnë dhe ai nxjerr në pah mënyrën se si funksionon ESP e duke e vënë theksin jo vetëm tek faktorët e suksesshëm, por gjithashtu në modifikimin e aspekteve të cilat janë më pak të suksesshme...”¹⁷⁰.

4.2. Informacion rreth kursit të gjuhës angleze për inxhinierët

Gjuha shqipe është gjuha amtare për Shqipërinë, por gjuha Angleze njihet si gjuhë e dytë e huaj dhe përdoret gjerësisht. Në pjesën më të madhe të shkollave të mesme dhe universiteteve, lëndët zhvillohen në gjuhën shqipe, ndërsa gjuha angleze përfshihet në kurrikulat e shkollave si një gjuhë e dytë. Me caktimin e gjuhës angleze si gjuhë ndërkombëtare për komunikim si dhe me përdorimin e saj në mbarë botën, janë të shumta kolegjet dhe universitetet të cilat po ofrojnë kurse të ndryshme të gjuhës angleze studentëve të tyre, në mënyrë që ti shtojnë ata që të bëhen të aftë në karrierën e tyre të ardhshme. Në UPT, studentët e kanë të shtrirë programin e gjuhës së huaj, vetëm semestrin e parë të vitit të parë, në pjesën më të madhe të kurseve dhe ky sistem i tillë i shpërndarjes së orëve është bërë sipas Sistemit të Bolonjës¹⁷¹.

Studentët në të gjitha fakultetet e UPT-së punojnë me tekstin “Engineering”, një metodë e Express Publishing, i cili trajton tema të ndryshme të teknologjisë, por ne i pajisim ata gjithashtu me materiale shtesë të cilat bazohen në degën të cilën ata studiojnë, të tilla si materiale mbi elektronikën, informatikën dhe telekomunikacionin (në varësi të fushës së studimit). Këto materiale sigurohen nga burime të ndryshme në rrjet dhe zgjidhen sipas nevojave të studentit. Qëllimi është përmirësimi i gjuhës së profesionit në gjuhën angleze si dhe për një komunikim të suksesshëm në profesionin e tyre të ardhshëm. Përdorimi i këtyre mënyrave për gjetjen e informacionit në gjuhën e profesionit, shpesh herë është tepër i vështirë, për arsye se gjuha angleze zhvillohet që në semestrin e parë të vitit të parë dhe studentët përballen me këto terma për herë të parë, (madje pa punuar as edhe një herë tjetër më parë) me terma të profesionit në gjuhën angleze. Duhet të theksojmë këtu faktin

¹⁷⁰Duddely-Evans, T& St John, M. J.(1998). Developments in English for Specific Purposes: A *multi-disciplinary approach*. Cambridge:Cambridge University Press. fq-125

¹⁷¹Më 18 Shtator 2003 Shqipëria nënshkroi zyrtarisht Deklaratën e Bolonjës duke u bërë kështu pjesëmarrëse me të drejta të plota në një proces që ka filluar që në vitin 1999 dhe që ka si qëllim final krijimin e një HEAL. Kjo do të thotë që sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri të reformohet në bazë të standardeve të shpalluara dhe të pranuar tashmë nga vendet anëtare të procesit të Bolonjës duke e bërë atë të krahasueshëm dhe të përputhshëm me sistemet e tjera evropiane të arsimit të lartë.

se lëndët të cilat zhvillohen në vit të parë janë ato të formimit të përgjithshëm e jo lëndët e profesionit.

Pasi kanë studiuar për 14 javë tekste me terma të inxhinierive dhe terma të përgjithshëm në gjuhën angleze, studentët e kanë marrë një bazë të mirë të gjuhës së inxhinierisë por niveli i tyre në anglisht nuk është aq shumë i mjaftueshëm, pasi periudha e vënë në dispozicion për mësimin e saj është tepër e shkurtër. Ne jemi duke u përpjekur për të negociuar me departamentet e tjera në universitet në mënyrë që gjuha e huaj të ketë shtrirje gjatë tri viteve të studimeve të nivelit Bachelor dhe në këtë mënyrë studentët do të marrin baza të mjaftueshme të aftësive të tyre të inxhinierisë në gjuhën angleze e cila do t'i ndihmojë ata në profesionin e tyre në të ardhmen.

Por, një nga pengesat me të cilën përballemi që në fillim të vitit akademik është fakti që studentët vijnë në universitet me baza dhe nivele të ndryshme të gjuhës së huaj, madje ka dhe një pjesë të mirë të tyre që nuk kanë bërë ndonjëherë gjuhë angleze në shkollë të mesme, apo kanë bërë gjuhë tjetër. Niveli i metodave është B1/B2/C1, ku fokusi janë termat teknik, si edhe fjalori për këtë lloj gjuhe.

Një problem tjetër është fakti se ka një mungesë të laboratorit të studimeve të gjuhës angleze, e cila e bën e më të vështirë për studentët për të marrë informacionin dhe në mënyrë që ata të gjejnë informacion në lidhje me profesionin e tyre në faqet e internetit apo burime të tjera të ndryshme. Pasi kanë gjetur materialin, ata punojnë me fjalorin duke gjetur fjalë dhe terma të reja si dhe duke analizuar tekstin. Koncepti i nevojave të studentit është një nga kriteret themelore e cila është adaptuar dhe vlerësuar në ESP. “Që një kurs ESP-je është i bazuar në analizën e nevojave, e cila ka për qëllim që të specifikojë atë që studentët mund të komunikojnë me një nivel mesatar të gjuhës angleze”. Por, pyetja që ngrihet është fjala “nevojat”?¹⁷²

4.2.1. Përcaktimi i termave

Kur mundohemi të përcaktojmë kuptimin e termit “nevojat”, pikë së pari, shumë specialistë bien dakord që kjo fjalë mund të përmbajë kuptime të ndryshme dhe për rrjedhojë kuptohet në mënyra të ndryshme, duke marrë parasysh faktin se shumë pjesëmarrës janë të përfshirë në ndarjen e kurseve të EPS-së, duke emërtuar institucionet të cilat organizojnë kurset e gjuhës, mësuesit e gjuhës, studentët.

Sipas Chambers¹⁷³. ka një varietete të gjerë përkufizimesh që i huazojmë nga fjalori. Në fakt, kjo fjalë përmban në vetvete si ambiguitetin, ashtu edhe jo saktësinë; është gjithashtu një term i cili përkufizohet edhe me fjalën dëshirë; mund të mbulojë një gamë të gjerë nevojash, dëshirash dhe mangësish; “Është tërësish e qartë që termi “nevojë” është ambig dhe “jo i saktë”. Kjo pasaktësi terminologjike na çon në një shkapërderdhje të termave që kanë lidhje me fjalën “nevojë”, por që nuk janë të njëjta (zakonisht me disa mbiemra cilësorë), kërkesa ose kundërshtime të cilat janë trajtuar sikur janë pak a shumë të njëjta¹⁷⁴.

¹⁷²Robinson, P.(1991).ESP today: A practitioner’s guide. New York: Prentice Hall. Fq.3

¹⁷³Chambers, F. (1980). A re-evaluation of needs analysis. ESP Journal,1/1, fq. 25-33

¹⁷⁴ (Po aty. Fq.26)

Pyetja që shtrohet është pak a shumë se si mund ta bëjmë të mundur që ti përshtatim këto terma në mënyrë që të bëjmë një analizë e cila normalisht përfshin saktësinë shkencore. Për këtë arsye, Chambers¹⁷⁵ e përcakton në këtë mënyrë: “Vlera e analizës së nevojave nuk mund të përcaktohet qartë nëse ambiguiteti dhe mungesa e përcaktimit qartazi të termit nuk bëhen të qarta. Është e rëndësishme që si fillim të heqim termat e tepërt dhe së dyti të stabilizojmë qartë nivelet e ndryshme të nevojave, duke i ndarë edhe prioritetet midis tyre”.

4.3. Ndikimi i shkrimit teknik në kurset e inxhinierive të Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit, dega Inxhinieri Elektronike (Studim rasti)

Në kurset e gjuhës angleze në fakultetet e UPT-ës, një rëndësi e veçantë këtë vit ju kushtua edhe njëherë nga aftësive më të rëndësishme të mësimit që është shkrimi. Kjo pa dyshim lindi si nevojë dhe kërkesë e studentëve të Inxhinierisë Elektronike të cilët kishin mbaruar kursin e gjuhës së huaj dhe ishin në vit të tretë të studimeve në nivel Bachelor dhe ju drejtuan pyetësorë për të parë se çfarë do të ishte e nevojshme që të përmirësohej në kurset e viteve pasardhëse, mangësi apo probleme të cilat dilnin në pah pasi ata e kishin mbyllur ciklin e mësimit të gjuhës së huaj.

Në fakt, shkrimi duhet të luajë një rol thelbësor në edukimin e një inxhinieri dhe të përdoret në mënyrë efikase si një mjet pedagogjik në shumicën e kurseve të inxhinierive. Sa më shumë të vihet në përdorim mënyra e të shkruarit, aq më të mëdha krijohen mundësitë teknike në programet e inxhinierive. Lidhur me këtë, ne shpesh u kërkojmë studentëve të përdorin fjalë për përshkrimin e koncepteve; kështu ata motivohen të zhvillojnë një sërë idesh lineare, logjikisht të lidhura, që i ndihmojnë ata në përvetësimin e këtyre koncepteve. Kështu, çdo student duhet të mendojë me kujdes dhe në detaje. Detyrat që lidhen me shkrimin ndërthuren me materiale sipas fushës së studimit, ku studentët realizojnë punë analizuuese dhe projektuese. Gjithashtu, përmes këtyre detyrave ne jemi në gjendje të kontrollojmë mënyrën se si këta studentë mendojnë dhe të përcaktojmë nivelin që arrin studenti me anë të të kuptuarit. Ne e shikojmë këtë kontroll veçanërisht të rëndësishëm si një mjet vlerësimi në një mjedis edukimi ku kompjuterët, që përdoren gjerësisht në ditët e sotme, mbulojnë një mungesë të procesit të të kuptuarit të studentëve.

Një pjesë e konsiderueshme e studentëve janë të mendimit që programet 1/2-vjeçare janë plotësisht të papërshtatshme dhe që për të diplomuarit të kërkohet një program më i gjatë studimi, ku 1 ose 2 vitet shtesë të mund të përdoren për fusha të tjera studimi ose për një edukim më të hollësishëm inxhinierik e shkencor. Të tjerë mendojnë dhe propozojë zëvendësimin e një sërë kurseve të inxhinierive me ato fakultative, duke përfshirë në to ato lloj programesh të cilat do të mundësonin një eksperiencë arsimimi më gjithëpërfshirëse. Do të ishte me interes të veçantë edhe shtrirja e gjuhë së huaj në nivel Master e Doktoraturë.

Ky debat nuk është diçka e re. Po të kthehemi prapa në kohë, rreth 8 vjet më parë, gjuha e huaj shtrihet në dy vite akademike të plota, kështu që studenti kishte më tepër mundësi përvetësimi dhe praktike të gjuhës. Me hyrjen në fuqi të Sistemit të Bolonjës, gjuha e huaj

¹⁷⁵Chambers, F. (1980). A re-evaluation of needs analysis. ESP Journal,1/1, fq.25

u përqendrua vetëm në semestrin e parë të vitit të parë të studimeve Bachelor. Kjo bëri që programet të ngjishen dhe nuk mendojmë se është bërë një zgjedhje e drejtë, pasi gjuha e huaj e specialitetit ka një rëndësi të veçantë për studentët të cilët diplomohen në degët e inxhinierive dhe ky “cungim” i shtrirjes së gjuhës së huaj është në dëm të tyre.

Ne propozojmë ndryshime të thjeshta për kurset që Qendra e Gjuhëve të Huaja (QGJH) në Universitetin Politeknik të Tiranës, ti ofrojë studentëve të saj të degëve inxhinierisë.

Teza jonë është që përdorimi më i shpeshtë i procesit të shkrimit në kurset e inxhinierive ndihmon në thellimin dhe zgjerimin e njohurive teknike dhe arsimore. Shkrimi duhet konsideruar si një mjet ndihmës i cili përdoret gjithësisht në kurset e inxhinierive, si një mjet unik, i cili ndihmon çdo individ të mendojë me kujdes, e të zhvillojë argumente logjik. Më tutje, ne e shikojmë shkrimin si një mjet vlerësimi mjaft të vlefshëm në një mjedis edukimi ku avancimi i teknologjisë po i bën ata gjithmonë edhe më të paaftë dhe jo krijues.

Me këtë vëzhgim ne kemi dashur ti japim përgjigje Hipotezës 2: A duhet përfshirë shkrimi teknik në kurrikulën e gjuhës së huaj në mënyrë që të zhvillojmë kompetencën e shkrimit për kurset e inxhinierisë Elektronike?

Gjithashtu donim të tregonim dhe nxirrnim në pah atë se çfarë duhet përfshirë apo hequr nga planet dhe programet e kurseve të ESP-së në mënyrë që të përmbushen tërësisht nevojat e studentëve tanë. Gjithashtu, ne do të përpiqemi të tregojmë se përfshirja e shkrimit në kurset inxhinierike është një përvojë edukative me shumë premisa për çdo student. Në këtë mënyrë, detyrat që lidhen me shkrimin i bëjnë kurset inxhinierike më shumë përfshirëse si natyrë. Zgjedhja nuk është midis aftësive teknike apo atyre komunikuese, pasi të dyja mund të përmirësohen. Qëndrimi ynë tregon se integrimi i mësimin të shkrimit mund të sjellë si rezultat vetëm përmirësimin e edukimit në degët e inxhinierive.

Në fakt, nga një raport i ELAN (CILT 2000) thuhet se kompani të vogla dhe të mesme po humbasin një pjesë të mirë të bizneseve të tyre për arsye se të rinjtë e punësuar kanë mangësi njohurish gjuhe dhe aftësish ndërkulturore. Këto kompani po ndërgjegjësohen për faktin se vlera e mësimin të një gjuhe të huaj është e jashtëzakonshme dhe si rezultat janë duke adaptuar teknika për të lehtësuar komunikimin me klientët dhe furnizuesit jashtë kufijve¹⁷⁶

4.3.1. Parime pedagogjike të gjuhës për një shkrim të suksesshëm

Janë të shumtë studiuesit të cilët janë marrë me studimin dhe ndikimin që ka shkrimi në mësimin e gjuhës teknike. Ato na udhëheqin drejt një mënyre të saktë të aftësisë së shkrimit njohja e të cilave do i shërbente kësaj kategorie studentësh që të shmangnin gabime dhe të kalonin vështirësitë të cilat shfaqen në këtë zhanër. Një shkrimtar i gjuhës teknike është një profesionist i cili angazhohet me shkrimet teknike dhe prodhon

176

dokumentacionin teknik që i ndihmon njerëzit të përdorin një produkt apo shërbim. Ky dokumentacion përfshin ndihmën e përdorimit në internet, udhëzon përdoruesit si të përdorin e hartojnë manuale, letra, specifikimeve të projektimit, manuale të sistemit, planet e një projekti, planet e testit, korrespondencë biznesi, etj. Profesionistët të cilët merren me shkrimet teknike e krijojnë dokumentacionin në shumë forma, të tilla si të shtypura, të bazuara në rrjet, ose mjete të tjera elektronike.

Inxhinierë, shkencëtarë, dhe profesionistë të tjerë mund të prodhojnë shkrim teknik, por shpesh herë ia lënë në dorë një shkrimtari teknik profesionist për ta përpunuar, korrigjuar dhe formatuar materialin e shkruar në gjuhën teknike.

Shkrim teknik, i cili duhet të kuptohet lehtë dhe shpejt, përfshin:

- mbajtje shënimesh dhe e-mail;
- shkrimin e letrave (formale/jo formale);
- përpilimin e raporteve të punës;
- udhëzime;
- broshura dhe gazeta;
- kërkimit të punës;
- faqet e internetit;
- prezantimet në power point;
- grafikë

Në çdo rast, dokumenti i shkruar në gjuhën teknike duhet të jetë i matshëm, i saktë, dhe të kuptohet lehtë.

Në momentin që studentët tanë punësohen, a do ti duhet të përdorin shkrimin në profesionin e tyre? Përgjigja është “Po” kumbuese. Një arsye se përse duhet t’u mësojmë studentëve shkrimin teknik është në mënyrë që studentët të dinë se çfarë lloj dokumentesh duhet të shkruajnë në profesionin e tyre.

Sigurisht që kur studentët tanë të punësohen, nuk do iu duhet të shkruajnë ese, por atyre ju duhet të mësojnë se si të shkruajnë një ese gjatë kohës që studiojnë në shkollë të mesme; në momentin që fillojnë punë, esetë përfundojnë. Vendin e esëve e zënë shkrimi teknik, raportet, udhëzimet, propozimet, etj. Shkrimi teknik është lloji i komunikimit të gjuhës së shkruar për të cilën studentët tanë do të kenë nevojë kur të punësohen. Jo pa qëllim, nëse lexojmë kërkesat të cilat parashtrohen kur aplikon për një vend pune dhe rëndësi të veçantë zë kërkesa ku aplikanti duhet të jetë i aftë të komunikojë shumë mirë me gojë dhe me shkrim.

“Shkrimi i paqartë i kushton bizneseve amerikane shumë para-mbi një miliardë dollarë në vit, në bazë të një vlerësimi ... A e dini se shkrimi i impiantit bërthamor të Tre Mile Island i atribuohet pjesërisht procedurave të dobëta të mënyrës së shkruar?”¹⁷⁷ “Aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive është një aftësi që secili mund ta ketë qoftë kur mban një

¹⁷⁷Wicklen. Van Janet, 2000, Why Dick and Jane Can’t Write on the Job...and How to Help Them,” American Society of Training and Development.

ligjëratë të folur, apo kur i shpreh idetë e tua shefit tënd apo thjesht mënyra se si i rendit idetë kur je duke shkruar një e-mail apo duke lënë një mesazh zanor”¹⁷⁸.

Pedagogu që merret me shkrimin teknik përpiqet për të lehtësuar konceptet apo proceset komplekse si dhe për ta bërë më të qartë dhe të kuptueshëm një tekst për lexuesin. “Qëllimi përfundimtar i një dokumenti të veçantë është të ndihmojë lexuesit për të gjetur atë se çfarë ata kanë nevojë, të kuptojnë se çfarë ju duhet dhe të përdorin materialin në mënyrë të përshtatshme”¹⁷⁹. Për të arritur këtë qëllim, duhet të kuptojnë mënyrën se si të do ta përdorë audienca materialin dhe si do ta lexojë atë. Në fillim duhet bërë një analizë e audiencës e cila ndihmon të përcaktojë se çfarë kërkon ajo audiencë nga një dokument i caktuar¹⁸⁰:

Kur analizojmë audiencën duhet të ngremë këto pyetje:

- Kush është audienca e synuar?
- Cilat janë karakteristikat demografike?
- Cili është roli i audiencës?
- Si ndihet lexuesi në lidhje me temën e trajtuar?
- Çfarë forme të shkrimit pret lexuesi?
- Cilat janë detyrat që i dalin lexuesit?
- Cili është niveli i njohurive që ka lexuesi?
- Cilët janë faktorët të cilët ndikojnë në situatën e caktuar?

Analiza e saktë e audiencës na ofron një sërë udhëzimesh të cilat i japin formë përmbajtjes së dokumentit, hartimit dhe prezantimit (sistemet ndihmë online, website ndërvepruese, manualët e përdorimit, etj), si dhe i japin tonin e duhur njohurive të nivelit.

Qëllimi i referohet funksionit që ka një komunikim i veçantë. Kur je në rolin e një pedagogu ESP dhe në këtë rasti i cili merret me shkrimin teknik, atëherë duhet të analizojmë dhe të kuptojmë se cili është qëllim që ka një dokument i shkruar. Përcaktimi nëse një komunikim ka për qëllim të bindë lexuesit për “të menduar apo për të vepruar në një mënyrë të caktuar, për t’u mundësuar atyre mënyrën se si të kryejnë një detyrë, ti ndihmojë ata të kuptojnë diçka, si dhe të ndryshojnë qëndrimin e tyre¹⁸¹”. Ai na udhëzon se si të formatojmë komunikimin dhe llojin e komunikimit që ata zgjedhin (sistemet ndihmë online, propozimet, etj).

Konteksti nënkupton rrethanat fizike dhe mjedisore në të cilat lexuesi përdor shembullin e komunikimit, si p.sh në klasë, në zyrë në një fabrikë prodhimi, montimi, apo në kulmin e krizës së një kompanie të caktuar. Kuptimi i kontekstit të një situatë na tregon mënyrën se

¹⁷⁸“What You Need to Know About Career Planning,” 2002.

<http://careerplanning.about.com/cs/importantskills/2002>

¹⁷⁹Riordan, Daniel (2005). Technical Report Writing Today. Boston, MA: Wadsworth Cengage Learning. fq. 606

¹⁸⁰(Po aty)

¹⁸¹ Kostelnick, Charles (2011). Designing Visual Language. New York, NY: Longman. Fq.400.

si studentët e përdorin komunikimin. Kjo njohuri ndikon në mënyrën se si pedagogu e formaton komunikimin.

Hartimi i dokumentit është një përbërës i shkrimit teknik i cili ndikon në lexueshmëri dhe mënyrën e përdorimit. Sipas një eksperti, shkrimtarët teknik përdornin gjashtë strategji të projektimit për të planifikuar dhe për të krijuar komunikimin teknik: marrëveshjen, theksin, qartësinë, ngjeshjen, tonin, dhe etikën.

Rregullimi ka të bëjë me rendin dhe organizimin e elementeve vizuale në mënyrë që lexuesit të mund të shohin strukturën e tyre – mënyrën se si ata rrinë bashkë në grupe, se si ndryshojnë nga njëri-tjetri, dhe se si krijojnë shtresat dhe hierarkitë. Kur merren me rregullim shkrimtarët teknik shohim se si të përdorin titujt, listat, grafikët, dhe imazhet për të rritur mënyrën e përdorimit.

Theksi i referohet mënyrës se si një dokument radhit seksione të rëndësishme përmes famës apo intensitetit¹⁸². Kur e marrin në konsideratë theksin, shkrimtarët teknik venë në pah mënyrën se si ata mund ti tregojnë lexuesit seksione të rëndësishme, vërejtje, këshilla të dobishme, etj., përmes përdorimit të vendosjes së pjesëve me shkronja të zeza, ngjyra, dhe llojin e madhësisë së shkrimit të përdorur.

Qartësia i referohet strategjive që “ndihmojnë marrësin të deshifrojë mesazhin, për ta kuptuar atë sa më shpejt dhe plotësisht, dhe kur është e nevojshme, për të reaguar pa kundërthënie.”¹⁸³. Kur marrim në konsideratë qartësinë, duhet të përpiqemi për të reduktuar zhurmën vizuale, të tilla si raportet e kontrasteve të ulëta, listat tepër komplekse ose grafikët, dhe pjesët e palexueshme, të cilat mund ta pengojnë studentin që të kuptojë materialin.

Ngjeshja i referohet “pjesës më të madhe vizuale dhe të ngatërruar¹⁸⁴ të projektimit, për shembull, numri i titujve dhe listave, linjat dhe kutitë, detaje të vizatimeve dhe tregues i të dhënave, madhësia variacionet, zbulurim i tepërt, dhe ndarjet e tekstit”¹⁸⁵. Ne duhet ti marrim parasysh të gjitha këto strategji të projektimit për t’u siguruar që studentët mund ta përdorin pa problem një dokument.

Ton do të thotë tingull ose ndjesia e një dokumenti. Lloji i dokumentit dhe audiencia dikton se komunikimi duhet të jetë formal dhe profesional, ose gazmor dhe me humor. Përveç zgjedhjes së gjuhës, toni i komunikimit teknik duhet vendosur nëpërmjet përdorimit të hapësirës, imazheve, etj.

Etosi është shkalla e besueshmërisë që gjuha vizuale arrin në një dokument¹⁸⁶. Këtu duhet të përpiqemi për të krijuar dokumentacione profesionale dhe pa gabime për të krijuar besueshmëri me audiencën.

Për t'u mësuar studentëve shkrimin e teknologjisë, duhet të zotërojmë aftësi shumë të forta të komunikimit me shkrim, dhe pasioni që kemi për mësimdhënien me siguri do të na ndihmojë për ta arritur këtë qëllim. Që të shkruash në gjuhën teknike, ndoshta nuk mund

¹⁸²Po aty

¹⁸³ Po aty

¹⁸⁴Po aty

¹⁸⁵ Po aty

¹⁸⁶Kostelnick, Charles (2011). *Designing Visual Language*. New York, NY: Longman. fq. 400.

të jetë e nevojshme që të bësh një një arsimim të specializuar, por arsimi dhe përvoja janë domosdoshmëri për disa fusha dhe në fushën e Inxhinierisë Elektronike ku ne kemi bazuar edhe studimin tonë kjo aftësi ishte një domosdoshmëri.

4.3.2. Objekti i studimit

Në këtë pjesë të studimit do i japim përgjigje hipotezës së parë (H1) të ngritur nga ne në fillim të studimit:

H2: A duhet përfshirë shkrimi teknik në kurrikulën e gjuhës së huaj në mënyrë që të zhvillojë kompetencën e shkrimit për kurset e inxhinierisë Elektronike?

Për vërtetimin e kësaj hipoteze ne kemi bërë një studim me anën e intervistave dhe pyetësorëve ku kemi përfshirë studentët e vitit të tretë Bachelor të FTI-së, dega Elektronikë, të cilët i kishin mbyllur studimet e tyre në lëndën e gjuhës së huaj. Atyre ju drejtua një pyetësor i cili kishte për qëllim të bënte një pasqyrë të asaj se çfarë mendonin studentët se duhej përfshirë më tepër në orën e mësimit të gjuhës së huaj. Ky sondazh u zhvillua me këtë grup studentësh për arsye se, meqenëse këta studentë e kishin zhvilluar lëndën e gjuhës së huaj në vit të parë, atëherë kur akoma nuk kishin filluar të mësonin edhe vetë lëndët e specialitetit të degës së tyre, do të kishin ide më të qarta se çfarë do ju duhej përgjatë rrugës së studimeve të tyre të mëtejshme. Kur je një student në vit të parë, nuk mund të kesh të qartë atë se çfarë do të nevojitet përgjatë realizimit të studimeve universitare. Për më tepër, dihet se këta studentë janë kontingjent i cili në fund të studimeve të vitit të tretë, janë në kërkim të një vendi pune dhe ata e ndjejnë më tepër se cilido tjetër student rëndësinë që ka zotërimi i një gjuhe të huaj në tregun e punës.

Studentëve ju drejtuan disa pyetje ku informacioni i marrë u bë shtysë në marrjen e vendimit të disa ndryshimeve në programet dhe organizimin e orës së gjuhës së huaj të specialitetit.

4.4. Analizë e rezultatit të sondazhit të kryer me studentët e vitit të tretë, dega Elektronikë

Kontekstin në të cilin u realizua sondazhi në fjalë si dhe gjetjet e tij po i analizojmë në vazhdim të këtij punimi, në mënyrë që të krijojmë një tablo sa më të qartë të situatës në të cilën ndodhen studentët që kanë mbyllur mësimin e gjuhës së huaj të profesionit dhe të arrijmë në rezultate konkrete të nismave që duhen marrë në favor të ndryshimeve pozitive të hartimit të plan/programeve të reja si dhe plotësimit të nevojave të studentëve që fillojnë të mësojnë gjuhën e huaj të profesionit në vitet e para. (shiko Shtojcën9).

- Pjesëmarrësit dhe të dhënat rreth tyre

Në këtë etapë studimore morën pjesë 57 studentë të viteve të treta, dega Elektronikë, Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit. Studentët u përzgjedhën nga kjo degë, për arsye se duhet të bënim krahasimin mbi mangësitë dhe përfitimet që këta studentë kanë rezultuar gjatë mësimit të gjuhës së huaj në vit të parë si dhe për të bërë të mundur përmirësimin e plan/programeve dhe materialeve që do i ofrohen studentëve të viteve të

para të kësaj dege. Studentët u përkisnin moshës 21-22 vjeçare dhe kishin një prejardhje heterogjene përsa i përket prejardhjes social-kulturore, ekonomike dhe formimit të tyre intelektual.


- **Mbledhja dhe analiza e të dhënave**

Kërkimi u bazua në grumbullimin e të dhënave të marra nga pyetëtori. Pyetëtori u konceptua në mënyrë që të përfshinte si fillim plotësimin e informacionit personal mbi studentët (gjinia, moshë, vendlindja). Më pas, kishte të bënte me pyetje të cilat i referoheshin gjuhës së huaj të specialitetit, mundësisë së përdorimit të kësaj gjuhe në ambientet e universitetit dhe jashtë saj, vështirësive që ata kishin hasur dhe mangësive që kishin nga mësimi i kësaj gjuhe. Pyetjet përfshinin edhe një analizë më reflektuese ku studentët dhanë mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi atë që ata mendonin se duhej hequr apo shtuar në mënyrë që studentët të cilët do të uleshin në bankat e universitetit në vitet e para, të kishin rezultate më frytdhënëse teksa mësonin gjuhën e huaj të profesionit. “Qëndrimet e studentëve ndaj procesit mësimor në tërësinë e vet njihen në literaturën pedagogjike si një faktor thelbësor për mësimdhënie të suksesshme”¹⁸⁷.

- **Analiza e rezultateve**

Ashtu siç e bëmë të ditur edhe më lart, anketimi ynë u mbështet në disa shtylla kryesore nga të cilat u mblodhën këto rezultate:

a) *A e përdorin studentët gjuhën e huaj për studimet e tyre?*




Grafiku 1

¹⁸⁷John T.E. Richardson, “Instruments for obtaining student feedback: a review of the literature”, *Assessment & Evaluation in Higher Education*, vëll.30/4, Routledge, 2005, fq.387-415.

Nga analiza e përgjigjeve të tyre doli se 100% e studentëve e përdornin gjuhën e huaj në studimet e tyre. Këtu përfshihej, shfletimi i literaturës së huaj të cilën ua sugjeronin pedagogët e lëndëve të tjera për të thelluar studimet e tyre. Gjithashtu ishte edhe përdorimi i internetit ku ata gjenin burime dhe informacione të rëndësishme në përgatitjen e detyrave të kursit. Studentët e Inxhinierisë Elektronike janë përdorues të rregullt të kompjuterëve sepse dhe një pjesë e mirë e detyrave të kursit të cilat ata i përgatisin për lëndët e specialitetit, kërkojnë përdorimin e kompjuterit. Për rrjedhojë, përdorimi dhe zotërimi i gjuhës së huaj është një domosdoshmëri për këta studentë.

b) *A kanë vështirësi studentët në përdorimin e gjuhës angleze të profesionit dhe në cilat aftësi (lexim, dëgjim, shkrim apo e folur)?*




Grafiku 2

Nga rezultatet e përgjigjeve të tyre treguan se 36% e studentëve kishin vështirësi në menaxhimin e plotë të gjuhës së profesionit dhe ata kishin vështirësi kryesisht në leximin e teksteve, në përkthimin e tyre si dhe në mënyrën e përshtatjes së gjuhës së profesionit në gjuhën shqipe. 32% e studentëve shfaqën vështirësi në përgatitjen e detyra me shkrim siç janë përgatitja e raporteve apo projekteve në gjuhën angleze. Për sa i përket kompetencave gjuhësore të cilat u vinin në ndihmë studentëve për të komunikuar më mirë me të huajt, apo për të aplikuar në një vend pune me sipërmarrës të huaj, përgjigjet e mbledhura theksonin se vështirësitë më të mëdha studentët i kishin në aftësitë e ligjëratës së folur ku 21 % e studentëve hasnin vështirësi në mënyrën e të shprehurit. Për sa i përket aftësisë së dëgjimit, 11% e studentëve u shprehën se hasnin vështirësi në dëgjim. Kjo ndodhte veçanërisht në rastet ku personat me të cilët studentët komunikonin ishin të një kombësie jo anglisht folëse dhe kjo gjë e vështirësonte mënyrën e komunikimit mes tyre. Duke marrë shkas nga ky rezultat, besojmë se më tepër vëmendje dhe hapësirë i duhet kushtuar këtyre

aftësive kur ndërtojmë një plan-program për studentët të cilët mësojnë gjuhën e huaj të profesionit.

- c) Cilat nga aftësitë e mësuara në vit të parë, do të donin ti kushtojë më tepër vëmendje (leximit, shkrimit, dëgjimit apo ligjëratës së folur)?




Grafiku 3

Në këtë pyetje, përgjigjet e studentëve ishin të ndara në dy grupime, përgjithësisht, për sa i përket rëndësisë që ata i kushtonin aftësive. 37% e studentëve ishin të mendimit që shkrimi ka tepër rëndësi në formimin e tyre në fushën e inxhinierisë. Ata ishin të mendimit se gjatë periudhës në të cilën shtrihej gjuha e huaj, nuk kishin pasur kohën e mjaftueshme për t'iu dedikuar punëve me shkrim dhe e kishin nënvlerësuar atë. Tashmë, një pjesë e mirë e tyre janë të mendimit se i duhet dhënë më tepër hapësirë punëve me shkrim në formimin e tyre si inxhinierë të ardhshëm për arsye se do i duhej në formulimin e projekteve, raporteve, apo punës së tyre të përditshme. Për sa i përket aftësisë së gjuhës së folur, 28% e studentëve ishin të mendimit se i duhej dhënë më tepër përparësi gjuhës së folur që në përzgjedhjen e metodës së gjuhës së huaj. Gjuha e folur duhet të zinte një hapësirë të gjerë dhe ata të mund të kishin më tepër mundësi komunikimi. Sigurisht që një pjesë të konsiderueshme zinte edhe numri i përgjigjeve mbi leximin i cili ishte 23% dhe arsyeja që ata jepnin ishte se tekstet e vëna në dispozicion për lexim në librin që ata punojnë “Engineering”, janë tekste të shkurtra dhe ato duhet ti përshtaten standardeve të testimeve ndërkombëtare të gjuhës angleze si (TOEFL, IELTS), ku pjesët e leximit janë të gjata, të ndarë në paragrafë dhe me një gjuhë të komplikuar. Teksa studentët punojnë me materialet e tekstit, ata nuk hasin shumë vështirësi në analizimin e tyre, por kur punojnë me materiale të cilat ua sigurojmë ne si pedagogë, atëherë ata e shohin që kanë vështirësi në analizimin e tyre. Dëgjimi zinte 12 % të përgjigjeve të studentëve dhe theksi vihej në faktin se duhej të

bënin më tepër ushtrime me dëgjim (listening) gjatë orëve të mësimit. Kjo do t'i ndihmonte ata më tepër në zhvillimin e aftësive dëgjimore.


d) Çfarë mendimi kanë për shtrirjen në kohë të mësimit të gjuhës së huaj?



Grafiku 4

Sipas studentëve (e kemi shprehur edhe më lart), gjuhës së huaj të specialitetit nuk i është dhënë hapësira e duhur në hartimin e kurrikulave në nivel Universitar. Ndarja jo e saktë e orëve nëpër fakultete, cungimi i shtrirjes në kohë nga dy vjet në një semestër janë faktorë të cilët ndikojnë gjithashtu në një paraqitje jo frytdhënëse të gjuhës së huaj të specialitetit. Mbi 90% e studentëve ishin të mendimit që gjuha e huaj e ka të pamjaftueshme shtrirjen në kohë dhe 8% prej tyre mendonin se koha ishte e mjaftueshme. Për të bërë një ndarje të drejtë në kohë të gjuhës së huaj, duhet që të bëhen një unifikim i kreditove në rang universiteti ku gjuha e huaj të ketë të njëjtën ndarje dhe shtrirje të orëve për çdo fakultet.


e) Çfarë mendimi keni për vendin që duhet të zëjë gramatika në tekstet tuaja?



Grafiku 5

Duke u bazuar në përgjigjet e tyre mund të themi se koha që i duhet vënë në dispozicion gramatikës në orën e gjuhës së huaj të specialitetit duhet të zëjë një vend të rëndësishëm në hartimin e silabuseve të reja. Ajo është tepër e nevojshme në përgatitjen e studentëve të inxhinierisë së elektronikës. Pavarësisht se ata kanë bërë gramatikë që në arsimin 9-vjeçar, që përkon me kohën kur këta studentë kanë filluar të mësojnë gjuhë të huaj, sërish gramatika mbetet një pjesë e rëndësishme e mësimin të gjuhës angleze ku studentët hasin pengesa. Sigurisht që kur ata mësojnë gjuhën e profesionit, gramatika duhet të vijë e ndërthurur me motivet e një teksti në gjuhën teknike dhe duhet parë e aplikuar në këtë lloj zhanri, gjë e cila tingëllon si e re për studentët. Ata nuk janë mësuar ta shohin gramatikën në një kontekst shkencor, por vetëm letrar, ndaj këtu ka shumë për t'u punuar. Ndaj dhe gramatika duhet të jetë pjesë e tekstit mësimor, e jo vetëm e materialeve të sjella në përdorim nga pedagogu. Teksti Engineering nuk përfshin gramatikë në përbërjen e tij. (shiko shtojcënku kemi shkëputur një mësim nga Engineering).

- f) Si do t'i vlerësonit aftësitë tuaja për sa i përket të dhënave të mëposhtme në kompetencën e shkrimit teknik? (Plotëso duke vendosur numrin përkatës në një shkallë ngjitëse: 1- I pa mjaftueshëm; 2- mjaftueshëm; 3- mirë; 4-shumë mirë)




Grafiku 6

Në bazë të rezultateve, në këtë pikë të pyetësorit, rezultoi se studentët kishin shumë mangësi përsa i përket shkrimit dhe shtrirjes së tij në kurset e inxhinierive. Në përgjigjet e tyre shohim se pjesa e shkrimit ku studentët ndiheshin më mirë ishte shkrimi i eseve dhe kjo për arsye se studentët e kanë trajtuar esenë në silabuset e shkollave të mesme. 79% e studentëve u përgjigjën se kishin aftësi shumë të mira në krijimin e eseve. Rezultoi dhe një pjesë e vogël studentësh prej 3% që nuk kishin marrë ndonjëherë leksione mbi shkrimin e eseve por ata gjatë intervistave janë shprehur se në shkollë të mesme kishin bërë vetëm hartime. Një tjetër pjesë e shkrimit ku studentët ndiheshin mirë dhe që kishin punuar më parë ishte përmbledhja e një materiali në gjuhë të shkruar. Po ashtu, me 42% të përgjigjeve rezultoi se studentët ishin shumë të aftë për të shkruar letra formale dhe jo formale. Kjo për arsye se pjesa më e madhe e studentëve e kishin zhvilluar në shkollë të mesme ose në kurset private që kishin bërë në gjuhën angleze. Për sa i përket shkrimit të një progres raporti, 89% e studentëve u përgjigj që kishin njohuri të pa mjaftueshme për ta aplikuar këtë lloj shkrimi. Edhe shkrimit të një artikulli teknik në gazetë, rezultati ishte 84% e tyre nuk kishin aftësitë e mjaftueshme për ta bërë. Një përqindje të lartë të pamjaftueshmërisë së aftësisë për të shkruar, në përgjigjet e studentëve rezultoi edhe përshkrimi i hapave të një procesi, ku 82% e studentëve thonin se nuk kishin bërë ndonjëherë më parë këtë lloj përshkrimi. Duhet të theksojmë këtu faktin se shkrimi dhe e folura në shprehjen e hapave të një procesi në gjuhën teknike, zë një pjesë të mirë në profesionin e inxhinierëve. Me 66% të përgjigjeve të studentëve rezultoi pamjaftueshmëria e njohurive të studentëve në përshkrimin e një produkti në gjuhën angleze.

Duke marrë parasysh këto faktorë, mund të themi se ka shumë për t'u bërë në drejtim të shkrimit profesional me studentët tanë të inxhinierive dhe theksi duhet vënë më tepër në shkrimet profesionale si përshkrimi i objekteve, hapat e një procesi, përshkrimi i një progres raporti, mënyra e shkrimit të një projekti, etj.

- g) Sa ndikon shkrimi në profesionin tuaj të ardhshëm?
1) nuk ndikon fare 2) mjaftueshëm 3) shumë



Grafiku 7

Sipas përgjigjeve të studentëve, në këtë pikë të pyetësorit, 73% e studentëve ishin të mendimit se mënyra se si ata shkruajnë, organizojnë mendimet e tyre dhe mënyra se si e shprehin atë në fjalë, është shumë e rëndësishme për profesionin e tyre. 24% e studentëve pohuan se shkrimi ka ndikim të mjaftueshëm dhe 3% e tyre mendonin se nuk ndikon fare. Kjo pjesë e studentëve të cilët mendojnë se shkrimi nuk ka fare rëndësi në edukimin e tyre, e kishin këtë mendim në fillim të vitit akademik, ku ata e justifikonin idenë e të punuarit me shkrim si një faktor të pa rëndësishëm në edukimin e tyre si inxhinierë të ardhshëm. Më pas, me kalimin e orëve mësimore në auditor, me punën e jashtëzakonshme me të cilën u përballën përgjatë këtij eksperimenti, ata ndërruan mendim. Dua të theksoj këtu faktin se, të gjithë studentët, në shkallën 100% u përfshinë tërësisht në këtë projekt. Ata u angazhuan me përkushtim në realizimin e detyrave, përgatitjen e tyre në klasë dhe gjithashtu me detyrat të cilat ju caktuan në shtëpi, si në mënyrë individuale, ashtu edhe në punën në çift apo në grup.

4.5. Pasqyrë e funksionimit të metodës Engineering

Metoda e vënë në dispozicion për studentët e viteve të para, “Engineering”, është e organizuar për të funksionuar në këtë mënyrë:

Le të marrim si shembull mësimin e parë i cili titullohet: “What is Engineering”¹⁸⁸? (shiko shtojcën 9). Si fillim, studentëve iu bëhen pyetje dhe janë të lirë të shprehën mbi temën e dhënë duke shfaqur njohuritë e tyre, në këtë rast mbi atë që dinë mbi fushën e inxhinierisë. Në fillim të mësimin ndodhet një rubrikë e cila quhet “Get ready” (Bëhuni gati). Studentëve i kërkohet që para se të lexojnë tekstin, të diskutojnë disa pyetje që kanë lidhje me temën e dhënë, si p.sh: 1) How does technology make your life easier? 2) Why are mathematics and physics important? 1. Në ç’menyrë jua lehtëson jetën teknologjia? 2. Përse matematika dhe fizika janë të rëndësishme?

Pasi studentët diskutojnë për rreth 7 minuta, atyre i kërkohet që të kalojnë në pjesën e Reading-leximit. Në këtë rast, tema e shtruar në formën e një artikulli të shkurtër reviste është: Today’s top careers, Engineering - Karrierat më të kërkuara sot në Inxhinieri. Studentëve i kërkohet që të bëjnë një skanim të tekstit, duke e parë atë në mënyrë diagonale nga lartë poshtë dhe duke krijuar një ide rreth tekstit. Në fillim, studentët ishin mësuar (nga shkolla e mesme), që të lexonin tekstin, më pas të lexonin pyetjet dhe më pas sërish tekstin për të gjetur përgjigjet e pyetjeve. Studentëve i sugjeroj që të përqendrohen në ndarjen e paragrafëve, duke theksuar faktin se ideja kryesore ndodhet në fillim apo fund të çdo paragrafi. Më pas ju sugjeroj që të nënvizojnë fjalët kyçe, ato me të pjerrëta, të errëta apo data dhe emra të përveçëm që dalin në tekst. Më pas studentët përpiqen që ti japin përgjigje pyetjeve pa e lexuar akoma tekstin (try to guess). Pasi e lexojmë tekstin së bashku, tre apo katër studentë, në varësi të paragrafëve, merremi me analizimin e fjalëve të reja apo përkufizimin e termave në gjuhën shqipe. Viojmë me ushtrimet ku ju kërkohet studentëve të zgjedhin përgjigjen e duhur (Read this magazine article and then choose the correct answer a, b, c or d) – (Lexoni këtë artikull gazete dhe zgjidhni alternativën e duhur a, b, c apo d).

Ushtrimi i tretë trajton çështjen e fjalorit të dalë nga teksti që studentët kanë lexuar. Në këtë rast, ushtrimi e ka të organizuar analizën e fjalorit në mënyrë të tillë që studentët duhet të zgjedhin fjalinë e cila e përdor saktë fjalën e nënvizuar, P.sh:

Exercise 3 – Ushtrimi 3

Check the sentence that uses the underlined word correctly - Zgjidh fjalinë e cila e përdor saktë fjalën e nënvizuar.

1 ___ A A machine is a branch of instruction or learning.

___ B To design something is to plan hoë it ëill llok and function.

Exercise 4 – Ushtrimi 4

Ushtrimi i katërt ka të bëjë sërish me fjalorin ku në këtë rast i kërkohet studentëve që të vendosin fjalën e duhur në fjali duke përzgjedhur nga fjalët e dhëna, P.sh

Use the words from the word bank to fill in the blanës – Përdor fjalët e dhëna për të plotësuar vendet bosh.

¹⁸⁸Në shtojcën 9 kemi paraqitur një model të mësimin të parë të shkëputur nga metoda Engineering.

Mathematics engineering engineer physics disciplines

1. _____ includes studying addition and division.
2. _____ investigates how mass and movement interact.

Exercise 5 – Ushtrimi 5

Ushtrimi i pestë trajton anën e dëgjimit. Sigurisht që kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e cila i ndihmon studentët të dëgjojnë mënyrën e shqiptimit të fjalëve të reja, ti japin theksin e duhur dhe shqiptimin e saktë. Në këtë ushtrim studentët dëgjojnë artikullin që trajtuan në fillim të orës.

Exercise 6 – Ushtrimi 6

Edhe ky ushtrim ka të bëjë me dëgjimin, por në këtë rast studentët dëgjojnë një bashkëbisedim ndërmjet një inxhinieri dhe një të sapo punësuar dhe ata duhet të shënojnë me T (True) nëse fjalitë janë të vërteta dhe me F (False) nëse fjalitë nuk janë të vërteta. P.sh

Listen to a conversation between an engineer and a new employee. Mark the following statements as true (T) or false (F). – Dëgjoni një bisedë ndërmjet një inxhinieri dhe një punonjësi të ri. Shënoni fjalitë e mëposhtme me T nëse janë të vërteta dhe me F nëse nuk janë.

- 1 ___ The woman just left the engineering lab.
- 2 ___ The woman is there to inspect a design.
- 3 ___ The man designed the vehicle's engine.

Exercise 8 - Ushtrimi 8

Ky ushtrim ka të bëjë me pjesën e gjuhës së folur (Speaking). Këtu studentëve i kërkohet që të luajnë me role dialogun të cilin e dëgjuan dhe e plotësuan duke bërë në këtë mënyrë edhe anën praktike të punës. P.sh

Speaking

With a partner, act out the roles below, based on task 7. Then switch roles.

Zgjidh një partner dhe luaj rolet e dhëna më poshtë bazuar në ushtrimin 7. Më pas ndërroni rolet.

Use language such as: Përdorni gjuhë të tillë si:

- Do you know where the ___ is? A e dini se ku ndodhet ___?*
I'm here to analyse the ___. *Kam ardhur këtu për të analizuar ___.*
But we're still working on ___. *Por ne jemi ende duke punuar mbi ___.*

Student A: You are a new employee. Talk to student B about:

Studenti A: Ju jeni një i sapo punësuar. Fol me Studentin B rreth:

- Location of a room vendndodhjen e dhomës
- Your project për projektin tuaj
- Student's B project për projektin e studentit B

Make up a name for the employee. Vendosi një emër punëtorit

Student B: You work with student A, answer his or her questions. Make up a name for the employee.

Studenti B: Ju punoni me studentin A dhe përgjigjuni pyetjeve të tij/saj. Vendos një emër për punëtorin.

Pasi studentët e përgatisin dialogun për jo më shumë se tre minuta, ata fillojnë ta luajnë atë me role. Sigurisht që në këtë fazë fillimi të vitit akademik, ku ky është edhe mësimi i parë, shohim një hezitim dhe ngurrim nga ana e studentëve për tu shprehur për arsye se ata nuk njihen me njëri-tjetrin dhe i druhen frikës së paragjykitimit apo vlerësimit negativ. Këtu i inkurajojmë studentët duke ju thënë se nëse shpreheni dhe gaboni nuk do të penalizoheni, përkundrazi, kjo na bën ne që të nxjerrim në pah vështirësitë e mundshme dhe të shpjegojmë e analizojmë mënyrën e duhur që duhet përdorur. Nëse ju nuk shpreheni, edhe ne e kemi të vështirë të kuptojmë atë që ju nuk dini e për rrjedhojë nuk qartësohemi. “Practise makes perfect”, që do të thotë që sa më shumë të praktikohesh atë më tepër aftësohesh.

Në këtë fazë të mësimi, duke qenë se dhe studentët nisin të shprehen, atëherë ata shfaqin edhe gabimet apo mangësitë gramatikore në gjuhën e folur. Meqenëse kjo metodë nuk e përfshin gramatikën¹⁸⁹, atëherë na del si detyrë neve si pedagogë që të shpjegojmë edhe anën gramatikore. Në përgjithësi, orët e para merremi me gramatikën në përgjithësi duke shpjeguar funksionin e kohëve, trajtave e mënyrave të ndryshme gramatikore, e më pas, jemi munduar që të përshtatim gramatikën e caktuar që përputhet me temat e trajtuara në tekst. Gramatikën ia ofrojmë studentëve edhe në formën e materialeve të fotokopjuara, materiale të nxjerra nga interneti apo literatura të ndryshme ku janë të ndërthurura teoria mbi një temë të caktuar të gramatikës, bashkë me ushtrimet përkatëse.

Ushtrimi i fundit që trajtohet, është shkrimi (Writing). Ky lloj ushtrimi, zakonisht i jepet studentëve si detyrë me shkrim për ta zhvilluar në shtëpi dhe për ta sjellë orën e ardhshme. Në fakt, unë aplikoj me studentët e mi korrespondencën me postë elektronike (e-mail), ku studentët e nisin detyrën dhe unë ua kthej të korrigjuar. Afati i dorëzimit dhe korrigjimit është brenda javës që zhvillohet mësimi. Në këtë mënyrë, që herën e parë përballemi me vështirësinë e kësaj korrespondence se një pjesë e madhe e studentëve nuk kanë një adresë e-maili. Ata madje as nuk dinë se si të shkruajnë një e-mail dhe mënyrën se si duhet bërë detyra. Por kjo vështirësi kalon që me herën e parë dhe më pas korrespondenca vazhdon deri në fund të semestrit, aty ku mbaron edhe lënda e gjuhës së huaj. Studentët të cilët nuk

¹⁸⁹Tek analiza e bërë rreth pyetësori mbi metodën “Engineering”, kemi nxjerrë në pah nevojshmërinë e përfshirjes së gramatikës në tekstin që studentët kanë në përdorim.

kanë mundësi logjistike, si p.sh kompjuter, atëherë ata e dorëzojnë detyrën në formën e një letre. P.sh

Exercise 9 Writing

Ushtimi 9 Shkrimi

You are an engineer. Use the conversation from task 8 to complete a diary entry about your first day at a new job (100-120 words). Write about:

- someone you met and what they do
- what you are doing in your new job
- a room you were shown to
- use today's date

Ju jeni një inxhinier. Përdorni bashkëbisedimin e ushtrimit 8 për të plotësuar faqen e ditarit me përshtypje nga dita e parë e një pune të re (100-120 fjalë).

- Dikë që takuat dhe me se merrej
- Me se do merresh në punën e re
- Përshkruaj ambientet
- Përdor datën e sotme

Kjo që parashtroam më lart, është një orë tipike se si zhvillohet gjuha angleze teknike në fakultetet e inxhinierisë elektronike. Sigurisht që ky ishte vetëm mësimi i parë dhe po të vëmë re, teksti, ushtrimet dhe gjuha e përdorur është e një niveli A2. Duhet të kemi parasysh që metoda është e ndarë në 3 pjesë ku nga 45 Units, 15 Units janë niveli A2, 15 niveli B1 dhe 15 të tjerat niveli B2 (ndarje kjo sipas KPER). Format i shtrirjes së orës së mësimi është i njëjtë, me të vetmin ndryshim që niveli i gjuhës së përdorur, fjalorit, ushtrimeve vjen duke u vështirësuar. Tekstet bëhen me një fjalor më teknik, të pasura me shprehje të shumta të gjuhës së specialitetit. Edhe ushtrimet të cilat trajtojnë shkrimin vështirësohen duke ju kërkuar studentëve të bëjnë detyra të ndryshme me shkrim, si ese, letra formale jo formale, të shpjegojnë hapat e një procesi etj.

4.5.1. Ri-organizimi i orës së mësimi pas sondazhit

Pasi kryem këtë sondazh (muaji shkurt 2014), menduam që në bazë të analizës së përgjigjes së studentëve të bazoheshim për të bërë një klasë eksperimentale. Kjo klasë u mendua vetëm për vitin akademik 2014-2015, ku ramë dakord që orët të cilat studentët e elektronikës së vitit të parë do ti kishin në dispozicion të laboratorit, ti vendosnim në dispozicion të praktikës së njërës prej aftësive. Ajo u përzgjedh në bazë të përqindjes më të lartë të kërkesave të studentëve dhe ishte shkrimi.

- Si u organizua ora e mësimi?
- Çfarë materialesh u përzgjedhën e mbi çfarë bazash?
- Cilat ishin reagimet e studentëve dhe rezultatet e arritura?

William Zinsser¹⁹⁰, e paraqet shkrimin si një mjet efektiv mësimor për çdo disiplinë, duke filluar nga artet dhe muzika deri tek matematika dhe fizika. Ai përpiket të bindë lexuesin se një shkrim i realizuar mirë, është një synim që inxhinierët, matematicienët dhe shkencëtarët duhet të arrijnë, ashtu si artistët.

- **Si u organizua ora e mësimi?**

Lëndët që studentët zhvillojnë në semestër të parë të vitit të parë akademik janë: matematikë, fizikë, kimi, gjuhë e huaj, pra janë lëndë të karakterit të formimit të përgjithshëm dhe jo lëndë të mirëfillta të profesionit. Që në javën e parë, nisëm t'i kërkonim studentëve të dorëzonin detyra që kishin lidhje me shkrimin. Në detyra, studentëve ju kërkua të mblidhnin informacion rreth materialeve dhe temave që trajtonin në çdo mësim. Nëpërmjet detyrave studentët mund të vinin në zbatim mënyrat më efikase të marra gjatë mësimi në punën e tyre me shkrim, duke përforcuar në këtë mënyrë atë që ata kishin mësuar.

Në mënyrë që ti jepnim shkrimi hapësirën e nevojshme, ne përdorëm dy orët e laboratorit që kanë në një javë mësimore studentët, për të aftësuar stilet e shkrimit. Në një orë tipike të shkrimit, studentëve ju parashtrohej zhanri i shkrimit për të cilin do të punonin. P.sh. kur trajtuam shkrimin e një letrë formale/jo formale, i vura në dispozicion studentëve dy letra. Ata duhet të bënin dallimin ndërmjet dy letrave, që në formatin e paraqitjes së letrave, mënyrën e shkrimit, gjuhën e përdorur, shkurtimet e përdorura etj. Pasi ky dallim bëhej i qartë për ta, atëherë i kërkoja që të punonin në palë dhe të bënin një format të tillë dhe ta lexonin në klasë. Edhe për detyrë shtëpie studentëve ju ngarkua që të bënin dy letra, një të formale (ku të aplikonin për një vend pune) dhe tjetrën jo formale ku ti drejtoheshin një miku apo familjari. Si fillim, kishte paqartësi në mënyrën e përzgjedhjes së gjuhës së përdorur, e sidomos kur bëhej fjalë për të shkruar gjuhën formale. Kjo mangësi vjen si rrjedhojë se studentëve nuk i është dashur deri tani që të aplikojnë për një vend pune apo të drejtojnë një letër formale diku dhe kështu që shfaqnin këto lloj vështirësish. Ndërsa për sa i përket gjuhës jo formale, ata e gjenin veten më mirë duke përdorur zhargonin e përditshëm. Vështirësia dilte vetëm në (outline), në paraqitjen e letrës, në vendosjen e adresës, marrësit apo dërguesit si dhe në ndarjen e paragrafëve.

Gjatë semestrit studentët plotësuan një sërë detyrash, ku secila u vlerësua për përmbajtjen logjike, qartësinë dhe stilin. Meqenëse studentët ishin të pasigurt për sa i përket hartimeve teknike pa ndonjë model paraprak të gatshëm, detyrat e para u shoqëruan me nga një shembull ku i paraqitëm studentëve një format të përshtatshëm që duhet të ndiqnin. (shtojca 10).

Disa studentë e patën të vështirë si fillim kur mendonin se do ju duhej të shkruanin në gjuhën teknike. Ata justifikoheshin me faktin se “nuk ishin marrë më parë me kësaj lloji fjalori e mënyrë të shkruarit”. Kishte studentë të tjerë të cilët e shihnin si sfidë dhe përshtateshin më lehtësisht. Sigurisht që ekziston pothuajse në çdo klasë një numër prej dy apo tre studentësh të cilët janë ndeshur edhe më parë me terma në gjuhën teknike pasi kanë kryer studimet e tyre në shkollë të mesme teknike/profesionale. Por me kalimin e orëve

¹⁹⁰Zinsser, 1988 William. Writing to Learn: How to Write—and Think Clearly about Any Subject at All. New York: Harper & Row,

mësimore, cilësia e detyrave me shkrim të disa prej tyre nisi të përmirësohej dukshëm dhe kundërshtitë filluan të zbehen.

Por rezultoi se shumë prej tyre u përmirësuan gjatë semestrit. Në kundërshtim me rezistencën e disa prej studentëve, pjesa më e madhe i mirëpritën detyrat që në fillim dhe i realizuan me vendosmëri dhe entuziazëm.

Puna e tyre u përmirësua vazhdimisht gjatë semestrit; shkrimet patën një rritje të nivelit të analizave kritike. Këta studentë ndërmorën hapa të mëdha duke i dhënë vlera gjuhës së huaj të profesionit dhe duke u bindur gjithnjë e më shumë për të mirat që ajo i siguron. Pavarësisht arsyeve, ata dukej se besonin në rëndësinë që ka shkrimi në edukimin e tyre inxhinierik.

Gjatë kursit shumë studentë pranuan se shkrimi i ndihmon për ta kuptuar lëndën në një nivel më të thellë. Ata u shprehën se “akti i të shkruarit i nxiti të mendojnë dhe kuptojnë pikërisht atë që ata donin”. Shumë studentë nuk arritën ti realizonin me sukses detyrat e tyre. Kjo pasi pjesa më e madhe nuk ishte akoma e bindur për rëndësinë që ka shkrimi në edukimin inxhinierik dhe si rrjedhim nuk u përpoqën mjaftueshëm. Duke u nisur nga cilësia e shkrimeve të tyre, mendoj se ato ishin shkrime fillestare e të thjeshta, pasi përsëritja është jetike për një shkrim të mirë. Në këto punë, edhe pse të varfra ka prova për mënyrën e të menduarit të studentëve.

Fakulteti i Inxhinierisë së Teknologjisë dhe Informacionit (FTI), sipas nesh, luan një rol qendror në korrigjimin e këtij keqkuptimi. Ne shihemi nga studentët si modele profesionale dhe si të tillë jemi pikërisht ne, ata që duhet ti bindim për rëndësinë e mësimit të gjuhës së huaj të profesionit si dhe të shkruarit. Në qoftë se studentët janë vazhdimisht të ekspozuar ndaj FTI-së që thekson rëndësinë e shkrimit në karrierën e tyre të ardhshme, ata mund të fillojnë të përpiqen që të përmirësojnë vlerat e tij. Ne jemi të hapur për një bashkëpunim në rang fakulteti e universiteti në mënyrë që ti gjendemi sa më pranë plotësimit të nevojave të studentëve dhe të hartojmë plan/programe bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesat e standardet e universiteteve të tjera si motra në Rajon, Evropë e më gjerë. Sigurisht që ky bashkëpunim nuk ka munguar, por duhet të punojmë drejt një ndërgjegjësimi më të gjerë, që dhe gjuha e huaj e profesionit të zërë vendin që meriton në kurrikulat e UPT-së.

4.5.2. Çfarë materialesh u përzgjedhën e mbi çfarë bazash?

Materialet e përzgjedhura për t’u përdorur në orën e aftësimin të shkrimit inxhinierik ishin në pjesën më të madhe, ushtrimet e metodës që studentët përdornin orën e seminareve, Engineering, si dhe të metodës Technology që ka qenë në përdorim tre vite më parë në të gjitha fakultetet e UPT-së. Ashtu siç e paraqitëm edhe më sipër, kur folëm për organizimin e orës së mësimin, në fund të çdo Unit, studentët kishin seksionin e shkrimit (Writing). Këto ushtrime, së bashku me materiale shtesë të përzgjedhura qoftë nga interneti apo edhe nga literatura të tjera bashkëkohore, i vihen në dispozicion studentëve për të përmirësuar nivelin e shkrimit dhe për t’ju bërë atyre më të lehtë mënyrën e përpunimit të materialit. Më poshtë po paraqesim disa modele ushtrimesh të trajtuara gjatë eksperimentit, p.sh:

-
1. Ushtrime të cilat kanë të bëjnë me zgjidhjen e një problemi të caktuar. Studentëve ju dha një figurë (si p.sh the Stirling engine, motorri me avull, shtojca 11) dhe ata duhej të vendosnin hapat e procesit në rendin e duhur duke u nisur nga figura e dhënë, apo udhëzime për përdorimin e një aparati (si p.sh Using a medical inhaler, Përdorimi i një aparati për njerëzit të cilët vuajnë nga hasma) dhe ata në këto lloj ushtrimesh duhej të vlerësonin nëse gjuha e zgjedhur për të udhëzuar përdoruesit e këtij aparati ishte e kuptueshme ose jo për një përdorues. Më pas studentëve u jepet një material me të dhëna (si p.sh the description of how to charge batteries for an electric wheelchair, Udhëzime se si të karikojmë bateritë e një karroce për paraplegjikë), ku ata duhej të paraqisnin me hapa në formën e një udhëzuesi që të ishte i vlefshëm dhe i qartë për përdoruesit e kësaj kategorie njerëzish.

Shembulli: Shtojca12

Një tjetër metodë e cila u aplikua me studentët në mënyrë që të mësonin të shkruanin saktë ishte (Notetaking) mbajtja e shënimeve. Kjo metodë e shkrimit iudhëzon dhe ndihmon ata në zhvillimin e një stili të mirë të orientuar të mbajtjes së shënimeve. Atyre ju dhanë detyra me shkrim për të bërë ushtrime të tilla si:

Exercise 1. – Ushtrimi 1

Use the conversation from the task above to complete the client's notes.

Përdorni bisedën nga ushtrimi i mëparshëm për të plotësuar shënimet e klientit.

Building Design – Skica e ndërtesës

Question: Why have _____?

Benefits: _____

Drawbacks: _____

Decision: _____

Exercise 2 – Ushtrimi 2 (Shtojca 13)

Use the bid sheet and the conversation from task given to complete the order form of your project. Make up a name for the engineer.

Përdor fletë ofertën dhe bashkëbisedimin nga ushtrimi i dhënë dhe plotëso formën e projektit tënd. Zgjidh një emër për inxhinierin.

Materials Order

Engineer Name: _____

Materials (check the box to order item):

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

Exercise 3 – Ushtrimi 3

Use the conversation from task given to complete the engineers notes.

Përdor bashkëbisedimin për të plotësuar shënimet e inxhinierit.

Tools Recommended

Tool 1: _____

Purpose: _____

Tool 2: _____

Purpose: _____

Selection: _____

Në këtë fazë të shkrimit, i kërkuam studentëve që në shënimet e tyre të përfshinin edhe diagrame, shifra (si përqindje, sasi), shprehje të matjeve, shënime mbi një intervistë pune, mbi një artikull gazete, si të bënin një porosi, si të shkruanin një raport pune, si të shkruanin një e-mail, si të mbanin shënime mbi informacionin e një seminari inxhinierik, si të shkruanin një artikull, si të përshkruanin hapat e një procesi teknik, etj.

2. Një tjetër lloj ushtrimi që aplikuar me studentët në mënyrë që të mund t'i ndihmonim për të bërë një shkrim të saktë, ishte edhe analiza e strukturës organizative të materialit që ata lexojnë. Pasi ata e kanë lexuar një material të dhënë, si p.sh Unit 7, Table and graphs me temë “Production progress report”¹⁹¹ “Progres raporti I prodhimit” (shih Shtojcën10) dhe më pas të punonin në të njëjtën mënyrë me shkrim. Ushtrime të tilla i ndihmuan studentët që të qartësoheshin në idetë e tyre dhe ta kishin më të thjeshtë të bënin analizën dhe referimin e materialit të përdorur. Ky është gjithashtu një stil i shkrimit që të ndihmon të shprehesh qartë dhe në mënyrë organizative. Për shmbull:

¹⁹¹Lloyd, Ch. Fraizer, a. James 2013, Career paths, Engineering, fq.16.

Student A: You need to make a graph. Talk to student B about:

Studenti A: Ju duhet të bëni një grafik. Fol me Studentin B rreth:

- graphs used already grafikëve të përdorur
- suggested graphs grafikëve të sugjeruar
- adding visual materials shtoni material pamore

Make up a name for your co-worker – Zgjidh një emër për bashkëpunëtorin

Student B: You are the student's a co-worker. Answer to his/her question.

Studenti B: Ju jeni bashkëpunëtori i studentit. Përgjigjuni pyetjeve të tij/saj

Writing - Shkrimi

Use the conversation from the given task to complete the engineer's review of a co-worker's report.

Përdor bisedën nga ushtrimi i dhënë për të plotësuar rishikimin e inxhnieirit mbi relacionin e bashkëpunëtorit.

GRAPH REVIEW

Name: _____

Report: _____

Problems: _____

Recommendations: _____

3. Një tjetër lloj ushtrimi që u aplikua me studentët ishte të përmblihdnin me fjalët e tyre (summary) e një tekst të cilin e kishin lexuar. Në këtë mënyrë ne testuam edhe zhvillimin e aftësive në parafrazim. Atyre ju kërkua që të shprehnin informacionin e marrë duke bërë një artikull me fjalët e tyre. Në këtë rast ne vlerësuam edhe aspektin se sa mirë e shprehin studentët informacionin e marrë me fjalët e tyre. Për shembull:

Studentët lexojnë një artikull me temë: Cleaning up Nuclear Power: Reprocessing spent fuel rods. Pastrimi energjisë bërthamore: Ripërpunimi i shufrave të karburantit(materiali në shtojcën 14).

Pasi e kanë lexuar materialin studentët mund ta shprehin atë me fjalët e tyre. Më pas, në seksionin Speaking, atyre u kërkohet:

With a partner, act out the dialogue from task 7 (shih shtojcën),then switch roles. Use language such as:

Me një partner, interpretoni dialogun nga detyra 7 dhe më pas ndërrooni rolet. Përdorni këto shprehje të tilla si:

I don't think reprocessing fuel rods...

I think it's a great idea! Why don't you like it?

Those breeder reactions create...!

Student A: You want to know what an engineer thinks about fuel rod processing. Talk to Student B about:

Studenti A: Ju doni të dini se çfarë mendon një inxhinier për përpunimin e shufrave të karburantit. Fol me Studentin B rreth:

- opinion about processing mendimi juaj rreth ripërpunimit
- support for opinion justifikim mendimin tënd

Student B: You are a nuclear engineer. Answer Student's A questions.

Studenti B: Ju jeni një inxhinier bërthamor. Përgjigju pyetjeve të studentit A.

Pasi studentët kanë punuar me këto tre pjesë, pra kanë lexuar dhe ritreguar me fjalët e tyre materialin e lexuar, kanë plotësuar bashkëbisedimin dhe e kanë aktruar atë me role të ndara, më pas kanë bërë një dialog dhe e kanë bërë me role edhe atë, vjen pjesa e shkrimit.

Writing - Shkrimi

You are trying to decide whether or not you support nuclear fuel rod reprocessing. Use the article and the conversation from task 8 to write about its pros and cons (100-120 words)¹⁹². Write about:

¹⁹²Burimi: Engineering textbook, 2013, Lloyd, Ch. Dhe Fraizer, A. James, fq 30

Ju po mundoheni të vendosni nëse ta përkrahni ripërpunimin e shufrave të karburantit bërthamor. Përdorni artikullin dhe dialogun nga ushtrimi 8 për të shkruar rreth anëve pozitive dhe negative të saj.

- Why nuclear fuel rod reprocessing is potentially dangerous
- How nuclear fuelrod reprocessing helps the environment
- How nuclear fuel rod reprocessing is more efficient than finding new uranium-235.

4. Një metodë tjetër e cila u aplikua për mësimin e shkrimit të saktë ishte edhe ajo e përshkrimit. Këtu përfshimë përshkrimin e grafikëve, matjeve, substancave, vendve, dhe objektve. Sigurisht që këtë metodë pune ne aplikua nga fundi i detyrave me shkrim për arsye se ky lloj interpretimi me shkrim kërkonte që studentët të ishin në nivel më të avancuara. Për shembull:

Studentët lexojnë një tekst që titullohet, *Engineering design method*¹⁹³. Në këtë rast artikulli i prezantuar është në formën e një e-mail. Studentëve u kërkohet që të përshkruajnë me shkrim një proces të bazuar në tekstin e lexuar. (shih shtojcën 15)

Writing: Shkrimi

You are an engineer working on a product design. Use the e-mail to write a description of the process (100-120 words). Write about:

- what the process of writing the design is
- what some considerations need to make are

Ju jeni një inxhinier që po punoni mbi skicimin e një produkti. Përdorni postën elektronike për të bërë një përshkrim të procesit (100-120 fjalë). Shkruaj rreth:

- çfarë është procesi i shkrimit të skicimit
- çfarë duhet pasur parasysh

5. Një lloj tjetër ushtrimi i aplikuar ishte kombinimi i fjalive të shkurtra në ato më të gjata. Kjo ju dha studentëve mundësinë për të praktikuar një koordinimin të saktë të fjalisë duke krijuar nga dy apo më shumë fjali të shkurtra, një fjali më të gjatë. Për shembull;

- Për të treguar veprime të cilat ndodhin menjëherë, ne përdorim *when* (Kur):

Action 1: The spring starts to unwind.

Action 2: The gears engage

When the spring starts to unwind the gears engage.

¹⁹³Burimi: Engineering textbook, 2013, Lloyd, Ch. Dhe Fraizer, A. James, fq. 17.

- Për të shprehur veprime të cilat ndodhin në të njëjtën kohë ne përdorim *as (ndërkohë)*:
Action 1: You walk
Action 2: The electric shoe charges batteries.
As you walk, the electric shoe charges batteries.
 - Për ti vendosur veprimet në renditje ne përdorim *before* (para) ose *after* (*pas*):
Action 1: The radio plays for 30 minutes.
Action 2: You have to wind it up again.
The radio plays for 30 minutes **before** you have to wind it up again.
6. Edhe plotësimi i ushtrimeve me shkrim ku përfshihej diktimi ishte një nga mënyrat që u praktikua me shkrim. Studentëve u jepej një fjali dhe ata vijonin duke e përfunduar atë ose plotësonin në vendet bosh. Në këtë mënyrë, ata zhvillnin imagjinatën dhe njihnin marrëdhëniet midis fjalive.
 7. Ashtu si në aftësitë e tjera, zhvillimi i shkrimit mund të rritet përmes përdorimit të mjeteve të përshtatshme vizuale siç janë ilustrimi i figurave, qarqeve, grafikëve etj. Le të shohim një shembull se si teksti Technology¹⁹⁴ përdor një diagram të ciklit të motorit me avull (Stirling engine) për të udhëhequr studentët në punën me shkrim. Studentët duhet vetëm të zgjidhnin kombinimin e saktë të elementeve dhe të shkruanin rreth funksionimit të këtij motori. (shih shtojcën 11)


Detyra me shkrim duhet të strukturohej me kujdes. Ata gjithashtu duhet të praktikonin dhe të përgatiteshin në çifte për t'iu përgjigjur pyetjeve që vijonin mbi faktorët e rëndësishëm në funksionimin e këtij motori. Ky lloj shkrimi u bë me ushtrime që u bazuan në një model të dhënë të cilin studentët e panë të ilustruar në figurë, vendosën informacionin në rendin e duhur duke krijuar kështu një lidhje logjike të materialit duke përshtatur procesin e figurës së dhënë dhe pastaj u zgjeruan në analizën e përgjigjeve të pyetjeve të shtruara për diskutim. Më pas, atyre ju prezantua një figurë, ku i kërkohej që si fillim të gjenin (guessing) se për çfarë mjeti teknologjik bëhej fjalë. Në bazë të figurës studentët duhej të punonin në çift dhe të bënin pyetje e përgjigje rreth aparatit dhe funksionit të tij. Pra në këtë rast, studentët i angazhuam me dy lloje ushtrimesh, ku i pari i kishte të dhënat, por jo në rend kronologjik dhe i dyti nuk kishte asnjë të dhënë, përveç figurës, ku i dilte atyre për detyrë që të analizonin si figurën duke shkruar në një shkrim të ngjashëm me ushtrimin e parë.

Këtu ne ecëm me idenë se nëse duhej punuar drejt zhvillimit të aftësive me shkrim, atëherë duhej punuar në mënyrë graduale drejt këtij qëllimi. Korrigjimi i këtyre shkrimeve kërkon shumë kohë në dispozicion dhe kështu që duhet të kufizohen në gjatësi dhe qëllimin. Në vijim po shfaqim disa modele që ju ofruan studentëve për punët me shkrim:

¹⁹⁴Glendinning, H. Eric, 2007, Technology, Oxford University Press, fq.31

Appropriate technology

- 1 Study the diagram of this mechanical device. Choose its correct function.
 - a farming
 - b exploding mines
 - c travelling on the Moon
 - d filming in dangerous places
 - e carrying things
- 2 List some of the components of this device in the table.
- 3 Now read the description of how the device works to find the answer to these questions.
 - 1 What is the device called?
 - 2 What does it do?
 - 3 Why is it suitable for the developing world?
 - 4 Why do the wheels have steel teeth?
 - 5 How often does a wheel have to be changed?
 - 6 Why does the machine not miss any mine in its path?



Item	Quantity
5-metre metal or bamboo poles	3

Three-wheeled life-saver

The device is called a Dervish. It is a mine-detonating vehicle for clearing anti-personnel mines from farmland in developing world countries. It has a very simple design and uses inexpensive parts. The United Nations estimates that 24,000 people die each year because of mines.

The Dervish has three wheels. Each wheel has steel teeth to create more

pressure. When the teeth pass over a mine, it explodes. The wheels can explode around 1,500 mines before they have to be changed.

A motorbike engine powers the Dervish. The device rotates. As each wheel passes a certain point in the rotation, it slows down. This makes the machine advance in tight circles, about 30 mm apart. For this reason no mine in its path is missed.

Gjatë kohës që studentët shkruajnë në klasës, mësuesi mund të qarkullojnë në mesin e studentëve, të monitorojnë progresin e tyre, dhe të ofrojë sugjerime. Ky mund të jetë një aktivitet i dobishëm. Sigurisht që përzgjedhja e materialeve të cilat u vunë në përdorim u munduan ti përshtatnim me nevojat e studentëve, me pritshmëritë e tyre, nivelin gjuhësor si dhe me materialet e ofruara nga metoda e vënë në përdorim.

4.5.3. Cilat ishin reagimet e studentëve dhe rezultatet e arritura?

Eksperimenti i kryer me vitet e para të inxhinierisë elektronike, mund të themi se na rezultoi tepër pozitiv dhe frytdhënës. Ne arritëm që me shumë punë e përkushtim të dyanshëm, si nga ana jonë, ashtu dhe nga ana e studentëve, të arrinim qëllimin të cilin e kishim caktuar që në fillim të punës sonë eksperimentale: të mund të organizonim dhe ndërthurnim orën e mësimit të gjuhës angleze të profesionit në mënyrë të atillë që temat e trajtuara në orët e seminareve të ishin në funksion të plotë të orës së gjuhës së shkruar dhe t'i bënim studentët që ta vlerësonin shkrimin duke i dhënë atij kohën e duhur për t'u mësuar. Ato ushtrime që një vit më parë ne i anashkalonim me një detyrë të thjeshtë shtëpie, kësaj radhe u konkretizuan duke u zgjeruar e marrë formën e një ore të plotë mësimi, e cila ju dedikua tërësisht shkrimit inxhinierik.

Duke punuar në këtë mënyrë, ne arritëm që në fund të semestrit të rritnim cilësinë e shkrimeve të studentëve, ti bënim ata të ishin më të organizuar në idetë e tyre, të mund të shkruanin qartë e pa gabime duke i dhënë shkrimit të përzgjedhur gjuhën e duhur, mënyrën e duhur të shtrirjes dhe përzgjedhjen e duhur të fjalorit. Në fund mund të themi se në fund të kursit studentët ishin të aftë të:

- të përmbledhnin materialet që kishin lexuar me fjalët e tyre.
- të merrnin shënime në ligjërata ose lexime.
- të shkruanin paragrafë koherent mbi tema të njohura.
- të shkruanin letra të shkurtra në format standarde.
- të shkruanin për një shumëllojshmëri qëllimesh, pavarësisht nga nevojat e zonës së tyre të specialitetit si p.sh artikuj, letra formale/jo formale, raporte, projekte, ese, etj.
- të përshkruanin hapat e një procesi
- të përshkruanin një dukuri në formën e një raporti, etj.

4.6. Gramatika si pjesë e shkrimit teknik dhe problemet që shfaqën studentët gjatë punës së tyre

Pasi bëmë analizën e detyrave me shkrim të studentëve, një nga pjesët që shfaqti më tepër problematika dhe doli në dritë gjatë korrigjimit të detyrave me shkrim ishte dhe pjesa gramatikore. Meqenëse metoda "Engineering", nuk e ka të përfshirë gramatikën në përbërjen e saj, atëherë këtë mund ta konsiderojmë si një minus në përbërjen e metodës.

Gramatika është një pjesë tepër e rëndësishme në mësimin e gjuhës së huaj dhe e tillë duhet konsideruar edhe kur studentët mësojnë gjuhën e profesionit. Pavarësisht faktit se në i kemi bërë ushtrime me bazë gramatikore studentëve (materiale të përzgjedhura nga ana jonë, të përfutuara nga botime të ndryshme si dhe on-line), sërish ndjehet nevoja që gramatika të jetë pjesë e literaturës të cilën studiojnë studentët. Si e tillë, ajo do të jetë e gërshetuar ngushtë me qëllimin e tekstit dhe mësimin dhe studentët do ta kenë më të lehtë që të përftojnë gramatikën e duhur në kontekst.

Më poshtë po rendisim disa nga gabimet më të shpeshta që hasëm në krijimet e studentëve:

1. Përdorimi i nyjave (a, an, the)
2. Problem me rendin e fjalëve: ndajfoljet
3. Përdorimi i kohëve (si p.sh dallimin ndërmjet kohës së kryer me kohën e shkuar)
4. Përdorimi i folje + ing e foljeve kundrejt Folje + to + folje (paskajore)
5. Përdorimi i formës jo veprare
6. Drejtshkrimi
7. Përdorimi i shenjave të pikësimit

Këto ishin disa nga aspektet më kryesore gramatikore ku studentët shfaqën më tepër vështirësi gjatë punës së tyre me shkrim. Shumë studentë e vendosin theksin në mësimin e gramatikës duke e konsideruar atë të rëndësishëm dhe të nevojshme. Ndodh shpesh të përqendrohemi ekskluzivisht tek gramatika duke i dhënë më tepër rëndësi asaj se sa detyrës së caktuar që mund të jetë analiza e një grafiku apo raportim të dhënash nga një inxhinier, etj. Por nuk është e domosdoshme të dish gramatikën në mënyrë perfekte për të shprehur një proces apo diagram. Studentët u inkurajuan që ta vinin në përdorim gjuhën angleze dhe të vijonin e punimet e tyre edhe në rastet kur ata bënë gabime. Ne u përpoqëm ti bëjmë të qartë faktin që nuk po mësonin rreth gjuhës angleze por po mësonin gjuhën angleze teknike. Në mënyrë frekvente i kërkoja studentëve që të shprehnin mendimet e tyre dhe të mos hezitnin edhe në rastet kur nuk ishin të bindur për korrektësinë e asaj që do të shprehnin. Në këtë mënyrë i inkurajoja duke i thënë se “kur ata gabonin më jepnin mundësinë që unë ti shpjegoja informacione të cilat nuk i kishin kuptuar”. Duhet të theksojmë faktin se në fund të fundit, qëllimi kryesor i përdorimit të gjuhës është komunikimi.

Por kur bëhet fjalë për të shkruar një letër formale/jo formale e-mail etj., gramatika merr rëndësinë e duhur. Mësimi i rregullave gramatikore është i rëndësishëm në mënyrë që të bëhet një prezantim i qartë dhe i saktë i materialit për prezantim. Format gramatikore të cilat janë më të dobishme janë ato të cilat kontrollojnë funksionet e nivelit të fjalisë të tilla si format pyetësore, mohore, përdorimi i kohës së duhur, format veprare dhe jo veprare etj.

- *Përdorimi i nyjave në tekstet inxhinierike.*

Përdorimi i tyre ndihmon shumë në përfitimin e një procesi të saktë inxhinierik. Në mënyrë që të vendosim se cilën nyje duhet të përdorim, si p.sh *a, an, the* apo asnjë nyje mund të jetë diçka konfuze.

Për shembull:

Structural and stress analysis is *a* process used to study *the* distribution of forces through *the* members of *a* structure. Fibre reinforced plastic is *an* advanced composite material which has potential for *the* repair and strengthening of structures¹⁹⁵.

Analiza strukturore dhe stresi është një proces i përdorur për të studiuar shpërndarjen e forcave përmes përbërësve të një strukture. Fibrat e përforcuara plastike janë materiale të përbëra të avancuara të cilat kanë potencial për riparimin dhe forcimin e strukturave.

- *Përdorimi i formës jo veprare në tekstet inxhinierike*

Përdorimi i formës jo veprare gjendet shpesh në shkrimet teknike ku fokusi vendoset mbi veprimin dhe jo personin që kryen veprimin. Ai përdoret gjithashtu për të raportuar një procedurë eksperimentale dhe në mënyrë që të shmangim përsëritjen e shpeshtë të vetës së parë njëjës “I”. Në mënyrë që ta përdorim saktë formën jo veprare është e rëndësishme që studentët të dinë dallimin ndërmjet përdorimit të formës veprare dhe asaj jo veprare. Me anë të formës jo veprare, në gjuhën inxhinierike ne mund të shpjegojmë një proces që ndodh;

Për shembull: *The plastic travels through the barrel*¹⁹⁶

The mould is now cool
Plastika rrjedh nëpër fuçi
Myku tashmë është ftohur

Përdorimi i formës jo veprare kur shpjegojmë një proces është i nevojshëm sepse nuk ka rëndësi se kush e kryen veprimin. Disa folje, të tilla si *which*, nuk marrin një kundrinor, si p.sh *travel*, ose folje që shprehin ndjenje dhe mendim, p.sh folja *be* nuk mund të përdoret në formën jo veprare. Nuk mund të themi: *The plastic is travelled through the barrel*.

Positive

Welding was done by hand.

=subject + was /were + past participle

Fajali dëftore

Saldimi bëhej me dorë.

= kryefjala+ishte/ishin+pjesoren e shkuar

Negative

Cars were not inspected by robots.

= subject + wasn't/weren't + past participle

Fjali mohore

Makinat nuk kontrolloheshin nga robotë.

= kryefjalë+ishte/ishin+ pjesoren e shkuar

Questions

Were designs produced on computer?

= was/were + subject + past participle

Forma pyetëse

A bëheshin skicat me kompjuter?

=ishin/ishte+kryefjalë+pjesoren e shkuar

¹⁹⁵ Glendinning. H. Eric, 2008, Technology, Oxford University Press. Fq.118

¹⁹⁶ Glendinning. H. Eric, 2008, Technology, Oxford University Press. Fq.118

Question words

How were designs produced?

=question word +was/were + subject + past participle.

Fjalët pyetëse

Si hartoheshin skicat?

=fjala pyetëse+ishte/ishin+kryefjalën+pjesoren e shkuar

Ne mund të përdorim edhe formën jo veprorë të shkuar kur duam të flasim për procese dhe sisteme në të shkuarën. P.sh

Supplies were ordered by staff, not by computer. Pjesët porositen nga stafi, jo me kompjuter.

- *Përdorimi i kohës së shkuar në tekstet inxhinierike*

Kur flasim për kohë të shkuar, këtu kemi parasysh Past Simple, Past perfect (Koha mëse e kryer), Past Continuous (E shkuara në vazhdim). Kur shkruajmë një tekst inxhinierik, ne mund të përdorim njërin nga këto kohë dhe secila nga këto ka ndryshim nga njëra-tjetra si në kronologji apo edhe në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet.

Përdorimi i kohës së shkuar kur duam të shprehim se një veprim ka ndodhur në një periudhë të caktuar në të shkuarën; p.sh.

I operated different types of equipment (it is clear that this person no longer operates different types of material).

Unë kam përdorur lloje të ndryshme pajisjesh (është e qartë që ky person nuk përdor më material të ndryshme).

Ne mund ta përdorim kohën e shkuar të shoqëruar nga shprehje të tilla si *in + year / month / season , before dhe after.* (*para/fjalën në+vitin/muajin/stinën, para ose pas*).

- *Rendi i fjalëve*

Në anglisht, rendi i fjalëve ka shumë më shumë rëndësi nga ç'mund të ketë në shumë gjuhë të tjera. Në krijimet e tyre studentët kishin prodhuar fjali të cilat tingëllonin të çuditshme për veshin për shkak se rendi i fjalëve në fjali ishte i gabuar. Modeli bazë për një fjali në anglisht është: Kryefjalë-Folje-Kundrinor-Vendi-Koha. Fjalitë nuk duhet të ketë domosdoshmërisht të gjitha këto pjesë, por në qoftë se të gjitha pjesët do të nevojiten, ato me shumë gjasa do të kenë këtë rend. Nëse në një fjali janë shprehur të dyja njëherësh, vendi dhe koha, shpesh njëra prej tyre vendoset në pjesën e përparme të fjalitë.

Një ndryshim në rendin themelor të fjalëve në një fjali mund ta shndërrojë një fjali në anglisht në të pakuptimtë ose e ndryshon komplet kuptimin e saj. Për shembull, nëse një pjesë e foljes zhvendoset dhe vihet para kryefjalës, ne fitojmë një fjali pyetëse, psh:

"As world oil supplies dry up, petrol will get more and more expensive";

"Me shterimin e burimeve natyrore, karburanti do të shtrenjtohet gjithnjë e më shumë"

"Will petrol get more expensive as world oil supplies dry up?"¹⁹⁷

¹⁹⁷Glendinning. H. Eric, 2008, Technology, Oxford University Press, fq.48.

“A do të shtrenjtohet karburanti më tepër meqenëse po shterojnë burimet natyrore?”

- *Përdorimi i foljeve*

Ka disa probleme thelbësore që hasin studentët me foljet në shkrimet e tyre në gjuhën angleze. Në thelb, megjithatë, sistemi foljor anglez është mjaft i thjeshtë (më i thjeshtë se sa shumica e gjuhëve të Evropës Perëndimore, por pak më i komplikuar se gjuhët orientale). Më poshtë po rendisim disa nga problemet që studentët kanë:

Koha e tashme: Koha e tashme në shumicën e gjuhëve i referohet veprimeve që janë duke u zhvilluar në të tashmen (në momentin që jemi duke folur). Në anglisht, kjo nuk është gjithmonë e vërtetë. Aty, koha e tashme përdoret për t'iu referuar veprimeve që janë të zakonshme, të përsëritura, ose gjithmonë të vërteta, p.sh:

He wants to be a Civil Engineer - Ai ka dëshirë të bëhet Inxhinier Ndërtimi.

We celebrate the Independence Day on the 28-29th of November-Ne festojmë Ditën e Pavarësisë në 28-29 nëntor.

Anglishtja përdor të tashmen progresive (e tashme e vazhduar) për të shprehur veprime që po ndodhin në të tashmen. p.sh:

I am reading a teacher's qualification manual - Unë jam duke lexuar një manual për kualifikimin e mësuesve;

I am doing a project on a new bridge - Unë po përgatis një projekt mbi një urë të re;

You are preparing to get your diploma - Ju po përgatiteni për të marrë diplomën tuaj.

Koha e ardhme: Forma më e përdorshme për të ndërtuar të ardhmen nuk përdor vetëm “will” sepse studentëve i vjen më për mbarë për ta shprehur në këtë mënyrë duke e përshtatur me “do të” në gjuhën shqipe. Forma më e përshtatshme e të ardhmes formohet me shprehjen *going to*, psh:

I'm going to eat – Po shkoj të ha;

He's going to show us how... - Ai do të na tregojë se si... ;

We're going to study – Po shkojmë të studiojmë;

Duhet të kemi parasysh se, në të folurën e përditshme *going to* shqiptohet edhe "gonna" dhe se nuk është e gabuar të thuhet në këtë mënyrë për aq kohë sa ajo është e kuptueshme nga të tjerët.

Foljet e përbëra: Disa veprime në gjuhën angleze janë të shprehura nga frazat që përbëhen nga një folje dhe një parapafjalë ose ndajfolje. Veprimi nuk është shprehur vetëm me foljen. Për shembull, *Get* do të thotë “të zotërosh, të fitosh, të marrësh, etj” ndërkohë që *get over* do të thotë që të shërohesh nga një sëmundje ", dhe *get up* do të thotë që të ngrihesh nga pozicioni mbështetës."

Ka me dhjetëra fraza të tilla në gjuhën angleze. Përdorimi i këtyre frazave janë shpesh një problem për studentët, sepse nuk janë të listuara veçazi në fjalor dhe kuptimi i tyre është i vështirë për t'u gjetur. Një libër i mirë ndoshta do të na mësonte shumë nga këto folje dy-fjalëshe, por nëse libri nuk është i tillë, do të na duhet t'ua mësojmë ato studentëve tanë në situata që dalin natyrshëm në klasë (për shembull, Hand in your papers = Dorëzoni detyrat tuaja).

Përveç se nuk paraqiten si folje të veçanta në fjalor, këto folje dy-fjalëshe paraqesin dhe një problem tjetër. Disa prej tyre janë të ndashme dhe ndërmjet hyn një emër apo përemër që zëvendëson emrin, janë dhe të pa ndashme, p.sh:

Medical robots will *carry out* operations, controlled by surgeons who might be hundreds of kilometres away¹⁹⁸.

Doktorët robotë do të bëjnë operacione, të kontrolluar nga kirurgë të cilët mund të ndodhen në një distancë të largët prej qindra kilometrash.

His father *set up* the company in 1965 – Babai i tij e krijoi kompaninë në 1965-n.

She asked me to *call her up* after dinner – Ajo më tha ta telefonoja pas darke.

Foljet dy-fjalëshe pjesët e së cilës nuk mund të ndahen njëra nga tjetra quhen "të pandashme" kurse të tjerat quhen "të ndashme." Shiko listën e mëposhtme"

Shembuj :

If we *work it out* today, we won't have to *look for it* tomorrow. - Në qoftë se e zgjidhim atë punë sot, nuk do të na duhet ta kërkojmë nesër.

They wanted to *look the car over* - They wanted to *look it over*.

Ata donin të kontrollonin makinën – Ata donin ti bënin asaj një kontroll

Por JO: They wanted to *look over* it.

- Përdorimi i foljes *Do*

Në anglisht, ne përdorim foljen *Do* (*Do*, *Does*, *Done*, *Did*, etj.) në të paktën katër mënyra të ndryshme:

1. Si një folje si gjithë foljet e tjera: *Ann is doing* the homework - Ann po bën detyrat (*Do* tregon veprim)
2. Përdoret për të theksuar veprimin: I *did* finish my homework-Sigurisht që i mbarova detyrat.
3. Si një folje e cila mund të vendoset para kryefjalës për të formuar një pyetje kurse në qoftë se i bashkëngjisim asaj edhe pjesëzën mohuese *not* formojmë një fjali mohuese: *Does she think nylon is the best choice?* – A mendon ajo se najloni është

¹⁹⁸Glendinning. H. Eric, 2008, *Technology*, Oxford University Press, fq.105

zgjedhja më e mirë? You don't design sport equipment.- Ju nuk skiconi pajisje sportive.

4. Si një zëvendësuese me qëllim që të mos përsëritet e njëjta folje ose shprehje brenda fjalisë, p.sh

You worked all day in front of the computer, and I did too.- Ti punove gjithë ditën përpara kompjuterit, po ashtu veprova dhe unë.

They didn't work very hard, but I did.- Ata nuk punuan shumë, ndërsa unë, po.

- *Përdorimi i Parafjalëve*

Parafjalët në anglisht janë një problem për shkak se gjuhë të ndryshme përdorin parafjalë të ndryshme për të shprehur të njëjtën ide. Do i ndihmonim studentët nëse nuk do i mësonim shumë parafjalë në të njëjtën kohë. Gjithashtu do i ndihmonim duke përdorur parafjalët në shumë kontekste, në situata të cilat na vijnë natyrshëm.

- *Përdorimi i Emrave*

Një problem me të cilin u ndeshën studentët në shkrimet e tyre ishte dhe përdorimi i emrave të numërueshëm dhe të pa-numërueshëm. Nëse diçka është e numërueshme, ajo mund të ketë një formë të shumës. Në qoftë se kjo është e pa-numërueshme, ajo nuk mund të ketë një formë të shumës dhe forma njëjës përdoret për t'iu referuar çdo sasi ose mase. Disa nga gjërat që ne i konsiderojmë të pa-numërueshme në anglisht janë: abstraksioni, idetë, idealet, emocionet, gazrat, lëngjet, materialet me grimca shumë të vogla të papërshtatshme për tu numëruar, si dhe fushat e studimit. Shumë gjuhë kanë të njëjtin koncept të numërueshmëve dhe të pa-numërueshmëve, por ata nuk i ndajnë gjithmonë sendet në të njëjtat kategori si në anglisht. Për shembull, në anglisht, Information (informacioni) dhe Homework (detyrat e shtëpisë) në përgjithësi janë të pa-numërueshme, (për shembull;ne nuk themi informations), ndërsa në gjuhën shqipe, këto emra janë të numërueshëm dhe kanë forma shumësi.

Studentët duhet të mësojnë se si ndahen emrat sipas këtyre kategorive në gjuhën angleze, sepse kjo ndikon në vazhdim dhe në parimet e tjera gramatikore, (si p.sh. nëse duhet të përdorim *a little* apo *a few* para emrit). Ka probleme të tjera me gramatikën angleze ku duhet pasur kujdes, por tekstet më të mira mund të na udhëzojnë më mirë. Pikat kryesore të përfshira këtu janë përmendur vetëm që të na bëjnë të vetëdijshëm se ka shumë aspekte të gjuhës angleze të cilat nuk janë problem për folësit vendas (madje edhe ata të paarsimuarit), por që mund të shkaktojnë probleme për studentët tanë.

- *Problemet me përkufizimet*

Po japim një shembull se si i është paraqitur një seri e përkufizimeve të ndryshme studentëve të elektronikës:

A circle is a planar curve with special quality that each point on it is equidistant from a particular point called the center of the circle. This distance is called the radius of the

circle. The diameter of a circle is twice the radius. The length of the curve is called the circumference of the circle.

Një rreth është një kurbë planare me cilësinë e veçantë që çdo pikë në të është e barazlartuar nga një pikë e veçantë të quajtur qendra e rrethit. Kjo distancë është quajtur rrezja e rrethit. Diametri i rrethit është sa dyfishi i rrezes. Gjatësia e kurbës quhet perimetër i rrethit.

Kështu, përkufizimet e rrethit, qendrës, rrezes, diametrit dhe perimetrit të rrethit janë të ndërlidhura njëra me tjetrën.

Në këtë kuadër, rrethi, rrezja dhe qendra janë reciprokisht të përkufizuara: ato janë përdorur të gjitha për të përcaktuar njëra-tjetrën, me ndërmjetësimin e dy kushteve të tjera të cilat supozohen të jenë të njohur tashmë, distanca dhe plani. Termat e mbetura, perimetri diameteri, janë përkufizuar më pas duke iu referuar një nga tre përkufizimeve të para dhe këtu duke marrë të mirëqenë dy kushtet e tjera që janë supozuar të jenë të njohur dhe zotëruar, gjatësia dhe dyfishi.

Këtu ka disa vështirësi që janë specifike për këtë shembull: nocionet e 'kurbë planare', të 'çdo pikë e kurbës', dhe 'gjatësinë e një rrethi'. Gjithashtu, çdo shembull i zgjedhur ndoshta do të paraqesin probleme të veçanta të vetat. Por në të njëjtën kohë struktura e përgjithshme është shumë e ndërlikuar dhe kjo është diçka që mund të gjendet kudo në matematikë dhe në tekste shkencore. Studentët duhet si fillim të arrijnë të kuptojnë një grumbull të koncepteve fillestare shkencore, të gjitha në të njëjtën kohë dhe pastaj menjëherë të përdorin kuptim e tyre, në mënyrë që të nxjerrin koncepte të tjera nga ato fillestaret. Këto marrëdhënie janë ngritur me anë të një aparati gramatikor.

Kështu, një term teknik nuk përbën ndonjë problem të madh në vetvete dhe nuk ka vështirësi për t'u kuptuar - nuk ka asgjë të vështirë në lidhje me fjalën diametër dhe përkufizimi i saj si dyfishi i rrezes është mjaft i lehtë për t'u kuptuar me kusht që ne të dimë se çfarë është rrezja.

Një ndërtim teknik i këtij lloji, në të cilin termat janë të ndërlidhura dhe përdoren për të përcaktuar njëri-tjetrin, i paraqesin studentit një detyrë të konsiderueshme intelektuale. Shkrimtarët ndonjëherë përpriqen që t'ia thjeshtojnë detyrën lexuesit duke shtuar përkufizime të tjera, por ata nuk e kuptojnë se në një ndërtim të këtij lloji, sa më i madh është numri i gjërave të përkufizuara, aq më e vështirë bëhet ajo për t'u kuptuar.

4.7. Problemet që hasin studentët me klasifikimet sipas kritereve teknike

Në shkencat inxhinierike, konceptet teknike kanë pak kuptim në vetvete. Ato nxjerrin kuptimin e tyre më në pah nga të qenit të organizuar nëpër kategori sipas vetive të përbashkëta. Kategorizime të tilla nuk janë thjesht elemente të lidhura me disa kushte të përbashkëta; ato janë grupime të mirë-organizuara në të cilën çdo term ka një vlerë të caktuar

funkionale. Ashtu si Wignell, Martin dhe Eggins¹⁹⁹ nxjerrin në pah më poshtë në studimin e tyre, një kategorizim teknik është i bazuar kryesisht në dy marrëdhënie themelore semantike:

'a është një lloj x' dhe 'b është një pjesë e y'. Kështu bëhet dallimi dhe klasifikimi i elementeve sipas grupeve të cilët ato u përkasin.

Le të marrim një shembull:

Some organisms, such as amoeba and others in the group of species that have reviewed, are composed of a single cell. These organisms are called-cell. Having lived in the water, these animals are in direct contact with food, water and oxygen they need to survive a self absorbed unicellular of food you need. Along with the food, the animal gets well water. Additional water enters the cell via diffusion of these animals. Normal movement of cytoplasm and carries with food, water and oxygen to all cells. Useless waste materials directly eliminated being put out of the cell. Most unicellular organisms can survive in aquatic environments.

Disa organizma, të tilla si ameba dhe të tjerët në grupin e gjallesave që kanë shqyrtuar, janë të përbërë nga një qelizë e vetme. Këto organizma quhen njëqelizore. Duke jetuar në ujë, këto kafshët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqim, ujë dhe oksigjen që kanë nevojë për të mbijetuar. Njëqelizorët e tresin vetë ushqimin që i nevojitet. Së bashku me këtë ushqim, kafsha merr gjithashtu dhe ujë. Uji shtesë hyn në qelizën e këtyre kafshëve nëpërmjet difuzionit. Lëvizja normale e citoplazmës mbart me vete dhe ushqimin, ujin dhe oksigjenin në të gjithë qelizën. Materialet e mbeturinave të padobishme eliminohen direkt duke u nxjerrë jashtë qelizës. Shumica e organizmave njëqelizor mund të mbijetojnë vetëm në mjedise ujore.

Ka shumë mundësi që shkrimtari i këtij pasazhi ka qenë duke u përpjekur për ta bërë atë më interesant për lexuesin duke luajtur me radhën dhe llojshmërinë e kategorive që duhen mësuar: llojet e organizmave, pjesët e organizmave dhe kështu në vazhdim. Kështu çdo klauzolë fillon me një temë të re: disa organizma, këto organizma, që jetojnë në ujë, kafshë njëqelizore, ujë shtesë, lëvizje normale citoplazmatike, materialet e mbeturinave etj. Për fat të keq, ndonëse ky lloj përshkrimi mund të jetë shumë i admirueshëm për një tekst letrar, nëse tekstet shkencore janë shkruar në këtë mënyrë ato janë shumë më të vështirë për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar. Është shumë e vështirë për të ndërtuar klasifikimet përkatëse të gjallesave në bazë e këtij lloji shkrimi.

4.7.1. Dykuptimësia sintaksore

Marrim shembujt e mëposhtëm:

¹⁹⁹Wignell, M. & S. Eggins 1987 The discourse of deography: drdering and dexplaining the experimental world. In: Halliday, M.A.K. & J. R. Martin (eds.) 1993 Writing Science: Literacy and the Discourse of Power. Falmer. 136-165

(h) Increased responsibilities may affect the improvement of electronic circuits.

Rritja e përgjegjësiave mund të ndikojë në përmirësimin e qarqeve elektronike.

(j) Increase improving statistics on electronic circuits from different companies is associated with increased requirements of these regions in the sales market.

Rritja e statistikave mbi përmirësimin e qarqeve elektronike nga kompani te ndryshme është i lidhur me rritjen e kërkesave të këtyre qarqeve në tregun e shitjeve.

(k) A higher yield means more serviles.

Një prodhimtari më e lartë nënkupton më shumë shërbime.

Të gjithë kanë një strukturë shumë të thjeshtë: një grup emëror i cili funksionon si kryefjalë, i ndjekur nga një grup foljor, i ndjekur nga një grup tjetër emëror (në dy raste) i lidhur me një parafjalë. Nëse ne përqendrojmë vëmendjen në shprehjet foljore, mund të vëmë re lehtësisht se ato janë të paqarta në dy aspekte;

Në radhë të parë, ne nuk mund të themi nëse ato tregojnë një pasojë të veprimit, apo janë thjesht fakte që e pohojnë atë. Për shembull: në (h), *ka përmirësim të qarqeve elektronike që tregon se përgjegjshmëria është rritur*, apo *rritja e tyre sjell ndryshime në përmirësimin e qarqeve*? Në vazhdimësi, duke menduar se mund të identifikojmë një marrëdhënie shkak-pasojë, ne ende nuk mund të përcaktojmë se çfarë shkakton çfarë. Në (k), për shembull, *është produktiviteti i lartë që vjen si rrjedhojë e rritjes së shërbimeve ndihmëse*, apo *ka nevojë për më tepër shërbime ndihmëse*? Kjo mund ti duket e qartë shkrimtarit apo mësuesit i cili e di se ç'ka në mendje dhe se çfarë nënkupton por këto shprehje janë të paqarta për një student dhe mësues dhe studentët mund të interpretojnë të njëjtën shprehje ndryshe duke mos qenë të vetëdijshëm se mund të ketë dhe një interpretim tjetër.

Edhe shprehja (j) mund të interpretohet në 2 mënyra të ndryshme. Ne mund të dimë se *përmirësimi i qarqeve elektronike nga kompani të ndryshme është i lidhur me rritjen e kërkesave të këtyre qarqeve në tregun e shitjeve dhe kështu, sa më e lartë cilësia, aq më e madhe do të jetë kërkesa*. Por kjo fjali mund të shprehë edhe *kërkesën e lartë që kanë qarqet në treg, dhe për rrjedhojë kjo çon në rritjen e prodhimit të tyre*.

Por kur fillojmë të eksplorojmë domethënien e këtij shembulli më me kujdes, shohim se përmban më shumë paqartësi përveç asaj që e kemi parë tashmë në folje; P.sh, çfarë do të kuptojmë ne me "*statistika të prodhimit të qarqeve nga kërkesa e tregut*?" A tregon ajo se "*sa shumë njerëz kërkojnë të blejnë këto qarqe*", apo "*sa shpejt shiten këto qarqe kur kërkesa e tyre është më e lartë në treg*"?

Duke marrë të mirëqenë një prej interpretimeve, si p.sh "*më shumë njerëz kërkojnë të blejnë qarqe dhe më e lartë është prodhimi*", ne ende nuk e dimë nëse ata janë të njëjtit njerëz apo jo – janë vetëm ata që i përdorin në mënyrë të vazhdueshme apo lind kërkesa dhe nga njerëz të cilët nuk i kanë përdorur më parë? Ne nuk dimë nëse situata është e

vërtetë apo hipotetike? Nëse kombinohen të gjitha këto mundësi, ne arrijmë në interpretime të ndryshme, shumica e të cilave janë mjaft bindëse dhe të mendosh se ato janë alternativa të vërteta me të cilat ballafaqohet një lexues i vërtetë, jo simulimet e çuditshme të ndonjë programi analizues të kompjuterizuar.

Nga se vijnë këto paqartësi? Ato rrjedhin nga burime të ndryshme. Një nga këto janë dhe foljet shumë kuptimshme dhe në gjuhën shkencore angleze ka me dhjetra folje të tilla që i përkasin kësaj klase. E megjithatë paqartësitë më të mëdha vijnë në ato raste kur foljet shndërrohen në emra. Që do të thotë, diçka që në gjuhën angleze të folur do shprehej zakonisht me një folje të thjeshtë, tani është shprehur nga një grup fjalësh që kanë në qendër një emër. Nëse unë them:

“Ann announced that she had accepted the invitation”,

“Ana njoftoi që e kishte pranuar ftesën”, unë e kam bërë të qartë se kush e bëri veprimin, por në qoftë se unë them;

“Notification of Ann’s acceptance”- “njoftimi që Ana pranoi ftesën”;

Këtu nuk e dallojmë dot në qoftë se e bëri Ana njoftimin apo dikush tjetër e bëri për Anën? A ishte Ana që po pranonte diçka apo ishte ajo që po pranohej diku? Në qoftë se Ana kishte/ishte pranuar tashmë apo do të pranonte/pranohej në të ardhmen. Kështu ky grup i vetëm emëror “njoftimi i pranimit të Anës” korrespondon më shumë kuptime dhe interpretime të ndryshme. *Ana njoftoi se ajo do pranojë; Ata njoftuan se Ana ishte pranuar, e kështu me radhë.* Një pjesë e madhe e informacionit humbet kur shprehet foljore zëvendësohen nga një grup emëror. Shkrimet shkencore përdorin të përdorin sa më pak ndërtime emërore të kësaj natyre, sidomos kur kombinohen me foljet. Të dyja këto karakteristika janë, siç e kemi parë, shumë të paqarta, edhe pse ne zakonisht nuk e njohim cila është paqartësia derisa ne e riformulojmë fragmentin në një formë tjetër. Të shqyrtojmë një shembull tjetër:

The glass master disc is placed in a chemical bath. The resist coating is not affected but where the laser has removed the resist, the chemical etches tiny pits into the surface of the glass²⁰⁰.

Disku i xhamit është vendosur në një banjë kimike. Veshja rezistente nuk është prekur, por kur lazeri e ka hequr rezistencë, banja kimike krijon gropa të vogla në sipërfaqen e qelqit.

Duke marrë në konsideratë të gjitha interpretimet e mundshme të kësaj fraze ne mund të marrim shumë kombinime të mundshme të ndryshme. Por nisur nga këto statistika duket e vështirë për të zgjedhur se cilin interpretim do marrim të mirëqenë.

4.7.2. Karakteristikat e komunikimit teknologjik efektiv

²⁰⁰Glendinning. H. Eric, 2008, Technology, Oxford University Press.

Komunikimi i mirë teknologjik është i saktë, i qartë, konciz, koherent dhe i përshtatshëm. Në fushën e shkencës dhe teknologjisë, këto cilësi janë ndonjëherë të vështira për t'u arritur. Shkenca dhe teknologjia jo vetëm që mbështeten thellë në koncepte dhe terminologji të specializuara, por ato gjithashtu kanë përdorim të gjerë të numrave dhe grafikëve.

Shembulli i mëposhtëm tregon sesi cilësitë e ndryshme të prozës teknike punojnë së bashku.

Electrical energy is the energy carried by moving in an electric conductor. It cannot be seen, but it is one of our most useful forms of energy because it is relatively easy to transmit and use. All matter consists of atoms, and every atom contains one or more electrons, which are always moving. When electrons are forced along a path in conducting substance such as wire, the result is energy called electricity.²⁰¹

Energjia elektrike është energjia që lëviz në një përcjellës elektrik. Ajo nuk mund të shihet, por ajo është një nga format më të dobishme të energjisë, sepse ajo është e lehtë për të transmetuar dhe përdorur. ajo e tëra përbëhet nga atome, një atom secili përmban një ose më shumë elektrone, të cilat janë gjithmonë në lëvizje. Kur elektronet janë të detyruara të ecin së bashku në një rrugë me substanca përcjellëse të tilla si tela, rezultati është energji e cila quhet energji elektrike.

Shembulli është i llogaritur në dy mënyra. Ai është llogaritur me stil preciz të gjuhës në përdorimin e tij. Ai është teknikisht i llogaritur në përdorimin e termave teknik të specializuar siç janë elektrizimi, ngarkesa, fusha elektrike dhe përcjellësi, kuptimet e të cilave janë bazuar në kontekstin e një disipline teknike. Të dy tipet e saktësisë-saktësia e mënyrës së të shprehurit dhe saktësia e koncepteve teknike-janë të rëndësisë së parë në shkrimet shkencore dhe teknologjike.

Shembulli është gjithashtu i qartë sepse është shkruar me fjali të thjeshta direkte. Ai është konciz në përdorimin e minimumit të fjalëve për të shprehur idenë kryesore të elektrizimit. Ai nuk është shumëfjalësh dhe nuk devijon nga ideja kryesore e shtruar.

Shembulli është koherent sepse zhvillon çështjen në një eseje që ndjek linjën e të menduarit. Fjalitë janë më tej të lidhura nga shprehje referuese të tillë si “consists of”, “as a result”.

Së fundi, shembulli është i përshtatshëm për qëllimin e tij për të paraqitur një përshkrim të përgjithshëm të procesit të energjisë elektrike, si dhe për audiencën e tij, lexues të shkolluar të shkencës, që nuk janë domosdoshmërisht ekspertë të fushës së energjitikës.

²⁰¹http://www.energyeducation.tx.gov/energy/section_1/topics/forms_of_energy/electrical_energy.html

4.7.2.1. Saktësia

Saktësia duhet përdorur në shkrimet teknike. Ajo, ka tre aspekte kryesore:

1. *Saktësia e dokumentit* i referohet trajtimit të duhur të çështjeve të trajtuara me detaje të përshtatshme. Shpesh një dokument i saktë duhet të fokusohet qartësisht në një problem. Saktësia e dokumentit është përgjithësisht e lidhur me një formulim të qartë të problemit dhe një skice paraprake. Këto mjete të shkrimit ndihmojnë në fokusimin e përpjekjeve tona në shkrim, duke reduktuar të dhënat në një mënyrë që të zgjidhim një problem teorik ose praktik.
2. *Saktësia stilistike* ka të bëjë me përdorimin e kujdesshëm të gjuhës për të shprehur kuptimin. Gjuha e saktë kërkon përdorimin me kujdes të strukturës së paragrafëve dhe fjalive dhe zgjedhjen e fjalëve për të përshkruar dhe analizuar çështjet me efektivitet. Saktësia stilistike është gjithashtu një çështje e përdorimit të fjalëve me saktësi.
3. *Saktësia teknike* kërkon saktësi stilistike por nuk është bazuar vetëm në të. Dokumenti efektiv në shkencë dhe teknologji duhet të jetë i bazuar në një kuptim të saktë teknikisht dhe prezantimin e temës. Saktësia teknike varet nga aftësia konceptuale e shkrimtarit të subjektit dhe në fjalorin e tij, po aq sa nga aftësia e tij/saj për të analizuar dhe rregulluar të dhënat me një minimum të shtrembërimeve. Në shkencë dhe teknologji, energji kreative shumë e madhe jepet për përvetësimin e këtij aspekti teknik të zhvillimit të subjektit.

4.7.2.2. Konciziteti/Ngjeshja

Konciziteti ka një vlerë të veçantë në fushat e teknologjisë. Shkrimtarët janë shpesh të tunduar për të përfshirë gjithçka që mund të jetë e vlefshme për temën e tyre, sesa pak nga gjithçka që është e vlefshme për detyrën e komunikimit. Dokumenti konciz është një pjesë shkrimi që përmban vetëm materialin e nevojshëm. Në nivelin e të gjithë dokumentit, konciziteti ndihmohet nga fokusi dhe renditja e qëllimit të problemit në një problem dhe përgjigje të menaxhueshme. Përgatitja e një prezantimi të qartë dhe përmirësimi i një skice të detajuar, janë dy strategji që na ndihmojnë të kontrollojmë gjatësinë dhe rrjedhën e dokumentit. Ne duhet të identifikojmë dhe eliminojmë materialin që nuk është i nevojshëm për të mbështetur çështjet tona. Duhet parë për seksione, duke përfshirë shtojcat, të cilat janë esenciale për punën tonë. Grafikët janë ndihmë e fuqishme për koncizitetin sepse shkurtojnë sasinë e prozës së nevojshme për të përshkruar objekte dhe procese, përmbledhin të dhëna dhe demonstrojnë lidhjet. Konciziteti kërkon përsëritje të kujdesshme. Ne duhet të praktikohemi me strategjitë e reduktimit të fjalëve të tepërta duke gjetur mënyra për të reduktuar fjalë të panevojshme, fjali dhe seksione nga dokumenti.

4.8. Përfundime

Fakti që shkrimi është një proces mësimi i vlefshëm dhe unik, është arsyeja kryesore pse në çdo sistem edukimi ai është thelbësor. “Shkrimi nuk është thjesht i vlefshëm, as thjesht i

veçantë, por unik”²⁰². Shkrimi përdoret si një mjet mësimi në çdo fushë. Ai është një proces zbulimi. Akti i të shkruarit nuk është i thjeshtë; disa hapa duhet të ndiqen. Mësimi, organizimi dhe qartësia që përjeton shkrimtari gjatë përgatitjes për të shkruar mund të jetë i vlefshëm dhe jo i vlefshëm ndonjëherë.

Pas përfundimit, një shkrimtar i kujdesshëm ka një zotërim shumë më të vendosur të materialit, në krahasim me çdo të kishte pa procesin e të shkruarit. Ky proces zbulimi është i rëndësishëm për studentët sepse ata e përjetojnë dhe kuptojnë materialin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale. Ky proces është i ngjashëm me atë që përjetojnë pedagogët gjatë përgatitjes së leksionit. Çdokush që ka dhënë mësim, me shumë mundësi e ka pyetur veten nëse e kishin kuptuar plotësisht më parë lëndën. Ndjesia kur zotëron një temë dhe kur e kupton atë në mënyrë radikale, është diçka e zakonshme për mësuesit. Në të dyja rastet, si gjatë procesit të dhënies së mësimi, ashtu edhe shkrimi, së pari duhet që çdokush të jetë i qartë për qëllimin e tij. Pastaj, sipas strukturës së leksionit, mësojmë, qartësojmë dhe organizojmë. Ne kështu jemi të nxitur të zhvillojmë një diskutim gjithëpërfshirës dhe logjikisht të strukturuar.

Shkrimi, ashtu si mësimi, nxit procesin e të menduarit. Një eksperiencë e tillë mund t’u sigurohet studentëve në qoftë se ata besojnë se shkrimet e tyre janë të rëndësishme. Nga vënia e një mekanizmi të tillë, të paktën në pjesë të veçanta, në shumë nga klasat tona ne përftojmë një mjet pedagogjik të fuqishëm.

Është gjithashtu shumë e rëndësishme që studentëve t’u tregohet kujdes në korrigjimin dhe vlerësimin e shkrimeve të tyre. Në të kundërt, ata mendojnë se këto detyra nuk janë të rëndësishme për pedagogun dhe rrjedhimisht kjo do ndikojë në detyrat pasardhëse. Gjithashtu, ne duhet të përfshijmë në leksionet e tyre, të paktën disa nga shkrimet e studentëve aktualë. Kështu vlerësohen shkrimet e studentëve, çfarë është vendimtare që puna me shkrim të merret seriozisht nga klasa. Shkrimi duhet të paraqitet si një pjesë përbërëse e kursit për shkak të efekteve të dëshirueshme që çdokush të tregojë veten. Nëse ne shfrytëzojmë përfitimet e mirënjohura pedagogjike të shkrimi për studentët e inxhinierisë, atëherë ata duhet të jenë të bindur se ne besojmë në rëndësinë e tij.

Në tërësi, studentët përfituan shumë nga mësimet që morën mbi shkrimin dhe nëse të gjithë e presin me entuziazëm dhe vendosmëri jemi të bindur se detyra të tilla do të jenë me shumë vlerë për studentët tanë. E gjithë eksperiencia e tyre mësimore e inxhinierisë do të përmirësohet. Siç e dimë, detyrat e të shkruarit dhe vlerësimi i tyre kërkojnë kohë.

Shkrimi mund të plotësojë punë llogaritëse, si dhe bën që studenti ta zotërojë më të plotë materialin. Vetëm atëherë kur përfitohet një kuptim i qëndrueshëm, ne mund të presim që studentët të transportojnë dijet e fituara nga një disiplinë tek tjetra. Argumenti i shkruash për të mësuar është i njohur tashmë; edukatorët e disiplinave të ndryshme e kanë përdorur për të thelluar dhe pasuruar procesin e të mësuarit për shumë vite me radhë. Ata dinë që, nëpërmjet procesit të shkrimi, aftësitë teknike jo vetëm që nuk ulen, por zhvillohen më tej. Nëpërmjet detyrave me shkrim, kurset e ESP-së bëhen më interesante, më aktuale dhe më tërheqëse për studentin. Detyrat mund të përfshijnë tema të rëndësishme nga e kaluara ose

²⁰² Emig, Janet, 1977;”*Writing as a Mode of Learning*”, Source:College Composition and Communication; Vol.28,No2,fq.122-128.

zhvillime interesante të kohës. Për shembull, një detyrë mbi fibrat optike apo qarqet elektronike do t'i lejonte studentët të hetonin mbi zhvillimet e tanishme në këtë fushë e cila ka shumë rëndësi për studentët e inxhinierisë elektronike. Pasi kanë shkruar në lidhje me një temë, shumë studentë, në një shkallë të caktuar do ta kenë bërë punën e tyre dhe do të krijojnë tashmë një pikëpamje të tyre në lidhje me këtë temë. Detyra të tilla janë një mënyrë efektive për të prezantuar diskutime informuese në lidhje me tema historike.

Si pedagogë të gjuhës angleze të specialiteti në fakultetet e inxhinierisë, qëllimi ynë është t'u sigurojmë studentëve edukim teknik rigoroz dhe t'u japim atyre mjetet që të bëhen udhëheqës dhe vendimmarrës në shoqëri. Ne duhet ti shikojmë të diplomuarit tanë në konkurrimin për rolin udhëheqës dhe vendimmarrës në shoqëri. Nëse ata janë për t'u bërë planifikues dhe udhëheqës efektiv, atëherë qëllimi ynë është që të `prodhojmë` të diplomuar që nuk përqendrohen vazhdimisht në disa pjesë të vogla dhe që mësojnë shpejt tema të reja. Shoqëria vuan, ashtu si profesioni i inxhinierëve, nga mungesa relative e përfshirjes së inxhinierëve në vendime të rëndësishme. Sa më shumë probleme të përmbajnë, qoftë në disa pjesë të tyre, aspekte teknike, nevoja që vendimmarrësit të zotërojnë aftësi teknike rritet. Në qoftë se inxhinierët lejohen të marrin pjesë në grupet vendimmarrëse, ata duhet të tregojnë se mund të zgjidhin çështje të karakterit ekonomik, social dhe historik. Pra, studentët tanë duhet të jenë të aftë që të mendojnë në mënyrë krijuese. Shkrimi nxit pikërisht këtë lloj të menduarit për çdo student, pavarësisht nga aftësitë e lindura apo mënyra e të mësuarit. Pozita e inxhinierit si profesion do të përmirësohet nga rritja aftësisë të së shkruarit. Shumë e thjeshtë, ata që shkruajnë më shumë, kanë më shumë mundësi të shkruajnë dhe komunikojnë më mirë se ata që shkruajnë më pak. Të qenit një komunikues efektiv ndihmon që çdo inxhinier t'u bëjë të qartë të tjerëve, në mënyrë sa më bindëse për rëndësinë dhe dobinë e inxhinierisë në shoqëri.

Më në fund, ajo çfarë përfitojnë më tepër studentët e inxhinierisë së elektronikës nëse praktikojnë më tepër ligjëratën e shkruar, lidhet me faktin se shkrimi shërben si një mjet i fuqishëm në vlerësimin edukativ në fushën e inxhinierisë. Shkrimi siguron një kontroll gjithëpërfshirës dhe të mprehtë në procesin e të menduarit. Si i tillë, siguron prova të forta të pranisë ose mungesës së mendimeve krijuese dhe të arrira si dhe jep prova të qarta të dijeve dhe aftësisë për të komunikuar në mënyrë efektive. Ne mendojmë se një gjë e tillë është veçanërisht e rëndësishme në kurset e inxhinierisë informatike, elektronike dhe telekomunikacionit meqenëse ky kontingjent studentësh i përdorin shumë mjetet kompjuterike dhe ndonjëherë, mangësitë që ata kanë mbi dijet e shkrimit, fshihet mbas paketave të gatshme të programeve kompjuterike. Duke përdorur shkrimin në kurset tona, në përmirësojmë vlerësimet. Ne nuk mund të themi se do të arrijmë rezultate të larta që në fillim, por, duke vënë theksin në hartimin e një plani të programuar mbi ligjëratën e shkruar, me kalimin e kohës zbulojmë prova të qarta se si një program inxhinierie plotëson shumë nga kriteret ABET²⁰³, si të qenit i informuar mbi çështje etike dhe profesionale,

²⁰³ ABET, i njohur si Bordi i Akreditimit për Inxhinieri dhe Teknologji, është një organizatë jo-qeveritare që akrediton programe të arsimit post-sekondar në shkencat e aplikuara, informatikë, inxhinieri, inxhinieri dhe teknologji. Akreditimi i këtyre programeve ndodh kryesisht në Shtetet e Bashkuara, por edhe ndërkombëtarisht. Që nga tetori 2012, rreth 3278 programe janë akredituar, të shpërndara mbi më shumë se 670 universitete dhe kolegje në 23 vende. ABET njihet në Shtetet e Bashkuara dhe është akreditues i programeve të kolegjeve dhe universiteteve në shkencat e aplikuara, informatikë, inxhinieri, dhe teknologji.

aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive, zotërimi i një edukimi të plotë dhe dije mbi çështjet e sotme. Për këto fusha, ligjërata e shkruar mund të jetë vërtet një mjet vlerësimit më i fuqishëm i mundshëm; provat e siguruara nga shkrimet e studentëve janë të qarta dhe imponuese.

Megjithëse shumë aspekte të argumenteve të mësipërme nuk janë diçka e re dhe ne që përkrahim mënyrën e shkrimit në kurset e inxhinierive nuk jemi të parët, sfidat tona janë reale, të tregojmë leverdinë dhe rëndësinë e shkrimit në inxhinieri. Nëpërmjet një shkrirje të plotë të procesit të shkrimit në programin inxhinierik, ne mund të përmirësojmë aftësitë teknike të të diplomuarve; t'u sigurojmë atyre një përvojë edukative më të plotë; të përmirësojmë aftësitë komunikuese; të fitojnë një mjet vlerësimi të fuqishëm. Si pedagogë të gjuhës angleze të profesionit, ne kemi kontroll mbi mënyrën si është perceptuar shkrimi. Hapi më i mirë që mund të marrim është të tregojmë, me anën e veprimeve tona, se besojmë në rëndësinë që ka një mënyrë e mirë, e qartë dhe e saktë shkrimi. Ky hap është i nevojshëm nëse duam që studentët tanë t'i kushtojnë vëmendje shkrimeve të tyre dhe si rrjedhim të korrin atë që kanë mbjellë.

Mund të ndodhë që shumë studentë të inxhinierisë elektronike nuk do të mbeten inxhinierë. Të mësuarit gjatë gjithë jetës u jep atyre mundësinë të zgjedhin një profesion tjetër, ndoshta juridik apo mjekësi, të tjerë mund të zgjedhin të bëhen sipërmarrës, shumë të tjerë do të punësohen në industri, të cilët marrin inxhinierë të diplomuar, jo për shkak të dijeve teknike specifike, por më shumë sepse konsiderohen si individë inteligjentë, të motivuar, të gatshëm dhe të aftë për të mësuar. Atëherë arsyeja me imponuese që pedagogët që japin gjuhën angleze të profesionit në fakultetet e inxhinierisë të ndërmarrin këtë hap që lidhet me faktin se shkrimi është një mjet efektiv për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Shkrimi është një mjet i vlefshëm mësimor, e në qoftë se e injorojmë këtë mjet, ashtu siç ndodh tani në degët e tjera të fakulteteve të inxhinierive në UPT, studentët privohen nga një përvojë kaq e rëndësishme dhe formuese për karrierën e tyre. Për shumë studentë, procesi i zbulimit të dijeve nëpërmjet shkrimit mund të jetë mes aftësive më të rëndësishme të fituara gjatë gjithë karrierës së tyre studentore.

ABET siguron gjithashtu udhëheqje ndërkombëtare përmes seminareve, konsulencave, memorandumeve të mirëkuptimit, dhe marrëveshjeve reciproke të njohjes, siç është Marrëveshjes së Uashingtonit. ABET është njohur nga Këshilli për Akreditimin e Arsimit të Lartë (CHEA) që nga viti 1997.

KREU V

ANALIZA E METODËS “ENGINEERING”. PËRVETËSIMI I FJALORIT DHE PROBLEMET ME LEXIMIN E TEKSTEVE TEKNIKE. STUDIM RASTI

5.1. Probleme me të cilat përballen studentët me metodën e gjuhës angleze “Engineering”

5.1.1. Përzgjedhja e teksteve në mësimin e ESP-së

Gjuha angleze për qëllime të veçanta, është një nga qasjet zotëruese në ditët e sotme në arsimin e lartë, për arsye se ajo i përgjigjet nevojave të studentit. Kur bëhet fjalë për tekste të ESP-së në fakultetet e inxhinierive, shohim se janë të shumtë tekstet që ofrohen në treg. Mësuesit e ESP-së duhet të marrin në konsideratë faktorët e nevojshëm të cilët duhen përfshirë për të bërë zgjedhjen e tekstit të duhur. Por, mesa duket, të bësh zgjedhjen e duhur nuk është dhe aq e lehtë. Materialet e mësimdhënies, janë ato që përcaktojnë edhe përmbajtjen e kursit si dhe ndikojnë në metodat e mësimdhënies, motivimin e studentit si dhe mësimin e funksioneve gjuhësore dhe fjalorit.

ESP përkufizohet si roli i gjuhës angleze në një kurs gjuhe ku përmbajtja dhe qëllimi i kursit përcaktohen nga nevojat e studentit²⁰⁴. Por përkufizimin e ESP-së e gjejmë edhe të këtillë se “...ajo përcakton se ESP është një përgjigje që i jepet nevojave të studentit si dhe njohjes gjuhësore që ka lidhje me gjuhën e profesionit”²⁰⁵.

Kur flasim për përzgjedhjen e materialeve të ESP-së, Cunningsworth²⁰⁶ thekson se duhet bërë një përzgjedhje e kujdesshme e cila të reflektojë qëllimet, metodat dhe vlerat e programit të mësimdhënies, si dhe të plotësojë nevojat e studentit. “Qëllimi i ESP-së është që të qendërojë studentin dhe për pasojë konsideratat e studentëve duhet të vendosen në krye të listës së kritereve përzgjedhëse²⁰⁷”. Për më tepër, duhet marrë parasysh edhe faktin se çfarë njohurish gjuhësore kanë arritur studentët si edhe trageti i nivelit që do i duhet të mbërrijnë në mënyrë që të komunikojnë suksesshëm në gjuhën e tyre të profesionit.

Tekstet shkollore luajnë një rol tepër të rëndësishëm në përfitimin dhe mësimin e gjuhës si dhe konsiderohen si faktorë i dytë kyç në mësimin e gjuhës së huaj, pas rolit të mësuesit. Por, të një rëndësie të veçantë janë edhe materialet të cilat përpunohen nga vetë mësuesi, të cilat përzgjidhen në bazë të asaj çfarë studentëve ju nevojitet për karrierën e tyre në të ardhmen.

Në këtë mënyrë, theksohet nevoja e të qenit fleksibël në përzgjedhjen e materialeve për të mos u ndjerë skllëvër të teksteve shkollore duke rënë dakord me CunningsWorth, i cili thekson se “...mësuesi duhet të gjejë mënyrën më të mirë për të përshtatur dhe vënë në

²⁰⁴ Richards J. C., & Schmidt, R. (2010). Longman dictionary of language teaching and appliedLinguistics(4th ed), Harlow: Pearson Education Ltd.

²⁰⁵ Silva, F.(2002). ESP teaching for Learners in the Health Sciences Field, American Journal of Nursing,1,fq.35-40.

²⁰⁶ Cunningsworth, A. (1995). Choosing your course book. Oxford: Heinemann

²⁰⁷Vicic, P. (2011). *Preparing materials for ESP teaching*. Retrieved March 5, 2012, nga <http://www.sdutsj.edus.si/InterAlia>

përdorim këto lloj materialesh...²⁰⁸“ Megjithëse tekstet shkollore ideale nuk ekzistojnë dhe për rrjedhojë do të jetë e kotë të rrih në pritje të tyre, qëllimi ynë duhet të jetë gjetja e materialeve të cilat korrespondojnë me pikëpamjet tona të procesit mësimor si edhe të përputhen me nevojat e studentit.

Kur përpilohet një tekst, shkrimtari bën një gjykim rreth asaj se çfarë njohurish do të përfitojë lexuesi dhe se si do ti vejë ai në përdorim dijet e marra nga ky libër. Studentëve të UPT-së ju duhet gjuha angleze në mënyrë që të përforcojnë njohuritë e tyre mbi gjuhën e specialitetit, në këtë rast atë inxhinierike, në mënyrë që të plotësojnë aftësitë e tyre akademike dhe të mos jenë të izoluar nga zhvillimet teknologjike të cilat arrihen në vendet e zhvilluara. Atyre u nevojiten tekste të ESP-së me anë të të cilave ata mund të përballojnë një bisedë në gjuhën angleze shkencore.

5.2. Analiza e tekstit “Engineering”

Në një përpjekje për ti hapur rrugën përgatitjes së teksteve për studentët e inxhinierive, ne kemi analizuar tekstin me të cilin jemi duke punuar në të gjitha fakultetet e UPT-së, Engineering. Për të bërë këtë analizë, ne kemi përgatitur dy pyetësorë ku janë përfshirë pedagogët e gjuhës angleze pranë Qendrës së Gjuhëve të Huaja në UPT, si dhe studentët e inxhinierive, për të diskutuar rreth përmbajtjes së tekstit. Në bazë të përgjigjeve të tyre si dhe komenteve të bëra mbi tekstin ekzistues jemi munduar të përmbledhim përgjigjet dhe të bëjmë një zgjidhje të mundshme të problemit.

Studentëve të cilët studiojnë në UPT, u nevojitet gjuha angleze në mënyrë që të përforcojnë njohuritë e tyre si dhe për të marrë informacione të reja nga libra apo materiale shkencore në fushën e tyre të specialitetit. Ata kanë nevojë për materiale leximi në mënyrë që ti vijnë në ndihmë në plotësimin e kërkesave akademike si dhe t’i përputhet interesave të tyre në pasurimin e gjuhës angleze. Shohim që ka nevojë për materiale të mira mësimdhënieje, të cilat do ti përgatisin studentët të jenë të aftë të përballen me situata për të cilat ata po studiojnë, si edhe do ta bëjnë punën e mësuesit (tonën), më interesante dhe frytdhënëse.

Një nga faktorët kyç në hartimin e teksteve të ESP-së është që të dish tiparet të cilat spikasin në tekstet shkencore dhe teknike. Parë nga këndvështrimi i diskutimit, shohim se ka disa tipare dhe karakteristika në gjuhën angleze shkencore të cilat e bëjnë atë të jetë ndryshe nga llojet e tjera. Në mënyrë që ta provojmë këtë fakt ne bëmë një analizë të tekstit për t’u marrë si shembull. Këto lloj njohurish na vijnë në ndihmë për të krijuar ushtrime të dobishme për materiale të ndryshme teknike.

Për të përcaktuar çfarë duhet të arrijnë studentët saktësisht përmes mesatares së gjuhës angleze, është e domosdoshme të kryhet një studim i cili është përcaktuar si “procesi i përcaktimit të nevojave për të cilat një student apo një grup studentësh kërkojnë në mësimin e një gjuhe të huaj, si dhe menaxhimi i nevojave sipas prioriteteve”²⁰⁹. Thënë kjo pas përdorimit të tekstit “Technology” për katër vite akademike, përkatësisht 2009-2013, QGJH në UPT, e cila është e vetmja qendër që mbulon të gjitha fakultetet e UPT-së me

²⁰⁸Cunningsworth, A.1984 Evaluating and selecting EFL Teaching materials. London. Heinemann.Fq.8-9

²⁰⁹Richards, J. C & Platt, H. (1992) Dictionary of language teaching and applied linguistics.Malaysia: Longman. fq 242

gjuhë të huaja, vendosi ta ndryshojë metodën e mësimdhënies në vitin 2013, duke vënë në përdorim metodën “Engineering”, një metodë bashkëkohore e Express Publishing, me autorë Charles Lloyd dhe James, A. Fraizer. Ndërrimi i metodës u bë pasi u pa e arsyeshme që studentët e UPT-së kishin nevojë që të kishin në përdorim një metodë më bashkëkohore dhe që të kishte lidhje të drejtpërdrejta me fushat e studimit të këtij lloji grupi studentësh.

Me anën e intervistave të zhvilluara me studentët menduam se do të ishte e udhës që ta zgjeronim studimin tonë duke bërë një sondazh më të përcaktuar me anën e pyetësorëve. Vëzhgimi u zhvillua me qëllimin për të përcaktuar dhe nxjerrë në pah nevojat e gjuhës angleze që kishin studentët e inxhinierisë elektronike në Fakultetin e Teknologjisë dhe Informacionit (FTI) në UPT. Më saktësisht, ky studim u krye me qëllim që të identifikonte perceptimet e frekuencës në përdorimin e aftësive të gjuhës angleze nga studentët, rëndësinë e këtyre aftësive dhe preferencat e tyre për kurset e gjuhës angleze. Gjithashtu, rezultatet e pyetësorit dhe intervistave na ndihmuan për të përgatitur planin mësimor meqenëse sipas Nunan²¹⁰, “për përgatitjen e një plani mësimor, pjesëmarrësit kryesorë janë mësuesit të cilët kanë në dorë drejtimin e kursit dhe nxënësit të cilët marrin pjesë në të”. Rezultati i dhënë pati rëndësi për studentët e inxhinierisë elektronike dhe identifikoi mangësitë e tyre, dëshirat dhe nevojat duke iu referuar aftësive të gjuhës angleze. Në vijim kemi përfshirë implikime pedagogjike që mund të ndihmojnë për të përmirësuar kurset aktuale të gjuhës angleze bazuar në nevojat e studentëve. (Shtojca 8)

- Pjesëmarrësit dhe konteksti demografik

Në këtë studim morën pjesë 81 studentë të Fakultetit të Teknologjisë dhe Informacionit, dega inxhinieri elektronike, telekomunikacion dhe informatikë, të vitit të parë, në vitin akademik 2013-2014. Për të bërë studimin tonë përzgjedhëm këtë fakultet për arsye se unë jap mësim pranë këtij fakulteti që prej vitit 2002 dhe e pashë të arsyeshme që ti kushtoja rëndësi të veçantë këtij grupi studentësh. Menduam gjithashtu që të përfshinim të tre degët e FTI e jo vetëm degën e inxhinierisë elektronike në mënyrë që të krijonim një ide më të qartë e të plotë të situatës në rang fakulteti si dhe për ta shqyrtuar problematikën nga një këndvështrim më i gjerë e gjithëpërfshirës. Sigurisht që kjo analizë vlen për të gjitha fakultetet e UPT-së ku zhvillohet metoda “Engineering”.

Pjesëmarrësit ishin studentë të viteve të para, me një moshë 18-19 vjeçare dhe me prejardhje social-kulturore e ekonomike heterogjene.

- Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Ashtu si e thamë dhe më sipër sondazhi u bë me anën e pyetësorëve. Pyetësi ishte i formuar nga 17 pyetje të cilat kishin për qëllim të identifikonin nevojat gjuhësore që shfaqnin studentët teksa studionin gjuhën angleze gjatë semestrit të parë, të vitit të parë të studimeve të tyre, në degën Inxhinieri Elektronike Telekomunikacion Informatikë (pasi gjuha e huaj, sipas Sistemit të Bolonjës ka vetëm këtë shtrirje në fakultetet e UPT-së); mangësitë e gjuhës angleze, rëndësinë e këtyre aftësive dhe dëshirat e studentëve për përmirësimin dhe shtrirjen në një periudhë më të gjatë kohore të gjuhës angleze. Përveç

²¹⁰Nunan, D. 1992, The learner-centered curriculum, Cambridge University Press, fq. 45.


kësaj, studimi illustroi perceptimet e studentëve mbi kursin aktual të gjuhës angleze si dhe për kursin që ata do të preferonin të zgjidhnin.

Më poshtë po pasqyrojmë pyetësin dhe rezultatet e pyetësit drejtuar 81 studentëve të viteve të para të FTI në UPT në degët Elektronikë, viti IA dhe IB Telekomunikacion, viti IA dhe IB Informatikë, IA dhe IB.

Pyetësi pati si qëllim vlerësimin nga ana e studentëve të metodës së re të aplikuar atë vit akademik, 2013-2014, në mënyrë që të shihej impakti që kjo metodë kishte tek studentët, a i përputhej ajo metodë nevojave të tyre dhe se çfarë do të donin të ndryshonin nga ajo metodë.

- Analiza e nevojave


1. A e konsideroni të rëndësishme gjuhën e huaj në studimet tuaja?



Grafiku 8

Të gjithë studentët ishin të mendimit se gjuha angleze ishte e rëndësishme për studimet e tyre. Ata u përgjigjën 86% në favor të gjuhës angleze dhe 14% ishin në mëdyshje nëse duhej të ishte gjuha e huaj pjesë e studimeve të tyre.

2. Përveç studimit, a merreni me ndonjë aktivitet tjetër profesional? 3. A punoni? 4. Nëse Po, a e vini në përdorim gjuhën e huaj?



Grafiku 9


Nga përgjigjet e studentëve na rezulton se një pjesë e studentëve janë të punësuar me kohë jo të plotë dhe punojnë në kompani private apo shërbime të ndryshme. Nëse orët e mësimit do të shtriheshin vetëm gjatë paradites, atëherë do të ishte edhe më i lartë numri i studentëve që do të punësoheshin. Duke qenë se studentët e fillojnë mësimin në mëngjes dhe në pjesën më të madhe të javës e mbarojnë pasdite, atëherë e kanë të vështirë të punësohen. Të pyetur në intervista se “Pse studentët zgjedhin të punojnë edhe kur janë duke studiuar?” ata përgjigjen se “...e kanë të nevojshëm punësimin në mënyrë që të përballojnë shpenzimet e jetesës dhe të shkollimit”. Duhet të marrim parasysh këtu faktin se studentët vijnë nga zona të ndryshme të vendit dhe kanë probleme të thella ekonomike, një pjesë e mirë e tyre. Në intervista ata janë shprehur se punojnë nëpër bare, restorante, në qendra interneti, në servise kompjuterësh, apo edhe si operatorë shitjesh. Nga studentët e punësuar, 15 prej tyre e vinin në përdorim gjuhën angleze.

5. Cilat janë aftësitë tek të cilat ata përqendrohen më tepër?

6. Cilat nga këto aftësi mendoni se zotëroni më mirë tani?

Në këtë pyetje studentët ishin më tepër të interesuar mbi gjuhën e folur. Ata mendonin se për të filluar punë diku, pyetja e parë që i bëhet është “nëse dinë të flasin anglisht”. Ata mendojnë se duhet ti japin më tepër përparësi gjuhës së folur në kursin e gjuhës së huaj, për arsye se ato merren më së shumti me ushtrime leximi e plotësuese. Studentët janë të ndërgjegjshëm për faktin se kanë mangësi në gjuhën e folur dhe kjo si rrjedhojë e mësimit të gjuhës angleze në shkollë të mesme. Me interes për ta ishte edhe dëgjimi, ku 24 studentë e kishin vendosur si aftësi tek e cila duhej të përqendroheshin. Përballja me punëdhënës të huaj i vë atyre para vështirësisë për të kuptuar një anglisht folës dhe në këtë rast ata janë të mendimit që të praktikojnë më tepër dëgjimin në klasat e gjuhës së huaj. Edhe për sa i përket leximit, ata ndjenë vështirësi, sidomos nëse bëhet fjalë për lexime të teksteve me

karakter teknik. Studentët nuk u përqendruan shumë tek shkrimi duke menduar se më tepër për ta kishte mënyra e komunikimit verbal, sa të pranoheshin në vendin e punës!




Grafiku 10

Studentët mendojnë se zotërojnë më mirë leximin për arsye se ndihen më të sigurtë teksa lexojnë sesa kur shprehen në gjuhën e folur apo në perceptimin e dëgjimit.


7.Për momentin, si do ta klasifikonit nivelin tuaj gjuhësor?

Në bazë të pyetjes, na rezultoi se një numër prej 41 studentësh mendojnë se kanë një nivel gjuhësor të mirë. Ata e bazojnë këtë lloj vlerësimi sipas njohurive të gjuhës angleze të përgjithshme të përfituar gjatë studimit në shkollë të mesme. Një numër i konsiderueshëm prej 30 studentësh janë të mendimit se e zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze duke përfshirë këtu aftësinë e tyre në të katër shprehjet bazë (gjuhë e folur, shkrimi, leximi dhe dëgjimi). Ndërsa 10 studentë e ndjenin veten të dobët në zotërimin e këtyre aftësive.



Grafiku 11


8. Nëse keni akoma vështirësi në përdorimin e gjuhës angleze, cilat aspekte i rendisni më të vështirat?



Grafiku 12


Bazuar në përgjigjet e studentëve, na rezulton se studentët hasin më tepër vështirësi në gramatikë, qoftë ajo e përgjithshme, ku 19 studentë besonin se kishin vështirësi të mbartura nga studimet e mëparshme, qoftë ajo gramatikë e bazuar në tekstet me karakter teknik e shkencor ku 22 studentë besonin se kishin vështirësi. Ata pohojnë në intervistën me gojë se zgjedhja e tyre ka të bëjë me faktin që nuk janë marrë më parë me tekste shkencore (një pjesë e madhe e tyre) e për rrjedhojë ndjejnë vështirësi teksa analizojnë një tekst të këtillë. Për sa i përket leksikut në përgjithësi, 13 studentë pohojnë se kanë vështirësi në mënyrën e përvetësimit të fjalorit dhe në vënien e tyre në përdorim. Ndërsa 16 studentë pohuan se kishin vështirësi në përkthimin e termave teknik e sidomos kur bëhej fjalë për tekste të gjata dhe të sofistikuara.

9. Si do ta përshkruanit perceptimin që kishit për gjuhën angleze në fillimin e studimeve tuaja?




Grafiku 13

10. Si ju duket sasia e orëve mësimore e vënë në dispozicion të gjuhës angleze?




Grafiku 14

11. A përdorni materiale në gjuhën angleze për ti vënë në përdorim për lëndët e tjera?




Grafiku 15

12. Nëse po, sa përqind të librave apo materialeve që përdorni janë në gjuhën angleze?




Grafiku 16

13. A ju kërkojnë/inkurajojnë pedagogët e lëndëve të tjera që të shfletoni literaturë në gjuhën angleze? 14. Nëse PO, cilat janë qëllimet e përdorimit të këtyre materialeve?



Grafiku 17



Grafiku 18

Në fund të kursit të gjuhës angleze, duke parë njohuritë e përfituara në gjuhën angleze, a jeni i aftë të:

- a) Të kuptoni leksione të prezantuara në gjuhën angleze?
- b) Të flisni anglisht rrjedhshëm?
- c) Të lexoni lehtësisht anglishten e përgjithshme?
- d) Të lexoni lehtësisht në anglishten teknike?
- e) Të shkruani saktë në gjuhën angleze?
- f) Të dëgjoni konferenca/referime të prezantuara nga ekspertë në gjuhën angleze?
- g) Të shkëmbeni pikëpamjet tuaja me ekspertë të huaj në situata formale dhe jo formale?
- h) Të shkruani relacione mbi lëndët profesionit duke përdorur materiale në gjuhën angleze?
- i) Të gjeni një punë ku kërkohet gjuha angleze?
- j) Të kryeni kërkime shkencore të mëtejshme?

Përfundime dhe analiza mbi pyetëtorin

Zbulimet e nxjerra nga 17 pyetjet hulumtuese të ofruara u bënë në një perspektivë nga e cila mund të identifikohet "hendeku midis asaj çfarë është dhe çfarë duhet të jetë"²¹¹, në lidhje me nevojat gjuhësore të studentëve të FTI-së.

Për shembull, që në përgjigje të pyetjes së parë ku studentët pyeten për faktin se *nëse e konsiderojnë të rëndësishme gjuhën angleze në studimet e tyre*, 86% e studentëve e konsideronin të rëndësishme. Duke marrë parasysh faktin që këta studentë kanë parësore lëndët e shkencave ekzakte, është vërtetë për t'u vlerësuar fakti që një numër kaq i konsiderueshëm e vlerësojnë gjuhën angleze. 14% e studentëve të cilët mendojnë se nuk ka aq shumë rëndësi gjuha angleze, vjen si pasojë e faktit se ata mendojnë që kanë zgjedhur për të studiuar inxhinieri dhe konsiderojnë më të rëndësishme lëndët e specialitetit.

Në vijim të pyetëtorit, edhe pse subjektet perceptuan dëgjimin, leximin, shkrimin dhe nën- aftësitë për të qenë më shpesh të përdorurat, ato konsideruan pothuajse të gjitha aftësitë gjuhësore të rëndësishme. Por të pyetur se cilën nga aftësitë ata mendonin se zotëronin më mirë, pjesa më e madhe e tyre pretendonin se zotëronin leximin. Unë mendoj se ata kanë bërë këtë zgjedhje për faktin se këta studentë ndihen të pa sigurt në manifestimin e shprehive të tjera, siç janë të folurit, të shkruarit apo të dëgjuarit.

Duke qenë se nuk kanë besim tek aftësitë e tyre, nuk kanë pasur mundësi komunikimi dhe praktike të gjuhës angleze, ata e mendojnë se e kanë më të thjeshtë për ta lexuar një tekst, sesa ta përshkruajnë atë me fjalë. Kjo vë në pah faktin se më shumë vëmendje i duhet kushtuar praktikës së gjuhës së folur duke i inkurajuar studentët që të venë në praktikë fjalorin e marrë, të riprodhojnë tekstet e lexuara, të punojnë në grupe dhe të dëgjojnë CD, të jenë në gjendje që të plotësojnë ushtrimet me informacionin që dëgjojnë. Këto rezultate tregojnë vetëdijen e studentëve për rëndësinë e gjuhës angleze, e cila është bërë gjuha dominuese e përdorur në çdo profesion e për më tepër në profesionin e inxhinierit.

Për sa i përket pyetjes së tetë ku studentëve i duhej që të *rendisnin aspektet në të cilat ndjenin se kishin më tepër vështirësi në mësimin e gjuhës angleze të profesionit*, pjesa më e madhe e tyre zgjodhën se kishin më tepër vështirësi në përshtatjen e gramatikës së teksteve profesionale. Kjo për rrjedhje e mangësive të mëparshme (në shkollën nëntë-vjeçare dhe gjimnaz) në gramatikë nga ana e studentëve. Gramatika, në fakt, në vite ka rezultuar si një nga aspektet gjuhësore ku studentët hasin më tepër vështirësi.

Kur studentët u pyetën për faktin nëse ju duk e favorshme që ata e kishin gjuhën e huaj si lëndë në programin e vitit të parë, 100% e studentëve ishin pro dhe e shihnin si shumë pozitiv faktin që gjuha e huaj ishte pjesë e kurrikulave në fakultetin ku ata studionin. I vetmi problem qëndron në shtrirjen e gjuhës e huaj e cila duket se nuk është shumë e përshtatshme. Studentët e FTI-së e kanë të shtrirë gjuhën angleze gjatë semestrit të parë të vitit të parë dhe ka pesë kredite, nga të cilat tre janë semianre dhe dy janë orë laboratorit.

Do të ishte e udhës dhe tepër e favorshme edhe për studentët, që gjuha e huaj të shtrihej përgjatë tërë vitit akademik, po me të njëjtin numër kreditesh, por edhe gjatë vitit të tretë.

²¹¹Brindly, G. (1989). The role of needs analysis in adult ESL programme design. In Johnson, R. (Ed). The second language curriculum, fq. 63-78. Cambridge: Cambridge University Press.

Ashtu siç dihet, studentët e kanë të detyruar që në fund të studimeve të tyre Bachelor dhe në mënyrë që të fillojnë studimet e tyre Master, ata duhet të japin provimin ndërkombëtar të gjuhës angleze. Pra, nëse studentët do të ishin në kontakt me gjuhën e huaj edhe përgjatë tre viteve të tyre Bachelor, do të ishte tepër e favorshme për ta që të mësonin, praktikonin dhe aftësoheshin më tepër në gjuhën e huaj të profesionit.

Studentët pohojnë se shtyhen nga profesorët e tyre për të shfletuar literaturë në gjuhën angleze dhe pjesa më e madhe e tyre e bëjnë për arsye se *u duhet për t'u konsultuar me materiale plotësuese në fushën e tyre të profesionit në gjuhën angleze.*

Përgjigjet e pyetjes së pesëmbëdhjetë e cila ishte e ndarë në 10 nën-pyetje tregojnë se shumica e studentëve të anketuar mendonin se ata nuk mund të përdorin në mënyrë efektive anglishten. Me tekstin e punuar gjatë semestrit të parë të vitit të parë akademik, ata mund të ishin në gjendje vetëm të shkëmbenin një informacion mbi profesionin e tyre, apo të kuptonin një kumtesë të mbajtur nga profesori i tyre, por e kishin të vështirë të kuptonin një referim apo konferencë të mbajtur nga ekspertë të huaj, apo të bënin një relacion për lëndët e tyre të profesionit në gjuhën angleze. Në të njëjtën linjë, ata shprehën mendimin se do të donin mësim dhe trajnim të vazhduar që të përmirësohen në të gjitha aftësitë gjuhësore. Kjo konfirmon seriozitetin e nevojës së studentëve të inxhinierisë elektronike, telekomunikacion dhe informatikë në një kontekst jo-amar për të zhvilluar aftësitë gjuhësore specifike të cilat do t'i ndihmojnë ata të funksionojë në mënyrë efektive në fushën e tyre objektive.

Lidhur me pyetjen e fundit kërkimore (pyetja 17) përgjigjet e studentëve tregojnë *se kursi i gjuhës angleze nuk plotëson nevojat e tyre gjuhësore.* Edhe koha e përcaktuar për kursin nuk është e mjaftueshme për t'i mundësuar atyre përdorimin e gjuhës në mënyrë efikase, (kjo duke marrë parasysh faktin se studentët e FTI-së e kanë të shtrirë lëndën e gjuhës së huaj vetëm semestrin e parë të vitit të parë me 5 kredite gjithsej).

"...Kurseve të ESP-së" rrallë u japin kohë të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat e identifikuar, as kohë të mjaftueshme për të mbledhur dhe analizuar nevojat e të dhënave, që do të thotë se mësuesit zakonisht i hartojnë kurset e tyre në bazë të një informacionit jo të plotë²¹²". Në këtë mënyrë, edhe ne, si pedagogë të tyre, si përzgjedhës të teksteve të cilat këta studentë përdorin, si dhe të organizimit të orës së tyre mësimore, na del si detyrë që ti bëjmë vetes pyetje të tilla si:

Përse nga 81 studentë, 57 prej tyre u përgjigjën që *kursi i gjuhës angleze nuk i plotëson nevojat e tyre?*

Çfarë nuk shkon me tekstin që studentët kanë në përdorim?

Çfarë duhet të heqim apo të rregullojmë në mënyrë që studentët të tërhiqen nga metoda?

Mbi çfarë kriteresh duhet përzgjedhur metoda në mënyrë që të plotësojë të gjitha nevojat e studentëve?

²¹²Hyland, K. (2006). English for academic purposes: an advanced resource book. Taylor & Francis e-Library, 2006. Fq 74

Studimi zbuloi se zotësia në anglisht është serioze dhe duhet të trajtohet urgjentisht. Kjo është për shkak se, si në shumë vende, edhe në Shqipëri, gjuha angleze, është një kërkesë thelbësore në fushën akademike dhe vendin e punës. Përveç kësaj, kurset e gjuhës angleze të marra nga ana e studentëve të FTI-së nuk i kanë mundur atyre që të përdorin anglishten në mënyrë efektive. Kështu, studentët, kanë nevojë për ndihmë në bazë të nevojave të tyre dhe dëshirave. Abu-Rizaizah (2005)²¹³ beson se: *të kënaqesh nevojat dhe interesat e studentëve ndikon shumë në motivimin e tyre për të mësuar dhe për të qenë të suksesshëm.*

“...Përfshirja e studentëve në hartimin e kurseve të ESP-së vetëm do të rrisë interesin dhe motivimin e tyre për të nxitur aftësitë e të menduarit kritik; t'i bëjë ata të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme gjuhësore me entuziazëm dhe të japin rezultat në mësimin efektiv²¹⁴”. Një hap i tillë do të bëjë të kënaqshëm procesin mësimdhënie/mësimnxënie dhe të hapë rrugën për arritjen e objektivave të kursit. Këto pretendime nxjerrin në pah një domosdoshmëri për të hartuar një program mësimor të ri për të përmbushur nevojat e studentëve. Kështu rekomandimet në vijim mund të ndihmojnë në hartimin e një kursi të gjuhës angleze për studentët e elektronikës në UPT:

1. Nevojat e perceptuara duhet të përkthehen në terma pedagogjikë. Me fjalë të tjera, kur të programohet kursi i gjuhës angleze, ne, si pedagogë të ESP-së duhet të marrin në konsideratë nevojat e studentëve duke u fokusuar në të gjitha aftësitë gjuhësore, e veçanërisht më shumë të vihet theksi në përdorimin e gjuhës së folur dhe analizës së teksteve teknike.
2. Programi nuk ka nevojë për t'u ri-ngritur, por do të ishte më mirë të ndryshohej për t'iu përshtatur nevojave të studentëve. Ai duhet të përputhet me atë që studentët mësojnë, me atë që ata do të përballen në fushat e tyre akademike dhe profesionale.
3. Një program elementar apo i ndërmjetëm do të jetë më i përshtatshëm për të përmbushur nivelin e aftësisë së studentëve. "...duhet që studentët të marrin të dhëna të kuptueshme në gjuhën angleze; të dhëna të cilat ata mund t'i kuptojnë...²¹⁵".
4. Nevojave të studentëve, vështirësive dhe motivimit i duhet dhënë më shumë vëmendje teksa hartohet një kurs ESP-je.
5. Kohëzgjatja dhe numri i kurseve duhet të rritet në mënyrë që Anglishtja të bëhet një kurs themelor në FTI.

Për të përmbledhur, studimi aktual hulumtoi nevojat e gjuhës angleze të studentëve të inxhinierisë elektronike, telekomunikacion dhe informatikë. “Në kryerjen e një hulumtimi të analizës së nevojave të studentëve, do të ndihmonte në "identifikimin e përgjithshëm për nevojat specifike të gjuhës, të cilat mund të adresohen në zhvillimin e qëllimeve,

²¹³Abu-Rizaizah, S. (2005). The process of designing an ESP writing course for engineers in a Saudi company. University of Newcastle-upon-Tyne ARECLS e-journal. 2 (a3)

²¹⁴Rayan, A. (2007). Learner participation in the design of English for Biotechnology. ESP World, 2 (15).

²¹⁵Shuib, M. (2008). Teaching academic courses in English: Issues and challenges. In Moris, Z. Abdul Rahim, H & Abdul Manan, S. (Eds.), Higher Education in the Asia Pacific: Emerging Trends in Teaching and Learning. fq. 168

objektivave dhe përmbajtjen e një programi gjuhësor dhe të sigurojë të dhëna të cilat mund të shërbejnë si bazë për shqyrtimin dhe vlerësimin e një program ekzistues...²¹⁶ ".

Si e tillë, përveç identifikimit të nevojave të studentëve, rezultatet tregojnë se kursi i tanishëm i gjuhës nuk është i mjaftueshëm në kohë për studentët dhe për rrjedhojë ka dhe mangësi të cilat u shfaqën edhe në pyetësorë. Shpresohet se rezultatet dhe rekomandimet e këtij studimi mund të shërbejnë si udhëzues se për çfarë duhet të bëhet në rishikimin dhe ri-zhvillimin e kurrikulit të ESP-së të ofruar për studentët e FTI-së në UPT.

5.3.Fjalori teknik dhe ndikimi i tij në mësimin e gjuhës angleze të profesionit

Ky kërkim është realizuar në përpjekje për ti dhënë përgjigje hipotezës së tretë (H3), të parashtruar në fillim të studimit tonë e cila është:

H3: Cilat janë sfidat kryesore pedagogjike dhe gjuhësore me të cilat përballen pedagogët e ESP-së në QGJH, UPT të cilët u mësojnë gjuhën dhe fjalorin teknik studentëve të fakulteteve të inxhinierive dhe zgjidhjet që ata ofrojnë në përpjekjet për të sjellë mënyra sa më efikase për përvetësimin e fjalorit teknik?

Ky studim ka për qëllim:

- a. Të japë një pasqyrë të shkurtër rreth mëimit dhe përvetësimit të fjalorit të ESP-së si dhe zbatimit të tij me studentët e Inxhinierisë Elektronike në UPT.
- b. Të nxjerrë në pah sfidat pedagogjike me të cilat përballen pedagogët e ESP në mësimdhënien e fjalorit teknik në fakultetet e UPT-së.
- c. Të sugjerojë disa zgjidhje të mundshme në lidhje me mësimdhënien e fjalorit për këtë kategori studentësh.

5.3.1. Pasqyrë e shkurtër rreth mëimit dhe përvetësimit të fjalorit të ESP-së si dhe zbatimit të tij me studentët e Inxhinierisë Elektronike në UPT

Një nga temat më interesante, si në mësimin e gjuhës së përgjithshme dhe në ESP, është çështja se si të mësojmë fjalorin, cilat nivele të mëimit të përfshijmë në këtë proces, strategjitë e përvetësimit të fjalorit, pasojat që përfshijnë një paradigëm njohëse dhe parimet e tjera gjuhësore. Njohja e shkencës së aplikuar për mësimin e gjuhës përhap nocionin pragmatik e që do të thotë të kuptuarit në kontekst. Në faqet në vijim, ne do të shqyrtojmë shkurtimisht këtë proces përmes një eksperience praktike në një kurs të anglishtes teknike për inxhinierinë e elektronikës, viti parë (viti akademik 2012-2013), gjithmonë duke pasur parasysh masat disiplinore të kësaj teknike.

Gjuha angleze për qëllime të veçanta është zhvilluar në mënyrë graduale dhe tashmë ajo konsiderohet si një nga fushat e gjuhës me anën e së cilës realizohen shumë veprimtari. Mësimi i fjalorit, veçanërisht në fakultetet e UPT-së po bëhet gjithnjë e më shumë si një

²¹⁶ Richards, J., Platt, J & Weber, H. (1985). Longman dictionary of applied linguistics. Harlow: Longman. Fq. 7

sfidë për pedagogët të cilët e aplikojnë atë në mësimdhënien e tyre me studentë të cilët studiojnë në këto fusha. Mësimdhënia e fjalorit duhet të jetë pjesë e pandashme e çdo programi mësimor dhe si i tillë duhet parashtruar më së miri edhe në plan-programet me të gjitha parametrat e tij. Është tepër e rëndësishme që të përcaktohet qartë përzgjedhja e fjalorit që do të përdoret me studentët, në varësi edhe të degës të cilën ata studiojnë. Në këtë mënyrë ne i përshtatemi më së miri nevojave të studentëve. Në përgjithësi, studentët përballen me vështirësi teksa mësojnë fjalët e reja në gjuhën teknike. Këto terma janë të vështira për arsye se ato nuk përdoren shpesh dhe për më tepër në fjalorin e jetës së përditshme. Por duhet të theksojmë këtu faktin se mësimi i fjalorit është qendra e çdo gjuhe dhe është tepër i rëndësishëm për studentët sepse fjalët janë pjesa kyçe e gjuhës dhe ato veprojnë së bashku. Me ndihmën e fjalëve, nxënësit mund të emërtojnë objekte, veprime dhe të shprehin ide në mënyrë që të kuptohen dhe të komunikojnë.

Edhe mësimi i strategjive të përvetësimit të fjalorit është një përgjegjësi e mësuesit të gjuhës. Me zhvillimet e teknologjisë, pjesa më e madhe e studentëve janë bërë “dembelë”. Ata preferojnë që një fjalë të cilës nuk i dinë kuptimin, ta kërkojnë nga fjalorët elektronikë online, duke përdorur celularët e tyre apo mjete të ndryshme të teknologjisë, duke u mjaftuar me një linjë interneti. Shpesh herë kjo mënyrë e përkufizimit të fjalëve kthehet në një bezdisje për ne pedagogët e gjuhës, për arsye se për ne është e rëndësishme që studentët ta përkthejnë fjalën në kontekst apo të mundohen ta gjejnë vetë kuptimin (guessing). Në këtë mënyrë, është më i lehtë edhe fiksimi apo mësimi i fjalëve të reja. Duke përdorur fjalorët elektronikë, studentët thjesht sa bëjnë përkthimin e fjalës dhe nuk mundohen të bëjnë një analizë të asaj që “pse duhet ky përkufizim dhe jo një tjetër”. Pavarësia e studentëve mund të përmirësohet vetëm më anën e disa strategjive të cilat i vijnë atyre në ndihmë në përvetësimin e fjalorit dhe ata do të përmirësohen më tepër nëse familjarizohen me këto strategji përgjatë procesit të mësimt. Në këtë mënyrë ata do të bëhen më aktivë dhe më të përgjegjshëm me mënyrat e përkthimit dhe përshtatjes së fjalëve në kontekst.

5.3.1.1. Kategoritë e fjalorit

Siç është deklaruar tashmë nga teoricienët kryesorë të ESP (Robinson²¹⁷; Hutchinson Waters²¹⁸; Dudley-Evans²¹⁹), mësimi i fjalorit në klasë ESP mund të ndahet në tri ndarje: teknik, fjalori nën-teknik dhe fjalori i përgjithshëm i përdorimit të shpeshtë në tekste shkencore në të cilin aplikohet mësimi i gjuhës. Le të shikojmë shkurtimisht, tiparet dalluese të çdo kategorie sipas Alcaraz²²⁰:

Fjalori teknik ka dy karakteristika kryesore: "një përkufizim unanim dhe lokacioni brenda një teorie²²¹". Fjalët janë njëkuptimshme dhe nuk përdoren nga burime specifike për të cilat ato janë krijuar. Për këtë grup ne mund të përshtatim, në fushën e inxhinierisë së

²¹⁷Robinson, P., 1991. "ESP today: A practitioners' guide", Prentice Hall International. New York.

²¹⁸Hutchinson, T., and A. Waters, 1987. English for specific purposes: a Learning-centered Approach", Cambridge University Press. Cambridge

²¹⁹Dudley-Evans, A. and A.M. St. John, 1998. " Developments in English for Specific Purposes: A multi-disciplinary approach" , Cambridge University Press. Cambridge.

²²⁰Alcaraz E. 2000, El inglés profesional y académico. Madrid: Alianza

²²¹ (po aty fq.42)

Elektronikës, termat si “analog”, “digital”, “bandwidth” si dhe shkurtesa të tipit AC (Alternating Current), AM (Amplitude Modulation) etj.

Fjalori gjysmë teknik është formuar nga njësi leksikore nga gjuha e përbashkët që kanë fituar një ose disa kuptime të reja brenda një fushë të dijes²²². Ky fjalor është shumëkuptimësh, pasi secili term mban kuptimin e tij origjinal duke shtuar dhe kuptime të tjera që i përkasin kontekstit specifik. Këtu ne mund të përfshijmë fjalët si *loop*, që do të thotë *lak* në gjuhën e përgjithshme dhe një *qark të mbyllur të energjisë elektrike* në gjuhën teknike, *bus*, autobus (mjet transporti publik) në gjuhën e përgjithshme dhe *rruga e të dhënave që lidhet me një numër të pajisjeve*, në gjuhën teknike. Një shembull tipik është rruga e të dhënave në bordin e një qarku kompjuterik.

Fjalori i përgjithshëm përfshin grupin më të madh të termave të përfituara nga studentët. "Ai është formuar nga fjalët e leksikut të përgjithshëm që, pa humbur kuptimin e vet, ashtu si në grupin e parë, jetojnë brenda ose në kufijtë e specialitetit²²³". Ato nuk janë terma teknik, megjithatë janë të nevojshme në kontekstin e tij. Këtu shfaqen emra si: *mjet* (device), *makineri* (machine), folje të caktuara si *distortion* (në sistemet që merren me sinjale elektrike, shtrembërim është një ndryshim në përgjithësi i padëshiruar në sinjal) dhe shumë mbiemra si *diversity* (në sistemet radio, diversiteti është një metodë e përmirësimit të besueshmërisë dhe kapacitetin, duke përdorur kanale të shumta të komunikimit për të kryer çdo sinjal).

Koha e vënë në dispozicion për studentët e viteve të para nuk është në favorin tonë. Sigurisht që nuk pretendojmë që në një semestër ti mësojmë studentëve tanë të gjithë fjalorin teknik, por patjetër që qëllimi ynë është që kur ata të mbyllin kursin e gjuhës angleze, të kenë krijuar një fjalorth mbi gjuhën e specialitetit dhe profesionit të tyre të ardhshëm. Edhe detyra e kursit e cila u kërkohet studentëve në fund të studimeve të lëndës së gjuhës së huaj, ka si qëllim krijimin e një fjalori teknik, ku studentët e kanë përvetësuar dhe punuar gjatë kohës së kursit të gjuhës.

Tradicionalisht, mësimi i fjalorit ka qenë sinonim i asaj se çfarë duhet të mësojnë studentët në mënyrë që të kuptojnë, do të thotë që fjalori i përket fushës së semantikës. Studimet e fundit dhe aplikimet e tyre mbi eksperimente të mësimdhënies në klasat shumë-gjuhëshe ku mësohen shumë në të njëjtën kohë kanë treguar që bien në kundërshtim me këtë teori. "...Një artikull gjuhësor është në fakt një monedhë me dy fytyra: një nga anët e saj i është atribuar semantikës dhe ana tjetër shqiptimit dhe asnjëra prej tyre nuk mund të konceptohet pa tjetrën"²²⁴. Në klasat shumëgjuhëshe, është provuar se, pa dallime të qarta mendore të termave të ndryshëm, studentët nuk do të guxojnë ti përdorin ato, pavarësisht nga njohuritë e tyre të kuptimit të termave, të paktën për qëllime të ligjëratës së folur. Nuk ka kuptim pa shqiptim. Ky është përfundimi i fundit i një rrugë logjike tashmë të ndërmarë, ku ndër të tjera thuhet se:

²²² (po aty fq.43)

²²³ (po aty fq.44)

²²⁴ Spoettl C. and B. Hinger 2002, Principled Pedagogical Paths in a Multilingual Teaching Context. ELIA VII, Encuentros de lingüística aplicada. Universidad de Sevilla.

"Kuptimi oral dhe komanda e shprehjes kërkojnë një vlerësim të rolit të fonetikës dhe të fonologjisë në anglishten profesionale dhe akademike, një çështje e lidhur me disa punime në gjuhët e specializuara"²²⁵.

Megjithatë, një specifikim i rëndësishëm, duhet theksuar. Për të njëjtën arsye që studentët e elektronikës tekta mësojnë ESP, nuk kanë për të kuptuar bazat e fonetikës, ata nuk do të mësojnë gramatikën apo dhe shprehjet e veçanta të cilat përdoren në situata të caktuara. Në fakt, ne mësojmë atë fonetikë jo në vetvete, por për shkak se ajo është përbërës i qartë në bartjen e kuptimit.

Ky dallim na lejon për të marrë përsëri citatat e mëparshme në të gjithë gjatësinë e saj:

"Që kur dallimet fonematike lidhen me kuptimin, ato janë më të rëndësishme se dallimet alofonike për një student i cili mëson një gjuhë për të qenë i aftë të komunikojë nëpërmjet saj si dhe ta kuptojë atë"²²⁶.

5.3.1.2. Teksti gjuhësor

Fjalorin e shohim në dy aspekte, ku njëra anë është fonematika, e cila provon rëndësinë e madhe të mësimin të termave me përmbajtje të qëndrueshme, gjithashtu duhet bërë një reflektim mbi mënyrën se si janë gërshtuar këto terma pasi ato do të kenë vlerë më tej në kuptimin e tekstit. Kjo detyrë ka qenë tradicionalisht e bazuar në konceptet të tilla gjuhësie, si referencat dhe konkluzionet e tyre vijnë për të pasuruar dhe zgjeruar procesin e plotë të kuptimit.

"...Ka një lidhje të rëndësishme mjaft të fortë midis kuptimit të fjalorit të përgjithshëm dhe termave specifike të panjohura nga studentët, lidhur me njohuri të temës, organizimin informativ të përmbajtjes dhe pranimin e tekstit"²²⁷.

Nga ky këndvështrim fjalori konsiderohet si një element tekstual, por gjithashtu semantik dhe një njësi fonematike. Teksti dhe konteksti i menjëhershëm i tij, në rastin e një teksti shkencor, studentët duhet të krijojnë një skemë të njohurive, ku të aktivizohet bashkëpunimi mendor i bazuar në informacione të përgjithshme dhe mprehtësi por edhe të bëhet dallimi i kuptimit të secilës fjalë të përdorur, rreshtave, paragrafëve dhe i komplet tekstit të shkruar. Roli i fjalorit me terma ose i fjalëve kyçe është mjaft i theksuar dhe i domosdoshëm.

-Ato shkaktojnë imazhe të gjalla në mendjen e lexuesit.

-Ato janë të lidhura në një mënyrë mjaft të qartë me temën e trajtuar.

²²⁵Van Dijk T. A. and W. Kintsch 1982, *Strategies of Discourse Comprehension*. New York: Academic Press.fq.33.

²²⁶Prator C. 1971, *Phonetics vs. Phonemics in the ESL classroom: When is Allophonic Accuracy Important?* *Tesol Quarterly* 5, fq.61-72.

²²⁷Durán P. 1999, *Análisis y evaluación del texto científico. Aplicaciones didácticas a la enseñanza del inglés con fines académicos*. Madrid: UNED.

-Ato janë të lidhura me qëllimin e lexuesit.

Në nivelin e jashtëm ne do të vendosim tekstin shkencor, si një njësi në vetvete, dhe në fund kuptimin dhe menjëherë duhet të gjejmë fjalorin akademik, që është një aparat i fuqishëm gjuhësor për të gjitha disiplinat shkencore dhe i lidhur me modelet e caktuara retorike të imponuara nga vetë përdorimi i termave (si fjalët lidhëse, parafjalët, lidhëzat, shprehje dhe përcaktime të ndryshme etj). Brenda dy niveleve të mëparshme, në thelbin e diagramit, ne duhet të vendosim atë që ne mund ta quajmë bërthamën teknike, si një grup fjalësh të një discipline, e njohur zakonisht nga studentët. Çdo nivel duhet të jetë i pranishëm në mësimdhënien tonë dhe secili rrjedh në të dy drejtimet. Bërthama është ajo që na lejon që të vendosim tekstin tonë brenda në një zonë të njohur.

5.4.Trajtimi i fjalorit të gjuhës teknike në degën e Inxhinierisë Elektronike

Ashtu siç e kemi bërë të qartë edhe në kapitujt e mëparshëm, në të gjitha fakultetet e UPT-ës, në lëndën e gjuhës së huaj, mësojmë terma të teknologjisë, informacionit dhe të gjuhës teknike të profesionit dhe kjo përforcohet më shumë gjatë orëve të laboratorit. Studentët e FTI-së kanë dy orë laborator në javë. Meqenëse kushtet laboratorike janë jo funksionale, atëherë ne si pedagogë të gjuhës na del për detyrë që të punojmë në kushte të tjera duke gjetur mënyra të ndryshme për ta zhvilluar orën e laboratorit. Në këto mënyra përmendim: audio, ku dëgjohet me CD dhe plotësohen ushtrimet në tekst, video, me materiale të shkarkuara nga interneti, analizë teksti teknik, etj. Gjatë mësimit të gjuhës, atyre u duhet të përballen me situata mjaft komplekse, përveç përvetësimit të fjalorit, janë edhe strukturat gjuhësore të temave të lidhura me materialin nga i cili vjen informacioni (qoftë ai teksti që kanë në përdorim, apo materialet e përzgjedhura nga ne si pedagogë, ose nga vetë studentët). Në fakt, veprimtaria që zhvillohet në orët e laboratorit zhvillohet në fazat e mëposhtme:

a) Ora e mësimit dhe mësuesi i gjuhës:

Studentët kryejnë detyra të ndryshme me gojë dhe me shkrim të destinuara për të mësuar shqiptim e saktë të fjalorit të botuar në mësim, një detyrë e cila është përforcuar edhe me aktivitete të tjera të tilla si, klasifikimin, përkufizimin apo shpjegimin e proceseve të ndryshme ku na shfaqen terma të larmishëm. Nga ky organizim, studentët mbase nuk i shkojnë në thellësi studimit të termave por ata kanë një sfond mjaft të gjerë i cili mund të quhet një informacion shtesë për ta. Mësuesit të gjuhës i del si detyrë që ti orientojnë studentët drejt rrugëve të thjeshtuara për të përzgjedhur ato terma të cilat kanë interes për ta dhe lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fushën e tyre të studimit.

b) Studentët shohin një sekuencë video :

"Integrated circuits", "qarqet e integruara" është tema e mësimit e trajtuar gjatë tre orëve të seminarit gjatë javës. Studentëve ju vendosim një video dhe e ndalojmë sa herë që e konsiderojmë se është e nevojshme për një sqarim të caktuar. Për të bërë të sigurt që shpjegimet janë kuptuar plotësisht, ne (pedagogët) i prodhojmë fjalët në gjuhën shqipe. Pas shikimit të plotë, kontrollojmë nivelin e të kuptuarit me anë të

pyetjeve spontane. Kështu, studentët marrin përvojë të kombinuar ku një temë e caktuar përshkruhet me anë të dy gjuhëve, anglisht dhe shqip.

c) Ora e laboratorit të gjuhës teknike:

Studentëve ju është dhënë transkriptimi i videos apo tekstit të cilin e dëgjojnë me CD, të cilën e kanë parë apo dëgjuar orën e laboratorit dhe ju duhet të punojnë me detyra të ndryshme mbi të, duke u përpjekur për të rregulluar shprehje dhe karakteristika të tilla si kuptimi i tekstit dhe koherencës, modele retorike, dhe kështu me radhë. Më tej ushtrimet vazhdojnë akoma, këtë herë duke përfshirë materiale pedagogjike, si gramatika teknike apo fjalori dhe ushtrime fonetike prej manualeve të ndryshme (ku disa shembuj gramatikorë apo ushtrimesh jepen nështojca16).

Në këtë aktivitet, roli ynë si mësues është kryesisht “ofruesi i materialeve”, ku detyra jonë është t’i mësojmë dhe t’i bëjmë studentët të aftë për të kuptuar dhe zgjidhur ushtrime.

Tani le t’i japim përgjigje disa pyetjeve lidhur me këtë aktivitet, arsyes përse është zgjedhur kjo temë dhe jo ndonjë temë tjetër nga ana jonë dhe kontributin e këtyre kurseve në kualifikimin e studentëve.

d) Si bëhet përzgjedhja e temës së trajtuar?

Arsyet për zgjedhjen e kësaj teme janë si më poshtë:

1. Të gjithë studentët tanë të cilët studiojnë gjuhën angleze teknike të Inxhinierisë Elektronike herët a vonë do t’ju duhet të përballen me tema specifike rreth elektronikës për arsye se kur ata të diplomohen dhe dalin në tregun e punës do përdorin gjuhën e specialitetit.
2. Temat përzgjidhen në bazë të lëndëve që studentët do të trajtojnë më tej gjatë studimeve të tyre dhe në këtë mënyrë do ta kenë më të lehtë për ta kuptuar një tekst në gjuhën e profesionit kur ne ja sugjerojmë si literaturë profesorëve të këtyre lëndëve për t’u konsultuar apo referuar. Prandaj edhe bashkëpunimi me pedagogët e lëndëve të profesionit ka shumë rëndësi për ne. Po të marrim shembullin e qarqeve, zhvillimi i vërtetë i përbërësve elektronike dhe qarqeve elektronike përfshin një fushë tepër të gjerë të aplikimit të Inxhinierisë Elektronike dhe është baza për teorinë e mësimin nga ana e studentëve që mësojnë këtë fushë të inxhinierisë. Kështu, një studiuesi të kualifikuar do t’i duhet të jetë i familjarizuar me gjuhën në të cilën ky hulumtim është kryer dhe me kontekstin ndërkombëtar që ajo kërkon.
3. Më shumë se 90% e botimeve lidhur me këto tema janë në anglisht. Bibliografia themelore jepet nga pedagogu i lëndës dhe është pothuajse tërësisht në gjuhën angleze.
4. Përkthime në gjuhën shqipe nga referenca të ndryshme nuk janë në dispozicion.
5. Për shumë fjalë kyçe të cilat janë të vetë-përcaktuara në anglisht, përkthimi tingëllon i vështirë ose shumë i gjatë, kështu që kërkohet ndërhyrja e specialistit të gjuhës dhe pedagogut të lëndës për ta përkufizuar sa më saktë termin.

Ne mendojmë se shtrirja e gjuhës angleze të profesionit përgjatë tre viteve të studimit Bachelor, si dhe në nivel Master e Doktoraturë në të gjitha fakultetet e UPT-ës, mund:

- a) ti ndihmojë studentët me njohuri mbi gjuhën e profesionit në gjuhën angleze duke i bërë ata më të aftë në komunikim;
- b) ti ndihmojë studentët që të jenë më të zhdërvjellët në komunikim pas tre viteve studime të ciklit Bachelor dhe të jenë më të aftë kur të dalin në tregun e punës;
- c) ti ndihmojë studentët që të jenë të aftë për të lexuar dhe përkthyer një manual, projekt, apo libër në gjuhën e profesionit;
- d) ti ndihmojë studentët që të jenë të aftë për ta mbrojtur lëndën e gjuhës së huaj në nivele të larta, pasi do ju duhet certifikata si kusht për të hyrë në nivelin Master;
- e) të ndihmojë pedagogët të përdorin materialet e tyre në gjuhën angleze, duke shmangur përkthimet jo të sakta;
- f) të rris interesin e studentëve në këto klasa, pasi praktika e tyre zhvillohet kryesisht në gjuhën shqipe por pjesa më e madhe e literaturës shtesë me të cilën konsultohen studentët është në gjuhën angleze;
- g) të shërbejë si përvojë metodologjike për pedagogët e këtyre lëndëve.

5.5.Çfarë arrihet nëpërmjet kësaj praktike me studentët?

Ne kemi përmbledhur të mirat e kësaj praktike në klasat e mësimdhënies në anglisht në tre grupe të cilat janë edhe më kryesore:

- 1) *Nga pragmatika dhe teksti gjuhësor*; ajo që ne po bëjmë është që të kthehet një tekst informativ në një tekst komunikues, sido që të jetë, me gojë ose me shkrim. Funkzioni primar i tekstit shkencor, është që të përcjellë pjesë të caktuara të dijes. Nga ana tjetër, një tekst shkencor përcjell informacionin e nevojshëm tek lexuesi (në kë rast tek studentët tanë). Ndonjëherë ne nuk arrijmë ta realizojmë pasi nuk marrim përgjigjet e duhura. Përkundrazi, ne kemi shqyrtuar modele retorike që ta kthejnë atë në një tekst informativ, në mënyrë që të pajisë studentët me shprehjet e nevojshme për kryerjen e një detyre të ngjashme me vetë dukurinë që ato marrin në shqyrtim.
- 2) *Nga njohja*; një tekst bëhet "i njohur", në momentin që ne jemi të aftë të flasim përreth tij. Studentët aktivizohen duke reflektuar dhe kujtuar njohuritë e marra më parë, pasi kanë lexuar tekste të ngjashme. Informacioni që ata marrin nuk është i ri, por studentët bëhen të vetëdijshëm për mjetet shprehëse në dispozicion, për aktivitete gjithëpërfshirëse dhe produktive.
- 3) Nëpërmjet bashkëpunimit midis pedagogut dhe studentëve arrihet në idealin ose thënë ndryshe në qëllimin që kërkojmë të arrihet nëpërmjet kësaj praktike. Ky bashkëpunim është mjaft i rëndësishëm dhe i domosdoshëm pasi vetëm në këtë mënyrë studentët do të perfeksionohen mbi kuptimin e terma vetë fjalorit si dhe teksteve shkencore. Njohja e këtyre termave e bën më të lehtë praktikën dhe punimin shkencor të studentëve.

5.6.Parashtrimi i studimit. Objekti dhe pyetjet kërkimore

Në mënyrë që të vërtetojmë hipotezën tonë të ngritur në fillim të këtij studimit, ne hartuam dhe vumë në përdorim një sërë metodash duke përfshirë këtu intervistat, pyetësorët dhe analizat e tyre. Të dhënat u mblodhën në mënyrë formale dhe jo formale. Pyetjet që ngritëm që në fillim të studimit u munduam ti japim përgjigje gjatë rrugës së kërkimit tonë.

- Cilat janë sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballen pedagogët e ESP-së?
- Çfarë zgjidhjesh ti ofrojmë këtyre pedagogëve mbi vështirësitë që dalin në mësimin e fjalorit dhe aftësive të tjera në ESP?

5.6.1. Pjesëmarrësit dhe procedurat

Në këtë studim morrin pjesë studentë të degës së inxhinierisë elektronike dhe telekomunikacionit. Gjithashtu në studim u përfshinë edhe 7 pedagogë të QGJH të punësuar me kohë të plotë të cilët ju përgjigjën një pyetësori të përpiluar për ata. Pyetësori drejtuar pedagogëve u bë në mënyrë që të merrnin më tepër informacion rreth mënyrës se si ata e konceptonin metodën në përdorim, se si e vinin atë tërësisht në funksion të studentëve si dhe për të plotësuar e mbështetur studimin tonë. Pyetësori u përqendrua në tre faza: (shih Shtojcën 7)

1. Faza e parë pati për qëllim analizën e metodës, mbi anët pozitive dhe negative të saj.
2. Faza e dytë pati për qëllim të bënte një pasqyrë të strategjive që përdornin pedagogët në klasë mbi përvetësimin e fjalorit
3. Faza e tretë kishte të bënte me pyetje dhe sugjerime.

5.6.2. Procedura e mbledhjes së të dhënave

Në mënyrë që të mblidhnin informacionin që na duhej për ta analizuar për studimin tonë, secilit pedagog në mënyrë individuale ju nisëm pyetësorin me anën e postës elektronike. Kjo në mënyrë që ata të mos ndikoheshin nga njëri-tjetri në plotësimin e përgjigjeve të pyetjeve. Më pas, kur ata e përfunduan së plotësuari pyetësorin, ma dorëzuan dhe organizuam edhe intervistat, më së shumti mbi pyetjet e ngritura në pyetësor dhe më gjerë.

5.6.3. Analiza e të dhënave

Ashtu siç është e nevojshme të kuptojmë se cilat janë strategjitë dhe mënyrat me të cilat mësojnë më mirë studentët, ashtu duhet të informohemi edhe për mendimet dhe perceptimet e pedagogëve në lidhje me strategjitë e tyre në mësimdhënie, por edhe me faktin se ata duhet të njohin mirë preferencat e studentëve përpara se të vijnë përballë një

auditori. Përgjigjet që u dhanë nga pedagogët ishin të ndryshme. Strategjitë dhe praktikat ishin të shumëllojshme, efikase dhe të dobishme.

Gjatë gjithë vitit akademik pedagogët kishin për detyrë të nxisnin studentët e tyre, të jepnin mendime se cilat ishin aftësitë në të cilat studentët ndiheshin më mirë, cilat kishin nevojë të përmirësoheshin, çfarë ishte e tepërt dhe çfarë mungonte nga kjo metodë.

Pedagogu A, pyetjes se: “Nëse do të shtonin apo hiqnin diçka nga metoda që keni në dispozicion “Engineering”, çfarë do të ndryshonit?”, iu përgjigj:

“Do të ndryshoja monotoninë që e karakterizon si pasojë e organizimit të njëjtë të të gjitha mësimeve në të tre nivelet duke e bërë edhe të mërzitshëm në disa raste. Një larmi ushtrimesh do ta pasuronte tekstin dhe do ta bënte më tërheqës. Do të përfshija edhe ushtrime lidhur me gramatikën bazuar në një trajtim teorik paraprirës të një teme të caktuar gramatikore”.

Një tjetër pedagog B, u përgjigj: *“Mësimet të ishin më të zgjeruara, ushtrimet më të gjata dhe të konsiderohej edhe gramatika. Disa nga mësimet përcjellin informacion shumë të përciptë”.*

Pedagogu C e mendonte në këtë mënyrë: *“Në çdo mësim ndiqet i njëjti format që shkakton monotonitë tek studentët dhe nuk është interesant as për pedagogun”.*

Pedagogu D: *“Ushtrimet e Reading duhet të përmbajnë tekste më të gjata dhe të testohej i kuptuari i tekstit me disa lloje ushtrimesh jo vetëm me një lloj siç ndodh te libri “Engineering”.*

Roli i pedagogëve në këtë studim nuk ishte vetëm të mbikëqyrnin procesin apo të mblidhnin informacionin dhe të dhënat e marra nga anketimet dhe pyetësorët, por edhe të reflektonin mbi perceptimet e tyre personale në lidhje me këtë çështje. Kur pedagogët u pyetën në lidhje me strategjitë e ndryshme që kërkonin studentët apo edhe me vendimet retorike që u janë dashur të marrin gjatë vitit akademik, ata u përgjigjën në këtë mënyrë:

Kur u shpjegojmë studentëve gramatikë, ata ndihen më mirë dhe kanë dëshirë për të punuar. Nëse vjen puna për të diskutuar, studentët ulin kokën dhe preferojnë të mos shprehin. Kjo tregon një pasiguri nga ana e studentëve për tu shprehur në gjuhën e folur dhe nxjerr në pah faktin se këto janë mangësi dhe reflekse të fituara nga studentët në vitet e mëparshme ku u është dashur që vetëm të plotësojnë ushtrime e ti lexojnë ato.

Më poshtë kam përzgjedhur edhe një listë të përgjigjeve të dhëna nga pedagogët rreth përdorimit të metodës, materialeve shtesë, mënyrës së përzgjedhje së materialeve, për faktin se përse pedagogët duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë që kanë stilet e të mësuarit:

- **Mbi çfarë bazash i përzgjidhni materialet?**
 - a) *Pas një analize të nevojave të studentëve dhe përfshirjes së tyre në këtë përzgjedhje, nivelit të vështirësisë të tekstit, autenticitetit, degës përkatëse, etj.*
 - b) *Materialet i përzgjedh gjithmonë në bazë të nevojave të studentëve, fushës së tyre të studimit, nivelit të tyre dhe (më e rëndësishmja) në lidhje me temat e*

mësimi përkatës, duke bërë të mundur që njohuritë që informacioni i materialit shtesë përcjell, të jetë më i zgjeruar dhe si rrjedhojë edhe fjalori ESP-së që përthithet është më i madh.

- c) Mbi bazë të kërkesave dhe interesave të tyre.*
 - d) Ushtrime dhe materiale nga interneti të cilat kanë lidhje me fushën e specialitetit.*
 - e) I zgjedh duke u mbështetur në nivelin e gjuhës angleze të studentëve si dhe sipas fushës së studimit. Gjithashtu marr parasysh edhe formatin e testeve të gjuhës angleze që njihen ndërkombëtarisht.*
- **Përse duhet të jenë të vetëdijshëm mësuesit e ESP-së për rëndësinë që kanë stilet e të mësuarit e veçanërisht fjalori?**
 - a) Sepse ato e bëjnë më të lehtë mësimdhënien e ESP-së duke vënë studentin në qendër dhe duke e bërë mësimin bashkëveprues.*
 - b) Mësuesit e ESP-së duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë që kanë stilet e të mësuarit, sepse në këtë mënyrë mund t'i drejtojnë studentët drejt një mësimnxënie më efikase dhe të arrijnë qëllimin kryesor që çdo mësues ESP-je ka: të bëjë të mundur që nëpërmjet një mësimdhënie të larmishme, studentët të praktikojnë sa më shumë të katërta aftësitë duke zgjeruar fjalorin e ESP-së.*
 - c) Gjatë studimeve në vijim secili prej tyre do të thellojë njohuritë në anglisht duke i dhënë bazën për ta është më i lehtë orientimi. Përqendrimi tek fjalori dhe shkrimi janë dy aftësi që kërkojnë një interes të veçantë.*
 - d) Pasi flitet për mësim të gjuhës për qëllime specifike e mendoj se fokusi në këtë rast është tek fjalori i fushës përkatëse dhe dialogë mes profesionistëve.*
 - e) Me qëllim që ta shpjegojnë mësimin që të jetë i kuptueshëm për të gjithë dhe që të përzgjedhë veprimtari që ta gjejnë veten të gjithë studentë.*
 - **A kanë studentët vështirësi në përvetësimin e fjalorit dhe cilat strategji vini në përdorim për mësimin e fjalorit?**

Të gjithë pedagogët ishin unanim në përgjigjet e tyre për sa i përket përvetësimit të fjalorit dhe vështirësive që ato hasnin me studentët e tyre. Pedagogët e ESP-së janë të angazhuar me përkushtim në mësimdhënien e fjalorit dhe janë të mendimit që kjo aftësi të zërë një vend kryesor edhe në hartimin e programeve të UPT-së. Mësimi i fjalorit nuk duhet të mbetet thjesht në kornizat e asaj çfarë ofrohet në tekstin mësimor por i duhet dhënë hapësira e duhur në shtrirje kohore dhe në praktikën mësimore.

Për sa i përket strategjive mbi përvetësimin e fjalorit të aplikuara në auditor nga pedagogët gjatë orës së mësimi, përmendim:

1. Të punojnë me fjalorin për përkufizimin e fjalëve të reja. Përdorimi i fjalorit patjetër që zë një vend të rëndësishëm në përkufizimin e fjalëve të reja, veçanërisht nëse duhet të përkthejnë një tekst apo të shkruajnë diçka dhe i duhet të përshtatin fjalën e duhur në kontekst. Por në fakt, edhe konsultimi i fjalorit nuk është zgjidhja

-
- e duhur pasi të shohësh një fjalë në fjalor dhe të kopjosh përkufizimin e tij nuk është zgjidhja e duhur për përvetësim.
2. Përdorimi i fjalëve të reja në fjali. Krijimi i fjalive me fjalët e reja në fakt është mënyrë shumë e mirë për të mësuar fjalorin.
 3. Përkufizimi i termave në kontekst është një tjetër mënyrë e cila vihet në përdorim. Studentët bazohen në kuptimin e tekstit për të përkufizuar fjalën që nuk kuptojnë. Por jo gjithmonë kjo strategji është ajo e duhura për arsye se, në mënyrë që të kuptosh një fjalë nga konteksti na nevojiten shumë udhëzime.
 4. Memorizimi i përkufizimeve mund të bëhet edhe me anën e ushtrimeve që bëhen me role. Pasi studentët lexojnë tekstin, përcaktojnë kuptimin e fjalorit, ata mund të krijojnë situata me role ku të venë në përdorim fjalorin e marrë.
 5. Edhe detyrat që jepen me shkrim, si në klasë edhe në shtëpi, janë një mënyrë e mirë për të vënë në praktikë fjalorin e ri.
 6. Integrimi i njohurive të mëparshe me njohuritë e reja është një mënyrë e mirë për përvetësimin e fjalorit.
 7. Përzgjedhja e materialeve për lexim bëhet në bazë të interesave të studentëve dhe në këtë mënyrë ata marrin kënaqësi teksa lexojnë për diçka e cila i ngjall interes. Këto lloj tekstesh shoqërohen me ushtrime me kuize për të vënë në praktikë fjalët e reja të dala nga teksti.

• **Në opinionin tuaj, sa të rëndësishme janë materialet e mësimdhënies dhe cilat nga ato preferoni më shumë dhe Pse?**

- a) *Pa dyshim që materialet mësimdhënëse janë lënda e parë e pedagogut, me të cilën me punë dhe qasje përkatëse ai mund të japë një produkt cilësor që të kënaqë pritshmërinë e tij dhe të realizojë synimet e mësimin.*
- b) *Materialet e mësimdhënies janë shumë të rëndësishme, sepse ato pasurojnë procesin e mësimdhënies, duke e bërë atë më interesant dhe më frytdhënës. Materialet bëjnë të mundur që aktivizimi i studentëve të jetë më i madh dhe si rrjedhojë kemi një rritje të interesit dhe vëmendjes së tyre. Materialet që preferoj më shumë janë ato që sillen nga interneti, sepse janë të larmishme, të shoqëruara me foto, shpikje, krahasime etj dhe plotësojnë më së miri mësimet përkatëse. Por gjithashtu përdor edhe pjesë nga libra të tjerë të fushës së inxhinierive (Technology).*
- c) *Mendoj se janë shumë të rëndësishëm. Personalisht preferoj tekstet e ndryshme pasi nëpërmjet tyre ndalem tek fjalët dhe struktura e fjalisë si dhe dëgjimi i dialogëve.*
- d) *Materialet që gjenden në internet janë bashkëkohore duke qenë se dhe vetë ESP është diçka që zhvillohet shumë shpejt.*
- e) *Materialet e mësimdhënies sigurojnë një bazë ku të mbështetet ora e mësimin dhe çdo veprimtari mësimore.*

Një çështje në diskutim ka qenë për këtë vit ndarja e orëve të mësimin të gjuhës angleze në orë seminari, leksioni dhe orë laborator.

Dihet se gjuha angleze, nuk mund të referohet si një orë leksioni për arsye se ajo duhet të jetë një orë ndërvepruese, ku si mësuesi ashtu edhe nxënësi duhet të bashkëpunojnë dhe punojnë në plotësimin e ushtrimeve të dhëna. Për sa i përket orëve të laboratorit, do të ishte ideale të zhvilloheshin si orë, por për arsye mungese logjistike dhe të një laboratorit të mirëfilltë të gjuhës angleze, ato orë nuk mund të zhvilloheshin.

Kështu që pyetjet 14, 15, 16 të përfshira në pyetësor kanë të bëjnë me këtë temë:

A keni orë laborator/leksione të përfshira në programin tuaj?

Nëse Po, a ju duken me vend përfshirja e tyre në programet e gjuhës angleze?

Nëse Po, ju lutemi sqaroni.

Përgjigjet në përgjithësi ishin si vijon:

- a) *Megenëse ESP-ja fokusohet në termat përkatëse të fushave të caktuara mendoj se leksionet nuk janë të domosdoshme. Mbase mund të organizohen një apo dy leksione për të prezantuar studentët me ESP-në, tiparet dhe veçoritë e saj dhe ndonjë leksion mbi shkrimin e CV-së apo aplikimeve për punë dhe përgatitjes për intervista pune, që mund të bëhen edhe pa pasur orë specifike leksioni apo t'u jepen studentëve si detyra shtëpie dhe më pas të diskutohen në klasë. Për sa u përket orëve të laboratorit mendoj se ato do të ishin mjaft të vlefshme nëse do të kishim laboratorë të gjuhës së huaj të pajisur me aparaturat e duhura. Ato do të na ndihmonin për të zhvilluar orë dëgjimi me synime të caktuara.*
- b) *Mendoj se orët e leksionit nuk janë të përshtatshme pasi kemi të bëjmë me studentë të cilët mësojnë gjuhën e huaj për ti ndihmuar ato në profesionin e tyre i cili është tërësisht i ndryshëm nga ai i një lektori apo studiuesi të gjuhës së huaj. Për ata është i vështirë asimilimi i leksioneve sepse niveli i gjuhës i përdorur për një leksion shpesh nuk është i nivelit të tyre, pasi ato mësojnë gjuhën e huaj si një gjuhë të dytë. Ata nuk janë studentë të cilët si bazë të studimit kanë gjuhën angleze (sikurse janë studentët që studiojnë në Departamentin e Gjuhës Angleze, FGJH), edhe pse kjo lëndë ka një peshë të konsiderueshme në degën e tyre të studimit.*
- c) *Mendoj se vetë gjuha e huaj është një lëndë që nuk mund të ndahet në seminare e leksione pasi kërkohet bashkëpunim i ngushtë mes pedagogut e studentit*
- d) *Mendoj se do ishte e udhës të bëhej një unifikim i krediteve të gjuhës së huaj në të gjitha fakultetet e Universitetit Politeknik. Gjuha e huaj duhet shtrirë përgjatë gjithë vitit akademik dhe jo vetëm gjatë një semestri. Viti i dytë dhe i tretë do të ishin më të përshtatshme për studentët për arsye se gjuha e specialitetit do të merrte më tepër kuptim për studentët pasi ata do të ishin futur në lëndët e specialitetit dhe do e kishin më të thjeshtë përvetësimin e termave teknik. Nuk e shoh me vend përfshirjen e leksioneve në një orë gjuhe, por pajisja me një laborator me kushte bashkëkohore do të ishte ideale për studentët e inxhinierive.*

5.6.4. Rezultatet e studimit

Sipas rezultateve të këtij studimi, rishikimi i metodës në përdorim do të ishte një çështje serioze për tu diskutuar dhe marrë në konsideratë për vitin e ardhshëm akademik 2015-2016.

Nga ana tjetër, rezultatet e studimit treguan se mungesa e materialeve të domosdoshme për mbarëvajtjen e gjuhës angleze gjatë një ore mësimi, ndikon rrënjësisht në ecurinë e studentit (mungesa e laboratorit, kompjuterit, videos, audios, etj.). Kjo gjë jo vetëm që nuk e ndihmon studentin, por përkundrazi, çorienton atë duke mos e plotësuar me materialet e nevojshme.

Gjithashtu, është tepër e rëndësishme përfshirja e gramatikës në tekstin mësimor që po mësojnë studentët. Teksti aktual nuk e përfshin gramatikën dhe kjo është një mangësi e cila është ndjerë shumë nga ana e studentëve. Edhe ne si pedagogë jemi detyruar që ti plotësojmë studentët me materiale shtesë duke përfshirë dhe përshtatur gramatikën sipas tekstit të dhënë.

Kjo gjë na ka bërë që të sforcohemi në realizimin e planit mësimor sepse pajisja e studentëve me materiale shtesë ku primare ishin materialet që përmbanin ushtrime gramatikore, ishte një gjë ekstra. Do të ishte e udhës që të aplikohet një metodë e cila ta kishte të përfshirë gramatikën në programin e saj. Gramatika duhet të jetë një pjesë e pa ndarë e mësimi të një gjuhe të huaj, qoftë ajo edhe gjuha e profesionit.

Perceptimi që kanë studentët për metodën e gjuhës së huaj, në fillim duket si diçka e thjeshtë dhe më pas, vjen duke u vështirësuar. Sigurisht që u duket interesant fakti që po mësojnë terma në gjuhën e tyre të profesionit, por kur vjen çështja në aplikimin e termave dhe përdorimin e tyre në gjuhën e folur, e shohin se kanë vështirësi.

Kjo lloj analize e cila u bë më anë të pyetësorëve drejtuar studentëve dhe pedagogëve, dy palëve të përfshira në veprim, na bëri të reflektojmë dhe të bëjmë një analizë të hollësishme të silabusit, programit, planit mësimor si dhe tekstit të gjuhës angleze. Nga përgjigjet e marra, jo vetëm që kuptuam se cilat ishin avantazhet dhe jo-avantazhet me të cilat ishin përballur studentët teksa përdornin metodën Engineering, por edhe rritjen e interesit të studentëve për mësimin e termave teknik si dhe përdorimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës së huaj.

5.6.4.1 Sfidat e mësuesve të ESP-së në mësimin e fjalorit

Gjatë mbledhjes së të dhënave, analizës së tyre dhe të intervistave të bëra me pedagogët e ESP-së dalim në përfundimin se ata përballen me sfida dhe vështirësi në mësimdhënien e gjuhës së specialitetit. Këto vështirësi bëhen edhe më të mëdha në rastin kur për mësimdhënien e gjuhës së huaj, pedagogët përballen me:

- Mungesë fjalorësh të specializuar
- Mungese ambientesh e auditorësh
- Mungesë mjeteve audio/video
- Mungesë interneti, kompjuterësh
- Mungese njohurish të specializuara mbi elektronikën
- Mungesën e disa teknikave të mësimdhënies
- (ndonjëherë) mungesë interesi nga ana e studentëve

Nga përgjigjet e pyetësorit ne shohim se pedagogët që japin mësim ESP, janë pedagogë të GE dhe janë bërë të këtuillë pa ndjekur studime mbi këtë fushë apo pa ndonjë trajnim mbi

fushën e ESP-së. Ata nuk kanë njohuri të thelluara mbi fushën e ESP-s dhe papritur janë gjendur përballë temave të pa zakonta për njohuritë e tyre, me një sërë shprehjesh teknike të sofistikuara dhe shprehjesh pa fund.

Në mënyrë që të përmirësojnë aftësitë e tyre në mësimdhënie në këtë fushë të ESP-së, sipas intervistave të zhvilluara me pedagogët e QGJH, ata po përpiqen me të gjitha mënyrat për të përmirësuar teknikat e mësimdhënies së tyre, si dhe po pasurojnë njohuritë duke u angazhuar në përfundimin e studimeve Master, ndjekjen e studimeve të thelluara për titullin Doktor i Shkencave mbi këtë fushë si dhe duke ndjekur trajnime apo konferenca për të zgjeruar njohuritë e tyre.

5.6.4.2. Aftësimi i pedagogëve në mësimdhënien e fjalorit teknik

Nga rezultatet e pyetësorit, një nga sfidat me të cilat përballen pedagogët e QGJH, përveç infrastrukturës dhe mungesës së logjistikës, janë edhe strategjitë e mësimdhënies së fjalorit teknik. Duke përdorur teknikat e vjetruara, ata bëhen të mërzitshëm për studentët e tyre dhe ora e mësimi nuk është tërheqëse. Sigurisht që metoda luan një nga rolet bazë pasi nga aty merren bazat e mësimi dhe mbi të ngrihet edhe puna e pedagogëve. Duke parë problemet që shfaqen gjatë orës së mësimi, duke dialoguar me studentët dhe duke hyrë në botën e tyre, bëhet edhe më e lehtë përzgjedhja e materialeve plotësuese nga ana e pedagogut. Me qëllim që ora e mësimi të bëhet më interesante, duhet zbatuar edhe puna në grupe, ku studentët punojnë së bashku për të krijuar një situatë në bazë të fjalorit të marrë dhe duke e aktruar atë me role. Kjo gjë është praktikuar dhe ka funksionuar me studentët tanë.

5.6.4.3. Teknika të ndryshme të aplikuara gjatë orës së mësimi dedikuar fjalorit teknik

Tema: Unit 14 Electrical Engineering²²⁸ (Mësimi 14: Inxhinieria Elektrike)

(shih shtojcën 17)

Koha në dispozicion: 4 minuta

Burimi: teksti Engineering

Procedura: Pasi është shpjeguar mësimi i ri, kanë dalë fjalët e reja dhe janë përkthyer në kontekst, studentët punojnë me ushtrime në mënyrë që të venë në përdorim dhe në praktikë fjalorin e ri.

Activity 1: Match the words (1-4) with the definitions (A-D)

Veprimtari 1: Lidhni fjalët (1-4) me përkufizimet (A-D)

²²⁸Burimi: Metoda Engineering nga Charles Lloyd dhe James A. Fraizer, Express Publishing 2013. Unit 14, fq.30

- | | |
|-----------------------|------------------------------------|
| 1. ___ volt | A. measure of electrical power |
| 2. ___ output voltage | B. measure of electrical potential |
| 3. ___ watt | C. voltage put out by a device |
| 4. ___ output power | D. watts put out by a device |

Exercise 2: Use the words from the word bank to fill in the blank.

Ushtrimi 2: Vendos fjalët e dhëna në vendet bosh.

input voltage power supply components

1. The _____ directs electricity to the disk drive.
2. This TV needs a minimum _____ to work.
3. The factory assembles the different _____.

Pasi studentët i plotësojnë vetë ushtrimet, i lexojnë njëri pas tjetrit.

Activity 2: Affixes

Veprimtaria 2: Parashtesat

Në tabelë shkruajmë një fjalë dhe rreth saj vendosim (affixes) parashtesa të mundshme të cilat na ndihmojnë në fjalëformim. Në këtë mënyrë studentët përveç fjalëve të reja që i dalin në tekst, mësojnë edhe fjalë të tjera të cilat dalin si pasojë e vendosjes së parashtesave.

Tema: Unit 15 The future of Technology²²⁹

(Mësimi 15: E ardhmja e Teknologjisë)

Koha në dispozicion: 10 minuta

Burimi: Teksti Technology

- a) I shpjegojmë studentëve kuptimin që ka parashtesa (affix). I pyesim studentët se përse sipas mendimit të tyre ka rëndësi mësimi i parashtesave kur përdoret në fjalët teknike. (sigurisht që përgjigja është se i ndihmon ata në përkufizimin e fjalëve të pa njohura. I kërkojmë studentëve të shikojnë tabelën si dhe të studiojnë parashtesat dhe kuptimet e tyre.
- b) Pasi studentët e vëzhgojnë tabelën, i kërkojmë atyre ta bëjnë ushtrimin në mënyrë individuale. Si fillim disa studentë mendojnë se ky lloj ushtrimi është i vështirë. Ne ju shpjegojmë se përdorimi i parashtesave është tepër i thjeshtë. Ne e ilustruam me shembull për t'ia shpjeguar dhe bërë më të qartë ushtrimin: P.sh *tele* (një parashtesë e marrë nga tabela, do të thotë, në distancë) + *medicine* (fjalë e dhënë në ushtrim) = *telemedicine*

²²⁹ Burimi: Metoda Technology, prodhim I vitit 2012, Eric, H. Glendenning, Oxford University Press, fq 107.

Affix	Meaning	Example
bio	life	biotechnology
ex	out of	external
inter	between	internet
intra	inside, within	intranet
less	without	wireless
micro	very small	microwave
mini	small	minidisk
poly	many	polyester
pre	before, earlier	prefabricated
super	above, much greater	supermarket
tele	far, distant	telecommunication

Exercise 2: Using the table, work out the words which have the following meanings.

Ushtrimi 2: Përdor tabelën dhe lidh fjalët me kuptimin e tyre.

Pasi studentët kanë lidhur fjalët me parashtesat e dhura, ata plotësojnë ushtrimin që vijon duke e konkretizuar kuptimin e fjalës së re të formuar nga vendosja e parashtesës dhe duke e dhënë përkufizimin në gjuhën angleze dhe më pas në gjuhën shqipe.

1. medicine at a distance
2. a very small electronic chip
3. a plastic containing many molecules of carbon
4. an instrument for measuring very small thicknesses
5. concrete which has been stressed earlier
6. a computer much more powerful than ordinary computers
7. a very small procesor
8. a fan which removes ar and bloës it out
9. a phone without a cord
10. measuring according to biological data

Activity 3: Word groups

Veprimtaria 3: Ndarja e fjalëve në grupe

Tema: Unit 1 Technology and society²³⁰

(Mësimi 1: Teknologjia dhe shoqëria)

Koha në dispozicion: 7 minuta

Burimi: Teksti Technology

Disa fjalë teknike ngjasojnë me njëra-tjetrën, por përdoren në mënyra të ndryshme, p.sh *mechanic* dhe *mechanics*. Një mënyrë për ti mbajtur mend këto fjalë dhe ndryshimet

²³⁰Burimi: Metoda Technology, prodhim I vitit 2012, Eric, H. Glendenning, Oxford University Press, fq 8.

ndërmjet tyre, është ndarja e këtyre fjalëve në grupe. Ky lloj ushtrimi i prezanton studentët me një tjetër mënyrë për të mësuar dhe mbajtur mend fjalorin kyç teknik.

I shpjegojmë studentëve dallimin ndërmjet mechanic dhe mechanics duke ju thënë se mechanic i përket një grupi që në përbërje ka njerëzit dhe profesionet, ndërsa Mechanics i referohet një grupi lëndësh.

Studentëve ju është dhënë një listë me fjalë teknike të përdorura më shpesh dhe studentët i ndajnë ato duke i vendosur në tabelë sipas kategorive përkatëse.

mechanic	mechanics	mechanical	mechanism
elektron	electronic	electronics	
technical	technology	technician	
electricity	electrical	electrician	
engine	engineer	engineering	

Subjects	People and jobs	Things	Adjectives
engineering	engineer	engine	engineering
mechanics	mechanic	mechanism	mechanical
electronics	-	elektron	electronic
technology	technician	-	technical
-	electrician	electricity	electrical
engineering	engineer	engine	engineering

Activity 4: Pair work

Veprimtaria 4: Punë në çifte

Tema: Unit 7 Manufacturing (Mësimi 7 Prodhimi)²³¹

Koha në dispozicion: 4 minuta

Burimi: teksti Technology

Hapi i parë: Studentët diskutojnë në çift rreth diagramit të cilin e kanë të ilustruar në libër (Shtojca 20). Tema për diskutim është rreth prodhimit të CD-ve ku studentët japin mendimet e tyre rreth procesit që mund të ndiqet për prodhimin e tyre. Studentët ndajnë rolet ku njëri është A dhe tjetri B.

Hapi i dytë: Secili nga studentët ka në dispozicion një tekst të shkurtër ku përshkruhen hapat e procesit. Studentët përpiqen të lidhin secilin nga tekstet me një nga hapat në proces

²³¹Burimi: Metoda Technology, prodhim i vitit 2012, Eric, H. Glendenning, Oxford University Press, fq.43.

Hapi i tretë: Studentët diskutojnë e debatojnë me njëri tjetrin duke dhënë arsye për zgjedhjet e tyre dhe deri sa të bien dakord për renditjen e duhur të hapave të procesit.

Ilustrimi me figurë i ndihmon shumë studentët edhe në rastet kur ata nuk i kuptojnë të gjitha fjalët në tekst.

E konsideruar në tërësi, në një orë mësimi shfaqen të gjitha elementet tipike për nga stili shkencor: fushat leksikore (mjete, materiale), format joveprore, foljet dëshirore, parafjalët, mbiemra dhe shumë elementë të tjerë.

Në fazën e zbatimit të fjalorit në praktikë, studentët janë familjarizuar tashmë edhe me modelin e mësimdhënies dhe me përmbajtjen e fjalorit. Megjithatë, para se të diskutojmë mbi një material, tekst apo video, studentëve ju jepen fjalët kyçe të cilat do të jenë pjesë e mësimi.

P.sh. Mësimi 7: Manufacturing (Prodhimi)

Alloy- përzierje	copper - bakër
rubber - gomë	plastik - plastikë
steel - çelik	wood - dru
titanium - titan	aluminium - alumin

Klasa ndahet me tre grupe nga 10 veta (duhet të theksojmë këtu, që një grup i vitit të parë të degës telekomunikacion, ka 30 studentë) të cilët kanë një nivel të ngjashëm të gjuhës angleze dhe ata punojnë mbi të njëjtën temë. Detyrat e secilit grup do të jenë:

1. Të njohin fjalët.
2. Ti shprehin ato.
3. Ti përkthejnë
4. Ti përkufizojnë

Në tabelën e mëposhtme, ne mund të vëzhgojmë rezultatet; nga e majta në të djathtë, mund të shohim numrin e studentëve të cilët përfunduan me suksese detyrat 1,2 dhe 3 si dhe mesataren për çdo detyrë .

alloy	10	6	10	Mesatar
rubber	7	6	10	Mirë
steel	9	10	10	Mirë
titanium	5	4	9	Mesatar
copper	5	5	6	Keq
plastic	6	5	8	Mesatar
pollyurathine	4	2	2	Keq
aluminium	8	7	10	Mirë
electrons	10	10	10	Mirë

welding	6	5	6	Mesatar
---------	---	---	---	---------

Disa fjalë të reja që mund të përdoren përgjatë mësimit me studentë të cilët duan të ecin akoma më tej me ritme të shpejta janë:

Injection moulding – injeksion i derdhur

Impact extrusion

Bonding – lidhje kimike

vacuum forming – formimi i vakumit

laser beam recording – rregjistrimi i rreze laser

Nga këto të dhëna, ne mund të nxjerrim përfundimet e mëposhtme:

1. Nga të gjitha detyrat primare, studentët kanë vështirësi në përkthimin, të ndjekur nga përcaktimi dhe njohjen (në të njëjtin nivel) dhe shqiptimin, përveç në rastet kur kemi ngjashmëri fonematike me gjuhën shqipe në të cilën procesi bëhet më i lehtë.
2. Njohja me termat vjen nga fakti i përdorimit të leksikut si dhe nga ngjashmëria fonematike.
3. Pjesa fonematike e kuptimit duhet përforcuar deri në nivelin e përkthimit, nëse ne presim që studentët të përdorin vetë ato terma.

Këto janë disa nga përfundimet kryesore, gjithashtu disa nga detyrat prioritet mbi të cilat janë krijuar këto metoda janë:

- a) të dëgjojnë fjalët në audio dhe të shohin video të ndryshme lidhur me subjektin që studiojnë;
- b) punimi në transkriptimin e tekstit
- c) pyetja e studentëve lidhur me shpjegimin e subjektit si dhe studentët vetë të japin mendimet e tyre lidhur me këto çështje duke përdorur fjalë nga fjalori i mësuar përgjatë kursit.

Pasi aktiviteti të ketë përfunduar, studentëve u jepet një pyetësor i cili krahasohet më pas me ato të mëparshmet, ku studentë të mëparshëm të kenë ndjekur të njëjtin kurs si studentët aktualë. Statistikat na tregojnë se 90% e studentëve kuptuan 75% dhe 100% të informacionit të videos në klasat ESP. Për sa i përket kurseve ESP, studentët treguan, në terma të përgjithshme, një shkallë më të lartë të interesit dhe pjesëmarrjes.

Si përfundim, mund të themi se nga ana akademike, eksplorimi i fjalorit në kontekste gjuhësore, na çon të kërkojmë nga vetja (mësuesit e gjuhës) të bëjmë një përpjekje më të lartë në kërkimin shkencor, në mënyrë që këto kurse të jenë sa më efikase dhe për të gjetur ekuilibrin e duhur midis mësimit të fjalorit akademik dhe fjalorit të termave.

Përvoja që shfaqet këtu, konsiderohet në terma relativë, ku është hedhur vetëm hapi i parë për eksplorimin e mëtejshëm dhe bashkëpunimet ndërdisiplinore. Kjo është thelbësore, mbi të gjitha, se kjo mënyrë e zbatimit të mësimin gjen qëllimin e duhur të saj në një situatë krejtësisht të re, jo vetëm si një eksperiencë në klasat e mësimdhënies, por në të gjitha aspektet e veprimtarisë akademike.

Pedagogë nga të gjitha disiplinat duhet të përfshihen në këtë proces ashtu siç të gjithë pedagogët e gjuhës. Mësimi dhe praktika është një kontribut i vogël por mjaft i rëndësishëm për sfidat e mëdha me të cilat mund ndeshen studentët në të ardhmen.

Pra, si përfundim mbi mësimin e fjalorit mund të themi se: fjalori me përmbajtje të qëndrueshme duhet të mësohet në një kurs ESP të unifikuar, së bashku me fjalorin akademik. Dhe kjo duhet të bëhet lidhur me faktin që studentët tashmë e dinë shumicën e këtij fjalori, sepse studentët nuk do të mund të jenë në dijeni të aftësive të tyre derisa ata nuk do të komandojnë anën tjetër të medaljes së fjalorit: shqiptimin.

5.7. Ndikimi që ka leximi i materialeve të gjuhës angleze me terma teknik tek studentët e UPT-së

Ky studim pati si qëllim të paraqesë një rrugë të re për përgatitjen e një programi leximi mësimor ESP në klasat e nivelit B2 (sipas Kornizës së Përbashkët të Referencave për Gjuhët) në gjuhën angleze në Fakultetet e Inxhinierive në UPT. Për të realizuar këtë, në vitin akademik 2012-2013, fillimisht, ky program i leximit mësimor ESP u zbatua në grupet e studentëve të Fakultetit të Inxhinierisë së Gjeologji-Minierave (FGJM) dhe ai i Teknologjisë dhe Informacionit (FTI) në UPT. Për të realizuar hulumtimin, dy grupe të përzgjedhura rastësisht të përbëra nga një numër i barabartë studentësh njëra nga studentët të FGJM dhe grupi tjetër i përbërë nga studentët të FTI. Duhet marrë parasysh fakti që lëndët që zhvillohen në semestrin e parë të vitit parë, janë ato të formimit të përgjithshëm dhe ku merren bazat e inxhinierisë si matematika, fizika dhe kimia.

Tradicionalisht pjesët bazë të aktivitetit të ESP në UPT janë të përqendruara gjatë vitit të parë të studimeve. Tashmë është fakt që studentët janë të detyruar që ta mbrojnë gjuhën angleze në përfundim të studimeve të tyre të nivelit Bachelor dhe gjuha angleze është kusht për vijimin e studimeve të tyre në nivelet Master e doktoraturë. Përgatitje për këto lloj njohurish bëhen që në sistemin e shkollës së mesme ku studentët e kanë gjuhën e huaj të detyruar për ta dhënë në provimet e fund vitit. Mendohet që në vitet pasardhëse qëllimi për të përmirësuar nivelin e anglishtes është rritur për nevojat kryesore të komunikimit. Kur studentët pranohen në universitet dhe nisin studimet e tyre, perceptimi i gjuhës angleze është diçka tjetër. Ata përballen me gjuhën e specialitetit (pjesa më e madhe e tyre për herë të parë, duke përjashtuar këtu ata studentë të cilët kanë mbaruar një shkollë të mesme teknike dhe janë prezantuar edhe më parë me terma teknike të gjuhës së specialitetit). Rritja e interesit për ESP mund të listohet si më poshtë :

- 1) Pas ndryshimeve në vend, me ardhjen e demokracisë, futjen e teknologjive në jetën e përditshme, komunikimi me botën, liberalizimi i tregut, industrisë, etj. zunë vend

sidomos në fushën teknologjike dhe atë ekonomike dhe si pasojë ndodhi dhe dëmtimi i gjuhës (Angleze).

- 2) Zhvillimet e reja u paraqitën në Edukimin Psikologjik, për shembull u rrit interesi për të mësuar dhe nevojat e kërkesat e studentëve për mënyrën e marrjes së informacionit dhe mënyrës së mësuarit.
- 3) U rrit kërkesa për një nivel më profesional për kurset e gjuhës angleze, përkatësisht në nivel gjuhësor, me metodologji specifike për të vëzhguar prurjet e reja.

Megjithatë nuk mund të anashkalohet fakti që një program specifik kërkon disa studime specifike. "...Qëllimi kryesor i programit gjuhësor i ESP duhet të ofrojë mundësitë optimale të përvetësimit për të gjithë studentët përmes njohjes së një modeli individual dhe unik me kusht rritjen dhe zhvillimin..."²³² gjithashtu "...Gjithçka që përfshihet në programin e ESP-së mund të përmblihet në dy aspekte kryesore":

- 1) Vendosja e një "mbulese" në anglisht veçanërisht lidhur me studimin e shkencës.
- 2) Adaptimin e shkathtësive komunikuese në anglisht si dhe në aspektin e përgjithshëm të gjuhës angleze tashmë të përvetësuar²³³

Këto janë pikat e shqyrtimit që mbështesin parimin e injektuar në këtë studim.

"...me qëllim që të përmirësojmë aftësitë e leximit tek studentët, ne ndërtuam një kurs i cili shton vëmendjen në karakteristikat gjuhësore të tekstit. Ata gjithashtu thonë se: "më në fund vërejmë një vëmendje specifike në diskursin logjik në tekstet e matematikës i cila na mundëson një përmirësim në mënyrën e kuptimit e leximit..."²³⁴

Është e lehtë për të vëzhguar gjithë këto shembuj që reflektojnë rëndësinë e nevojave të studentëve për të pasqyruar ESP e tyre edhe në përditshmëri.

Gjithashtu Moorhouse një mësues i modës, raporton eksperiencat e tij më poshtë si vijon: *"...Aftësitë e lidhura me kurse të cilat janë zhvilluar në disa qendra arsimore për të rriturit në Londër. Kjo lëvizje ka për qëllim të kombinojë mësimdhënien për njohuritë e një fushe specifike në lidhje me aftësitë e arsimit që duhen në praktikë duke e zgjeruar atë në nivele të pavarura. Prandaj është e sigurt që të pohojmë që studimet në vende të ndryshme kanë vërtetuar se studentët ESP duhet të fitojnë të dyja, edhe njohuri të përgjithshme të gjuhës angleze dhe disa terminologji të veçanta të lidhura me fushën e tyre të veçantë të aktivitetit në mënyrë që ta kenë të lehtë të kuptojnë një tekst në gjuhën angleze por të jenë të aftë edhe në fushat e tjera të studimit..."²³⁵*

²³²Fredeneks, Charles.(1996) "How to Develop an ESP Currieulum." Overseas Education Centre Reference Collection. Ref. 15A14: I

²³³Waters, Alan.(1977)"English for Specific Purposes" Ed.Susan Holden. Overseas Centre Reference Collection. Ref. 17B/31:fq. 41-42,

²³⁴Bensoussan, M; J. Golen.(1985) "An Advanced English Course for Students of Mathematics." in Reading for Professional Purposes. Ed. J. M. Ulijn and A.K. Pugh. Acco: Amersfoort fq.185-87.Në studimin e tyre, Bensoussan dhe Golan raportojnë se studentët e matematikës në" Halfia University" u është kërkuar të lexojnë materiale të avancuara matematikore të shkruara në gjuhën angleze, edhe pse këta studentë mendohet të kenë njohuri fillestare në gjuhën angleze prandaj ata e shohin të vështirë të përballen me gjuhën e specializuar dhe tekstin e përshtatur për lëndën e matematikës.

²³⁵

Ajo që njihet gjerësisht është fakti se çdo program duhet të ketë qëllimet e tij që duhet të arrijë, dhe objektivat janë vendosur në formën e kushteve që do të sjellë dhe realizimin e qëllimit. Në synojmë që të paraqesim një program të ri për studentët e inxhinierëve në UPT, duke bërë të mundur zhvillimin e një politike për të manipuluar dijet e përgjithshme në të lexuar ndërkohë që një student është duke ndjekur një problem matematikor ose një problem shkencor ose duke lexuar një artikull që i referohet këtyre fushave të studimit.

Gjatë intervistave, një grup studentësh të Fakultetit të Inxhinierisë së Gjeologji-Minierave u “ankuan” duke thënë se: *ata kishin vështirësi të ndiqnin kurset e nivelit B2 të gjuhës angleze pasi mendonin se niveli i tyre ishte më i ulët nga se pretendohet.*

Ata gjithashtu shpjeguan që në kohën që u diplomuan nga gjimnazi shtetëror nuk studionin matematikë, fizikë dhe kimi në gjuhën angleze. Në këtë mënyrë ata nuk kishin njohuri mbi terminologjinë në gjuhën angleze të këtyre disiplinave. Këta studentë nuk kishin bërë ndonjëherë kurs ESP, por ndërkohë kursi në vitin e parë në universitet është i përbërë nga tekste me terma teknik, fjalor dhe ushtrime të cilat kanë bazë kryesore terminologjinë e specialitetit.

Përveç kësaj, në këto kurse studentët tentojnë kryesisht të mësojnë përmendësh fjalorin duke e përfshirë atë si aktivitet të leximit. Megjithatë, sipas këndvështrimit të tyre do të kishte qenë më mirë për ta nëse do të kishin mësuar thelbin e terminologjisë së matematikës, fizikës dhe kimisë në mënyrë intensive. Në këtë studim përgjigjet e pyetjeve janë si në vijim;

- 1) Cili është opinioni i studentëve për gjendjen e tanishme të programit ESP?
- 2) A ka ndonjë dallim të dukshëm ndërmjet studentëve të vitit të parë, inxhinieri elektronike me studentët e vitit të dytë?
- 3) A ka ndonjë dallim të rëndësishëm mes studentëve të cilët kanë qenë në kontakt me materialet e leximit të ESP përfshirë këtu materialet matematikore, fizike, kimi dhe tekste të përgjithshme të leximit dhe atyre që ndjekin nivelin e mesëm B2 të gjuhës angleze?
- 4) Cilët janë përbërësit e modelit të propozuar?

Rezultatet e anketimeve treguan se studentët e viteve të dyta, dega Elektronikë në FTI e panë të nevojshme për të përfituar njëkohësisht të dyja edhe aftësitë e leximit dhe disa njohuri të përgjithshme të terminologjisë në fusha të ndryshme si në matematikë dhe shkencë, të gjitha në gjuhën angleze me qëllim që të jenë në gjendje për të kuptuar dhe për të zgjidhur problemet në kurse të lidhura që në fillim të programit mësimor.

Qëllimi ishte për të lexuar tekste matematikore apo ato shkencore me një gjatësi të përcaktuar dhe me një shpejtësi leximi të përcaktuar dhe duke pasur parasysh që të gjithë studentët të ishin në të njëjtën gjendje. Duke mbledhur këto të dhëna, më pas mund të përcaktonim aftësitë e ekzekutimit që karakterizohen nga aftësitë e ndryshme të studentëve për të lexuar.

Për të bërë të mundur mbajtjen mend të gjuhës angleze është menduar që programi i leximit ESP të zhvillohet në vitin e dytë dhe të tretë kur studentët të arrijnë nivelin mesatar dhe mbi mesatar të gjuhës angleze (B2;C1) dhe atëherë kur të mendohet që ata janë gati

për të studiuar dhe për t'u përqendruar për qëllimet specifike. Por kjo gjë kërkon bashkëpunim nga instancat e fakulteteve përkatëse të cilat duhet t'i kushtojnë më tepër rëndësi gjuhës së huaj të profesionit, duke i lënë edhe hapësirën e duhur në shtrirje kohore në programet e tyre. Gjithashtu Demirel²³⁶ sugjeron se: "në kurset e nivelit të mesëm qëllimi kryesor është të marrim informacion nga ato që kemi lexuar dhe ky lloj leximi do të japë një informacion sa më të saktë dhe më intensiv".

Me pak fjalë mund të thuhet se qëllimi i këtij studimi është të japë një kontribut praktik dhe pozitiv për përmirësimin e standardeve të ESP në lidhje me matematikën, fizikën dhe kiminë në fakultetet e inxhinierive të Universitetit Politeknik të Tiranës. Kur Demirel²³⁷ dhe Reiver²³⁸ dhanë përkufizimet dhe shpjegimet përkatëse, analiza të cilat janë tepër të dobishme dhe kanë bërë të mundur krijimin e një diagrami të paraqitur në figurën 9. Siç mund të shihet në figurë, modeli përshin një program shpjegues ashtu si dhe një program praktik. Diagrami paraqitet për të ilustruar se çfarë janë aftësitë e leximit dhe si ato duhet të paraqiten.




Fig. 9. Modeli procedural i fitimit të aftësive për deshifrimin e një teksti matematikor apo të një teksti shkencor.

²³⁶Demirel, Özcan. (1992). "EL T Methodology". Ankara USEM pfq. 75-83

²³⁷Po aty

²³⁸Rivers, Wilga. (1981) "Teaching Foreign Language Skills" . Chicago UCP

1. Substanca tekstuale është një grup i variabëlve që përfshijnë jo vetëm elementet e veçanta të pjesëve drejtshkrimore por edhe formulat matematikore dhe pjesë të tjera të diagrameve të ekranit dhe bashkëveprimi i tyre është realisht i komplikuar; për shembull, probleme të ndryshme matematikore dhe shumë probleme të tjera të ngjashme të cilat nuk mund të shpërfillen. Realisht studentët tanë duket se kanë probleme sidomos në lëndët matematikore apo shkencore në gjuhën angleze sidomos në qoftë se ata janë diplomuar në një gjimnaz të përgjithshëm jo publik.
2. Aftësi për të ndërtuar një koncept të përgjithshëm nga fragmentet sintaksore është një kusht i rëndësishëm që të garanton suksesin.

Me pak fjalë mund të përfundojmë duke thënë se qëllimi i këtij studimi ishte që të injektonte një program të ri leximi ESP që do të përfshijë dy aftësi: së pari të mund të lexohet pa vështirësi dhe pasurimi me disa terminologji në aspektet fizike të cilat janë të domosdoshme për studentët, gjithashtu në këtë studim besohet se krijimi dhe deshifrimi i një teksti përfshin rritjen dhe modifikimin e një strukture informacioni edhe pse mendohet se sfondi konceptual duhet të shihet si një rrjetë informacioni e cila është e nevojshme për një transformim krijues. Pikërisht kjo është arsyeja pse programi i propozuar përfshin edhe tekste të përgjithshme dhe specifike me qëllim që t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri të përgjithshme dhe specifike për të lexuar dhe në këtë mënyrë mund të transferojnë këto aftësi në studimet e tyre specifike.

5.7.1. Procedura dhe rezultatet

Studimi për analizat e nevojave për studentët e viteve të dyta të cilët kishin mësuar kurset ESP me anë të teksteve teknike në anglisht vitin e parë universitar, por jo njohuri për sa i përket terminologjisë në matematikë, kimi apo fizikë. Rezultatet mund të përmbledhen si më poshtë:

Studentët të cilët ishin në vitin e dytë të inxhinierisë elektronike dhe telekomunikacionit nuk janë të kënaqur me programin e leximit ESP dhënë për ta gjatë vitit akademik si eksperiment për t'u vënë në zbatim në vitin e ardhshëm akademik 2015-2016. Për shembull 87% e studentëve që morën pjesë në këtë sondazh deklaruan se në program nuk ishte e mundur për studentët që të mund të përmirësonin veten e tyre, profesionin apo objektivat që i kishin vënë vetes, gjithashtu dhe lëndëve që ata kishin më shumë nevojë për të mësuar nuk u ishte vënë rëndësia e duhur.

Për më tepër materialet e leximit nuk ishin të nevojshme për të plotësuar nevojat e studentëve. Në dritën e këtyre zbulimeve u kuptua që programi i leximit ESP i viteve të para duhej të ndryshohej dhe të riformulohej në përputhje me realitetin dhe nevojat e studentëve duke e bërë këtë program të dobishëm për studentët.

Vitet e dyta thanë se programi ESP në semestrin e parë të vitit të dytë (niveli B2 i gjuhës angleze) që përfshinte materiale specifike, struktura komplekse dhe një fjalor specifik në programet e leximit ishte shumë i ngarkuar. Në mënyrë të ngjashme, edhe pedagogët pohuan se "*përsheptimi dhe ngarkimi i studentëve me materiale leximi përtej kapacitetit të*

tyre dhe përtej asaj që ata mund të përballojnë mund të shkatërrojë besimin dhe forcat e studentëve duke i detyruar ata t'ju referohen fjalorëve apo listave me fjalë”.

Për grupin e parë disa materiale janë përgatitur me qëllim që të mësohen disa terminologji të veçanta lidhur me matematikën, fizikën, kiminë duke i mbushur me aktivitete të ndryshme leximi dhe për grupin e dytë ishte përgatitur një tjetër material, ishte zgjedhur për t'u mësuar atyre lëndë specifike që lidhen me pjesë të makinave, llojet e pajisjeve elektrike dhe kështu me radhë. Rrjedhimisht diferenca ndërmjet grupeve eksperimentale janë vërejtur pasi janë aplikuar lloje të ndryshme të leximit të ESP për 14 javë (në gjysmën e parë të vitit akademik).

Përbërësit e programit të leximit ESP të propozuar në këtë studim mund të jenë paraqitur sipas disa nëntitujve të tillë si përmbajtja, mësimi dhe situata provimi. Ajo gjithashtu përfshin dy faza kryesore:

- a) të prezantojë konceptet e leximit dhe më pas
- b) të zhvillojë vetëbesimin e studentëve në njohjen dhe aplikimin e tyre edhe në tekste matematikore apo edhe shkencore.

Kështu, pas shqyrtimit të propozuar, programi ESP është zbatuar dhe nga studentët të cilët priteshin të ishin të aftë të menaxhonin tekste të njohurive të përgjithshme qofshin ato koncepte matematikore apo shkencore por edhe gramatikë apo sinjale retorike.

Diagrami i mëposhtëm ilustron parimin e përgjithshëm të përdorur i cili u propozua në programin e leximit ESP.




Fig 10: Parimi i ri i materialit të leximit ESP

Ne shpresojmë se me përmirësimin e programit dhe kurrikulës të mund ti japim studentëve mundësinë për të zgjedhur ose për tu përgatitur me një program të gjuhës angleze në ESP sa më funksional dhe praktik për ata. Në këtë mënyrë studentët do të kenë mundësinë për të fituar njëkohësisht të dyja, edhe aftësi të përgjithshme leximi por edhe njohuri të thelluara për termat në lidhje me matematikën, fizikën dhe kiminë në gjuhën angleze të cilat realisht janë përbërësit kryesorë të programit të vitit të parë në të gjitha departamentet kryesore. Kështu besohet se një program i tillë do t’ju mundësojë studentëve të ndjekin kurse me lehtësi në departamentet e tyre pas një viti akademik në orën e gjuhës angleze.

5.7.2. Si të shpjegojmë materialin e përzgjedhur

Një nga çështjet më të cilat përballet mësuesi i gjuhës së huaj për qëllime të veçanta është edhe përzgjedhja e materialit në përputhje me nevojat e studentit. Pasi kemi nxjerrë në pah aftësitë dhe pritshmëritë e tyre dhe pasi kemi punuar duke i motivuar ata, hapi tjetër në mësimin e ESP-së është si të shpjegojmë materialin.

Në mënyrë që të krijojmë një mjedis sa më të dobishëm në klasë, duhet të sigurohemi që “...situata më e mirë për mësimin e gjuhës duket se janë ato që inkurajojnë nivelet e ulura

të ankthit²³⁹”. “...Aktivitetet e klasës fokusohen në tema të cilat janë interesante dhe që janë të kapshme nga studentët, duke i lejuar ata që të shprehin idetë dhe opinione, si dhe të transmetojnë mesazhe²⁴⁰. “...Faktorët të cilët kontribuojnë në një filtër të ulët afektiv përfshijnë orientimin pozitiv të folësve të gjuhës, duke kërkuar situata jo me tension dhe së fundmi pak besim te vetja²⁴¹”.

Një tjetër faktor i rëndësishëm është edhe kur mësuesi flet një gjuhë të qartë dhe të pastër. Bisedimi i natyrshëm, i ngadaltë dhe i qartë, mund të rrisë mënyrën e të kuptuarit, thjeshtë. Edhe pauzat e ndihmojnë studentin që të përpunojë atë çfarë është thënë më parë, para se të vijojë shpjegimin.

“...Përsëritja, ose shkurtime të natyrshme, e përforcojnë gjuhën. Gjatë mësimdhënies, duhet komunikuar e njëjta ide duke përdorur fjalor në vazhdimësi sa më shumë të jetë e mundur. Për të zgjeruar fjalorin, duhet komunikuar e njëjta ide duke përdorur fjalë të ndryshme ...²⁴²”.

“...Sugjerojnë që studentëve t’u sigurohet një pasqyrë e temave kryesore të mësimin dhe përmbajtjes si fakte...²⁴³. Mohan²⁴⁴ rekomandon, që së bashku me pasqyrën, mësuesit të vejnë theksin te struktura kryesore e njohurive mbi temat. Ai gjithashtu thekson se “...një aktivitet kombinon teorinë dhe praktikën...²⁴⁵. Një situatë vepruese është aspekti specifik, praktik, konteksti “këtu dhe tani²⁴⁶. “Mësuesi komunikon nëpërmjet situatave, aty ku rrethanat e bëjnë të qartë kuptimin...²⁴⁷”.

Kjo eksperiencë nuk është e kufizuar për ata studentë të cilët janë duke studiuar lëndën e tyre shkencore në gjuhën angleze. Kjo ndodh shpesh edhe në gjuhë të tjera ku format shkencore janë vështirë për t’u kuptuar. Por unë këtu dëshiroj të përqendrohem tek gjuha angleze; dhe është e rëndësishme për t’u theksuar se në studimin e gjuhës shkencore angleze nuk hasin vështirësi vetëm studentët e ESL-së (anglishtja si gjuhë dytësore), por edhe ata studentë që e kanë gjuhën angleze si gjuhë mëmë. Kam përshtypjen se teksa këta dy grupe studentësh, si ata studentë të cilët e kanë gjuhën angleze si gjuhë të dytë, edhe ata që e kanë si gjuhën e tyre të parë, mund ti përgjigjen anglishtes shkencore në mënyra të ndryshme, sërish janë të njëjtat tipare që shkaktojnë vështirësi për të dy këto grupe.

Në çdo rast, në klasat e gjuhës së huaj teknike, nuk ka një linjë të qartë dallimi ndërmjet grupeve të studentëve. Një orë tipike mësimi në gjuhën teknike shkencore mund të përfshijë nga njëra anë studentë të cilët kanë mbaruar një shkollë të mesme profesionale dhe janë përballur edhe më parë me terma teknikë dhe nga ana tjetër studentë të cilët nuk kanë pasur asnjë eksperiencë të gjuhës angleze. Ata janë kontingjenti më i vështirë i studentëve sepse vijnë nga zona të thella të vendit, ku nuk kanë bërë asnjë gjuhë të huaj,

²³⁹Stephen D. Krashen, Tracy D. Terrell: *The natural Approach; language acquisition in the classroom.* Published 1995 by Prentice Hall Europe. Fq. 38.

²⁴⁰ (Po aty, fq.21)

²⁴¹ (Po aty, 19-20)

²⁴² (Po aty fq.60)

²⁴³Chamot, A.U., & O'Malley, J.M. (1994). *The CALLA handbook: Implementing the cognitive academic language learning approach.* Upper Saddle River, NJ: Pearson Education Inc.fq. 33

²⁴⁴ Mohan, B. A. (1986) *Language and Content.* Reading, MA: Addison-Wesley. Fq. 28

²⁴⁵ (Po aty, fq.45)

²⁴⁶ Mohan, B. A. (1986) *Language and Content.* Reading, MA: Addison-Wesley, fq.53.

²⁴⁷ (Po aty, fq.106)

ose kanë bërë gjuhë tjetër, si p.sh. frëngjisht apo italisht. Të gjendur në këtë situatë, na duhet të mendojmë që ta trajtojmë problemin me tema të pranueshme për të tërë.

Si fillim, fokusi vihet tek vështirësitë leksikore; pra, vështirësitë e fjalorit. Kjo është ajo çfarë përkufizon termin ‘zhargon’, që do të thotë një mori termash teknike të vështirë. Fjala ‘zhargon’ shpesh mbart implikime të mëtejshme, domethënë se kushte të tilla që janë të panevojshme dhe se i njëjti kuptim mund të ishte përcjellë pa to në gjuhën e përditshme. Disa njerëz mendojnë se kjo është një mënyrë e panevojshme, ose pak a shumë mënyrë rituale e të shkruarit dhe se shkenca, konceptet shkencore dhe arsyetimi shkencor mund të shpreheshin në jetën e përditshme me terma jo teknike.

Ne mund ta krahasojmë këtë pikëpamje me mendimin e kundërt, që shkenca është e varur tërësisht nga gjuha shkencore; që ne nuk mund ta ndajmë mënyrën se si shkruhet shkenca, apo të rishkruajmë bisedime shkencore në mënyrë tjetër. Duke pasur parasysh këtë pikëpamje, ‘të mësosh gjuhën shkencore’ është e njëjta gjë si të mësosh gjuhën e shkencës. Nëse gjuha është e vështirë për tu kuptuar, ky nuk është një faktor shtesë i shkaktuar nga përzgjedhja që i është bërë fjalëve, por një vështirësi që është trashëguar nga vetë natyra e shkencës. Burimi i problemit është vetë lënda.

Zakonisht kur njerëz të ndjeshëm kanë pikëpamje kaq të ndryshme, realiteti shtrihet diku në mes; dhe kjo është sigurisht çështja në këtë instancë. Nuk mund që të përfaqësosh njohuri shkencore me fjalë tërësisht të pa kuptimta; termat teknikë nuk janë thjesht ekuivalente të fjalëve të zakonit, apo struktura konceptuale dhe procese arsyetimi të fizikës dhe biologjisë, por ka të bëjë me shumë nivele abstraksioni të eksperiencave të jetës së përditshme. Për rrjedhojë, gjuha me të cilën ato janë ndërtuar është e atillë që është e vështirë për t’u ndjekur. Në të njëjtën kohë, shpeshherë bëhet edhe më e vështirë nga se është e nevojshme; format e bashkëbisedimit teknik mund të vështirësohen dhe shkrintarët bllokohen në fraza të shkruara që janë të komplikuar në mënyrë të pa nevojshme dhe shprehen me terma teknikë të tepërta dhe në kontekste ku ato nuk mund të jenë të nevojshme apo nuk ka motiv që ato të përdoren. Këtu është edhe pika ku ne të ndërhyjmë në mënyrë të justifikueshme e flasim për ‘termin zhargon’; ku shkrintari është duke ndjekur një stil tek i cili synon (në mënyrë të pa vetëdijshme) ti japë fjalimit të tij ngjyrime të një elite intelektuale.

Është e rëndësishme që të arrijmë në një pikëpamje të balancuar në këtë çështje, sepse ne nuk duam vetëm të identifikojmë problemet e tipareve të anglishtes shkencore; ne duam të përpiqemi gjithashtu për ti shpjeguar ato-për të shfaqur funksionet që ato kanë në fjalimin në përgjithësi dhe arsyen se përse ato kanë evoluar si pjesë e gjuhës shkencore.

5.7.3. Analiza e përgjigjeve të studentëve

Pjesa më e madhe e studentëve ishin të mendimit se materialet e përdorura në tekstet e tyre nuk ishin shumë të vlefshme për ta. Ata ishin të mendimit se teksti “Engineering”, ishte një tekst shumë i përgjithshëm, i cili trajtonte në përgjithësi tema të teknologjisë dhe jo saktësisht për degën që ata studionin, si për elektronikë apo arkitekturë, etj. Mund të kish

vetëm një apo dy materiale në përbërje të tekstit të cilat plotësonin nevojat e termave apo gjuhës së tyre të profesionit si dhe degës për të cilën ata studionin. Ata besonin se një tjetër anë negative ishte edhe koha e shkurtër që i vihej në dispozicion studentëve për gjuhën e huaj në mënyrë që ata të kishin një përfitim të saktë dhe të plotë të gjuhës së huaj.

Për sa i përket anës gramatikore, studentët ishin të mendimit se gramatika duhet shpjeguar mbi baza të asaj çfarë përmban një tekst teknik, kur duhet përdorur “çfarë” dhe kur, jo, etj.. Një nga mënyrat më të mira për të shpjeguar gramatikën studentëve do të ishte që mësuesi të shikonte që studentët i përdorin rregullat gramatikore saktë gjatë ndërveprimit verbal në një orë mësimi. Disa studentë ishin të mendimit se dhe mënyra e prezantimit të fjalorit në klasë ishte e pa përshtatshme. Sugjerimet e tyre ishin se fjalori përfitohej më mirë në momentin kur studenti përballej me një tekst origjinal dhe interesant në gjuhën e tyre të profesionit.

Thënë këto, rezultoi se studentët nuk ishin të interesuar që teksti që ata kishin në përdorim mbulonte të gjitha degët e inxhinierive dhe ky ishte një disavantazh për ata. Ata u shprehën se të gjitha tekstet e librit duhet të kenë lidhje me degën për të cilën ata studionin, pra nevojiteshin më tepër terma teknikë e fjalor që kishte të bënte me fushën e tyre.

5.7.4. Analiza e përgjigjes së pedagogëve

Rezultati na nxori në pah se pjesa më e madhe e pedagogëve nuk ishin të kënaqur me tekstet që përmbante libri. Ata sugjeruan se përmbajtja e teksteve duhet të ishte më e pasur me terma teknikë. Tekstet për analizë duhet të ishin më të gjatë, më interesantë dhe ti përshtateshin interesave të studentëve, çfarë do të thotë që një student i cili studion për elektronikë, apo gjeo-informatikë, të ketë të bëjë vetëm me kësi lloj tekstesh e jo të ndërthurura. Pedagogët ishin të mendimit se gramatika e përfshirë në tekst shpesh nuk bazohej në atë çfarë studentët kishin në tekst dhe kjo çonte në një çorientim të studentëve dhe nuk arrinte objektivin e duhur. Duhej që gramatika të kishte lidhje me tekstin dhe analiza gramatikore të bëhej më konkrete.

Përsa i përket prezantimit dhe përfitimit të fjalorit, ai duhej ofruar në atë mënyrë që ti shtynte studentët që të gjenin kuptimin e fjalëve të panjohura për ta dhe ti inkurajonte ata në mënyrë që të përdornin strategji më të mira në leximin dhe përkthimin e teksteve. Thënë këto, pedagogët arritën në konkluzionin se secila degë e inxhinierisë duhet të ketë një metodë e cila t’u përshtatet degës për të cilën ata studiojnë.

PËRFUNDIME

Mësimdhënia e gjuhës së huaj për qëllime të veçanta po bëhet gjithnjë e më tepër një domosdoshmëri e kërkesave të kohës dhe tregut të punës. Tashmë çdo i/e diplomuar duhet ti përshtatet këtyre kërkesave duke e vënë në objektivin e tyre edhe mësimin e gjuhës së profesionit të ardhshëm. Studentët të cilët studiojnë në fakultetet e Universitetit Politeknik të Tiranës, gjithnjë e më shumë po e ndiejnë nevojën e mësimin të kësaj gjuhe, pavarësisht faktit se ata si qëllim kryesor kanë edukimin në inxhinieri. Ndaj edhe ne, pedagogët e gjuhës së huaj në këto fakultete, e ndiejmë përgjegjësinë e madhe që ka lënda jonë dhe jemi të angazhuar që ti përshtatemi nevojave dhe kërkesave të studentëve tanë, duke i dhënë në këtë mënyrë gjuhës së huaj të profesionit një vend të rëndësishëm në studimet e inxhinierëve tanë të ardhshëm.

Me mësimdhënien e gjuhës së profesionit ne i vijmë më pranë nevojave të studentëve dhe i përshtatemi në këtë mënyrë edhe kërkesave të kohës. Ndaj edhe studimi i ndërmarrë përbën një kontribut real të cilin e kemi konkretizuar me anën e zbatimeve konkrete kurrikulare, me zbatimet e plan/programeve si dhe me një analizë të hollësishme të kompetencave bazë në mësimin e gjuhës së huaj të profesionit siç është edhe shkrimi, leximi e përvetësimi i fjalorit.

Ky punim është fryt i një pune të madhe e të gjatë në kohë dhe ka pasur një vëmendje maksimale nga ana jonë për të përcjellë me përkushtim e vendosmëri çdo aspekt e veçori me të cilën përballen studentët e FTI dhe pedagogët e QGJH.

Në kreun e parë janë shtjelluar teori të ndryshme nga autorë anglezë e amerikanë me qëndrimet që ata kanë për ESP-në dhe zhvillimet e saj. ESP na vjen në shumë lloj përkrahimesh përkufizimesh por parimi kryesor që ajo përcjell është plotësimi i nevojave të studentit. Sipas Hutchinson dhe Waters, ESP duhet parë si qasje dhe jo produkt. ESP nuk është një lloj gjuhe apo metodologjie e veçantë dhe as nuk konsiston në një lloj të veçantë material. Ajo është një qasje për mësimin e gjuhës me në qendër nevojat e nxënësit. Ata i nisin vëzhgimet e tyre duke na prezantuar me një imazh metaforik në formën e një peme, duke na paraqitur marrëdhënien ndërmjet ESP-së dhe ELT-së. Një trajtim të veçantë në kapitullin e parë zë edhe ndryshimet ndërmjet EST (Gjuha Angleze e Shkencës dhe Teknologjisë) dhe ESP (Gjuha angleze për Qëllime të Veçanta) për arsye se ka pasur një qëndrim të ndryshëm dhe të pa qartë ndërmjet këtyre dy fushave. Përdorimi i termit EST, në fushën e ESP (mësimdhënia e gjuhës angleze për qëllime të veçanta), si fillim u shfaq në këto dy ndarje të hulumtimit të gjuhës, asaj të EAP/EVP (English for Academic Purposes/English for Vocational Purposes) dhe pjesërisht për arsye se përpjekjet e shumta për të arritur tek diçka “e veçantë” rreth gjuhës së shkencës dhe teknologjisë nuk ishin bindëse. Duhet theksuar fakti se EST është dega më e lartë e ESP-së; dega më e madhe në moshë, në numrin e artikujve të botuar si dhe të autorëve të cilët janë marrë me trajtimin e saj. Këtu kemi përfshirë edhe teorinë e disa prej shkrimtarëve më në zë të cilët janë marrë me analizat e këtyre dy degëve. Henry Widdowson, i cili njihet për kontributin

e tij në Gjuhësinë e Aplikuar si dhe mësimdhënien e gjuhës angleze, ka kontribute të pa diskutueshme edhe në hartimin dhe kërkimin e materialeve mbi EST. Sipas Hewings, ndikimi i Widdowson është ndjerë përgjatë gjithë zhvillimit të ESP-së në përgjithësi, si dhe të EST-së në veçanti. Swales shprehet se Widdowson ka qenë i vetmi zë me influencë në fushën e zhvillimit të EST-së. Dudley-Evans dhe St. John mendonin se historia e ESP-së ishte kryesisht historia EST-së. Nga një perspektivë tjetër, Clapham shprehej se janë të shumë kërkuesit e ESP-së të cilët janë përqendruar mbi EST-në, sa që është e lehtë të mendosh se ESP dhe EST janë sinonime. Sipas Brought, njihet gjerësisht që pozicioni dominues i EST shihet si rezultat i atillë ku gjysma e letërsisë botërore mbi shkencën është shkruar në gjuhën angleze dhe dy të tretat e literaturës së inxhinierive është në gjuhën angleze, por më tepër se dy të tretat e inxhinierëve profesionistë në mbarë botën nuk mund të lexojnë në gjuhën angleze.

Zhvillimet e reja në psikologjinë arsimore kanë kontribuar në rritjen e ESP, duke theksuar rëndësinë qendrore të studentëve dhe qëndrimet e tyre në mësim. Studentët kishin nevoja dhe interesa të ndryshme, të cilat ndikuan në mënyrë thelbësore në motivimin e tyre për të mësuar dhe për këtë arsye në efektivitetin e mësimin të tyre. Këto zhvillime i dhanë mbështetje zhvillimit të kurseve për të cilat pati një “larmi kërkesash” për të përmbushur nevojat dhe interesat e studentëve. Përmirësimi i mësimdhënies së gjuhës së huaj do t’i bëjë më të dukshme rezultatet e reformimit në shumë drejtime. Studentët dhe pedagogët do të jenë më shumë të integruar në fushën e kërkimeve universitare. Kërkimi shkencor kërkon dimensione të reja të të kuptuarit të idesë së ndërtimit të një hapësire Evropiane të kërkimit. Sot studentët dhe pedagogët janë të sfiduar nga idetë e një tregu global kërkimi dhe nevojës për krijimin e njohurive dhe ideve të reja. Strukturat e ndryshme kombëtare të kërkimit shkencor duhet të gjejnë rrugët e tyre optimale për t’u përfshirë në Hapësirën Evropiane të Kërkimit. Zotërimi i gjuhës së huaj në aspektin akademik aplikativ nuk është më një çështje që shtrohet për diskutim. Duke vlerësuar se intensiteti i kërkimit shkencor në vend është shumë i vogël krahasuar me vendet e tjera të BE, është imperativ riorientimi i programeve të këtij kërkimi dhe zotërimi i shprehive të komunikimit.

Por sigurisht që duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet pedagogëve dhe studentëve me qëllim përmbushjen e objektivave dhe realizim me sukses të planeve të përcaktuara. Roli i mësuesit është vendimtar në mësimdhënie ndaj dhe ne e kemi trajtuar çështjen e mësuesit të ESP-së në rolin e projektuesit të kursit dhe përgatitjes së materialeve mësimore, si përpilues i materialeve të vëna në përdorim për studentët, si bashkëpunëtor dhe si një vlerësues.

Një tjetër aspekt i trajtuar në kapitullin e parë është edhe nivelet gjuhësore të kurrikulave si pjesë e domosdoshme në hartimin e kurrikulave të reja në UPT dhe si një model në funksion. Arritje kryesore të Kornizës së Përbashkët Evropiane kanë qenë:

4. Krijimi i tre përbërësve përcaktues të kompetencave komunikuese gjuhësore: kompetenca gjuhësore, sociolinguistike dhe pragmatike
5. Katër aktivitetet gjuhësore: thithja, prodhimi, ndërveprimi dhe meditari
6. Tre fusha: personale, punësimi dhe edukimi

Megjithatë, më tepër e rëndësishme për mësuesit e gjuhës dhe nxënësit në Evropë ishte krijimi dhe përshkrimi i detajuar i Niveleve të Përbashkëta të Referencës (Common

Reference Levels) për të gjitha gjuhët në Evropë. Ato i inkurajojnë dhe ndihmojnë mësuesit që të përcaktojnë nivelet e studentëve dhe për rrjedhojë krijojnë lehtësira në vendosjen e objektivave për kurset e mësimit të gjuhëve. Qendra e Gjuhëve të Huaja duke pasur parasysh zhvillimet Evropiane, zhvillimet në Arsimin e lartë Shqiptar (orientimet e MASH), kërkesat e nevojat në rritje të studentëve për Nivele më të larta cilësore e sasiore në Gjuhët e Huaja është përpjekur që t'u përgjigjet këtyre zhvillimeve, tendencave e kërkesave konkrete që paraqiten për Nivelet e Gjuhës, sidomos angleze, në Ciklet e Parë, të Dytë e të Tretë të Studimit Universitar e Pasuniversitar.

Në këtë drejtim, synohet të unifikohen e standardizohen programet e mësimdhënies në Fakultete e Degë të ndryshme Inxhinierie për të synuar një unifikim të krediteve, shtrirje kohore e kohëzgjatje të programit për të realizuar objektivat e duhur në fushën e gjuhës (Teaching and Learning Outcomes).

Në këtë kuadër marrin rëndësi jo vetëm Metodatat Komunikuese, efikase dhe bashkëkohore në fushën e mësimdhënies, por edhe ngritja e një baze laboratorike të kompjuterizuar, krijimi i një mjedisi të dobishëm në favor të mësimdhënies, metodologjia e kërkimit dhe shfletimit të fjalorëve terminologjikë etj. në nxitje të edukimit profesional, shumë-gjuhësor të studentëve duke stimuluar interesin e studimit e tyre për lëndën e gjuhës së huaj.

Qendra e Gjuhëve të Huaja në pajtim dhe me Kurikulat e reja sipas Protokollit të Bolonjës si dhe me synimin për arritjen e standardeve gjuhësore sipas Kornizës Evropiane të Gjuhëve, është përpjekur të rrisë nivelin në mësimdhënie e mësim-nxënie përmes metodave të reja komunikuese dhe sa më cilësore duke u mbështetur në tekste dhe literaturë bashkëkohore, shoqëruar dhe me literaturën përkatëse të cilën e sigurojmë nëpërmjet artikujve të ndryshëm në rrjet si dhe mundësi të tjera të ofruara qoftë nga literatura e rekomanduar nga vetë Fakultetet apo laboratorit i gjuhëve të huaja. Nxitja e rritja e bashkëpunimit, shkëmbimi i përvojës e kooperimi i frytshëm si dhe efektiviteti si në institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, synojnë barazinë, ekuivalentimin dhe standardizimin e vlerave e produkteve përkatëse. Në kuadër të zhvillimeve e perspektivës së vendit tonë që synon të integrohet në BE, gjuha si mjeti kryesor e më i larmishëm i komunikimit, nuk mund të lihej mënjanë. Nën këtë vështrim, filluan dhe hapat e përpjekjet e para për krijimin e konturimit e Kornizës Evropiane të Gjuhëve të shteteve përbërëse të këtij Unioni. Përkufizimi kryesor i Kornizës së Niveleve gjuhësore do të shprehej më së miri e qartazi në gjuhën Angleze: “The Common European Framework of Reference for Languages-Learning, Teaching, Assessment”. Korniza e Përbashkët Evropiane e Gjuhëve pati si synim kryesor unifikimin e termave të referencës, në fushën e përvetësimit e kualifikimit sipas niveleve gjuhësore burimore të ndryshme dhe objektivave përkatës.

Studentët e UPT-së kanë nevojë të jenë të aftë për të komunikuar në mënyrë të suksesshme në gjuhën e tyre të profesionit. Detyra jonë si pedagogë është që ti motivojmë studentët në mënyrën e të mësuarit dhe gjetjen e rrugëve më efikase dhe të dobishme të mësimit të gjuhës edhe kur ata janë larg auditorëve apo mësuesve të tyre.

Organizimi dhe vetëdija janë të përfshira në objektivat e silabusit të ESP-së në mënyrë që studentëve tu jepet ndihma e duhur dhe njohuritë e duhura për të arritur nivelin B2 si standard që duhet për marrjen e Diplomës Bachelor, një nivel i njohur nga Evropa dhe që rrjedh nga Korniza e Përbashkët e Referencave për Gjuhët. Aftësitë e të mësuarit janë të përfshira në objektivat e mësim-nxënies në kurikulën e ESP-së për një zhvillim sa më profesional të kompetencave gjuhësore të studentit. Me qëllim që studentët të punojnë në mënyrë efikase dhe të dobishme edhe pasi të jenë diplomuar nga universiteti, ata kanë

nevojë të zhvillojnë aftësitë e tyre studiuese që të jenë të aftë të mësojnë në mënyrë të pavarur.

Më pas studimi ynë vijon me kapitullin e dytë ku trajtuam disa instrumente bazë të cilat vijnë në ndihmë për reformimin e kurrikulave ku përmendim KEK, Nivelin e Përbashkët të Kuadrit të Referenca për Gjuhët, Kuadrin e Kualifikimit si mjet për mbështetjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës, Reforma e Arsimit të Lartë. Ndryshimet në fushën ekonomike dhe dukuria gjithnjë e më e shpeshtë e ndryshimit të vendeve të punës dhe të profesioneve, shtron sidomos përpara shkollave të formimit profesional detyrën e zhvillimit të aftësive dhe të shprehive të shumanshme praktike si dhe të qëndrimeve pozitive për të nxënëit gjatë gjithë jetës. Parashikimet për të ardhmen kërkojnë që politikat arsimore të vënë theksin dhe rëndësinë që ka rritja e cilësisë në fushën e arsimit dhe cilësia e hulumtimeve shkencorë që lidhen me të. Njohuritë, shprehitë dhe aftësitë për t’i përdorur dhe menaxhuar përfundimet e hulumtimeve në një mënyrë krijuese, vlerësohen si pasuritë më të mëdha në këtë fushë. Prandaj kërkohet që arsimit të marrë përsipër përgjegjësi të mëdha për krijimin e një të ardhmeje më pozitive për të gjithë.

Në këtë këndvështrim bëmë edhe një vështrim mbrapa në kohë ku mblodhëm planet dhe programet ndër vite nga 80’, 90’ e deri ditët e sotme për të analizuar e nxjerrë përfundime.

Shohim se kemi një ndryshim të madh në vite që vjen që nga përzgjedhja e metodave të cilat janë tashmë të dedikuara tërësisht gjuhës angleze për qëllime të veçanta si dhe i përputhen në mënyrë dinjitoze kërkesave të kohës.

Në këtë studim, duket se është dalë në konkluzionin se mund të jetë e nevojshme të përdoret një silabus strukturor/situacional vitet e para të studimit të kursit, duke lëvizur më pas në një plan funksional të organizimit, e shoqëruar nga kombinimi nocional dhe duke përfunduar me një krijim të plotë komunikimi për fazat finale të kursit. Një zgjidhje e tillë do të ishte e përshtatshme për një gjuhë të huaj, ndërsa një përshtatje e pastër komunikative mund të jetë më e përshtatshme për t’u aplikuar në kuadrin natyral. Tipari më i rëndësishëm për çdo silabus modern gjuhësor, është respektimi i trashëgimisë potenciale kulturore e gjuhësore, rregullimi dhe shtimi gradual i saj, duke u bazuar në vendimet e marra me kujdes gjatë çdo niveli kursi.

Më pas në kreun e tretë kemi vijuar me një analizë më të hollësishme të analizës së silabuseve në vite të zbatuara në UPT, se çfarë pritej nga çdo nivel dhe se si trajtohej në çdo orë mësimi. Ndryshimet ndërmjet metodave GE dhe ESP zënë një vend të rëndësishëm në këtë kapitull për arsye se ilustrojnë më së miri të gjithë analizën e bërë më lart me planet e GE dhe me planet e ESP të zbatuara në UPT.

Qëllimi kryesor dhe i rëndësishëm i një kursi ESP është që studentët të pajisen me teknikat gjuhësore të cilat i nevojiten për të përmbushur studimet shkencore, apo të familjarizohen më termat teknik të sferës së tyre të profesionit. Thënë kjo, Widdowson thotë: “ESP mund të jetë tepër e përqendruar tek aftësia për të zhvilluar komunikim shkencor dhe teknik”. Nga ana tjetër, një kurs GE ka objektiva më të zgjeruara dhe të përgjithshme; i referohet gjuhës angleze si “një gjë e mirë për t’u mësuar si pjesë e një edukimi të gjerë. Në një kurs ESP-je objektivat përqendrohen në shërbim të nevojave të menjëhershme dhe dobishme të studentëve.

Qëllimet e domosdoshme të kursit të GE , përcaktohen nga brenda, duke iu referuar kërkesave të pranimit, pavarësisht nga fakti nëse ekzaminime të tilla reflektojnë ose jo përdorimet e gjuhës angleze që studentët vërtetë kërkojnë në karrierën e tyre; ndërsa në një kurs ESP, qëllimet janë të përcaktuara nga jashtë nga referencat për qëllime të veçanta.

Për këtë qëllim, plani mësimor i gjuhës angleze për qëllime të veçanta duhet të sigurojë studentët me gjuhën të cilën ata mund ta vënë për përdorim e praktikë të menjëhershme. Meqenëse studentët kanë nevojë që ta shfrytëzojnë gjuhën angleze në komunikim e në situata të vërteta të jetës, atëherë nevoja që t'u mësohet gjuha e përdorur dhe jo përdorimi i gjuhës, është i domosdoshëm. Pra, një shqetësim me ESP përfshin një shqetësim me aftësinë komunikuese dhe përdorimin e jo kompetencës gjuhësore. Në këtë pikë, është e rëndësishme të theksoj se materiali gjuhësor mësimor që përdor konceptin e kompetencës komunikuese, përqendrohet në qëllimin për të cilën gjuha është vënë në përdorim.

Por ashtu siç gjetëm ndryshime tek aftësitë, mund të themi se ndryshime gjejmë edhe tek gramatika dhe fjalori. Kursi ESP-së duhet të përfshijë në silabusin e tij në gjuhën angleze shkencore dhe përdorimin e ndërtimit të disa strukturave të caktuara të gjuhës (të tilla si forma jo veprorë, koha e shkuar e thjeshtë, koha e tashme, kushtore, urdhëroret, pjesorja e tashme (-ing), si dhe pjesorja e shkuar). Kjo duhet paraqitur në silabus i cili dhe të përqendrohet në këto zona. Por kjo nuk do të thotë që pjesë të tjera të gramatikës duhen neglizhuar. Në fakt puna e Ewer & Latorre na tregon se anglishtja shkencore përdor të gjitha strukturat kryesore, por duke theksuar më tepër ato struktura të cilat janë më të dobishme për studentët të cilët studiojnë profile shkencore duke bërë që studentët të jenë më të vëmendshëm dhe të përqendruar në to.

Gjithashtu, kur ri-ndërtuam planet e reja patëm si synim që në fushën e fjalorit të vinim në pah natyrën shkencore të materialit me të cilin do të merreshin studentët, ndryshe nga çfarë bënim më parë në një kurs të GE ku pjesën kryesore në hartimin e plan/programeve e zinin situata të jetës së përditshme, gramatika dhe ushtrime. Me fjalë të tjera, kur u hartuan planet e reja, një pjesë të madhe zuri përqendrimi fjalori teknik, p.sh, për studentët e degës së inxhinierisë së Teknologjisë dhe Informacionit, rëndësi zuri fjalori përkatës për degët, Elektronikë, Informatikë dhe Telekomunikacion.

Një silabus ESP duhet që në qëllimet e tij të ketë parësore plotësimin e nevojave të studentit. Kështu që, bazuar në kërkesat e menjëhershme, konkrete të natyrës praktike dhe instrumentale të studentëve, një silabus ESP përfshin një qasje komunikuese. Ne u përpoqëm për të treguar se si një program mësimor ESP mund ndryshojë në qëllim dhe përmbajtje nga një silabus i GE dhe pastaj të tregojë se si të tilla dallime mund të ndikojnë në mësimin e materialeve dhe teknikave duke iu referuar një grupi të veçantë studentësh, nevojat dhe qëllimet e të cilëve janë shtruar për mësimin e anglishtes. Ndërkohë, ne jemi përpjekur të nxjerrim në pah vlefshmërinë e këtyre argumenteve duke iu referuar situatës specifike të trajtuar më lart. Së fundi, kemi konstatuar nga nevoja akute hartimin e një plani mësimor ESP i cili reflekton nevojat komunikuese dhe interesat profesionale të studentëve të tillë. Një sugjerim është bërë që një kurs i tillë- kurs ESP-duhet të paraprihet ose shoqërohet me një kurs GE për të siguruar studentët me një argumentim të

mjaftueshëm në 'bërthamën e përbashkët' të gjuhës angleze e cila është parakusht për çdo lloj arritje gjuhësore.

Po ashtu me interes të veçantë në këtë kapitull ishte dhe analiza e stilit teknik shkencor të cilën e kemi trajtuar me shembuj konkretë.

Në kapitullin e katërt, pjesën më të madhe ia kemi kushtuar shkrimit. Kjo për arsye sepse për një inxhinier është tepër e rëndësishme të dijë të shkruajë një raport apo të përshkruajë në një projekt hapat e një procesi, gjë e cila nuk e ka pasur asnjëherë vëmendjen e duhur nga ana e mësuesit por është trajtuar thjesht si një detyrë shtëpie. Në këtë kapitull ne e kemi trajtuar në mënyrë të hollësishme duke u nisur që nga teori e deri në zbatime praktike ku kemi bërë pyetësorë e intervista me studentët tanë të Inxhinierisë Elektronike. Fakti që shkrimi është një proces mësimi i vlefshëm dhe unik, është arsyeja kryesore pse në çdo sistem edukimi ai është thelbësor. "Shkrimi nuk është thjesht i vlefshëm, as thjesht i veçantë, por unik". Shkrimi përdoret si një mjet mësimi në çdo fushë. Ai është një proces zbulimi. Akti i të shkruarit nuk është i thjeshtë; disa hapa duhet të ndiqen. Mësimi, organizimi dhe qartësia që përjeton shkrimtari gjatë përgatitjes për të shkruar mund të jetë i vlefshëm dhe jo i vlefshëm ndonjëherë.

Shkrimi ashtu si mësimi nxit procesin e të menduarit. Një eksperiencë e tillë mund t'u sigurohet studentëve në qoftë se ata besojnë se shkrimet e tyre janë të rëndësishme. Nga vënia e një mekanizmi të tillë, të paktën në pjesë të veçanta, në shumë nga klasat tona ne përftojme një mjet pedagogjik të fuqishëm.

Është gjithashtu shumë e rëndësishme që studentëve t'u tregohet kujdes në korrigjimin dhe vlerësimin e shkrimeve të tyre. Në të kundërt, ata mendojnë se këto detyra nuk janë të rëndësishme për pedagogun dhe rrjedhimisht kjo do ndikojë në detyrat e pasardhëse. Gjithashtu, ne duhet të përfshijnë në leksionet e tyre, të paktën disa nga shkrimet e studentëve aktualë. Kështu vlerësohen shkrimet e studentëve, çfarë është vendimtare që puna me shkrim të merret seriozisht nga klasa. Shkrimi duhet të paraqitet si një pjesë përbërëse e kursit për shkak të efekteve të dëshirueshme që çdokush të tregojë veten. Nëse ne shfrytëzojmë përfitimet e mirënjohura pedagogjike të shkrimit për studentët e inxhinierisë, atëherë ata duhet të jenë të bindur se ne besojmë në rëndësinë e tij.

Në tërësi, studentët përfituan shumë nga mësimet që morën mbi shkrimin dhe nëse të gjithë e presin me entuziazëm dhe vendosmëri jemi të bindur se detyra të tilla do të jenë me shumë vlerë për studentët tanë. E gjithë eksperiencia e tyre mësimore e inxhinierisë do të përmirësohet. Siç e dimë, detyrat e të shkruarit dhe vlerësimi i tyre kërkojnë kohë.

Shkrimi mund të plotësojë punë llogaritëse, si dhe bën që studenti ta zotërojë më të plotë materialin. Vetëm atëherë kur përftohet një kuptim i qëndrueshëm, ne mund të presim që studentët të transportojnë dijet e fituara nga një disiplinë tek tjetra. Argumenti `të shkruash për të mësuar` është i njohur tashmë; edukatorët e disiplinave të ndryshme e kanë përdorur për të thelluar dhe pasuruar procesin e të mësuarit për shumë vite me radhë. Ata dinë që, nëpërmjet procesit të shkrimit, aftësitë teknike jo vetëm që nuk ulen, por zhvillohen më tej. Nëpërmjet detyrave me shkrim, kurset e ESP-së bëhen më të interesante, më aktuale dhe më tërheqëse për studentin. Detyrat mund të përfshijnë tema të rëndësishme nga e kaluara ose zhvillime interesante të kohës. Për shembull, një detyrë mbi fibrat optike apo qarqet

elektronike do t'i lejonte studentët të hetonin mbi zhvillimet e tanishme në këtë fushë e cila ka shumë rëndësi për studentët e inxhinierisë elektronike. Pasi kanë shkruar në lidhje me një temë, shumë studentë, në një shkallë të caktuar do ta kenë bërë punën e tyre dhe do të krijojnë tashmë një pikëpamje të tyre në lidhje me këtë temë. Detyra të tilla janë një mënyrë efektive për të prezantuar diskutime informuese në lidhje me tema historike.

Si pedagogë të gjuhës angleze të specialiteti në fakultetet e inxhinierisë, qëllimi ynë është t'u sigurojmë studentëve edukim teknik rigoroz dhe t'u japim atyre mjetet që të bëhen udhëheqës dhe vendimmarrës në shoqëri. Ne duhet ti shikojmë të diplomuarit tanë në konkurrimin për rolin udhëheqës dhe vendimmarrës në shoqëri. Nëse ata janë për t'u bërë planifikues dhe udhëheqës efektiv, atëherë qëllimi ynë është që të `prodhojmë` të diplomuar që nuk përqendrohen vazhdimisht në disa pjesë të vogla dhe që mësojnë shpejt tema të reja. Shoqëria vuan, ashtu si profesioni i inxhinierëve, nga mungesa relative e përfshirjes së inxhinierëve në vendime të rëndësishme. Sa më shumë probleme të përmbajnë, qoftë në disa pjesë të tyre, aspekte teknike, nevoja që vendimmarrësit të zotërojnë aftësi teknike rritet. Në qoftë se inxhinierët lejohen të marrin pjesë në grupet vendimmarrëse, ata duhet të tregojnë se mund të zgjidhin çështje të karakterit ekonomik, social dhe historik. Pra, studentët tanë duhet të jenë të aftë që të mendojnë në mënyrë krijuese. Shkrimi nxit pikërisht këtë lloj të menduarit për çdo student, pavarësisht nga aftësitë e lindura apo mënyra e të mësuarit. Pozita e inxhinierit si profesion do të përmirësohet nga rritja aftësisë të së shkruarit. Shumë e thjeshtë, ata që shkruajnë më shumë, kanë më shumë mundësi të shkruajnë dhe komunikojnë më mirë se ata që shkruajnë më pak. Të qenit një komunikues efektiv ndihmon që çdo inxhinier t'u bëjë të qartë të tjerëve, në mënyrë sa më bindëse për rëndësinë dhe dobinë e inxhinierisë në shoqëri.

Më në fund, ajo çfarë përfitojnë më tepër studentët e inxhinierisë së elektronikës nëse praktikojnë më tepër ligjëratën e shkruar, lidhet me faktin se shkrimi shërben si një mjet i fuqishëm në vlerësimin edukativ në fushën e inxhinierisë. Shkrimi siguron një kontroll gjithëpërfshirës dhe të mprehtë në procesin e të menduarit. Si i tillë, siguron prova të forta të pranisë ose mungesës së mendimeve krijuese dhe të arrira. Jep prova të qarta të dijeve dhe aftësisë për të komunikuar në mënyrë efektive. Ne mendojmë se një gjë e tillë është veçanërisht e rëndësishme në kurset e inxhinierisë informatike, elektronike dhe telekomunikacionit meqenëse ky kontingjent studentësh i përdorin shumë mjetet kompjuterike dhe ndonjëherë, mangësitë që ata kanë mbi dijet e shkrimit, fshihet mbas paketave të gatshme të programeve kompjuterike. Duke përdorur shkrimin në kurset tona, në përmirësojmë vlerësimet. Ne nuk mund të themi se do të arrijmë rezultate të larta që në fillim, por, duke vënë theksin në hartimin e një plani të programuar mbi ligjëratën e shkruar, me kalimin e kohës zbulojmë prova të qarta se si një program inxhinierie plotëson shumë kritere si të qenit i informuar mbi çështje etike dhe profesionale, aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive, zotërimi i një edukimi të plotë dhe dije mbi çështjet e sotme. Për këto fusha, ligjëratat e shkruar mund të jetë vërtet një mjet i vlerësimit më i fuqishëm i mundshëm; provat e siguruar nga shkrimet e studentëve janë të qarta dhe imponuese.

Megjithëse shumë aspekte të argumenteve të mësipërme nuk janë diçka e re dhe ne që përkrahim mënyrën e shkrimit në kurset e inxhinierive nuk jemi të parët, sfidat tona janë

reale, të tregojmë leverdinë e të shkruarit në inxhinieri. Nëpërmjet një shkrirje të plotë të procesit të shkrimit në programin inxhinierik, ne mund të përmirësojmë aftësitë teknike të të diplomuarve; t'u sigurojmë atyre një përvojë edukative më të plotë; të përmirësojmë aftësitë komunikuese; të fitojnë një mjet vlerësimi të fuqishëm. Si pedagogë të gjuhës angleze të profesionit, ne kemi kontroll mbi mënyrën si është perceptuar shkrimi. Hapi më i mirë që mund të marrim është të tregojmë, me anën e veprimeve tona, se besojmë në rëndësinë që ka një mënyrë e mirë, e qartë dhe e saktë shkrimi. Ky hap është i nevojshëm nëse duam që studentët tanë ti kushtojnë vëmendje shkrimeve të tyre dhe si rrjedhim të korrin atë që kanë mbjellë.

Mund të ndodhë që shumë studentë të inxhinierisë elektronike nuk do të mbeten inxhinierë. Të mësuarit gjatë gjithë jetës u jep atyre mundësinë të zgjedhin një profesion tjetër, ndoshta juridik apo mjekësi, të tjerë mund të zgjedhin të bëhen sipërmarrës, shumë të tjerë do të punësohen në industri, të cilët marrin inxhinierë të diplomuar, jo për shkak të dijeve teknike specifike, por më shumë sepse konsiderohen si individë inteligjentë, të motivuar, të gatshëm dhe të aftë për të mësuar. Atëherë arsyeja me imponuese që pedagogët që japin gjuhën angleze të profesionit në fakultetet e inxhinierisë të ndërmarrin këtë hap që lidhet me faktin se të shkruarit është një mjet efektiv për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Të shkruarit është një mjet i vlefshëm mësimor, e në qoftë se e injorojmë këtë mjet, ashtu siç ndodh tani në degët e tjera të fakulteteve të inxhinierive në UPT, studentët privohen nga një përvojë kaq e rëndësishme dhe formuese për karrierën e tyre. Për shumë studentë, procesi i zbulimit të dijeve nëpërmjet të shkruarit mund të jetë mes aftësive më të rëndësishme të fituara gjatë gjithë karrierës së tyre studentore.

Në kapitullin e pestë dhe të fundit të punimit tonë jemi marrë me problemet që hasin studentët në përfitim e fjalorit dhe leximin e teksteve teknike. Theksi u vu në përzgjedhjen e teksteve origjinale, jo shumë të ngarkuar me terma shkencorë si dhe në mënyrën e të punuarit me një tekst shkencor. U dhanë disa mënyra të përvetësimit të fjalorit dhe ushtrime e praktika të ndryshme të zbatuara në auditorë me studentë.

Ky kapitull trajtoi në mënyrë të detajuar dhe studiuar analizën e metodës në përdorim duke nxjerrë në pah pikat e saj të forta dhe të dobëta. Konkluzionet na çuan në atë që na duhet një metodë e cila ti ketë të përfshira të katër aftësitë bazë por të përfshihet edhe gramatika në tekst. Të ketë metodë ekskluzive për çdo fakultet dhe shtrirja e gjuhës së huaj të jetë përgjatë vitit të tretë të studimeve për arsye se studentët njihen më mirë me gjuhën teknike dhe e kanë më të thjeshtë përshtatjen në gjuhën shqipe të termave teknik.

Pyetjes Në çfarë kriteresh duhet përzgjedhur metoda në mënyrë që të plotësojë të gjitha nevojat e studentëve?

Studimi zbuloi se zotësia në anglisht është serioze dhe duhet të trajtohet urgjentisht. Kjo është për shkak se, si në shumë vende, edhe në Shqipëri, gjuha angleze, është një kërkesë thelbësore në fushën akademike dhe vendin e punës. Përveç kësaj, kurset e gjuhës angleze të marra nga ana e studentëve të FTI-së nuk i kanë mundur atyre që të përdorin anglishten në mënyrë efektive. Kështu, studentët, kanë nevojë për ndihmë në bazë të nevojave të tyre dhe dëshirave. Të kënaqesh nevojat dhe interesat e studentëve ndikon shumë në motivimin e tyre për të mësuar dhe për të qenë të suksesshëm. Përfshirja e studentëve në hartimin e kurseve të ESP-së vetëm do të rrisë interesin dhe motivimin e tyre

për të nxitur aftësitë e të menduarit kritik; t'i bëjë ata të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme gjuhësore me entuziazëm dhe të japin rezultat në mësimin efektiv. Një hap i tillë do të bëjë të kënaqshëm procesin mësimdhënie/mësimnxënie dhe të hapë rrugën për arritjen e objektivave të kursit. Këto pretendime nxjerrin në pah një domosdoshmëri për të hartuar një program mësimor të ri për të përmbushur nevojat e studentëve. Kështu rekomandimet në vijim mund të ndihmojnë në hartimin e një kursi të gjuhës angleze për studentët e elektronikës në UPT:

1. Nevojat e perceptuara duhet të përkthehen në terma pedagogjikë. Me fjalë të tjera, kur të programohet kursi i gjuhës angleze, ne, si pedagogë të ESP-së duhet të marrin në konsideratë nevojat e studentëve duke u fokusuar në të gjitha aftësitë gjuhësore, e veçanërisht më shumë të vihet theksi në përdorimin e gjuhës së folur dhe analizës së teksteve teknike.
2. Programi nuk ka nevojë për t'u ri-ngritur, por do të ishte më mirë të ndryshohej për t'iu përshtatur nevojave të studentëve. Ai duhet të përputhet me atë që studentët mësojnë, me atë që ata do të përballen në fushat e tyre akademike dhe profesionale.
3. Një program elementar apo i ndërmjetëm do të jetë më i përshtatshëm për të përmbushur nivelin e aftësisë së studentëve. "...duhet që studentët të marrin të dhëna të kuptueshme në gjuhën angleze; të dhëna të cilat ata mund t'i kuptojnë...".
4. Nevojave të studentëve, vështirësive dhe motivimit i duhet dhënë më shumë vëmendje teksa hartohet një kurs ESP-je.
5. Kohëzgjatja dhe numri i kurseve duhet të rritet në mënyrë që Anglishtja të bëhet një kurs themelor në FTI.

Për të përmbledhur, studimi aktual hulumtoi nevojat e gjuhës angleze të studentëve të inxhinierisë elektronike, telekomunikacion dhe informatikë. Në kryerjen e një hulumtimi të analizës së nevojave të studentëve, do të ndihmonte në identifikimin e përgjithshëm për nevojat specifike të gjuhës, të cilat mund të adresohen në zhvillimin e qëllimeve, objektivave dhe përmbajtjen e një programi gjuhësor dhe të sigurojë të dhëna të cilat mund të shërbejnë si bazë për shqyrtimin dhe vlerësimin e një program ekzistues.

Si e tillë, përveç identifikimit të nevojave të studentëve, rezultatet tregojnë se kursi i tanishëm i gjuhës nuk është i mjaftueshëm në kohë për studentët dhe për rrjedhojë ka dhe mangësi të cilat u shfaqën edhe në pyetësorë. Shpresohet se rezultatet dhe rekomandimet e këtij studimi mund të shërbejnë si udhëzues se për çfarë duhet të bëhet në rishikimin dhe ri-zhvillimin e kurrikulit të ESP-së të ofruar për studentët e FTI-së në UPT.

PERSPEKTIVA PËR KËRKIME TË MËTJESHME

Në këtë studim ne u përpoqëm që të nxjerrim në pah disa aspekte të rëndësishme të ESP-së, duke u fokusuar kryesisht në hartimin e materialeve të ESP-së. Sigurisht që ne nuk pretendojmë që ti kemi dhënë zgjidhje të gjitha problemeve të cilat prekin kurset e ESP-së, por u përpoqëm të sjellim disa nga problemet të cilat prekin studentët dhe pedagogët të cilët janë të përfshirë në programet e ESP-së. Koha e vënë në dispozicion për mësimin e kursit të gjuhës së huaj është tepër e shkurtër, gjë që çon në mosplotësimin e të gjitha qëllimeve dhe objektivave të kursit duke i lënë të cingura dijet e përfutuara nga studentët. Studentët të cilët bëjnë anglishte për qëllime të veçanta, e shohin gjuhën si mjet për të plotësuar qëllimet e tyre akademike dhe për rrjedhojë ata kanë nevojë për një anglishte teknike në mënyrë që të shmangin izolimin nga zhvillimet shkencore të bëra nga shtete të tjera në mbarë botën.

Kështu që, është e rëndësishme që të balancohen të gjithë faktorët të cilët përfshihen në procesin e mësimdhënies. Për më tepër, sigurimi i materialeve shitesë, të përgatitura nga vetë pedagogët, duhet të vihen në përdorim nga studentët. Ato duhet të jenë materiale të përzgjedhura nga zhvillimet e fundit të teknologjisë, të jenë interesante, tërheqëse, ku studentët të mund të përfitojnë fjalorin e duhur për degën në të cilën ata studiojnë. Gjuha duhet parë si mjet komunikimi dhe duhen përfshirë materiale të atilla që nxisin pjesëmarrjen e studentëve në procesin e interpretimit të kuptimit si dhe debatit.

Ne me bindje themi se mësimi i gjuhës së huaj për qëllime të veçanta është bërë një nevojë e kohës dhe kërkon një vëmendje të veçantë. Qëllimi është për të plotësuar nevojat më të plota të studentëve ose publikun e specializuar me mjete praktike dhe ekonomike. Kjo përzgjedhje gjithashtu ndryshon në varësi të një pjese të realitetit që është marrë si objekt studimi, sepse çdo fushë e jetës e ka fjalorin e vet dhe mënyrën e konceptimit të realitetit.

Përzgjedhja e materialit dhe përpunimit të gjuhës për qëllime të caktuara, kërkon ndërtimin e një pedagogjie të veçantë të mësimdhënies së gjuhës angleze bazuar në interes të publikut dhe të atyre që ndjekin këto kurse.

Në pedagogjinë bashkëkohore, mësimi i një gjuhe të huaj është qëllimi përbushjes së një qëllimi të veçantë.

Unë jam shumë e sigurt se ne, si mësues dhe kërkues do të bëjmë më të mirën e mundshme drejt mësimdhënies e në veçanti ESP-së, në mënyrë që të kemi studentë të suksesshëm të cilët do mund t'ia dalin mbarë në karrierën e tyre të ardhshme.

